



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE**

**ASPEKTE TË HUAZIMEVE ME ORIGJINË ANGLO-SAKSONE NË GJUHËN E FOLUR
SHQIPE DHE NË MEDIAT SHQIPTARE NË MAQEDONI DHE KOSOVË**

(Punim në kërkim të gradës shkencore “Doktor” në Shkencat Gjuhësore)

Përgatiti :

MA. Agron ZEQRIRI

Udhëheqës shkencor :

Prof. dr. Viktor RISTANI

TIRANË, 2013



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE**

**ASPEKTE TË HUAZIMEVE ME ORIGJINË ANGLO-SAKSONE NË GJUHËN E
FOLUR SHQIPE DHE NË MEDIAT SHQIPTARE NË MAQEDONI DHE KOSOVË**

(Punim në kërkim të gradës shkencore “Doktor” në Shkencat Gjuhësore)

Komisioni:

Prof. Asoc. dr. Elida Tabaku.....(Kryetar)

Prof. dr. Raul Lilo..... (Oponent)

Prof. dr. Sami Ibrahimimi.....(Anëtar)

Prof. Asoc. dr. Shpresa Rira.....(Oponent)

Prof. dr. Brikena Kadzadej.....(Anëtar)

Përgatiti :

MA. Agron ZEQRIRI

Udhëheqës shkencor :

Prof. dr. Viktor RISTANI

TIRANË, 2013

Në vend të parathënies

“Gjuha është aq e rëndësishme, sa nuk mund të lihet vetëm në dorën e gjuhëtarëve. [...] “Gjuha është institucion i institucionëve”. (*Martin Heidegger*)

“Dëshmitë e qytetërimit të një populli janë: a) sjellja me pemët; b) sjellja me fëmijët dhe pleqtë; c) sjellja me gjuhën. Por gjuha mbetet më e rëndësishmja. Detyra e tij është që ta ruajë dhe ta lëvrojë atë si vlerë kulturore dhe si tipar identiteti”. (*Erwin Chargaff*)

“Gjuha Shqipe është mjeti i vetëm i ndriçimit dhe i përparimit moral. Për shkak të fuqisë dhe bukurisë që ka, ajo duhet të jetë krenaria e folësve të saj, si dhe mjeti i shenjtë për zhvillimin kulturor dhe intelektual të kombit të lashtë shqiptar”. (*Holger Pedersen*)

“Kurrë nuk kemi të drejtë të quhemi komb i qytetëruar, sado që të mësojmë gjuhë të huaja, sepse kombi nuk qytetërohet vetëm me mësimin e gjuhëve të huaja, por me mësimin e gjuhës së vet”. (*Filip Shiroka*)

“Gjuha shqipe ka aq pasuri fjalësh dhe është e ardhshme e plot gjallëri e jetë, sa mund të përkthehen në të klasikët e çdo kombi, e çdo kohe”. (*Gjergj Fishta*)

“Fjala e huaj në gjuhë është si dhia ndër dhen”. (*Naim Frashëri*)

“Zot! Jepu shqiptarëve vullnët dhe logjikë që të flasin shqip, të paktën kur janë në Shqipëri. Se, siç kanë zënë disa, shpejt a vonë do ta bëjnë atdheun Babiloni gjuhësh, ku s’do ta marrë vesh qëni të zonë”. (*Nonda Bulka*)

“Mbrotjtja e gjuhës është detyrë dhe peng nderi për çdo shqiptar”. (*Gjovalin Shkurtaj*).

“E mjera shqipe, ç’i punojnë e s’ka gjuhë të ankohet!” (*Tajar Zavalani*)

PASQYRA E LËNDËS

Në vend të parathënies.....	iii
PASQYRA E LËNDËS.....	iv
Falenderime	vi
HYRJE	vii
0. 1. Përlijgja e temës	vii
0. 2. Objekti i studimit dhe hipotezat e tij.....	vii
0. 3. Metodologjia dhe struktura e punimit	xii
Kreu i parë: Veçori të gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze	1
1. 1. Përhapja e gjuhës shqipe.....	1
1. 2. Origjina e gjuhës shqipe.....	1
1. 3. Kontaktet gjuhësore. Kontakti i shqipes me gjuhët e tjera.	5
1. 4. Fillimet e shkrimit të gjuhës shqipe	12
1. 5. Dialektet e gjuhës shqipe	15
1. 6. Njësimi i gjuhës shqipe	15
1. 7. Veçori tipologjike të shqipes së sotme të njësuar	17
1. 8. Përhapja e gjuhës angleze	18
1. 9. Origjina e gjuhës angleze	22
1. 9. 1. Statusi i sotëm i gjuhës angleze.....	23
Kreu i dytë: Roli i fjalëformimit në pasurimin e gjuhës	25
2. 1. Vendi dhe roli i fjalëformimit në gjuhësinë shqiptare.....	25
2. 2. Fjalëformimi dhe trajtimi i tij teorik në gjuhësinë shqiptare.....	26
2. 3. Fjalëformimi sipas literaturës teorike gjuhësore	27
Kreu i tretë: Huazimet – Anglicizma në gjuhën shqipe, si gjuhë marrëse	30
3. 1. Përkufizimi	30
3. 2. Shtresimet e gjuhës së gjallë. Shtresimet e anglicizmave sipas grup-moshave.	39

3. 3. Vështrim diakronik i anglicizmave në shqip. Anglicizmat si dukuri e kontaktit gjuhësor.....	46
3. 4. Klasifikimi i huazimeve – anglicizmave.....	48
3. 5. Ndërhyrjet (interferencat) fonike, ortografike, gramatikore dhe leksikore	48
3. 6. Huazimet leksikore. Përshtatjet e anglicizmave.	53
3.7. Fjalorët terminologjikë dhe termat ushtarake në gjuhën shqipe.....	60
3. 8. Standardizimi i terminologjisë së informatikës	65
3. 9. Anglicizma apo joanglicizma? Ndërhyrja e diskutueshme e anglicizmave si të tilla në gjuhën shqipe. Vërshimi i anglicizmave.....	69
Kreu i katërt: Standardi gjuhësor i shqipes në emisionet e lajmeve të Radio-Televizionit (Maqedoni dhe Kosovë).....	88
4. 1. Drejtshqiptimi	88
4.1.1. Mbi zbatimin e parimit fonetik të drejtshqiptimit.....	88
4. 1. 2. Zbatimi i normës lidhur me dukuri të veçanta	89
4. 1. 3. Shqiptimi i pakujdesshëm	89
4. 2. Çështje të stilistikës gramatikore (morfologo-sintaksore)	90
4. 3. Probleme të leksikut dhe të semantikës	91
PËRFUNDIME	94
SHTOJCA 1.....	98
SHTOJCA 2.....	179
BIBLIOGRAFI	182
BIBLIOGRAFI PLOTËSUESE	185

Falenderime

Mirënjohje dhe një falënderim të veçantë për udhëheqësin shkencor të temës Prof. Dr Viktor Ristanin për inkurajimin e vazhdueshëm, për vërejtjet, sugjerimet, opinionet dhe gjithë ndihmesën që më ka dhënë në përgatitjen e këtij punimi. Dëshiroj gjithashtu të shpreh mirënjohjen time më të thellë për të gjithë kolegët e Fakultetit të Gjuhëve të huaja, të departmentit të gjuhës angleze dhe jo vetëm, për mbështetjen morale dhe diskutimet e ndryshme që më kanë shërbyer gjatë punimit tim. Falenderoj me respekt të veçantë të gjithë profesorët dhe pedagogët e Fakultetit filologjik në Universitetin Shtetëror të Tetovës për mbështetjen e vazhdueshme. Mirënjohje të thellë për familjen time e cila më ka mbështetur gjithmonë.

HYRJE

0. 1. Përligjja e temës

Në kushtet e ballafaqimit të shqipes me gjuhët e tjera që ushtrojnë trysni mbi kodin gjuhësor të shqiptarëve, duke sjellë pa dyshim pasurim edhe të gjuhës, vihen re dhe dukuri negative që cenuan prestigjin e standardit dhe ulën kujdesin për kulturën e gjuhës në të gjitha rrafshet e përdorimit të saj publik. Nuk është vështirë të vihet re që vendin e parë ndër fjalët e huaja, e zënë anglicizmat.

Por, çdo përdorues gjuhe duhet të ruajë veten dhe të tjerët. Pikërisht, nisur nga ky parim, kemi bërë objekt të punimit tonë studimin e veçorive të huazimeve me burim anglo-sakson në gjuhën e folur shqipe dhe në mjetet e informimit masiv nëpërmjet analizës socio-linguistike, duke i vlerësuar :

- *së pari*, si përbërës thelbësorë të ligjërimit gojor dhe të ligjërimit publicistik ;
- *se dyti*, si fusha dhe si faktorë me ndikime të fuqishme gjuhësore, pozitive ose negative, pasuruese ose bastarduese;
- së treti*, si prurje të nevojshme ose të panevojshme të **gjuhës së folur** (nga njerëzit, televizionet dhe radiot) dhe të **gjuhës së shkrimit** (nga gazetatat, përkthimet informative dhe politike).

Pra, qëllimi i këtij studimi lidhet me shkallën e përhapjes së dukurisë në fjalë në rrafshet dhe në trevat e lartpërmendura, me vetëdijen komunikuese të përdoruesve, me qëndrimin ndaj saj. Përfundimet përkatëse janë nxjerrë nëpërmjet vjeljes, shoshitjes dhe shkoqitjes së dëshmimeve të folësve të gjinive, të moshave, të niveleve të ndryshme të arsimit, të cilësisë njohëse të gjuhës angleze, si dhe të anglicizmave të botuara në mjetet e shkruara të informimit masiv.

Mjetet e informimit masiv shfrytëzojnë gjuhën e shkruar, pra, që parapërgatitet në trajtë teksti të gatshëm, dhe gjuhën e folur, domethënë atë që nuk parapërgatitet në trajtë teksti të gatshëm. Megjithatë, pavarësisht nga ky fakt, duhet të mbahet mirë parasysh se gjuha e folur është formë e të shprehurit gjuhësor, e mbështetur në norma të ngulitura dhe e përpunuar deri në caqet e gjuhës së shkruar. Rrjedhimisht, edhe gjatë një bisede, një interviste ose një ligjërate, folësi është i detyruar të zbatojë rregullat themelore të gjuhës së shkruar, duke bërë aq shmangie sa nuk e dëmtojnë aktin e komunikimit, sepse midis gjuhës së folur dhe gjuhës së shkruar nuk mund të krijohet një hendek i gjerë që pamundëson njësimin e përafërt. Përveç kësaj, mbarëvajtja e aktit të komunikimit kushtëzohet edhe nga rrethana jashtëgjuhësore. Rendja me tepri dhe pa kurrfarë kriteri ndaj huazimeve bie ndesh me pasurimin, njësimin dhe ruajtjen e pastërtisë së gjuhës.

0. 2. Objekti i studimit dhe hipotezat e tij

Në këtë punim kemi bërë objekt studimi gjuhën e mjeteve të informimit masiv për disa arsye : si pjesë thelbësore e stilit publicistik, për rolin përhapës të këtyre mjeteve dhe ndikimin e tyre për normëzimin e mëtejshëm të shqipes. Hipotezat thelbësore të punimit lidhen me arsyet e vërshimit të huazimeve (veçanërisht anglicizmat), me tipologjinë e tyre, me përshtatjen e tyre në gjuhën marrëse dhe qëndrimin ndaj tyre. Shtypi i shkruar përbën burimin kryesor të korpusit

tonë.

Dihet se mjetet e informimit masiv në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën e Kosovës, edhe pse të ndodhura përballë pengesave dhe vështirësive të mëdha, kanë krijuar tashmë “thesarin” e tyre të vyer me shkrime, ligjërime dhe kumtime të arrira në drejtim të punës me gjuhën, sidomos për sa i përket zgjedhjes së fjalës së duhur, duke qëndruar larg barbarizmave. Mirëpo, atë e dëmtojnë mjaft shkrime, ligjërime dhe kumtime të mbingarkuara me huazime të tepërta, veçanërisht me anglicizma, ndërkohë që gjuha shqipe i ka mjetet e saj shprehëse. Në këtë mënyrë, ato çenojnë përcjelljen e saktë të thelbit të mesazhit të marrësit, vështirësojnë komunikimin dhe shkaktojnë “plagë” gjuhësore të natyrës leksikore, morfologjike dhe sintaksore.

Për ilustrim, gjejmë përdorime të tilla të shpeshta si: *handikapi i qeverisë* (në vend të “*të metat e qeverisë*”), *divizioni i marketingut* (në vend të “*ndarja e marketingut*”); *violojnë kondicionët e agreementit* (në vend të “*cënohen kushtet e marrëveshjes*”); *Shkupi është investuar direkt në agravimin e situatës* (në vend të “*Shkupi është përfshirë drejtpërsëdrejti në keqësimin e gjendjes*”); *drafti konstitucional* (në vend të “*drafti kushtetues*”); *përsistencë individuale* (në vend të “*këmbëngulje individuale*”), etj.

Po sjellim dhe disa shembuj të tjerë që ndeshen mjaft dendur si: *stafi ka performancë efikase; alokimi i fondeve; Maqedonia vinte pas shokeve deçizive; separacioni fraxhil i Kosovës; stabilitet në oshilacionë; establishmenti i faciliteteve, navigoj dhe çetoj në internet; karaktere të involvuara; bestseller brilant; interlokutor perfekt; paramilitarët serbë suportojnë krimin; evadimi i mbetjeve urbanë; mijëra përformues participuan në paradë; intervensionin human, aksesorë në demtimin e nëtuorkut; relacionët bilaterale nuk dipendojnë nga një nëgociatë politike; risponsibiliteti i premierit; defekt gjenëral; disraport propabil, resurse atraktiv; erozion hidrik; dekonfliktim parcial; topik inovativ; asistuan menaxhimin; interferim spiritual; kompeticion internacional; kapacitetet mobile, certifikimi i bekgraundit lokal; termat e referencës; u signatua nominalisht; intensionët përmanënte; incentiva që jep kabinëti; prohibicion apo përmicion; kontestimi elektoral; maturimi i participuesve; regjion i diversifikuar; Kosova në secesionin linguistik; eskalimi i violencës; nominimi i kandidatit; pollet që bëhen; mjuzikhollet e metropolit; rrugë terciare; presingu i rivalit, depresioni ekonomik; principet e selektimit; risku i maltrajtit; evidenca tangibile; uorkshope irrelevante; konstitucion relevant; margjinat e rotacionit; reverendi dhe ekselencia, bëjmë target gjenëral; ka avancuar indeksin, raport integral; radiacioni i eksplozimit: prevenoi aferën; e fasinueme nga starat; kishte akseptuar ofertën; ligji adoptohet në kushte ekstraordinare; bënifice komplementare; mediacion multilateral; recesioni aktual; impresionë shokuuese; suportuan kërkesat; civilizacion vulnërabël; aparenca eksternale; interkonëksioni i telefonisë fikse; aktorët diplomatikë reprezentues dhe vendet respektive; gjenërojnë kontributet; gjenërozitet ekstrem; administratorë abuzivë; vaniteti mental; prezentatori me reputacion; publikimet luajale; opsion nëutral; asete me importancë; inkompatibilitet privues; i jep suport involvimit; konkluzionë të induktuara; prezantimi i partis, kompatibël me inputet; absorboi ekspëriencë; kondicionohet nga religjioni; ka indiferenca të pasuportueshme; definicion adekuat; previzion temporar; ra në dipendencë totale; lider okult; kredo religjioze; fundamental për adresimin; muzikë laiv dhe plejbek; prioritet maksimal; lobing eventual; stilim me defekte, prospëritet galopues; respektimi i privacisë; amendimi me amendamente; reflektuan pa obsesion; rezidenca presidenciale; insistenca inoçente; advertizimi for fri, opinionist pa integritet; lejdi pa sharm; lançuesi i programit informativ; spikere me luk fals; analist konfidencial i premierit; xhurnalizëm*

kontemporan; thriller monstroz; killer serial; investigim kull; kontinuitet me pauza; etj.

Mirëpo, dëmtimi do të ishte më i vogël – fundja barbarizma të tilla dalin nga përdorimi me rritjen e vetëdijes gjuhësore të përdoruesve – sikur huazimet e panëvojshme, sidomos anglicizmat, të mos përjashtonin fjalë, shprehje dhe ndërtime të qëndrueshme me jetë të gjatë në gjuhën shqipe. Kështu, për shembull, për shkak të cektësisë së njohurive gjuhësore dhe të prirjes për t’u dukur i ”kulturuar”, ”modern” apo ”i ditur” nga ana e disave, po zëvendësohet ”drejtim” me ”menaxhim”; ”përrurim” me ”promovim”; ”ngritje në detyrë” me ”promocion” ose ”avancim”; ”përballim” me ”konfrontim”; ”qejfëz” me ”hobi”; ”sulm” me ”atakim”; ”kryeqytet” me ”metropol”; ”rend” (i ditës) me ”axhendë”, ”bërthamor” me ”nuklear”, ”thelbësor” me ”esencial”; ”kërshëri” me ”kuriozitet”; ”cilësi” me ”kualitet”; ”sasi” me ”kuantitet”; ”kundërshtar”: me ”oponënt”; ”bashkim” me ”union”; ”mirë” me ”okei”; ”arsim” dhe ”arsimim” me ”edukim”; ”ndodhia e ditës” me ”top stori”; ”kryeshfaqje” me ”top show”; ”formim” me ”bekgraund”; ”zbatoj” me ”implementoj”; ”frymëzohem” me ”inspirohem”; ”prehem” me ”relaksohem”; ”shpërndaj” me ”distribuoj”; ”përcaktoj” me ”determinoj”; ”elaboroj” me ”shohit”; ”bujari” me ”gjenërozitet”; ”kushte” me ”kondicionë”; ”këmbëngulje” me ”insistencë”; ”tungjatjeta” me ”tung” dhe ”haj”; ”mirupafshim” me ”baj-baj”; ”linda” me ”isha lindur”; ”më merr malli për ...” me ”më mungon”; ”jam nga ...” me ”vij nga ...”; ”jam i përfshirë në ...” ”jam i angazhuar në ...”; ”rrjedh nga...” me ”derivon nga ...” etj.

Po ashtu, megjithëse në pak raste, në mjetet e informimit masiv në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën Kosovës ndeshen huazime të pavolitshme kuptimore përkthimore, pra, anglicizma, të cilat prishin rrjedhshmërinë dhe bukurinë e ligjërimit sepse futen si mish i huaj në gjedhet e ngulitura të të menduarit shqiptar. Shembujt në vijim janë vërtet shqetësues: ”prodhon pasoja / festë / politikë / art / stabilitet / mentalitet”; ”dorëhiqet kryeministri”; ”bëhet tejet i konsiderueshëm”; ”mbledh guximin”; ”vuajmë mungesa”; ”pedagogë të rekrutuar për universitete”; ”vihet në opërim”; ”oficerët e kredisë”; etj. Këtyre u shtohen kalket e pakuptueshme, të ndërtuara në kundërshtim me gjedhet e fjalëformimit të gjuhës shqipe dhe me kuptimin e gjegjëseve të tyre burimore në gjuhën e huaj, si dhe ndërtimet e gabuara sintaksore dhe semantike, të tilla si: ”multipërforcoj”; ”multiplikatoj”; ”multigrindje”, ”multikulturë”; ”superoj”; ”emeton urrejtje”, ”jam kultivuar atje”.

Ndërkohë, fjalë të huaja ose me përbërës të huaj, të ligjërimit bisedor të përditshëm, zënë vend fare pa nevojë në ligjërimin libror. Për shembull: ”pavarësia e Kosovës pret okein”; ”shqiptarët i thonë baj-baj pushtimit serb”; ”ishte në Hevën”; ”jesmenët prostitutojnë me fjalën”; ”nuk hëngri brekfest”; ”faruelli i tij e pickoi në zemër”; ”gërllfrendi i tij është shumë hot”; etj.

Përveç kësaj sjelljeje të pahijshme gjuhësore, shpesh vërehen këto raste:

(1) **Kur fjala e huaj ose formimi sipas fjalës se huaj – anglicizma – përdoret krahas fjalës shqipe ose formimit shqip, herë me ”dhe”, herë pa ”dhe”.** Për shembull, ”e rrëmbyen dhe kidnëpuan”; ”përgjegjësitë dhe lajabilitetet”, ”pasoja dhe konsekuencat”; ”hendeku dhe gepi”; ”copëzimi dhe fragmentarizimi”; ”hapësira dhe spejci”; ndjeshmëria dhe sensibiliteti”; ”shkarkimi dhe daunlodimi”; ”detyrimet dhe obligimet”; ”helmimet dhe intoksikimet”; ”hyrja, introduksioni”; ”arranxhimi, rregullimi”; indiferenca, mospërfillja”; ”hezitimi, mëdyshja”; ”prononcimi, shqiptimi”; ”ofensivë, mësymje”; ”rehatia dhe komforti”; ”priti dhe simpatike”; ”ambige dhe e dykuptimshme”; ”receptive, marrëse”; ”stabile, e qëndrueshme”; ”timid, i druajtur”; ”spacioz, i bollshëm”; ”nominalisht dhe vetësisht”; ”ekskluzivisht, vetëm”;

“aprokismativisht, përafërsisht”; “ekskluduan dhe përjashtuan”; “spelluan dhe germëzuan”; “refuzuan dhe hodhën poshtë”; “denoncuan, dënuan”; “proklamuan, shpallën”; “bejbi tok, gjuhë foshnjore”; etj.

(2) **Kur fjala e huaj (anglicizmi) përdoret si mjet përforcues sqarues.** Për shembull, “gjithëkohësia, pra, përmanënca”; “zotësia, do me thënë, skilli”; “sforcimi fizik ose eforti”; etj.

(3) **Kur emra të përveçëm shqiptarë shkruhen gabim, sipas burimit të huaj.** Për shembull, “Kosovo” për “Kosovë”; “Ohrid” për “Ohër”, etj.

Duke marrë shkas nga vëzhgimet tona, kemi arritur në përfundimin se, të shumtën e herës, shkaqet e “anglishtizimit” të gjuhës shqipe në ditët tona janë thjesht subjektive. Për këtë mund të përmendim tre shkaqe kryesore:

Së pari, përdoruesit kanë formim të mangët gjuhësor. Ata gjithashtu vuajnë nga mungesa e njohurive të duhura të kulturës së gjuhës, pra, nuk kanë arritur të përvetësojnë normat gramatikore, drejtshqiptimore dhe drejtshkrimore, normat leksikore dhe stilistikore (aftësia për të zgjedhur dhe përzgjedhur fjalën, shprehjen, gjedhën sintaksore në shërbim të komunikimit të frytshëm). Për shembull: “finish” për “përfundim”; “bënitite” për “përfitime”; “hitet” për “më të ndjekurat” ose “më të pëlqyerat”; “startojnë” për “fillojnë, “selektoj” për “përzgjedh”; “nominonj” për “emëronj” ose caktoj”; “apdejtim” për “përditësoj” ose “freskoj” ose “rifreskoj”; “akseleroj” për “përshpejtoj”. Edhe pse të rregullta nga pikëpamja fonetike dhe gramatikore, këto “trillime” janë dëshmi e gjallë e shkeljes së normës leksikore dhe stilistikore, pra, janë barbarizma me burim anglez.

Së dyti, përdoruesit shpalosin qëndrime kozmopolite, prirje për t’u dukur të ditur dhe të mësuar, për t’u mburrur, përpara të tjerëve, ose dëshmojnë pakujdesi, mungesë përgjegjësie.

Së treti, përdoruesit nuk e gjejnë veten të përfaqësuar te roli i shtetit. Kështu, në Republikën e Kosovës, pas shpalljes së pavarësisë kohët e fundit, shteti ndodhet në etapën e krijimit nga e para dhe përballet me shumë sfida, të cilat e lardojnë vëmendjen nga hartimi i politikave të mirëfillta gjuhësore. Ndërkohë, në Republikën e Maqedonisë gjendja paraqitet edhe më e nderë, sepse ende nuk po vihet në zbatim Marrëveshja e Ohrit, megjithëse themelimi, pastaj, njohja zyrtare e Universitetit Shtetëror të Tetovës përbëjnë dy arritje me rëndësi mbarëkombëtare në mjaft drejtime, sidomos në ato që lidhen me ruajtjen, mbrojtjen dhe pasurimin e gjuhës shqipe. Edhe në Republikën e Shqipërisë, “teorikisht, duket se shteti ka një politikë gjuhësore që u përgjigjet kërkesave objektive të zhvillimit, të pasurimit e të pastrimit të mëtejshëm të gjuhës standarde shqipe, përderisa Kushtetuta e Shqipërisë, me një nën të posaçëm merr në mbrojtje trashëgiminë kulturore dhe gjuhën kombëtare. Por, praktikisht, na duket sikur shteti ose nuk e ka autoritetin e duhur, ose nuk pyet për gjuhën, përderisa nuk e shohim ta institucionalizojë e as ta vlerësojë sadopak mendimin shkencor por edhe publik për ta ruajtur e çuar më tej pastërtinë e gjuhës sipas parimeve e kriterëve shkencore, përderisa shteti e bën një sy qorr e një vesh të shurdhër për emërtime shitoresh e veprimtarish, për reklama e tabela, për etiketa, për fjalën angleze “open” pas fjalës shqipe “hapur” në dyer dyqanësh, sikur në Shqipëri të kishte dygjuhësi, përderisa vetë veprimtaria shtetërore që jepet për t’u pasqyruar në mjetet e informimit masiv e vetë botimet e shtetit lënë një shije jo fort të këndshme në punë të përdorimit të fjalëve të huaja, përderisa shteti ende nuk ka vendosur me ligj redaktorin gjuhësor”.

Fjalët e huaja të panëvojshme – anglicizmat – në mjetet e informimit masiv nuk i kërkon as *ligjërimi i ngritur* (për shembull, “falënderojmë sponsorët”; “mori lidërshtipin e radhës”, “përformuan lirshëm”; “top modelja ka menduar të pozojë nudo”; “është arrestuar në aeroportin londinëz”; “në uebsajtin e saj”; “triangël i çuditshëm”; “rreshtim bipartizan”; “nën promocionin e politikës”; “nëpërmjet e-maileve”; “nonsensi i marrëveshjes”), as *ligjërimi i përditshëm* (për shembull, “larje perfekte”; “hyrja fri”; “paguani kesh”; “para një billdingu”; “inëkzistenca e koshave të plehrave”; “festival badi-billdingu”; “ishte fer në ato që tha”).

Këto fjalë të huaja – anglicizma – janë mjaft të dëmshme për shëndetin e gjuhës shqipe sepse:

1. Si rrjedhojë e pabarazisë diturore të marrësve (lexuesve, dëgjuesve, shikuesve), sidomos në lëmin e anglishtes, mes njëri-tjetrit, nga njëra anë, dhe mes dhënësve (folësve, shkruarësve), nga ana tjetër, pamundësohet kumtimi, qartësia dhe kuptueshmëria e komunikimit të ndërsjellët.
2. Duke qënë pasuri më së shumti të stilit libror, dhe të tilla tingëllojnë kur krahasohen me gjegjëset vendase, ato e “trashin” gjuhën.
3. Me gjithë detyrën parësore të mjeteve të informimit masiv për të mbuluar të gjitha fushat e jetës në përputhje me ëndjet e rretheve të ndryshme të lexuesve, të dëgjuesve dhe të shkruarësve, ku nuk mund të shmanget plotësisht intelektualizimi i gjuhës si mjet pasqyrimi i vlerave dhe arritjeve të qytetërimit botëror, prapëseprapë, ato i përdorin fjalët e huaja – anglicizmat – me denduri të njëjtë në tekste shumë të përveçme, në tekste të natyrës shkencore-popullarizuese, si dhe në tekste, emisionë etj. të zakonshme; nuk gjejnë fjalë dhe formime shqipe ose kalke të zbërthyeshme, të shkoqitshme nga pikëpamja e gjedheve kuptimore dhe fjalëformuese; kanë shkëputur lidhjet me gjuhën e gjallë të popullit dhe nuk shfrytëzojnë atë, as frytet e shëndosha të autorëve të shquar shqiptarë.
4. Ato shkaktojnë “kalbje” të gjuhës së mjeteve të informimit masiv dhe e burokratizojnë atë.
5. Duke keqpërdorur aftësinë e gjuhës shqipe për përvetësimin e fjalëve të huaja – anglicizmave – mjetet e informimit masiv u hapin rrugë “ardhjeve” të tjera fare të panëvojshme, pa ua matur vlerat në lidhje me komunikimin ndërshqiptar.
6. Ngjyrimet e tyre vlerësuese-emocionuese nuk përputhen me ato të gjegjëseve përkatëse në gjuhën shqipe.
7. Ato çojnë në krijimin e dysoreve, kuptimisht të tkurrura, të fjalëve shqipe.
8. Përmes shtimit të numrit të tyre sipas qejfit të gjithsecilit, thyhen standardet, shkelen normat leksikore dhe stilistikore të gjuhës shqipe, “thahet” shprehësia, pëson plasaritje palca e identitetit kombëtar.

Pikërisht në këtë hulli dhe pa mbajtur qëndrime të njëanshme puriste, kemi shtjelluar përdorimin dhe shpërdorimin e fjalëve të huaja – anglicizmave – në mjetet e informimit masiv në

Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën e Kosovës, duke vënë fillimisht në dukje vlerat e gjuhës shqipe, të përfuara në rrjedhën e shekujve, përpjekjet e pareshtura, për ruajtjen, mbrojtjen, pastrimin dhe pasurimin e saj, si dhe duke pasur parasysh të vërtetat e mëdha se ato ushtrojnë ndikim të jashtëzakonshëm në mësimin dhe edukimin e marrësve me kulturë gjuhësore, se pajisin fëmijët tanë të sotëm me fjalorin e së ardhmes, se “të çmendësh” gjuhën do të thotë t’i përgatitësh varrin, sidomos në kushtet aktuale të globalizmit.

0. 3. Metodologjia dhe struktura e punimit

Ky punim përbëhet nga katër kapituj. Në kapitullin e parë do të pasqyrojmë disa nga veçoritë kryesore të gjuhës shqipe dhe asaj angleze. Mund të veçojmë këtu : origjinën dhe përhapjen e tyre, rolin e kontakteve gjuhësore në shtimin e huazimeve (aktualisht gjuhët japin e marrin si kurrë ndonjëherë) dhe njësimin e tyre.

Në kapitullin e dytë do të ndalemi te rëndësia e sistemit fjalëformues në pasurimin e leksikut të gjuhës. Dihet që leksiku, në dallim nga rrafshet e tjera gjuhësore, përbën një sistem tepër të hapur të gjuhës dhe të variantit të saj të standardizuar. Huazimi përbën aktualisht një nga mënyrat më aktive në gjuhën shqipe.

Më pas, në kapitullin e tretë do të ndalemi më hollësisht në huazimet-anglicizma dhe problemet që ato ngërthejnë. Do të analizojmë shtresimin e huazimeve-anglicizma sipas grup-moshave, tipologjinë e tyre, përshtatjen e tyre në gjuhën marrëse etj. Në kapitullin e fundit do të trajtojmë standardin e shqipes në lajmet dhe Radio-Televizionet e Maqedonisë dhe Kosovës, si edhe problematikën që sjell përdorimi i huazimeve.

Për hartimin e studimit tonë do të mbështetemi gjërësisht në literaturën e huaj dhe vendase. Analiza do të jetë përshkrimore dhe analitiko-sintetike.

Kreu i parë: Veçori të gjuhës shqipe dhe gjuhës angleze

1. 1. Përhapja e gjuhës shqipe

Gjuha shqipe flitet në Shqipëri, në Republikën e Kosovës, në Republikën e Maqedonisë Përqendimorë (brenda territorit ndërmjet Shkupit, Gostivarit, Tetovës dhe Dibrës), në Republikën e Serbisë (Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë), në Republikën e Malit të Zi (Krajë, Ulqin me rrethina deri në Tivar, Tuz e rrethinat e tij deri në Podgoricë, Hot, Grudë, Plavë e Guci), pra, në viset përqendimorë të Ballkanit, aty ku kryqëzohen rrugët që lidhin Lindjen me Përqendimin, pikërisht në djepin e qytetërimit antik evropian.

Gjuha shqipe flitet gjithashtu në diasporë (Republika e Italisë, Republika e Greqisë, Republika e Bullgarisë, Republika e Ukrainës, Republika e Turqisë) dhe në shumë vende të tjera të kontinentit tonë e më gjerë (Amerikë, Azi dhe Australi) nga shqiptarët e vendosur atje në kohë të hershme ose të vonshme.

Gjuha shqipe futet në familjen e gjuhëve indoevropiane. Ajo formon një degë më vete në këtë familje gjuhësore dhe nuk ka lidhje prejardhjeje me asnjërën nga gjuhët e sotme indoevropiane. Shpirti indoevropian i gjuhës shqipe, përkatësia e saj në familjen gjuhësore indoevropiane, u përcaktua dhe vërtetua diku në mesin e shekullit XIX, nëpërmjet studimeve të gjuhësisë historike krahasuese.¹

Në sajë të punës së njërës nga themeluesit kryesorë të këtij drejtimi gjuhësor, dijetarit të njohur gjerman Franz Bopp-i, u vërtetua me metoda shkencore përkatësia e gjuhës shqipe në familjen gjuhësore indoevropiane. Lidhur me këtë çështje, ai shkroi një vepër të veçantë me titull “Ueber das Albanësische in scinën verwandtschaftlichen Beziehungen”, që u botua më 1854.

Gjuhët indoevropiane ndahen në dy grupe: në gjuhë lindore ose *satem* dhe në gjuhë përqendimorë ose *kontum*; ndërkohë gjuha shqipe bën pjesë në grupin e gjuhëve lindore ose *satem*, së bashku me gjuhët indoiranike, gjuhët balto-sllave dhe armenishten.

1. 2. Origjina e gjuhës shqipe

Origjina e gjuhës shqipe është një nga çështjet tejet të debatuar të shkencës gjuhësore. Ajo buron prej njërës nga gjuhët e lashta të Gadishullit të Ballkanit, ilirishtes ose trakishtes. Në literaturën gjuhësore qarkullojnë dy teza themelore për origjinën e gjuhës shqipes: teza e origjinës ilire dhe teza e origjinës trake. Teza ilire ka gjetur mbështetje më të gjerë historike dhe gjuhësore. Ajo është formuar që në shekullin XVIII në rrethet e historianëve.

Përpjekjen e parë shkencore për të shpjeguar origjinën e shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre,

¹ J.Gjinari, Xh. Shkurtaç, *Dialektologjia*, SHBLU, Tiranë, 2003, f.258

e bëri historiani suedez, Hans Erich Thunmann-i, në veprën e tij “Undersuchunger liber di Geschichte der Östlichen europäischen Völker”, që u botua në Lajpcig më 1774. Duke u mbështetur në burime historike latinë e bizantinë dhe në dëshmi gjuhësore e onomastike, ai arriti në përfundimin se shqiptarët janë vazhduesit autoktonë të popullsisë së lashtë ilire, e cila nuk u romanizua, siç ndodhi me popullsinë trako-dake, paraardhëse të rumunëve.

Teza e origjinës ilire të shqiptarëve është mbështetur nga albanologu i mirënjohur austriak, Johannas Georges von Hahn-i, në veprën e tij “Albanësische Studien”, që u botua më 1854.

Që asokohe deri në ditët tona, mjaft dijetarë të shquar, historianë, arkeologë e gjuhëtarë, duke plotësuar njëri-tjetrin, kanë sjellë një sërë arsyesimesh historike dhe gjuhësore, që mbështesin tezën e origjinës dhe të shqiptarëve dhe të gjuhës së tyre. Disa nga këto arsyesime janë:

1. Shqiptarët vazhdojnë të banojnë në një pjesë të trojeve, ku në periudhën antike kanë banuar fise ilire; nga ana tjetër, burimet historike nuk japin asnjë informacion për ndonjë shpërngulje të mundshme të shqiptarëve nga vise të tjera për t’u vendosur në trojet e sotme.
2. Një pjesë e elementeve gjuhësore: emra sendesh, fisesh, emra njërëzish, glosa, etj., që janë pranuar si ilire, shpjegohen vetëm përmes gjuhës shqipe.
3. Trajtat e toponimeve të lashta të trojeve ilire shqiptare, të krahasuara me trajtat e tyre gjegjëse të sotme, vërtetojnë se ato janë zhvilluar në përputhje me rregullat e fonetikës historike të gjuhës shqipes, domethënë, kanë kaluar pa ndërprerje nëpër gojën e një popullsie shqipfolëse.
4. Marrëdhëniet e gjuhës shqipes me greqishten e vjetër dhe me latinishten, tregojnë se e para është formuar dhe zhvilluar në fqinjësi me këto dy gjuhë, këtu në brigjet e Adriatikut dhe të Jonit.
5. Gjetjet arkeologjike së bashku me ato të kulturës materiale e shpirtërore dëshmojnë se ka vijimësi kulturore nga ilirët antikë të shqiptarët e sotëm.

Nga të gjithë këto arsyesime, të parashtruara në mënyrë të përmbledhur, del se teza e origjinës ilire e gjuhës shqipe është teza më e qëndrueshme dhe më e besueshme nga pikëpamja historike dhe gjuhësore.

Burimet elektronike shprehen si më poshtë në lidhje me origjinën e gjuhës shqipe:

“Me gjithë praninë e disa pikave të ngjashme në strukturë dhe fonetikë, gjuha shqipe është krejt e veçantë, e dallueshme nga gjuhët që fliten nga kombet fqinjë. Kjo gjuhë është veçanërisht interesante si përfaqësuesja e vetme e mbijetuar e grupit të gjuhëve të ashtuquajtura thrako-ilire që formonin gjuhën e lashtë të banorëve të Gadishullit të Ballkanit. Megjithatë, për shkak të mungesës së monumenteve letrare të herëshme, analiza e saj paraqet vështirësi të mëdha dhe nuk arrihet dot në një përfundim të saktë për sa i takon formave të saj më të herëshme dhe zhvillimeve të saj më të herëshme. Gjatë rrjedhës së kohrave, gjuha shqipe është mbarsur me një numër të madh fjalësh të huaja, kryesisht nga greqishtja e vjetër dhe latinishtja, të cilat janë më të reja se gjuha shqipe, por ka disa tregues të sigurtë se gjuha e lashtë ilire ka ushtruar një shkallë

të caktuar ndikimi mbi zhvillimet gramatikore të gjuhëve që fliten sot në Gadishullin e Ballkanit.” (<http://www.albanian.com/main/history/origins.html>), [8 Nëntor 2001].

Shqipja është një gjuhë e dokumentuar vonë. Mungesa e dokumentacionit e vështirëson gjurmimin e origjinës së saj. Ajo është pranuar shkencërisht që në fillim të shekullit XX se është anëtare e familjes indo-evropianë. Shumë filologë e gjuhëtarë albanologë janë marrë me origjinën dhe zhvillimet e saj. Baugh dhe Cable (1981:25) shkruajnë për gjuhës shqipe:

“Në veripërëndim të Greqisë në bregdetin lindor të Adriatikut është ‘dega’ e vogël që quhet shqip. Ka mundësi që të jetë mbetje modernë e ilirishtes, një gjuhë që flitej në kohëra të lashta në Ballkanin veri-përëndimor [. . .]. Njohuritë tona për shqipen, përveç pak fjalëve, kthehen mbrapa në kohë vetëm deri në shekullin XV të kohës sonë [. . .]. Më parë ajo klasifikohet në grupin helenik, por qysh në fillim të shekullit tonë ajo është njohur si anëtare e pavarur e familjes.”

Fakti që gjuha shqipe është njohur si anëtare e familjes indoevropianë përmendet nga Jani Thomai (1999:221), i cili shkruan:

“Gjuha shqipe është një nga gjuhët më të vjetra të Ballkanit. Siç është vërtetuar tashmë përfundimisht, ajo përbën një degë të veçantë të familjes gjuhësore indoevropianë, por nuk ka lidhje birësie me asnjë nga gjuhët e kësaj familjeje, me gjithë afërinë në sistemin gramatikor apo në leksik që ka me to.”²

Fakte të reja rreth origjinës së gjuhës shqipe janë sjellë nga studjuesi shqiptar Moikom Zeqo (7 qershor 2000), ish-drejtor i Muzeut Kombëtar Shqiptar. Ai shkruan në “Gazetën Shqiptare” për një studjues shqiptar, Konda, i cili hodhi dritë mbi origjinën e gjuhës shqipe. Sipas Kondas, Georg Hahn-i, një nga mendjet më të ndritura të shekullit XIX, ishte shkrimtari i parë i cili botoi një korpus të madh studimesh mbi origjinën e gjuhës shqipe. Më 1854 Konda paraqiti një tezë me dy faza që vërteton faktin se shqiptarët janë pasardhësit e ilirëve, ndërsa vetë ilirët janë pasardhësit e pellazgëve.

Historia e Shqipërisë shpaloset pjesë-pjesë. Arshi Pipa (1989:1) shkruan:

“Gjuha shqipe është dokumentuar vetë në histori. Dokumenti i parë i shkruar, i cili është një formulë pagëzimi gegërisht, daton në vitin 1462. Ajo u pasua nga një fragment i “Ungjillit” në toskërisht ndoshta i viteve të fundit të shekullit XV. Teksti i shtypur më i vjetër i takon shekullit XVI; ai është **Meshari i Gjon Buzukut (1555)**, shtypur në dialektin verior të gegërishtes.”³

Këto fakte paraqesin një dukuri deri diku kontradiktore: nga njëra anë, kemi dëshminë e një gjuhe të shkruar vonë në histori, kurse nga ana tjetër, kemi një gjuhë të folur nga një popull autokton qysh në kohëra parahistorike. Studiuesi i parë që zbuloi karakterin indoevropian të

² J.Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2002

³ Po aty.

gjuhës shqipe ishte Franz Bopp në veprën e tij “Mbi shqipen dhe afërsinë e saj me gjuhë të tjera” (Çabej, 1960:5).

Shkrimtari francez Malte Brun thotë se gjuha shqipe është ilirishtja e vjetër, një gjuhë më vete dhe një nga gjuhët më të vjetra të gjuhëve evropiane. Kjo ide u përkrah nga Thunemann-i në *Popujt e Evropës Lindore*, nga Xylander-i i

Bavarisë në *Die Sprache der Albanënsen oder Skipetaren*, si dhe nga studjuesi e udhëtari i famshëm anglez i shekullit XIX William Martin Leake në veprën e tij *Kërkime në Greqi*.

Albanologu austriak Gustav Meyer i Universitetit të Gracit i quan shqiptarët e sotëm “neo-ilir” dhe shkruan:

“Në qoftë se e shqyrtojmë shqipen me kujdes vërejmë se një numër i madh fjalësh janë të ngjashme me ato të grupit indo-gjermanik evropjan: latinishten, greqishten, gjermanishten, keltishten, lituanishten si dhe me përsishten, indishten dhe armenishten, te cilat formojnë grupin indoevropjan. Forma dhe deklensionit (lakimet e zgjedhimet) e fjalëve shqipe kanë karakter indo-gjermanik. Pra, shqiptarët janë indo-gjermanë” (“Laboremus”, Maj 1925).

Siç citohet dhe nga “Laboremus” (Maj 1925, 3), në librin e tij *Die Albanische Sprachwissenschaft*, Paul Kretschmer-i tregon krahasimisht se shqipja është anëtare e grupit indo-gjermanik. Ai e ilustron thënien e tij kështu:

gjuha sanskrite	latinisht	gjermanisht	greqisht	shqip
asti	est	ist	este	Asht, është
dva	duo	zwei	dyo	dy
trayas	tres	drei	tres	tre, tri

Shaban Demiraj (1988:20) e përshkruan gjuhën shqipe si gjuhë të gjallë kështu:

“Një nga gjuhët e gjalla i.e. është edhe shqipja, e cila u ka qëndruar rrebesheve të kohës. Me gjithë trysnitë e forta dhe të gjata të greqishtes, latinishtes, sllavishtes dhe turqishtes ajo i ka ruajtur tiparet e saj thelbësore. Por natyrisht këto trysni të huaja kanë lënë gjurmë, kryesisht në fjalorin e saj.”⁴

Për sa i takon kohës kur shqiptarët përmenden për herë të parë në histori, E. Çabej (1976:26) shkruan:

“Në shekullin e dytë të erës sonë, gjeografi Ptolemeu në Aleksandri të Egjiptit, në hartën e tij botërore përmend për të parën herë fisin Albanoi, në qytetin Albanopolis midis Orestis e Almopërnit, diku në Shqipëri të mesme, midis Durrësit e Dibrës. Nga ky emër fisi ka trashëguar populli shqiptar emrin e tij të vjetër kombëtar **Arbën, Arbënësh, Arberesh**, emër me të cilin e quajnë edhe popujt të tjerë, ital. **Albanësi**, serb. **Arbanasi**, gr. **Arvenites**, etj.”

Që nga ajo kohë e deri në shekullin XI shqiptarët nuk përmenden në asnjë dokument të

⁴ Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, ASHSH, Tiranë, f.63

shkruar. Vetëm në shekullin XI kronikanët bizantinë Mihail Attaliatez dhe princesha Anna Komnëna i përmendin shqiptarët me emrin *Albanon* dhe popullin *Albanoi, Albanitai, Arbanitai*. Ky emër përdoret edhe sot në Shqipërinë e Veriut dhe në kolonitë arbëreshe në Itali. Këto burime nuk japin asnjë informacion për emrat *shqiptar* e *Shqipëri*, të cilët filluan të përdoren për t'iu referuar njerëzve që jetojnë në territoret shqiptare dhe për tokën e tyre pasi u larguan kolonët në shekujt XIV e XV. Autorët e vjetër të Veriut përdorin *Arbën* e *Shqipëri* dhe *arbënësh* e *shqiptar*. Emri i ri u përdor për të emërtuar gjuhën që flitet në këto territore.

“Emri i ri del në literaturë për të shënuar gjuhën, Gjon Buzuku (1555), **qi vjen me thashunë shqip**, Pjetër Budi (1621), **shqiptarët na e thotë**, dhe Pjetër Bogdani(1685), **Nji gramatikë latinisht-shqip**. Mendimi që **shqip** lidhet me emrin e shqipes, duke pasur shqiptarët emrin nga ky shpend, nuk ngjan se është i drejtë pasi te autorët e vjetër **shqip** shkruhet me **“i”**, kurse shpendi shkruhet me **“y” (shqyypja)**.” (1976:27)

1. 3. Kontaktet gjuhësore. Kontakti i shqipes me gjuhët e tjera.

Kontakti gjuhësor është një fushë e linguistikës që ka pasur një interes gjithnjë e në rritje në Evropë dhe Amerikë gjatë dekadave të fundit (Nælde et al 1986:151). Mesthrie (1995:218) e përcakton kontaktin gjuhësor si një marrëdhënie historike që mund të ekzistojë ndërmjet gjuhëve. Gjuhët nuk mund të bijnë në ‘kontakt’ sepse ato janë sisteme të mësuara të sjelljes, por përdoruesit, folësit e tyre mund të bijnë në kontakt me gjuhët e tjera. Ai është i vetëdijshëm për faktin se folësit mund t’i modifikojnë sistemet e tyre individualisht ose në grup në qoftë se njohin një sistem tjetër apo sisteme të tjera. Ai shkruan:

“Kur folësit e gjuhëve të ndryshme ose varianteve të gjuhëve bijnë në kontakt social, në një rast të dhënë një gjuhë (bile dhe me një fjali e vetme) mund të ndikojë mbi një tjetër në mënyrë të përhershme. Sapo një element leksikor (fjalë, morfemë gramatikore, etj.) ka mbushur një boshllëk në gjuhën B ose ka zëvendësuar plotësisht një element, elementi i ri në gjuhën B nuk është më fjalë e huazuar nga folësit.”

Në e shohim këtë zëvendësim kur dy folës, të cilët fillimisht i gjejnë dialektet e tyre respektive të pakuptueshme për njëri tjetrin, mundet që mbrenda pak orëve ose pak ditëve të zbulojnë çelësin e bashkëbisedimit të rrjedhshëm. Siç thotë Weinreich-i (1974:viii), nëse bashkëpunimi është domosdoshmëri e madhe, kushdo mëson mjaft shpejt nga gjuha e tjetrit për të vendosur komunikimin, bile edhe nëse dy mediumet në kontakt nuk kanë kurrëfarë ngjashmërie gjenetike apo sinkronike. Sipas tij, “kontakti kultivon imitimimin dhe imitimi kultivon konvergjencën linguistike”.

Weinreich-i arsyeton se dy ose më shumë gjuhë thuhet se janë në kontakt në qoftë se ato përdoren në mënyrë të ndërsjelltë nga të njëjtët persona. Këto raste të devijimit nga normat e cilëndo gjuhë, të cilat ndodhin në të folurit e bilingualëve si rezultat i njohjes së më shumë se një gjuhe nga ana e tyre, domethënë si rezultat i kontaktit gjuhësor, konsiderohen si fenomenë të interferencës (1974: 1). Sa më i madh të jetë ndryshimi midis sistemeve, domethënë sa më të

shumta në numër të jenë format e modelet ekskluzive të ndërsjellta tek secila, aq më i madh është problemi i të mësuarit dhe potenciali i interferencës (cf. Weinreich, 1974: 44). Në mënyrë mjaft bindëse, Weinreich-u (1974: 11) shpjegon fenomenin e interferencës kur gjuhët janë në kontakt. Ai bën një krahasim të mirë për të shpjeguar se si opëron fenomeni i interferencës:

“Në të folurit, interferenca është si rëre që e merr rryma; në gjuhë, ajo është si rërë e sedimentuar që depozitohet në fundin e liqenit. Në të folurit, ajo ndodh sërish në të shprehurit e folësit bilingual (dygjuhësh) si rezultat i njohjes së tij personale të gjuhës tjetër. Në gjuhë, në shohim se dukuritë e interferencës, të cilat kanë ndodhur shpesh në të folurit e bilingualëve, janë bërë dukuri të rëndomta dhe të konsoliduara.

Kur një folës i gjuhës X përdor një trajtë me origjinë të huaj jo si huazim të çastit, aty për aty, nga gjuha Y, por sepse e ka dëgjuar që është përdorur nga folës të tjerë të gjuhës X, atëherë ky element i huazuar mund të konsiderohet nga pikëpamja përshkruese se është bërë pjesë e gjuhës X.”⁵

Kontakti gjuhësor mund të sjellë ndryshime në secilën gjuhë. Blount dhe Sanches (1977: 6) shkruan: “Gjuhët në kontakt japin raste dramatike të ndryshimeve në strukturën e gjuhëve dhe në përdorimin e tyre. Mbrenda një gjenërate situata e kontakteve mund të shkaktojë dhe shfaqjen e gjuhëve të reja”.

Le t’i referohemi tani kontakteve të shqipes me gjuhët e tjera. Gjatë tërë historisë së saj, gjuha shqipe ka qënë në kontakt me shumë gjuhë të tjera. Kjo mund të shihet nga karakteri i përzier që ka. Kur shkruan për kontaktin gjuhësor dhe konvergjencën gjuhësore, Ilse Lehiste (1986: 61) shkruan:

“Një fushë e konvergjencës gjuhësore e studjuar gjërësisht gjëndet në Gadishullin e Ballkanit. Gjuhët që bëjnë pjesë në Balkan Sprachbund (një situatë e ekzistencës së gjuhëve për një periudhë kohe) u takojnë disa familjeve që kanë lidhje pak a shumë të ngushtë me njëra tjetrën. Tri gjuhë sllave janë anëtare të përbashkëta të Sprachbund-it: bullgarishtja, maqedonishtja dhe dialektet juglindore të serbo-kroatishtes. Gjuhët e tjera kryesore të Sprachbund-it janë gjithashtu indo-evropiane: shqipja, greqishtja modernë dhe rumanishtja.” Të huazuarit kulturor të trajtave të të folurit është zakonisht i dyanshëm. Ai është me një kahje vetëm deri në atë shkallë që një komb ka të japë më shumë se tjetri. Kështu, në periudhën e misionarëve, nga shekulli i shtatë e tutje, anglishtja e vjetër huazonte terma latinë që kishin të bënin me krishtërimin, si *church* „kishë”, *minister* „meshtar”, *angel* „engjull”, *devil* „djall”, *apostle* „apostull”, *bishop* „ipeshkv”, *priest* „prift”, *monk e nun* „murg”, *shrinë* „falëtoare”, *cowl* „mantel me kapuç”, *mass* „meshë” dhe imitonte semantikën latinë nëpërmjet kalkeve, por në atë kohë anglishtja nuk i dha asgjë latinishtes. Gjuhët skandinave përmbajnë shumë terma të tregtisë dhe të detarisë nga gjermanishtja e ulët që datojnë nga epërsia tregtare e qyteteve hansetike në mesjetën e vonë. Po ashtu rusishtja përmban shumë terma të detarisë nga gjermanishtja e ulët dhe nga holandishtja.

Përkundër rasteve si këto, zakonisht mund të bëjme dallim në mes të të huazuarit të rëndomtë kulturor dhe të të huazuarit *intim*, i cili bëhet kur dy gjuhë fliten në të njëjtin komunitet topografik dhe politik. Kjo situatë krijohet në të shumtën e rasteve nga pushtimi, më rrallë nga

⁵ J.Gjinari, *Dëshmi të historisë së gjuhës shqipe për kohën dhe vendin e formimit të popullit shqiptar*, “SF” 4, 1968

migrimi i qetë. Te huazuarit intim është me një kahje: dallojmë gjuhën *superiore* ose *mbizotëruese* që e flasin pushtuesit ose përndryshe grupi më i privilegjuar, dhe gjuhën *inferiore* ose të *ulët*, që e flasin njerëzit e nënshtuar apo si në Shtetet e Bashkuara të Amerikës — emigrantët e përlur. Të huazuarit të shumtën shkon prej gjuhës superiore kah gjuha inferiore, ndërsa shpesh shtrihet në trajta ligjërimi që nuk puqen me risitë kulturore.

Në kontaktin e gjuhëve të emigrantëve me anglishten në Shtetet e Bashkuara të Amerikës shohim një tip të të huazuarit shumë intim. Anglishtja, gjuha superiore, merr nga gjuhët e emigrantëve vetëm huazime kulturore, si *spaghetti* nga italishtja, *delicatessen*, *hamburger* etj. (ose me anë të kalkimit *liver-sausage*, “një lloj qofte”) nga gjermanishtja. Emigranti që në fillim pranon shumë më tepër huazime kulturore. Kur e flet gjuhën e vet burimore, ka rast të tregojë me emrat angleze shumë sende që është mësuar t’i njohë qysh se ka ardhur në Amerikë: *baseball* „bejsboll”, *alderman* „anëtar i këshillit bashkiak”, *boss* „pronar”, *ticket* „biletë” etj. Ai së paku përdor kalke, si në gjermanishte *erste paptere* „dokumentat e para (për nënshtetsim)”. Arsyeja kulturore është më e rrallë në rastet si *policeman* „polic”, *conductor* „konduktor”, *street-car* „tram-vaj” *depot* „stacioni i fundit i trenit”, *road* „rruge”, *fence* „gardh”, *saloon* „salon”, por mund të themi së paku se variantet amerikanë të këtyre gjërave disi dallojnë nga ato evropianë. Mirëpo, në shumë raste nuk u përgjigjet ky shpjegim. Së shpejti pasi të arrijë gjermani atje, vërehet se në të folurit gjermanisht përdor shumë trajta angleze, sikurse *coat* „pallto”, *bottle* „shishe”, *kick* „shqelm”, *change* “ndryshim, kusur”. Ai do të thotë, për shëmbull, *ich hoffe, sie werden's enjoyen* /ih hofə zi: 'verden se en'tsvojen/ „shpresoj se do t’ju pëlqej”, ose *ich hab' einen kalt gecatched* /ih ha:p aj-nən Trait ge'ketst/ „jam ftohur”. Ai bën kalke si, *ich gleich'das nicht* /ih 'glajh das mint/ „nuk më pelqen”, ku sipas modelit të fjalës *like* te anglishtes, folja me kuptimin „pëlqej” është e prejardhur nga mbiemri *gleich* „i barabartë, i ngjashëm”. Disa nga këto lokucionë, si ai i fundit, janë futur në mënyrë konvencionale në gjermanishten e emigrantit në Amerikë. Fazat fonetike, gramatikore dhe leksikore të këtyre huazimeve meritojnë një studim shumë më të thellë se sa është bërë. Caktimi i gjinisë së emrave anglezë në gjermanishte ose skandinavishte është treguar si temë e begatshme për vështrim.

Sfondi praktik i këtij procesi është evident. Gjuhën superiore e flet grupi mbizotërues ose i privilegjuar. Shumë lloje presioni e shtyjnë folësin e gjuhës inferiore ta përdorë gjuhën superiore. Pengesa qesharake dhe serioze e ndëshkojnë mospërsosjen e tij. Duke folur gjuhën inferiore me shokët e vet, ai mund të shkojë aq larg sa të krenohet që mund ta stolisë atë me huazime nga ligjërimi superior.

Në shumicën e rasteve të kontaktit intim, gjuha inferiore është indigjenë, ndërsa gjuha superiore imponohet nga një grup pushtuesish. Këta të fundit shpesh janë pakicë. Të huazuarit rrallë shkon me shpejtësi aq të madhe si në rastin amerikan. Shpejtësia e tij duket se varet nga shumë faktorë. Nëse folësit e gjuhës inferiore kanë kontakt me folësit e po asaj gjuhe të një regjioni të papushtuar, gjuha e tyre do të ndryshojë më ngadalë. Sa më të paktë të jenë pushtuesit aq më i ngadalshëm është hapi i të huazuarit. Një faktor tjetër që e ngadalëson të huazuarit është superioriteti kulturor, i mbrojtur realisht ose konvencionalisht, i një tere të nënshtuar. Madje dhe në mesin e emigrantëve të Amerikës familjet e arsimuara mund ta ruajnë gjuhën gjatë disa brezave duke e përzier fare pak me anglishten.

Duket se po ata faktorë, por me një dallim peshe, më në fund mund të shpien në mospërdorjen (zhdukjen) e njëres apo të tjetres gjuhë. Faktet tregojnë më shumë këtë të dhënë, e më pak të huazuarit si të tillë. Në mesin e emigrantëve në Amerikë shihet se zhdukja, sikur edhe të huazuarit, ecën me shpejtësi të madhe. Nëse emigranti është gjuhësisht i izoluar, nëse shkalla e

tij kulturore është e ulët, ndërsa mbi të gjitha, nëse ai martohet me dikë që flet gjuhe tjetër, mund të pushojë plotësisht së përdoruri gjuhën e vet dhe madje ta humbasë edhe aftësinë për ta folur kuptueshëm. Anglishtja bëhet gjuha e tij e vetme, ndonëse mund ta flasë atë shumë keq, ajo bëhet gjuhë burimore e fëmijëve të tij. Ata ndoshta e flasin atë në fillim me tipare të huaja, por kontaktet e jashtme së shpejti sjellin përmirësime të plota ose gati të plota. Në raste të tjera, emigranti vazhdon ta flasë gjuhën e tij burimore në shtëpi; ajo është gjuhë burimore e fëmijëve të tij, por në kohë të shkollimit ose madje dhe më herët ata pushojnë ta përdorin, ndërsa kur të rriten, anglishtja bëhet gjuha e tyre e vetme. Edhe nëse anglishtja e tyre e ruan një ngjyrë të huaj, ata e njohin pak apo s'e njohin fare gjuhën e prindërve. Bilinguizmi nuk është i shpeshtë. Në rast pushtimi procesi i zhdukjes mund të shtyhet gjatë. Ka gjasa të ekzistojnë një apo më shumë breza të folësve bilingë. Pastaj, në një kohë mund të vijë në brez i cili nuk e përdor gjuhën inferiore në moshën madhore, ndërsa fëmijëve ua përcjell gjuhën superiore.

Gjuha inferiore mund të mbetet e gjallë, ndërsa gjuha superiore të vdesë. Kjo mund të ndodhë nëse pushtuesit nuk janë të shumtë, ose sidomos nëse ata nuk i sjellin gratë me vete. Në rastet jo aq ekstreme pushtuesit vazhdojnë për disa breza ta flasin gjuhën e tyre, por e shohin gjithnjë e më të nevojshme ta përdorin dhe gjuhën e të pushtuarve. Kur njëherë formojnë klasën e lartë fare dygjuhëshe, lehtë mund të ndodhë zhdukja e gjuhës superiore si më pak e dobishme. I tillë ishte fundi i frëngjishtes normanë në Angli.

Konflikti i gjuhëve, pra, mund të marre rrjedha shumë të ndryshme. I tërë territori mund të përfundojë duke folur gjuhën superiore: latinishtja e sjellë në Gali rreth fillimit të erës së re nga pushtuesit romakë, gjatë disa shekujve përdorej në ligjërimin keltisht të galëve. I tërë territori mund të përfundojë duke folur gjuhën inferiore: frëngjishtja normanë e sjellë në anglishte me pushtimin (1066) ishte e pranishme në anglishte gjatë nja treqind vjetësh. Shpërndarja mund të jetë territoriale: kur anglishtja u soll në Britani në shekullin V të erës së re, vepronte në folurit burimor keltik në pjesët e largëta të vjedhëses. Në raste të tilla vijon një luftë gjeografike gjatë kufirit. Në Angli kornishtja u shua rreth vitit 1800, ndërsa gjuhës uelsianë i shembej trolli deri para do kohe.

Mirëpo, në të gjitha rastet, është gjuha inferiore ajo që huazon shumë nga gjuha superiore. Prandaj, nëse gjuha superiore vijon të ekzistojë, ajo mbetet siç ishte, pos me disa huazime kulturore, ashtu siç do të mund të huazonte nga çdo fuqi. Gjuhët romanë kanë vetëm disa huazime kulturore nga gjuhët që fliteshin në atë territor para pushtimit romak. Anglishtja ka vetëm disa huazime kulturore nga gjuhët kelte të Britanisë, ndërsa anglishtja amerikanë vetëm disa fjalë nga gjuhët e indianëve të Amerikës ose nga gjuhët e emigrantëve të shekullit XIX. Në raste pushtimi, huazimet kulturore që mbeten në gjuhën ekzistuese superiore janë kryesisht emra vendesh. Si dëshmi, për shembull, mund të shërbejnë emrat gjeografike të indianëve, si Masagusec, Viskonsin, Mioigen, Ihnoi, Cikago, Milvoki, Oshkosh, Shebojgen, Vokigen, Masikgon. Është interesant të shihet se aty ku anglishtja ka zëvendësuar holandishten, frëngjishten ose spanjishten si gjuhë koloniale, këto të fundit kanë lënë po ashtu shumë gjurmë njësoj si çdo gjuhe tjetër inferiore. Kështu nga holandishtja janë huazimet kulturore, si *colo-slaw* „sallatë me lakra“, *cookie* „biskote“, *cruller spree* „dëfrim“, *scow* „barkë e madhe me fund të sheshtë“, *boss* „patron“, e sidomos emrat e vendeve siç, janë: Shajlkil, Katskil, Harlem, Baueri. Emrat e vendeve japin dëshmi të çmueshme për gjuhët e zhdukura. Në këtë mënyrë një brez i gjerë i emrave gjeografikë në keltishte shtrihet nëpër Evropë nga Bohemia deri në Angli. *Vjena, Parisi, Londra* janë emra kelte. Emrat gjeografikë sllavë shtrihen në Gjermaninë Lindore: Berlin, Lajpcig, Drezden, Breslov

Në anën tjetër, nëse gjuha inferiore mbetet gjallë, ajo i ruan shenjat e luftës në formë të huazimeve të bollshme. Anglishtja me huazimet nga frëngjishtja normanë dhe me shtresën e madhe të fjalëve gjysmë të mësuara (frëngo-latinë) është shembull klasik i kësaj. Beteja e Hastingsut më 1086 e shënon fillimin. Fjalët frënge në dokumentet e shkruara në anglishte duken për herë të parë me të madhe në periudhën prej vitit 1250 deri më 1400. Kjo sigurisht do të thotë se të huazuarit e vërtetë për çdo rast është bërë disa decenie më herët. Rreth vitit 1300 anglezi i klasës së lartë, pa marrë parasysh prejardhjen e tij, ose ishte biling ose së paku e zotëronte mirë frëngjishten. Masa e popullit fliste vetëm anglisht. Më 1362 anglishtja përdorej në gjyqe, ndërsa po atë vit parlamenti u hap në anglisht. Konflikti mes dy gjuhëve i cili zgjati thuajse prej vitit 1100 deri më 1350, duket se nuk kishte ndikuar në strukturën fonetike ose gramatikore të anglishtes, pos në faktin se disa veçori fonetike, si nistoret (v-, z-, j-) dhe shumë tipare të sistemit morfologjik të frëngjishtes u ruajtën në trajtat e huazuara.

Efekti leksikor, megjithatë, ishte i tmerrshëm. Anglishtja huazoi terma të qeverisë (*state* „shtet“, *crown* „kurorë“, *reign* „sundim“, *power*¹ „fuqi“, *country* „vend, shtet“, *people* „popull“, *princ* „princ“, *duke* „duke“, *K da-kess* „dukeshë“, *peer* „për“ (një nga titujt e fisnikërisë në Britaninë e Madhe), *court* „oborr mbretëror“), të jurisprudencës (*judge* „gjyq“, *jury* „juri“, *just* „drejtë“, *sue* „padis“, *plea* „lutje“, *cause* „kauzë“, *accuse* „akuzoj“, *crime* „krim“, *marry* „martohem“, *prove* „provoj“, „argumentoj“, *false* „fals“, *heir* „trashëgimtar“), të luftës (*war* „luftë“, *battle* „betejë“, *arms* „armë“, *soldier* „ushtar“, *officer* „oficer“, *navy* „marinë“, *sienë* „rrethoj“, *danger* „rrezik“, *enemy* „armik“, *march* „marsh“, *force* „force“, *guard* „ruaj“), të religjionit dhe të moralit (*religion* „religjion“, *virgin* „virgjen“, *angel* „ëngjëll“, *saint* „shenjt“, *preach* „predikim“, *pray* „lutem“, *rule* „rregull“, *save* „shpëtoj“, „tempt“ josh, *blame* „fajësoj“, *order* „urdhër“, *nature* „natyrë“, *virtue* „virtut“, *vice* „ves“, *science* „shkencë“, *grace* „bir“, *cruel* „mizor“, *pity* „dëm“, *mercy* „mëshirë“), të gjuetisë dhe të sportit (*leash* „rrip qeni“, *falcon* „skifter“, *quarry* „pre“, *scent* „nuhatje“, *track* „gjurmë“, *sport* „sport“, *cards* „karta, letra“, *dice* „zar“, *ace* „as“, *suit* „kostum“, *trump* „endem“, *partnër* „partnër, ortak“), shumë terma me rëndësi të përgjithshme kulturore (*honor* „nder“, *Glory* „madhështi“, *finë* „delikat“, *noble* „fisnik“, *art* „art“, *beauty* „bukuri“, „color“, „ngjyre“, *figure* „figure“, *paint* „pikturoj“, *arch* „kubë“, *tower* „kulle“, *column* „shtyllë“, *palace* „pallat“, *castle* „keshtjelle“) dhe terma që kanë të bëjnë me ekonominë shtëpiake, ato që shërbetorët i kanë mësuara nga i zoti dhe e zonja e shtëpise (*chair* „karrige“, *table* - tavolinë“, *furniture* „mobile“, *serve* „shërbej“, *soup* „supe“, *fruit* „fruta“, *jelly* „pelte“, *boil-ziej“, fry* „fergoj“, *roast* - skuq, pjek“, *toast* „dolloi“). Në këtë sferë e fundit e hasim kontrastin shpesh të përmendur në mes të emrave burimorë anglezë të kafshëve me thundërr (*ox*, „ka“, *calf* „viç“, *swinë* „derr“, *sheep* „dele“) dhe të emrave të huazuar nga frëngjishtja për mishin e tyre (*beef* „mish lope“, *veal* „mish viçi“, *pork* „mish derri“, *mutton* „mish deleje“). Vlen të thuhet se emrat vetjakë të anglezëve të shumtën janë të prejardhur nga frëngjishtja, si *John*, *James*, *Frances*, *Helen*, duke i përfshirë madje dhe ata që patjetër kanë origjinë gjermanike, si *Richard*, *Roger*, *Henry*.

3. Prania e huazimeve në sferë semantike më të gjerë se të risive kulturore na bën të mundshme ta njohim një gjuhë inferiore që ka mbetur e gjallë, ndërsa kjo njohje hedh dritë jo vetëm në situatat historike, por gjithashtu nga evidenca e vetë huazimeve, në veçoritë gjuhësore të një periudhë të hershme. Shumë informata mbi etapat më të hershme të folurit gjermanik rrjedhin nga huazimet në gjuhët që ndonjëherë ishin nën sundimin e fiseve gjermanisht-folëse.

Me gjithë faktin e njohur se gjuha shqipe është anëtare e familjes indoevropiane, karakteri i saj indoevropian duhet të trajtohet në mënyrë të veçantë. Nga kjo pikëpamje, jo i

gjithë fondi gjuhësor i saj vjen nga fondi i botës indoevropjanë. Në “Fjalorin Etimologjik të Gjuhës Shqipe” (1891), Gustav Meyer konsideron 400 nga 5140 fjalë se janë me origjinë indoevropjanë. Autori nuk e përcakton origjinën e 730 fjalëve të tjera, të cilat më vonë u provuan se janë fjalë me origjinë indoevropiane. Ajo që mbetet, sipas tij, i takon fondit leksikor të greqishtes, latinishtes apo turqishtes. Në këtë mënyrë, ai arriti në një përfundim të gabuar kur e konsideron shqipen si *“përzierje apo gjysëm rumanishte”* duke u bazuar në numra dhe jo në fakte. Megjithatë, fjalët që Meyer-i i konsideron si fjalë që i takojnë familjes indoevropjanë janë koncepte bazë të jetës së përditshme, të cilat përdoren shpesh dhe janë produktive (Thomai, 1999: 228).

Leksikologjia e Gjuhës Shqipe hedh dritë mbi gjendjen e gjuhës shqipe gjatë shekujve. Gjatë shekujve XVI – XVII, siç dëshmohet nga shkrimet e autorëve të vjetër shqiptarë (Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Pjetër Bogdani), gjuha shqipe kishte fjalor të pasur dhe ishte e përpunuar. Megjithatë, ajo ishte e mbarsur me fjalë të huazuara, kryesisht nga latinishtja dhe greqishtja. Këto fjalë kishin hyrë nëpërmjet përkthimit të librave fetarë dhe përdorimit të termave që shpjegonin koncepte të ndryshme. Në këtë mënyrë autorët e vjetër e pasuruan fjalorin e gjuhës shqipe me terminologji ndërkombëtare (Thomai, 1999: 222).

Karakterit i përzier i fjalorit të gjuhës shqipe përmendet dhe nga Baugh e Cable (1981: 25): “. . . fjalori është aq i përzier me fjalë latine, greke, turke e sllave, për shkak të pushtimeve dhe për shkaqe të tjera, sa që është e vështirë ta veçosh shqipen origjinale”.

Historia provon se kontakti i popullit shqiptar me grekët, romakët, sllavët, turqit dhe vendet fqinjë çoi, nga njëra anë, në humbjen e një pjese të konsiderueshme të fondit të fjalëve të saj autoktonë të trashëguara dhe, nga ana tjetër, në marrjen e shumë huazimeve nga gjuhët përçark.

Sipas disa gjuhëtarëve, fjalët e huaja që ndeshen në gjuhën shqipe të dokumentuar ndahen në dy grupe të mëdha:

- a. Fjalë që shqipja i trashëgoi nga gjuha e saj origjinale, dhe
- b. Fjalë që shqipja i huazoi gjatë kontaktit të saj historik të drejtpërdrejt me gjuhë të tjera.

“. . . si cak kohor për veçimin e këtyre dy grupeve fjalësh prej burimit të huaj do të merret ajo periudhë, kur u krye shndërrimi cilësor nga ilirishtja në shqipe d.m.th. përafërsisht periudha midis shekujve IV – VI para erës sonë” (Demiraj, 1988: 105).

Sipas Demirajt (1988: 105-111), fjalët latine e greke u huazuan nga gjuha e ilirëve. Një marrëdhënie shumëshkullore midis stërgjyshërve grekë e shqiptarë kanë lënë gjurmë në gjuhën shqipe. Prania e një numri të konsiderueshëm të fjalëve nga greqishtja e vjetër në gjuhën shqipe është argumentuar në mënyrë bindëse. Në të njëjtën mënyrë, gjuha shqipe e dokumentuar përfshin një numër relativisht të madh fjalësh nga latinishtja e vjetër, të cilat dëshmojnë për kontakte historike të gjata të stërgjyshërve të shqiptarëve me romakët në Gadishullin e Ballkanit. Ekspansioni romak filloi drejt brigjeve lindore të Adriatikut të banuar nga ilirët. Në vitin 167 Para Krishtit ata e realizuan qëllimin e tyre duke zënë rob Gentin, mbretin e fundit të fisit ilir të Ardianëve, dhe pushtuan kryeqendrën e tij Shkodrën. Stërgjyshërit tanë ilir nuk mundën t'i shpëtonin presionit të vazhdueshëm që ushtronte gjuha e pushtuesve romakë mbi gjuhën tonë.

Përveç fjalëve të huazuara nga greqishtja e vjetër, shqipja huazoi një numër të konsiderueshëm fjalësh nga greqishtja e mesme dhe ajo modernë. Ndikimi i greqishtes mbi gjuhën shqipe u rrit shumë kur greqishtja u bë gjuha standarte e Përandorisë Bizantine në shekullin VII pas Krishtit. Fakti që shumë shqiptarë ishin kristianë dhe gjuha liturgjike ishte greqishtja e shtonte dhe më shumë këtë ndikim. Përveç kësaj, marrëdhëniet midis shqiptarëve

dhe grekëve në zonat kufitare u forcuan.

Kontakti i njerëzve që jetonin gjatë dy brigjeve të Adriatikut i shtua veçanërisht kur lulëzoi jeta politike dhe ekonomike e vendeve bregdetare, sidomos në Republikën e Venëdikut. Për shkak të marrëdhënies së italianëve me popullsinë shqiptare, fjalë të italishtes filluan të hyjnë në gjuhën shqipe në shekullin X pas Krishtit (Demiraj, 1988: 116-117). Korkuti et al (2001: 42) shkruan rreth ndikimit të gjuhëve fqinjë mbi shqipen.

Pas rënies së perandorisë romake, një ngjarje historike, e cila pati rëndësi vendimtare për gjuhën shqipe si dhe për të gjitha gjuhët e Ballkanit që vendosja e sllavëve në gadishull. Kjo dëshmohet edhe nga studiuesi Shaban Demiraj (1988: 118), cili shkruan: “Në shqipen e dokumentuar ndeshen edhe mjaft fjalë prej burimit sllav. Këto fjalë kanë depërtuar drejtpërdrejtë në gjuhën shqipe gjatë marrëdhënieve të saj historike me gjuhët sllave të Ballkanit”.

Një proces i brendshëm i cili thuhet se ka qënë aktiv gjatë gjithë kohës ishte procesi që ka të bëjë me marrëdhëniet e gjuhëve të Ballkanit ndërmjet tyre. Në lidhje me ballkanizmat, Shaban Demiraj (1988: 55) shkruan: “Marrëdhëniet shumëshekullore ndërmjet popujve të Gadishullit Ballkanik kanë bërë që në gjuhët e tyre të zhvillohen e të përhapen disa fakte e dukuri gjuhësore të përbashkëta që njihen me emrin **ballkanizma**”. Demiraj thekson faktin se këto fjalë mund të gjinden në gjuhët që fliten në Gadishullin e Ballkanit, në shqip, rumanisht, maqedonisht, bullgarisht e greqisht, prandaj dhe quhen **ballkanizma**.

Në fjalorin e gjuhës shqipe ka shumë fjalë me origjinë turke. Fjalët turqisht, përsisht e arabisht hynë në gjuhën shqipe mëpërmjet kontakteve me popullin turk. Këto kontakte vazhduan për më shumë se pesë shekuj. Në lidhje me ndikimet e turqishtes, Jani Thomai (1999: 222) shkruan se një ndikim kryesor i jashtëm mbi gjuhët e Ballkanit, përfshirë gjuhën shqipe, ishte pushtimi osman, i cili zgjati deri më 1912.

Ndikimi i fjalëve turke mbi gjuhën shqipe shprehet nga Demiraj (1988: 124) si më poshtë: Pushtimi i gjatë osman nuk mund të mos linte gjurmë të dukshme në gjuhën shqipe. Këtu është fjala për huazimet turke që kanë hyrë në fjalorin e gjuhës se dokumentuar në periudha të ndryshme”.

Demiraj (1988:125) tregon se fjalët turke hynë në gjuhën shqipe bashkë me objektet dhe fenomenët që sollën turqit në jetën e përditshme shqiptare. Disa fjalë të tjera turke hynë sepse turqishtja ishte gjuha e administratës, ushtrisë dhe shkollave. Hyrja e fjalëve turke arriti kulmin në shekujt XVII e XVIII dhe u bë më e dobët aty nga gjysma e dytë e shekullit XIX me fillimin e lëvizjes kombëtare, kur fushata për pastrimin dhe pasurimin e gjuhës mori përmasa më të mëdha.

Në atë kohë, shkrimtarët shqiptarë u përpoqën të ngrinin barriera për të ndaluar vërshimin e fjalëve turke. Në vend që të përdornin fjalë turke, ata krijuan fjalë të reja ose përdorën kalke. Prirja për të krijuar fjalë të reja karakterizon krijimtarinë e autorëve shqiptarë të shekullit XVIII. Gjuhëtari Jani Thomai (1999: 223-224) shkruan se kjo traditë u vazhduar nga shkrimtarët e shekujve XIX-XX. Të nisur nga ideale të larta, krahas luftës së tyre për liri e pavarësi, ata bënë përpjekje për të ruajtur kulturën dhe për t’i mësuar popullit shkrimin e gjuhës shqipe.

Një valë tjetër e fjalëve të reja erdhi në vitet 1920-të. Nën pretekstin e qytetërimit, nisën të përdoren fjalë nëo-latinë në gjuhën shqipe.

“Në vitet 1920 në gjuhën shqipe hynë fjalë nga gjuhët neolatine, nga frëngjishtja e latinishtja. [. . .] Po në këto vite nisën të hyjnë fjalë edhe nga anglishtja (terminologjia sportive), si huazime fjalësh ose kalke. Në disa shtresa intelektuale fjalët e huaja u bënë modë, duke menduar se janë fjalë të kulturës e të qytetërimit” (Thomai, 1999: 226).

Pas invazionit italian, gjatë viteve 1930-të, vërshuan në gjuhën shqipe fjalë italisht në fushën e teknologjisë, bujqësisë industrisë dhe artit. Gjuha italianë filloi të mësohet edhe në shkolla (Thomai, 1999: 226). Studiuesi Demiraj (1988: 129) e përforcon këtë fakt duke shkruar se një numër i konsiderueshëm fjalësh, të cilat përdoren gjërësisht edhe në gjuhë të tjera, hyri në gjuhën shqipe; këto fjalë njihen si **internacionalizma**. Pavarësisht nga e kishin origjinën, ato hynë në gjuhën shqipe nëpërmjet gjuhëve romanë (veçanërisht nga italishtja) dhe gjuhëve gjermanike (veçanërisht nga anglishtja). Demiraj shkruan gjithashtu se shumë fjalë e kanë prejardhjen nga anglishtja: “Kurse shumë terma të sportit e kanë burimin në gjuhën angleze, si: basketboll, futboll, hendboll, volejball, sport, etj. (1988: 129).

Kontaktet që përmendëm më sipër tregojnë përse gjuhëtarët dhe filologët theksojnë se fjalori i gjuhës shqipe është i përzier me elementë të huaj.

1. 4. Fillimet e shkrimit të gjuhës shqipe

Gjuha shqipe është një nga gjuhët e lashta të Ballkanit, por e dokumentuar me shkrim mjaft vonë, në shekullin XV. Dokumenti i parë i shkruar në gjuhën shqipe është ai që quhet “Formula e pagëzimit”, e vitit 1462. Është një fjali e shkurtër në gjuhën shqipe: “*Unte paghesont premenit Atit et birit et spërtit senit*”, e cila gjendet në një qarkore të shkruar në latinisht nga Kryepeshkopi i Durrësit, Pal Engjëlli, bashkëpunëtor i ngushtë i Skënderbeut. Ai, gjatë një vizite në Mat, vuri re çrregullime rrafshin e ushtrimit të fesë dhe, me këtë rast, la me shkrim disa porosi dhe udhëzime për klerin katolik, ndër të cilat edhe formulën e mësipërme, që mund ta përdornin prindërit për të pagëzuar fëmijët e tyre, në rastet kur nuk kishin mundësi t’i dërgonin në kishë, ose kur nuk kishte prift. Formula është shkruar me alfabetin latin dhe në dialektin e veriut.

“Formula e pagëzimit” është gjetur në Bibliotekën “Laurentiana” të Milano-s nga historiani i njohur rumun, Nikolla Jorga, dhe është botuar prej tij më 1915 në “Notes et extraits pour servir l’histoire des croisades au XV siecle IV, 1915”. Më pas, botimin filologjik të këtij dokumenti, të shoqëruar me riprodhimin fotografik të tij, e bëri filologu francez, Mario Rognës, në “Recherches sur les anciens textes albanais” (Paris, 1932).

Dokumenti i dytë, i shkruar në gjuhën shqipe është “Fjalorthi” i Arnold von Harf-it, i vitit 1496. Ai, në vjeshtë të vitit 1496, ndërmori një udhëtim pelegrinazhi për në “vendet e shenjta”. Gjatë këtij udhëtimi, kaloi edhe nëpër vendin tonë, duke ndaluar në Ulqin, në Durrës e në Sazan dhe, për nëvoja praktike të rrugëtimit, shënoi 26 fjalë, 8 shprehje dhe numërorët 1 deri në 10 dhe 100 e 1000, duke i shoqëruar me përkthimin në gjermanisht. Për herë të parë, ky “Fjalorth” u botua në Këln, më 1860.

Është edhe një tekst tjetër i shkruar në gjuhën shqipe, i cili i përket fundit të shekullit XV ose fillimit të shekullit XV dhe gjendet brenda një dorëshkrimi grek të shekullit XIV në Bibliotekën “Ambrosiana” të Milanos. Teksti përmban pjesë të përkthyer nga “Ungjilli i Shën Mateut”, etj. Ai është shkruar me alfabetin grek dhe në dialektin e jugut. Ky tekst i shqipes së shkruar, njihet me emrin “Ungjilli i Pashkëve”.

Megjithëse këto dokumente nuk kanë ndonjë vlerë letrare, ato paraqesin interes për historinë e gjuhës së shkruar shqipe. Kështu, që në krye të herës, shqipja dëshmohej e shkruar në të dy dialektet, në dialektin e veriut (gegërisht) dhe në dialektin e jugut (toskërisht), si dhe me dy alfabetet, me alfabetin latin dhe me alfabetin grek, gjë që tregon se kultura shqiptare ishte njëkohësisht nën ndikimin e kulturës latine dhe të kulturës greko-bizantine.

Libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe, që njohim deri më sot, është “Meshari” i Gjon Buzukut, i vitit 1555, i cili shënon edhe fillimin e letërsisë së vjetër shqiptare. Nga ky libër, na ka arritur vetëm një kopje, që ruhet në Bibliotekën e Vatikanit. Libri përmban 220 faqe, të shkruara në dy shtylla. “Meshari” i Gjon Buzukut është përkthimi në shqip i pjesëve kryesore të liturgjisë katolike. Ai përmban meshat e të kremteve kryesore të vitit, komente të librit të lutjeve, copa nga “Ungjilli” dhe pjesë të ritualit dhe të katekizmit, pra, pjesët që i duheshin meshtarit në ushtrimin e përditshëm të shërbimeve fetare. Duket qartë se kemi të bëjmë me një përpjekje të këtij autori për të futur gjuhën shqipe në këto shërbime. Po ashtu, edhe për gjuhën shqipe, ashtu si për mjaft gjuhë të tjera, periudha letrare fillon me përkthime tekstesh fetare. Me gjithë luhatjet e shumta të formave të fjalëve e të shkrimit të tyre, në libër gjallon një frymëzim letrar, një aftësi e çuditshme shprehëse dhe një ritëm i brendshëm që e bën Eqerem Çabejn të përfundojë se ky autor “jo vetëm nga pikëpamja e kohës, po përgjithësisht dhe e nivelit, zë kryet e vendit në literaturën shqiptare të vjetrën; në fushën e prozës poetike edhe për më vonë është vështirë t’i vihet ndonjë tjetër përkrah”.

“Mesharin” e Gjon Buzukut e zbuloi një klerik shqiptar nga Gjakova, i cili, duke u ndodhur në Romë më 1740, pa me habi të madhe këtë libër në bibliotekën e kolegjit të Propagandës së Fesë (“Propaganda Fide”), ku kishte studiuar vetë më parë. I ngazëllyer nga ky zbulim, ai kopjoi pasthënien e librit dhe një pjesë tjetër të shkurtër e ia dërgoi Imzot Gjergj Guxetës, themeluesit të Seminarit shqiptar të Palermos, i cilësuar si "prototip i fisnikërisë së shpirtit e i burrërisë e i bujarisë së kombit shqiptar". Kleriku gjakovar e përshkruan librin si "Meshar" fort i lashtë shqip krejt i grisur prej vjetërsie". Nga fundi i shekullit XVIII, libri kaloi në koleksionin e librave orientale të kardinalit Stefan Borxha e së këtejmi në Bibliotekën e Vatikanit, ku u rizbulua më 1909. Nxitës i këtij zbulimi që Pal Skiroi, peshkopi i arbëreshëve të Sicilisë (1866-1941), i cili kishte në bibliotekën e Seminarit të Palermos pikërisht ato dy fletë të kopjuara nga Gjon Kazazi. Pal Skiroi është edhe studiuesi i parë i "Mesharit" të Buzukut. Më 1929, atë Justin Rrota, atëherë profesor i gjuhës shqipe dhe i gjuhëve klasike në Gjimnazin e Shkodrës, u dërgua në Romë për të nxjerrë kopje fotografike të librit dhe për t’i sjellë në Shqipëri. Më 1968, libri u botua i transliteruar dhe i transkriptuar, i pajisur me shënime kritike dhe me një studim të gjerë hyrës nga gjuhëtari i shquar, Eqrem Çabej.

“Meshari” i Gjon Buzukut është shkruar në gegërishten veriore me alfabet latin, të plotësuar me disa shkronja të veçanta. Libri ka fjalor të pasur dhe ortografi e forma gramatikore përgjithësisht të qëndrueshme, gjë që dëshmon për gjallimin e një tradite të mëparshme shkrimore të gjuhës shqipe.

Eqrem Çabej ka nxjerrë përfundimin se gjuha e kësaj vepre “nuk është një arë fare e papunuar”. “Duke e shkruar me një vështrim më objektiv këtë tekst – pohon ai – nga gjuha e rrjedhshme që e përshkon fund e majë atë dhe nga mënyra, me gjithë lëkundjet e shpeshta, mjaft

konsekvente e shkrimit, arrin të bindet njëri, se në Shqipëri ka qënë formuar që më parë, së paku që në mesjetën e vonë, një traditë letrare me shkrime liturgjike”. Kjo tezë, sipas autorit, gjen mbështetje edhe në gjendjen kulturore të Shqipërisë mesjetare: “shkalla e kulturës së popullit shqiptar në atë kohë nuk ka qënë ndryshe nga ajo e vendeve përreth, sidomos e atyre të brigjeve të Adriatikut”.

Për një traditë të shkrimit të shqipes para shekullit XV, flasin edhe disa dëshmi të tjera të tërthorta. Është pohuar qënia e një tradite letrare në gjuhën shqipe të paktën që nga fundi i shekullit XIII, ose gjithsesi para pushtimit osman. Guillaume Adame-i, një klerik frëng, që shërbeu si kryepeshkop i Tivarit më 1324-1341, autor i një parashtrere “Directorium ad passagium faciendum ad terram sanctam” (“Udhëzim për të bërë udhëtimin për në Tokën e Shenjtë”), shkruar latinisht më 1332 në Tivar, pohon se: “Sado që shqiptarët kanë një gjuhë krejt të ndryshme nga latinishtja, prapëseprapë ata kanë në përdorim dhe në të gjithë librat e tyre shkronjën latinë (*litteram latinam*)”. Ky pohim është marrë sikur Guillaume Adame-i ka dashur të thotë se shqiptarët e shkruajnë gjuhën e tyre me shkronja latinë. Me një analizë të imtë filologjike, Selman Riza arrin në përfundimin se shprehja e mësipërme “shkronjën latinë” (“*litteram latinam*”), mund të shënojë jo vetëm shkronjat e alfabetit, po edhe vetë gjuhën e shkruar të popullit përkatës, do me thënë, Guillaume Adame-i ka dashur të thotë që shqiptarët, duke pasur një gjuhë të ndryshme nga latinishtja, përdorin latinishten si gjuhë shkrimi.

Si dëshmi e shkrimit të gjuhës shqipe para Buzukut është sjellë edhe një pohim i Marin Barletit në veprën e tij “De obsi dionē scodrensi” (“Mbi rrethimin e Shkodrës”), botuar në Venëdik, më 1504, që bën fjalë për disa anale të shkruara në “vernacula lingua”, domethënë, në gjuhën e vendit, sipas të cilave njëfarë Roza me motrën e vet Fa kanë qënë themeluesit e parë të Shkodrës. Këto dëshmi të Guillaume Adame-it dhe të Marin Barletit përputhen me të dhënat historike për këtë periudhë, të cilat flasin për një nivel ekonomik e kulturor të zhvilluar të viseve shqiptare në shekullin XIV dhe në fillim të shekullit XV. Në atë periudhë, në veri dhe në jug të Shqipërisë, lulëzuan ekonomisht Durrësi, Kruja, Berati, Vlora, të cilat u bënë qendra të rëndësishme tregtare, zejtare dhe kulturore.

Megjithëse dëshmi të tilla e bëjnë të besueshme ekzistencën e një tradite më të hershme shkrimore të shqipes, derisa kërkimet të mos kenë nxjerre në dritë ndonjë libër tjetër, “Meshari” i Gjon Buzukut do të mbetet libri i parë i shkruar në gjuhën shqipe dhe vepra e parë e letërsisë shqiptare.

Në shekullin XVI i ka fillimet edhe letërsia në gjuhën shqipe të arbëreshët e Italisë. Vepra e parë e letërsisë arbëreshe në gjuhën shqipe dhe vepra e dytë për nga vjetërsia, pas asaj të Buzukut, është ajo e priftit arbëresh Lekë Matrenga, “E mbesuame e krishterë...”, që u botua më 1592. Është një libër i vogël me 28 faqe, përktim i një katekizmi, i shkruar në dialektin e jugut, me alfabet latin, plotësuar me disa germa të veçanta për të paraqitur ata tinguj të shqipes, që nuk i ka latinishtja.

Një zhvillim më të madh njohu lëvrimi i gjuhës shqipe në shekullin XVII, si rrjedhojë e punës së një vargu autorësh, si Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani etj., të cilët nuk bënë vetëm përktime, por shkruan edhe vepra të mirëfillta. Kështu, Frang Bardhi, më 1635, hartoi të parin fjalor, “Fjalorin latinisht-shqip”, me të cilin zë fill shkenca gjuhësore shqiptare.

Gjatë Rilindjes Kombëtare, në shekullin XIX, në kushte të reja historike, ruajtja, mbrojtja, pastrimi, lëvrimi dhe pasurimi i gjuhës shqipe hynë në një etapë të re zhvillimi. Gjatë kësaj periudhe, u bënë përpjekje të vetëdijshme dhe të pareshtura për të ndërtuar një gjuhë letrare kombëtare, njësimi i së cilës u arrit në shekullin XX.

1. 5. Dialektet e gjuhës shqipe

Gjuha shqipe ka dy dialekte kryesore, dialektin e veriut ose gegërishten dhe dialektin e jugut ose toskërishten. Kufiri natyror që i ndan në vija të përgjithshme këto dialekte, është lumi i Shkumbinit, që kalon nëpër Elbasan, në Shqipërinë e mesme. Në anën e djathtë të Shkumbinit shtrihet dialekti verior, në anën e majtë të tij, dialekti jugor.

Dallimet midis dialekteve të gjuhës shqipes nuk janë të mëdha dhe, kësajsoj, përdoruesit e tyre kuptohen pa vështirësi me njëri-tjetrin. Megjithatë, gjallojnë disa ndryshime në sistemin fonetik dhe në strukturën gramatikore e në leksik, nga të cilët më kryesorët janë:

Dialekti i veriut ka zanore gojore dhe hundore, kurse dialekti i jugut vetëm zanore gojore; togut *ua* të toskërishtes, gegërishtja i përgjigjet me togun *ue* (për shembull, *grua* ~ *grue*); togut nistor *va* të toskërishtes, gegërishtja i përgjigjet me *vo* (për shembull, *vatër* ~ *votër*); *a*-së hundore të theksuar të gegërishtes, toskërishtja i përgjigjet me *ë* të theksuar (për shembull, *nanë* ~ *nënë*). Po ashtu, dialekti i jugut ka dukurinë e rotacizmit (kthimin e *n*-së ndërzanore në *r* (për shembull, *ranë* ~ *rërë*), që në gegërisht mungon; në toskërisht, grupet e bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, etj., ruhen të plota, kurse në gegërisht, janë asimiluar në *m*, *n* (për shembull, *mbush* ~ *mush*, *vend* ~ *ven*).

Në sistemin morfologjik, dialekti i veriut ka formën e paskajores së tipit “*me punue*”, kurse toskërishtja, në vend të saj, përdor lidhoren “*të punoj*”. Forma e pjesores në toskërisht, del me mbaresë, kurse në gegërisht, pa mbaresë (për shembull, *kapur* ~ *kapë*), etj. Dialekti i jugut ka format e së ardhmes *do të punoj* dhe “*kam për të punuar*”, ndërsa dialekti i veriut, përveç formave të mësipërme, ka edhe formën “*kam me punue*”.

1. 6. Njësimi i gjuhës shqipe

Formimi i gjuhës letrare kombëtare të njësuar, si varianti më i përpunuar i gjuhës së popullit shqiptar, ka qënë një proces i gjatë, i cili ka filluar që në shekujt XVI-XVIII, por përpunimi i saj hyri në një periudhë të re, në shekullin XIX, gjatë Rilindjes Kombëtare. Më 1824, Naum Veqilharxhi filloi punën për të krijuar alfabetin shqip dhe në vitin 1844 dhe 1845 u botua “Evetar”-i. Ky autor ishte i pari që shprehu qëllimet e Rilindjes Kombëtare Shqiptare përmes traktatit të tij, parathënies së “Evetar”-it, dhe shumë shkrimeve të tjera.

Në programin e Rilindjes Kombëtare, mësimi dhe lëvrimi i gjuhës amtare, pasurimi dhe pastrimin i saj nga fjalët e huaja dhe të panëvojshme, zinin një vend qëndror. Gjatë kësaj

përiudhe, u zhvillua një veprimtari e gjerë letrare, kulturore dhe gjuhësore. Kështu, për shembull, më 1879, u krijua “Shoqata e të shtypurit shkronja shqip”, e cila i dha shtypja të reja kësaj veprimtarie. U hartuan gramatikat e para me synime normative dhe u hodh hapi i parë për hartimin e fjalorit kombëtar të gjuhës shqipe, që është “Fjalori i Gjuhës Shqipe” i Kostandin Kristoforidhit, botuar pas vdekjes së autorit, më 1904.⁶

Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, u arrit të përvijoheshin dy variante letrare të kombit shqiptar, varianti letrar jugor dhe varianti letrar verior. U bënë gjithashtu përpjekje për afrimin e këtyre varianteve dhe për njësimin e gjuhës letrare. Problemi i parë që duhej zgjidhur ishte njësimi i alfabetit, ngaqë deri atëherë, gjuha shqipe ishte shkruar në disa alfabete: alfabeti latin, alfabeti grek, alfabeti turko-arab dhe alfabete të veçanta. Këtë detyrë e kreu Kongresi i Manastirit, i mbledhur më 14 deri më 22 nëntor të vitit 1908, në qytetin e Manastirit, që sot ndodhet në Republikën e Maqedonisë. Në këtë Kongres, pas shumë diskutimesh, u vendos që të përdorej një alfabet i ri, i mbështetur tërësisht në alfabetin latin, i plotësuar me këta nëntë dygermësha: *dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh*, dhe me dy shkronjat me shenja diakritike: *ç, ë*. Ky është alfabeti që ka edhe sot në përdorim gjuha shqipe. Kongresi e la të lirë edhe përdorimin e alfabetit të Stambollit, që kishte mjaft përhapje, por koha ia lëshoi vendin alfabetit të ri, që u paraqit në Kongres, pra, alfabetit të sotëm.

Një arritje tjetër në procesin e njëimit të gjuhës letrare shqipe lidhet me “Komisionin letrar shqip”, që u mblodh në Shkodër, më 1916. Komisioni vuri si detyrë kryesore lëvrimin e gjuhës letrare shqipe dhe zhvillimin e letërsisë shqiptare. Duke synuar dhënien e ndihmës në drejtim të formimit të një gjuhe letrare të përbashkët përmes afrimit të dy varianteve letrare në përdorim, ai vlerësoi variantin letrar të mesëm, si një urë mes toskërishtes dhe gegërishtes, dhe përcaktoi disa rregulla për drejtshkrimin e tij, të cilat ndikuan në njësimin e shqipes së shkruar. Vendimet e “Komisionit letrar shqip” për gjuhën letrare dhe për drejtshkrimin e saj u miratuan më vonë edhe nga Kongresi Arsimor i Lushnjës të vitit 1920 dhe vazhduan të zbatoheshin deri në Luftën e Dytë Botërore.⁷

Pas Luftës së dytë Botërore, puna për njësimin e gjuhës letrare kombëtare dhe të drejtshkrimit të saj, nisi të organizohet nga Instituti i Shkencave. U krijuan komisionë të posaçme për hartimin e projekteve të drejtshkrimit. Kështu, u hartuan disa projekte në vitet 1948, 1951, 1953 dhe 1956. U organizuan edhe dy konferenca shkencore më 1952, për të diskutuar për problemin e gjuhës letrare.⁸

Me 1967, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë botoi projektin e ri “Rregullat e drejtshkrimit të shqipes”, i cili filloi të zbatohet në të gjithë hapësirën shqiptare, në Republikën e Shqipërisë, në Kosovë, në Mal të Zi dhe në Maqedoni. Ndërkohë, përpjekje për njësimin e gjuhës letrare dhe të drejtshkrimit të saj, bëheshin edhe në Kosovë. Kështu, më 1968, u mblodh Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, e cila, e udhëhequr nga parimi “një komb – një gjuhë letrare”,

⁶ Rami Memushaj, *Shqipja standarde*, Toena, 2004, f.19

⁷ J. Gjinari, Xh. Shkurtaç, *Dialektologjia*, shblu, Tiranë, 2003, f.79

⁸ Po aty.

vendosi që projekti i ortografisë i vitit 1968, sapo të miratohej dhe të merrte formën zyrtare në Republikën e Shqipërisë, do të zbatohet edhe në Kosovë. Vendimet e kësaj Konsulte kanë qënë me rëndësi të jashtëzakonshme për njësimin e gjuhës letrare kombëtare shqipe.

Projekti “Rregullat e drejtshkrimit të shqipes “ i vitit 1967, pasi iu nënshtrua diskutimit në publik, u paraqit për shqyrtim në Kongresin e Drejtshkrimit të Shqipes, që u mbajt në Tiranë, më 1972, dhe ka hyrë në historinë e gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare, si Kongresi i njësimin të gjuhës letrare kombëtare. Kongresi i Drejtshkrimit të Shqipes, ku morën pjesë delegatë nga të gjitha rrethet e Shqipërisë, nga Kosova, nga Maqedonia dhe nga Mali i Zi dhe nga arbëreshet e Italisë, pasi analizoi të gjithë punën e bërë deri atëherë për njësimin e gjuhës letrare, miratoi një rezolutë, në të cilën përveç të tjerash, pohohet se “populli shqiptar ka tashmë një gjuhë letrare të njësuar”. Gjuha letrare kombëtare e njësuar mbështetet kryesisht në variantin letrar të jugut, sidomos në sistemin fonetik por në të janë integruar edhe elemente të variantit letrar të veriut.

Pas Kongresit të Drejtshkrimit, janë botuar një varg vepra të rëndësishme, që kodifikojnë normat e gjuhës standarde, siç janë “Drejtshkrimi i gjuhës shqipe” (1973); “Fjalori i gjuhës së sotme letrare” (1980); “Fjalori i shqipes së sotme” (1984); “Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe” (1976); “Gramatika e gjuhës së sotme shqipe I, Morfologjia” (1995); “Gramatika e gjuhës së sotme shqipe II, Sintaksa” (1997).

1. 7. Veçori tipologjike të shqipes së sotme të njësuar

Nga pikëpamja strukturore, shqipja paraqitet si gjuhë sintetiko-analitike, me mbizotërim të veçorive sintetike dhe me prirje drejt analizimit. Një pjesë e mirë e veçorive të saj fonetike dhe gramatikore janë trashëguar nga periudha e lashtë indoevropiane, kurse pjesa tjetër janë zhvillime të mëvonshme.

Gjuha shqipe ka sistemin e vet fonologjik me shtatë fonema zanore dhe me 29 fonema bashkëtingëllore. Shkruhet me alfabet latin, të caktuar në Kongresin e Manastirit, më 1908, që ka 36 shkronja, nga të cilat 25 janë të thjeshta: **a, b, c, d, e, f, g, h, i, j, k, l, m, n, o, p, q, r, s, t, u, v, x, y, z**; 9 janë dygermësha: **dh, gj, ll, nj, rr, sh, th, xh, zh**; dhe 2 janë germa diakritike: **ë, ç**. Shqipja ka theks intensiteti dhe përgjithësisht të palëvizshëm gjatë fleksionit. Në shumicën e rasteve, sidomos në sistemin emëror, theksi bie në rrokjen e parafundit.⁹

Gjuha shqipe ka sistem të pasur formash gramatikore; ka sistem lakimi binar dhe ruan format rasore zanafillore; ka sistem me tri gjini. Sistemi emëror ka trajtë të shquar dhe të pashquar dhe, rrjedhimisht, edhe lakim të shquar e të pashquar; nyja shquese është e prapavendosur; ka nyje të përparme tek emrat në rasën gjinore, të mbiemrat e nyjshëm dhe të emrat asnjans. Përveç fleksionit me mbaresa të veçanta, shqipja njeh edhe fleksionin e brendshëm, për shembull, “dash” ~ “desh”, “marr” ~ “merr” etj.; ka dy tipa strukturorë

⁹ Sh.Demiraj, *Fonëtika dhe fonologjia*, SHBLU, Tiranë, 2002, f.51

mblenash të ngjashëm, për shembull, “i madh”, “i ndershëm” etj., dhe të panyjshëm, për shembull, “trim”, “besnik” etj. Te numërorët përdor kryesisht sistemin decimal, për shembull, “dhjetë”, “tridhjetë”, “pesëdhjetë” etj., por ruan edhe sistemin vigezimal, për shembull, “njëzet”, “dyzet”; numërorët e përberë nga 11-19 formohen duke vënë numrin e njësheve përpara, parafjalën *mbë* dhe pastaj *dhjetshet*, për shembull, “njëmbëdhjetë”, “dymbëdhjetë” etj.

Sistemi foljor është tejet i larmishëm. Gjuha shqipe ka sistem të pasur formash mënyrore dhe kohore, një pjesë të e cilave janë trashëguara nga një periudhë e hershme, kurse pjesa tjetër mbetet fryt i evolucionit të saj historik. Folja ka gjashtë mënyra: dëftoren, lidhoren, kushtoren, habitoren, dëshiroren, urdhëroren, si dhe tri forma të pashtjelluara: pjesoren, paskajoren dhe përcjelloren. Koha e ardhme ndërtohet në mënyrë analitike, me dy forma: (a) me *do* (forma e foljes “dua”) + lidhore (“të punoj”); dhe (b) me foljen ndihmëse *kam* + paskajore.¹⁰

Rendi i fjalëve në fjali është përgjithësisht i lirë, por më i zakonshëm është rendi: **kryefjalë + kallëzues + kundrinor**.

Leksiku i gjuhës shqipe përbëhet nga disa shtresa. Një shtresë të veçantë përbëjnë fjalët me burim vendas, të trashëguara nga një periudhë e lashtë indoevropiane, për shembull, “ditë”, “natë”, “dimër”, “motër” etj., ose të formuara më vonë, me mjete të shqipes, për shembull, “ditor”, “dimëror”, “i përnatshëm”, etj.¹¹

Një shtresë tjetër përbëjnë huazimet nga gjuhë të tjera për shkak të kontakteve të ndryshme të popullit shqiptar me popuj të tjerë në rrjedhën e kohës. Fjalët e huazuara kanë hyrë nga greqishtja, greqishtja e vjetër dhe re, nga latinishtja dhe gjuhët romanë, nga sllavishtja dhe nga turqishtja, kurse sot më së shumti nga anglishtja, që po shfaqen si dukuri shqetësuese, të cilën do ta trajtojmë në krrerët vijues. Megjithatë, duhet theksuar se gjuha shqipe, pavarësisht nga huazimet e shumta, deri tani e ka ruajtur tjetërsinë e vet, si gjuhë e veçantë indoevropiane.

1. 8. Përhapja e gjuhës angleze

Sipas disa burimeve, numri i anglishtfolësve arrin në më se 300 milionë, ndërkohë, burime të tjera thonë se ky numër i kalon të 650 milionët. Sidoqoftë, dihet tashmë se anglishtja është gjuhë zyrtare e shumë vendeve anëmbanë botës, të cilat i kemi renditur në bazë kontinëntesh, si vijon:

Afrika:

Në Askensioni, pjesë e Mbretërisë së Bashkuar dhe krahinë e varur nga Shën Helena. Në

¹⁰Grupa autorësh, *Gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe (Morfologjia)*, ETMMSSH, Prishtinë, 1989, f.54

¹¹J.Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2002, f.32

Botsvana, Koloni e Kurorës deri më 1966. Këtu, përveç anglishtes, setsvanishtja është gjuha tjetër zyrtare, por flitet edhe bantuistja.

Në Kamerun, Koloni e Kurorës deri më 1961. Këtu, anglishtja dhe frëngjishtja janë dy gjuhët zyrtare, plus 24 grupeve kryesore të gjuhës afrikanë ende në përdorim.

Në Gambia që fitoi pavarësinë nga Britania më 1965. Këtu, anglishtja është gjuhë zyrtare, por fliten edhe mandinkaishtja, uolofishtja, fulanishtja dhe gjuhë të tjera amtare të vendasve.¹²

Në Gana që u pavarësua nga Mbretëria e Bashkuar më 1957. Këtu, anglishtja është gjuhë zyrtare, por gjuhët afrikanë (akanishtja, moshi-dagombaishtja, eveishtja dhe gaishtja) janë gjuhë amtare.

Në Lesoto që ishte protektorat deri më 1966. Këtu, sesotishtja, krahas anglishtes, është gjuhë zyrtare, por edhe zuluishtja dhe xhosaishtja janë dy gjuhë të tjera të rëndësishme.

Në Liberi, vendi ku, më 1822, u vendosën skllëvërit e çliruar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këtu, anglishtja është gjuha amtare e 96 për qind të popullsisë, por fliten edhe 20 gjuhë vendore të grupit gjuhësor nigerisht-kongoisht.

Në Malavi që ishte protektorat deri më 1964. këtu, dy gjuhët zyrtare janë anglishtja dhe çičevaishtja.

Në Mauritius që fitoi pavarësinë nga Britania më 1968. Këtu, anglishtja është gjuhë zyrtare, por fliten edhe kreolishtja, frëngjishtja, hindishtja, urduishtja, hakaishtja dhe bojporishtja.

Në Namibi që i përkiste Afrikës së Jugut deri më 1990, kur fitoi pavarësinë. Këtu, megjithëse anglishtja është gjuhë zyrtare, ajo flitet vetëm nga 10 për qind e popullsisë. Afrikanishtja është gjuha e 60 për qind të tjerëve, por fliten edhe gjermanishtja, oshivamboishtja, hereroishtja dhe namaishtja.¹³

Në Nigeri që ishte Koloni e Kurorës deri më 1960. Këtu anglishtja është gjuhë zyrtare dhe flitet si gjuhë e parë nga rreth 50 për qind e popullsisë, ose 44 000 000 veta. Gjuhët e tjera amtare janë hausaishtja, jorubaishtja, iboishtja dhe fulanishtja.

Në Shën Helena, territor në vartësi të Mbretërisë së Bashkuar. Këtu, anglishtja është gjuhë amtare.

Në Sejçeles që fitoi pavarësinë më 1976. Këtu, anglishtja, frëngjishtja dhe kreolishtja janë gjuhë zyrtare, por anglishtja është gjuha e parë e 2 për qind të popullsisë, ose e 2 000 vetave.

¹² K.Jorgaqi, *Leksione xhepi për gjuhën*, Dudaj, Tiranë, 2001, f.57

¹³ K.Jorgaqi, *Leksione xhepi për gjuhën*, Dudaj, Tiranë, 2001, f.61

Në Sierra Leonë që ndodhej nën varësinë e Britanisë deri më 1961. Këtu, anglishtja është gjuhë zyrtare, por përdoret rregullisht vetëm nga pakica. Mendeishtja, temnëishtja dhe krioishtja janë gjuhë amtare.¹⁴

Në Afrikën e Jugut. Këtu, dy gjuhët kryesore zyrtare janë anglishtja dhe afrikanishtja, plus nëntë gjuhë të tjera, ku përfshihen ndebeleishtja, pedishtja, sothoishtja, svazishtja, congaishtja, cvanaishtja, vendaishtja, xhosaishtja dhe zuluishtja. Anglishtja është gjuhë e parë e vetëm 10 për qind të popullsisë, ose e rreth 3 000 000 vetave.¹⁵

Në Tristan da Kunha që është pjesë e Mbretërisë së Bashkuar, si krahinë nën varësinë e Shën Helenës.

Në Uganda që fituar pavarësinë nga Britania që më 1962. Këtu, përveç anglishtes, suahilishtja është gjuhë zyrtare, por fliten edhe disa gjuhë vendase, të tilla si ugandaishtja, bantuishtja dhe nilotikishtja.

Në Zambia që ka qënë koloni e Britanisë deri më 1964. Këtu, anglishtja është gjuhë zyrtare, por fliten edhe rreth 70 gjuhë vendase (bantu).

Në Zimbabve që fitoi pavarësinë nga Britania më 1980. Prandaj, këtu, anglishtja është gjuhë zyrtare, por edhe gjuhët bantu, si shonaishtja dhe sindebeleishtja, janë vendase.

Amerika:

Në Belizë; kështu quhej Hondurasi Britanik deri më 1981. Këtu, përveç anglishtes, fliten edhe spanjishtja, majaishtja dhe garifunaishtja nga 65 për qind e popullsisë, ose 123 000 veta.

Në Bermuda, territor nën varësinë e Mbretërisë së Bashkuar. Këtu, anglishtja është gjuhë amtare e 95 për qind të popullsisë, ose e 56 000 vetave.

Në Kanada. Këtu, anglishtja dhe frëngjishtja janë gjuhë zyrtare. 60 për qind e popullsisë, ose rreth 16 000 000 veta, flet anglisht.

Në Ishujt e Karaibeve. Në Ishujt e Folklandit që është territor nën varësinë e Mbretërisë së Bashkuar. Këtu, anglishtja është gjuhë amtare.

Në Guajana që ka qënë Koloni e Kurorës deri më 1966. Këtu, anglishtja është gjuhë amtare për 75 për qind të popullsisë, ose 567 000 veta, por fliten edhe dialekte të tjera të armerindianishtes, plus hindishtes, urduishtes, kinëzishtes dhe portugalishtes.

¹⁴ Po aty, f. 63

¹⁵ Po aty, f.65

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Këtu, përveç anglishtes që është gjuha amtare e rreth 88 për qind të popullsisë, ose e 221 000 000 vetave, flitet edhe spanjishtja nga një pakicë mjaft e madhe.

Azia:

Në Hong Kong që fitoi pavarësinë nga Britania më 1997, anglishtja dhe kinëzishtja janë gjuhë zyrtare.

Në Indi, përveç anglishtes dhe hindishtes, e cila është gjuha e parë e 30 për qind të popullsisë, ka edhe disa gjuhë të tjera zyrtare, si bëngalishtja, teluguishtja, maratishjtja, tamilishtja, gujaratishjtja, malajalamishtja, kanadashjtja, orijaishtja, punjabishtja, assamesishtja, kashmirishtja, sindishtja, sanskritishtja. Shumica syresh nuk janë të kuptueshme për të gjithë, prandaj anglishtja luan rol të rëndësishëm në komunikimin kombëtar, politik dhe tregtar.

Në Pakistan anglishtja është gjuha zyrtare, *lingua franca* e elitës pakistanëze dhe e shumicës së ministrive të qeverisë. Gjithashtu, janë zyrtare urduishtja, sindishtja dhe pashtuishtja, por fliten edhe balokishtja dhe gjuhë të tjera.

Në Filipinë që fitoi pavarësinë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës më 1946, anglishtja dhe filipinishtja janë gjuhë zyrtare, por fliten edhe spanjishtja dhe visajanishtja.

Në Singapor që fitoi pavarësinë nga Britania më 1965. Këtu, anglishtja, kinëzishtja malajaishtja dhe tamilishtja janë gjuhë zyrtare, ndërkohë që malajaishtja është gjuhë kombëtare.

Australia dhe Oqeania:

Në Australi, i njohur ndryshe si “ishulli burg” i Britanisë, anglishtja është gjuha amtare e rreth 90 për qind të popullsisë, ose e 15 000 000 vetave, por fliten edhe gjuhë të tjera amtare të vendasve. Në Ishujt e Kukut që janë bashkuar me vullnët të lirë me Zelandën e Re, anglishtja është gjuhë zyrtare, por flitet edhe maorishtja. Në Fiji që fitoi pavarësinë nga Britania më 1970, anglishtja flitet gjërësisht, por nuk është e vetmja gjuhë zyrtare. Fijianishtja është gjithashtu gjuhë zyrtare, por fliten edhe hindustanishtja dhe kinëzishtja.

Në Kiribati që ka qënë Koloni e Kurorës deri më 1979, përveç anglishtes, gjuhë zyrtare është edhe xhilibertezishtja.

Në Nauru që fitoi pavarësinë nga Britania më 1968, anglishtja është gjuhë zyrtare dhe kuptohet në shkallë të gjerë, por përdoret vetëm për qëllime qeveritare dhe tregtare, duke qënë gjuhë e parë për 7% për qind të popullsisë, ose 600 veta. Gjuha tjetër zyrtare është nauruanishtja.

Në Zelandën e Re që fitoi pavarësinë më 1907. përveç anglishtes, gjuhës së parë të 93 për qind të popullsisë, ose e 3 000 000 vetave, maorishtja është gjuha e vendasve.

Në Guinënë e Re që fitoi pavarësinë nga Australia më 1975, anglishtja është gjuhë zyrtare, por flitet vetëm nga 1-2 për qind e popullsisë; megjithatë, anglishtja e përzier përdoret nga 66 për qind e popullsisë. Fliten gjithashtu motuishtja dhe 715 gjuhë vendase.

Në Ishujt e Solomonit që ishin pjesë e Britanisë deri më 1978, anglishtja është gjuhë zyrtare, por përdoret vetëm nga 1-2 për qind e popullsisë, kurse melanzishtja e përzier është *lingua franca* mes 120 gjuhëve vendase.

Në Tuvalu që ishte koloni deri më 1978, përveç anglishtes, edhe tuvaluanishtja është gjuhë zyrtare.

Në Vanuatu që fitoi pavarësinë nga Britania më 1980, anglishtja, frëngjishtja dhe bislamishtja (gjuhë e përzier) janë gjuhë zyrtare, por fliten edhe gjuhët melanë. Në Samoan Përendimore që i përkiste Zelandës së Re deri më 1962, anglishtja dhe samoanishtja (polinezishtja) janë gjuhë zyrtare.

Europa:

Në Ishujt e Kanalit (Guernsi dhe Xhersi) që janë territore nën varësinë e kurorës britanike, përveç anglishtes, gjuhë zyrtare është edhe frëngjishtja, por flitet edhe frëngjishtja normanë.

Në Gjibraltari që është territor nën varësinë e Mbretërisë së Bashkuar, anglishtja dhe spanjishtja janë gjuhë zyrtare, por fliten edhe italishtja, portugalishtja dhe rusishtja. Anglishtja flitet nga 35 për qind e popullsisë, ose 10 800 veta.

Në Republikën Irlandeze, përveç anglishtes që flitet nga 3 334 000 veta, edhe gaelishtja irlandishte (gjuha kelte) është gjuhë zyrtare.

Në Ishullin e Njëriut që është territor nën varësinë e kurorës britanike. Këtu, përveç anglishtes vendase, flitet edhe gaelishtja e Manksit (varianti kelt i gjuhës së Manksit).

Në Maltë që fitoi pavarësinë nga Britania më 1964, anglishtja dhe maltishtja janë gjuhë zyrtare, por flitet edhe italishtja. Anglishtja është gjuha amtare e 20 për qind të popullsisë, ose e 70 600 vetave. Orkni dhe Shetlendi janë pjesë e Mbretërisë së Bashkuar.

Në Mbretërinë e Bashkuar, përveç gjuhës amtare angleze, të cilën e përdorin 98 për qind e popullsisë, ose 56 236 000 veta, fliten edhe uellsishtja nga 26 për qind e popullsisë së Uellsit dhe gaelikishtja skoceze nga rreth 60 000 e popullsisë së Skocisë.

1. 9. Origjina e gjuhës angleze

Anglishtja futet në grupin proto-indo-evropian të gjuhëve. Sipas hamendjes së gjuhëtarëve, indo-evropianët duhet të kenë jetuar afërsisht 6 000 vjet më përpara në jug të

Kaukazit. Me kalimin e kohës, këta njerëz shtegtuan në drejtime të ndryshme dhe, 2 000 vjet më vonë, disa syresh erdhën dhe pushtuan tokat në pjesët përendimore të Detit Baltik. Gjuha që filluan të flisnin këta njerëz ishte gjermanishtja. Pas disa shekujsh, aty rreth viteve 450-600 pas Krishtit, tre fise gjermanë, jutët, anglët dhe saksonët, mërguan në Ishuj Britanikë, dhe gjuha që filluan të flisnin në tokat e tyre të reja ishte Anglishtja e Vjetër. Meqënëse gjuha gjithnjë ndryshon dhe zhvillohet, anglishtja që flisnin këta njerëz ishte shumë e ndryshme nga anglishtja që flitet sot. Kështu, shumica e njerëzve, gjuha amtare e të cilëve është anglishtja, kanë shumë të vështirë ose fare të pamundur të kuptojnë një tekst të shkruar në Anglishten e Vjetër. Rrjedhimisht, mund të thuhet se fjalët e anglishtes amtare burojnë nga Anglishtja e Vjetër ose nga dialektet e gjermanishtes që flisnin anglët, saksonët dhe jutët kur banonin në trojet e veta të kahershme.

1. 9. 1. Statusi i sotëm i gjuhës angleze

Brenda pak më shumë se një brezi, është kaluar nga gjendja ku gjuha botërore ishte thjesht mundësi teorike, në atë të shndërrimit të saj të vrullshëm në realitet. Në rrethana të tilla, asnjë qeveri ende nuk ka arritur të dalë me një politikë mbrojtëse gjuhësore të sendërtueshme ose të besueshme. Gjuhët e identitetit duhet të ruhen. Lidhjet me gjuhën globale në lindje e sipër, pra, me anglishten, e cila përceptohet si gjuhë e mundësive, duhet të garantohen. Ndërkohë, duhet të merren vendime tejet jetike për përparësitë. Të ndodhur në darën e kësaj “krize”, vendimmarrësit duhet ta dinë mirë se njërezimi është duke shkuar në drejtim të një çasti kritik në historinë e tij gjuhësore.¹⁶

Megjithatë, të çudit fakti se kjo po ndodh me anglishten, e cila mbetet ndër gjuhët që ka marrë më së shumti fjalë nga gjuhët e tjera. Kështu, nga analiza kompjuterike e rreth 80 000 fjalëve të fjalorit të anglishtes (“Shorter Oxford Dictionary”), bërë nga Thomas Finkenstaedt-i, më 1973, dhe botuar në *Ordered profusion; studies in dictionaries and the English lexicon (Annales Universitatis Saraviensis)*, ka treguar se 28,30 për qind e fjalëve të anglishtes kanë prejardhje frënge; 28,24 për qind kanë prejardhje latinë (duke përfshirë këtu edhe termat bashkëkohorë shkencorë e teknikë); 25 për qind burojnë nga Anglishtja e Mesme, norvegjishtja e vjetër dhe nga holandishtja, domethënë, kanë prejardhje gjermanike; 5,32 për qind kanë prejardhje greke; 4,03 për qind kanë etimologji të pazbërthueshme; 3,28 për qind kanë prejardhje nga emra të përveçëm dhe 1 për qind nga të gjitha gjuhët e tjera. Pra, rreth 70 për qind e fjalëve të anglishtes janë prej brumit të huaj. Anglishtja edhe sot vazhdon të huazojë fjalë nga gjuhët e tjera, nga 120 syresh. Për këtë arsye, ajo ka leksikun më të pasur në botë, të hedhur tashmë në fjalorin e vet, me më se 500 000 fjalë aktive dhe po kaq pasive, kur vetëm disa shekuj më parë ka pasur rreth 50.000-60.000 fjalë.

Vërtet sot pranohet se vetëm rreth 30 për qind e numrit të përgjithshëm të fjalëve në gjuhën angleze janë fjalë vendi, por këto fjalë formojnë korpusin e fjalëve që kanë përdorimin

¹⁶ S.Pinker, *The Language Instinct: How the Mind Creates Language*, Perennial (Harper Collins); First Edition (February 1995), f. 92

më të dendur në të folur e në të shkruar dhe janë polivalente e polisemantike, pra, të përshtatshme për lidhjen e fjalëve në sintagma e fraza, si dhe për krijimin e frazeologjizmave.

Kreu i dytë: Roli i fjalëformimit në pasurimin e gjuhës

2. 1. Vendi dhe roli i fjalëformimit në gjuhësinë shqiptare

Këto çështje paraqiten të ndërlikuara për disa arsye, ku mund të veçohen këto: (a) gjuhësia shqiptare është e re, konsolidimi i saj është më i vonshëm se ai gjuhëve të tjera evropiane, dhe ende kanë mbetur pa u zgjidhur një varg problemesh në rrafshet e ndryshme gjuhësore; (b) edhe gjuhësia modernë nuk ka lindur shumë herët, dhe mjaft probleme në kuadër të saj nuk janë shteruar përfundimisht, rrjedhimisht, edhe shqyrtimi teorik i fjalëformimit ka mbetur prapa.

Një gjysmë shekulli përvojë i gjuhësisë shqiptare, të sistemuar e të vendosur në rrugë të mbarë, është i pamjaftueshëm për hulumtimin, qëmtimin e trajtimin e plotë të të gjitha problemeve gjuhësore të shqipes, si dhe për plotësimin e kërkesave të mëdha të shkollës sonë, sidomos tani, në epokën e globalizmit. Detyra të vështira në kushte të pavolitshme, për shembull, shkëputja nga “e vjetra” dhe rendja e pareshtur pas “së resë” janë vetëm dy nga veçoritë e larmishme të zhvillimit të gjuhësisë shqiptare. Lidhur me këtë, duhet theksuar se kur në gjuhësinë shqiptare po përvijoheshin fillimet e studimit të organizuar të problemeve të saj, në pjesën tjetër të Evropës gjuhësia modernë, e themeluar nga “strukturalistët” dhe, pak më vonë, e pasuar nga “Shkolla e Pragës”, kishte mbushur gati katër dhjetëvjeçarë. Përveç kësaj, ishin ngritur tashmë edhe shkolla të tjera. Ndërkohë, larushia dhe begatia e mendimeve në fusha të caktuara gjuhësore kishte çuar në përmbysjen e shumë qasjeve, dikur të vyeshme, ndaj zbulimit, shtrimit dhe zgjidhjes së problemeve të gjuhës.¹⁷ Megjithatë, spikatin arritjet e gjuhësisë shqiptare për një kohë të shkurtër në mjaft drejtime. Puna e pakursyer dhe frytet e shëndetshme shkencore të vjela me mund e djersë nga gjuhëtarët tanë të shquar si, për shembull, Aleksandër Xhuvani, Eqrem Çabej, Androkli Kostallari, Kostaq Cipa, Selman Riza, Jup Kastrati, Idriz Ajeti etj., dhe nga brezat e tyre pasardhës, mundësuan hedhjen e themeleve të patundshme, të shenjta, të gjuhësisë shqiptare bashkëkohore, duke i hapur rrugë ndërmarrjes së studimeve në të gjithë lëmenjtë e dijeve gjuhësore, ku përfshihet edhe fjalëformimi.¹⁸

Gjuhësia shqiptare ka qënë, është dhe do të mbetet, shkencë e mirëfilltë mbi gjuhën shqipe, edhe pse ndërkohë, si rrjedhojë e kundërveprimit ndaj trysnisë së ndikimeve dhe të rrethanave historike, shoqërore, madje edhe politike, janë zhvilluar degë të tjera të gjuhësisë. Etimologjia, historia e gjuhës, gramatika kanë shënuar përparime të kënaqshme, kurse leksikologjia, fonologjia, semiologjia, stilistika, dhe mjaft degë të reja të makrolinguistikës, siç janë sociolingvistika, etnolingvistika, filozofia e gjuhës, gjuhësia kompjuterike, megjithëse ndodhen në rrugë të mbarë, kanë nëvojë të ngutshme të zgjerohen dhe të thellohen, për t’u dhënë zgjidhje të drejtë atyre problemeve që vetëm sa janë cekur ose nuk janë cekur fare.

¹⁷ A. Kostallari, *Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese*, në *Studime mbi leksikon dhe formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I*, Tiranë, 1972, f. 65

¹⁸ M.Celiku, *Çështje të gjuhës standarde*, Tiranë, 2001, f.95

Analiza fjalëformuese ka për detyrë të zbulojë mënyrën e bashkimit të morfemave që përbëjnë një fjalë me temë jo të parme, të sqarojë sistemin e lidhjeve e të marrëdhënive që kanë ato midis tyre. Me anë të analizës fjalëformuese zbulohen tipat e ndryshëm të fjalëformimit që veprojnë në gjuhë, me fjalë të tjera zbulohet sistemi i gjallë i formimit të fjalëve.

Për të zbuluar tipat dhe më tej sistemin e fjalëformimit, nuk mjafton vetëm të përcaktohen morfemat e një fjale. Duhet të sqarohen roli e kuptimi i tyre në fjalë. Në analizën e fjalës nga pikëpamja e formimit të saj në radhë të parë përcaktohet tema ose temat fjalëformuese. Në këtë mënyrë zbulohet mënyra e formimit të fjalëve të analizuara dhe kuptimi e roli i ndajshesav të tyre fjalë formuese. Kështu, fjala *pakënaqësi* ka si temë fjalëformuese *kënaqësi* dhe është formuar me anë të parashtesës *pa*, pra me parashtesim, kurse fjala *pagjumësi* ka si temë fjalë formuese *gjumë* dhe është formuar me anë të prapashtesimit të një togu parafjalor *pagjumë* + *si*.

Nga pikëpamja e strukturës së tyre morfologjike fjalët paraqiten mjaft të larmishme në tipa dhe nëntipa:

1. Fjalë të përbera vetëm prej morfemës rrënjore.
 2. Fjalë që kanë ose mund të kenë në përbërjen e tyre më shumë se një morfemë.
- Nga pikëpamja e numrit të morfemave rrënjore që mund të kenë, fjalët ndahen në dy grupe të mëdha:
1. Fjalë të thjeshta, të cilat kanë vetëm një morfemë rrënjore. Të tilla janë: breg, bregore, drejt, i drejtë, drejtoj, përkohësisht e të tjera.
 2. Fjalë të përbëra, të cilat kanë dy ose më shumë morfema rrënjore: gjëgjësë, thashetheme, tridhjetë etj.

Si fjalët e thjeshta ashtu edhe fjalët e përbëra mund të ndahen në disa tipa duke e marrë parasysh nëse janë pjesë të ndryshueshme ose të pandryshueshme të ligjeratës, nëse kanë temë të parme ose jo të parme, nëse kanë një morfemë rrënjore a më shumë etj.

2. 2. Fjalëformimi dhe trajtimi i tij teorik në gjuhësinë shqiptare

Trajtimi i fjalëformimit në gjuhën shqipe përputhet me gjendjen mbizotëruese të studimit të çështjeve të tjera gjuhësore, rrjedhimisht, edhe rezultatet e arritura në këtë lëmë barabiten me rezultatet e tyre. Pra, shqyrtimi teorik i tij mbetet brenda kufijve të metodës tradicionale që, pak a shumë, është zbatuar edhe në gjuhë të tjera, sigurisht, duke vënë në dukje veçoritë fjalëformuese të shqipes. Rezultatet, sidomos për sa i përket njohjes me fjalëformimin, kanë sjellë plotësimin e kërkesave të shkollës shqipe në të gjitha nivelet. Punimet e reja kërkimore dhe shkencore në këtë fushë kanë ecur në gjurmët e studimeve të thelluara të Aleksandër Xhuvanit, të Eqrem Çabejit dhe të Androkli Kostallarit. Përveç këtyre, gjuhëtarët e tjerë që u morën dhe vazhdojnë të merren me dukuri të ndryshme të fjalëformimit janë të shumtë, dhe mes tyre bëjnë pjesë Shaban Demiraj, Enver Hysa, Jani Thomai, Mehmet Çeliku, Josif Kole, Miço Samara, Minëlla Totoni, Seit Mansaku, Qemal Murati etj. Po ashtu, edhe numri i problemeve që ngrenë, shtrojnë dhe zgjidhin në këtë fushë studimore është i madh, ku përfshihen formimi i fjalëve në gjuhën shqipe dhe paradigmën fjalëformuese, tipat sipas formimit, koncepti për fjalën, vendi dhe kufijtë e saj në vargun e njësisë themelore të gjuhës, lidhjet ndërmjet formës dhe përmbajtjes, grupimi sipas formës, grupimi sipas kuptimit, rrugët kryesore për pasurimin e leksikut, formimi i fjalëve të reja

etj.¹⁹

Por, brenda cilës disiplinë gjuhësore klasifikohet e trajtohet fjalëformimi? Trajtimi i tij, a bëhet duke u mbështetur në përvojën e traditës apo shfaq prirje që të ndjekë shembullin e gjuhësisë modernë evropianë? Fjalëformimi dhe, në përgjithësi, problemet që lidhen me derivacionin, nuk zënë vendin e duhur në gjuhësinë përendimore.

Ky shqetësim ngrihet shpesh në literaturën e sotme gjuhësore. Përveç kësaj, fjalëformimi në gjuhësinë evropianë vështrohet në mënyra të ndryshme. Ai trajtohet e mësohet si pjesë e gramatikës dhe, në këtë kuptim, shpalos lidhje të llojit të vet me morfologjinë, si pjesë e leksikologjisë ose si pjesë e morfologjisë dhe e leksikologjisë njëherësh. Edhe mendimi shkencor për fjalëformimin është i kundërshtor dhe ende nuk ka mundur dhënien e një zgjidhjeje përfundimtare teorike dhe praktike se në ç'disiplinë gjuhësore futet ai. Kështu, disa studiues mendojnë se fjalëformimi i përket morfologjisë me të dy segmentet e tij, fleksionin e derivacionin, quajtur ndryshe si morfologji fleksive dhe morfologji leksikore; të tjerë mendojnë se fleksioni i përket morfologjisë, kurse derivacioni leksikologjisë; një grupim syresh i vogël gjykon se fjalëformimi i mirëfilltë mund të quhet vetëm derivacioni dhe, për këtë arsye, ai është pjesë e leksikologjisë. Koncepti sundues i kohëve të fundit, që ka shumë përkrahës, sidomos në radhët e studiuesve të gjuhësisë polake, gjermanë, ruse, çeke, sllovake, sllovenë, serbe, arabe, boshnjake dhe të ndonjë tjetre, është se fjalëformimi duhet të trajtohet si disiplinë gjuhësore e veçantë dhe e pavarur. Me sa duket, ai është përfutur si rrjedhojë e ndikimit të strukturalizmit dhe të gramatikës transformacionale.

2. 3. Fjalëformimi sipas literaturës teorike gjuhësore

Gramatikat greke, gramatika latinë dhe gramatikat e gjuhëve më të reja, të cilat mbështeten në parimet klasike, sipas John Lyons-it, përfshijnë eptimin ose “dijen e formës”, derivacionin ose fjalëformimin dhe sintaksën, por pa zënë vend të barabartë në to. Kështu, fjalëformimi del më i papërfillshëm, ngaqë, me sa duket, nuk trajtohet në gramatikat klasike. Gjithnjë sipas John Lyons-it, “trajtimi i fjalëformimit është një gjest i ngathët dhe teorikisht jokonsekuent”. Përfshirja e eptimit dhe e derivacionit në morfologji ka ndodhur në shekullin XIX, atëherë kur u fut ajo për herë të parë në gjuhësi; në “Enciklopedinë e gjuhës të Kembrixhit” (1987) si dhe në “Leksikonin e gjuhësisë modernë”, të autorit David Crystal, fjalëformimi trajtohet në kuadër të morfologjisë, ndonëse përshkruhen edhe mëdyshje në lidhje me këtë çështje. Sipas tij, fjalët qëndrojnë në mënyrë jo komode midis morfologjisë dhe sintaksës, se fjalëformimi në kuptim të mirëfilltë përfshin vetëm derivacionin, i cili shpreh raportet leksikore, se morfologjia derivative heton parimet që udhëheqin ndërtimin e fjalëve të reja pa marrë parasysh rolin e veçantë gramatikor që mund ta ketë ajo fjalë në fjali.

Në veprën e Steven Pinkerit (1999) “Fjalë dhe rregulla: Elementet përbërëse të Gjuhës” derivacioni vështrohet si objekt i gramatikës, pra, “gramatika është shkenca mbi tingujt, format, fjalëformimin dhe sintaksën”, pastaj “fjalëformimi është pjesë e veçantë e gramatikës”, duke nënkuptuar morfologjinë dhe sintaksën. Ndërkohë, jepet edhe mendimi se fjalëformimi i përket vetëm e morfologjisë. Po sipas këtij studiuesi, gjendja e tanishme në gjuhësi paraqitet si sistemim

¹⁹ F. Agalliu, *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f.38

i disiplinave apo i degëve gjuhësore: kështu, linguistikën e përbëjnë fonologjia, fonomorfolgjia, morfologjia, sintagmatika, sintaksa, fjalëformimi, leksikologjia, stilistika, psikologjia e fjalës, linguistika sociologjike, linguistika gjeografike dhe filozofia e gjuhës. Siç shihet, ky sistem me 12 degë përfshin edhe fjalëformimin më vete, njëlloj si fonetika e fonomorfolgjia, i cili ndahet në shkencën mbi strukturën morfologjike, derivacionin e fjalëve të reja, çerdhet fjalëformuese, dhe në shkencën mbi kompozimin, kufirin midis fjalëve të përbëra dhe mënyrën e bashkimit të fjalëve. Gjuhëtari Rahmi Memushaj e sheh fjalëformimin në kuadër të morfologjisë, e cila ndahet në morfologjinë e eptimit dhe në morfologjinë e fjalëformimit. Autori arrin në përfundimin se vendosja e kufijve brenda nënsistemeve të morfologjisë, midis fjalëndryshimit dhe fjalëformimit, është punë e vështirë.²⁰

U ndalëm në këto burime teorike gjuhësore për të vënë në dukje mëdyshjet që lidhen me përcaktimin e vendit të fjalëformimit në tekstet gjuhësore dhe sot, mëdyshje që më së shumti burojnë nga mospërcaktimi i kufijve ndërmjet semantikës dhe gramatikës, problem ende i pazgjidhur në teorinë gjuhësore. E njëjta pamje vërehet në gramatikat e tekstet shkollore në gjuhë të ndryshme, ku bie në sy mungesa e parimësisë. Në tekstet mësimore të dhjetëvjeçarit të fundit hetohen përpjekjet për përputhje me pikëpamjet e shprehura në gjuhësinë bashkëkohore.²¹

Nisur nga pohimet e mësipërme, gjykojmë se fjalëformimi përfundimisht duhet të përfshihet në leksikologji, si dukuri më vete, për këto arsye: së pari, është “mitra” pjellore e gjuhës, burimi i vetëm pasuror i saj; së dyti, fjalët e përbëra dhe fjalët e përngjitura kanë lidhje përafrie me njësitë frazeologjike dhe idiomat në rrafshin kuptimor, pse jo edhe në rrafshin ndërtimor, përderisa shkrimi bashkë, me vizë ose veç e veç, është zgjidhje konvencionale; së treti, vetë huazimet janë sjellje fjalëformuese, ngaqë përpunohen në “magjen” e gjuhës marrëse.

Studimet për fjalëformimin kanë përparuar ndjeshëm, qoftë për sa i përket këndvështrimit morfologjik, qoftë për sa i përket këndvështrimit semantik, veçanërisht në sajë të studimeve të thelluara mbi prejardhjen e fjalës. Ndërkaq, analizat e fjalës si sistem morfemash dhe si strukturë, studimet mbi parashtesimin, prapashtesimin, kompozimin, përngjitjen, dhe sidomos ato që merren me zhvillimin dhe ndërtimin kuptimor të llojeve të ndryshme të fjalës, duhet të vazhdohen, të zgjerohen dhe të thellohen, duke shfrytëzuar prirjet e reja që pasqyrohen në teorinë modernë të fjalës, sepse deri tani ato janë mbështetur në metodat tradicionale të hulumtimit gjuhësor. Pra, si në gramatikat shkollore e universitare, ashtu edhe në vështrimet studimore, fjalëformimi është trajtuar njëkohësisht në dy degë gjuhësore: në morfologji dhe në leksikologji; si në gramatikën e Kostaq Cipos, ashtu edhe në gramatikat e mëpastajme, të botuara në vitet 1950, 1960, 1970, deri te botimi e ribotimet dhe plotësimet e fundit të gramatikës së ASHSH-së, është vepruar kështu, natyrisht me disa ndryshime që nuk prekin parimin themelor. Trajtimi i tij në këto dy disiplina i përmbahet parimësisë.

Në mënyrë tradicionale, shtjellimi fillon me përkufizimin se fjala mund të jetë e thjeshtë, e prejardhur dhe e përbërë; jepen parashtesat e prapashtesat, si dhe kategoritë e fjalëve, ku paraqiten më prodhimtare; trajtohet si problem i veçantë edhe në kuadër të kategorive gramatikore (emër, mbiemër, folje etj.); hollësisht përshkruhen veçoritë morfologjike të fjalëve, motivet dhe mënyrat e arritjes së gjedhes fjalëformuese; nuk mungon qasja ndaj çështjeve semantike, por ato vështrohen në plan të dytë; fjalët e prejardhura klasifikohen në mënyrë të përgjithësuar sipas kuptimit, në varësi nga gjymtyrët fjalëformuese që marrin pjesë në to; në

²⁰ R.Memushaj, *Morfonologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1989, f.24

²¹ Po aty.

raste të rralla u kushtohet rëndësi rasteve të veçanta, të cilat për shmangen nga rregullsia fjalëformuese e klasës së cilës i përkasin.²²

Kohët e fundit, hetohet ndonjë ndryshim në trajtimin e fjalëformimit në gjuhësinë tonë; kjo vërehet edhe në tekstet mësimore, edhe në gramatika. Në ndonjërin syresh (gramatika e Mehmet Çelikut dhe gramatika e Bahri Becit), fjalëformimi trajtohet si kapitull më vete. Në këtë pikë, për sa i takon trajtimin të problemeve më specifike të fjalëformimit, studimet e autorëve të ndryshëm nuk dalin jashtë kufijve të përcaktimit të tij tradicional në morfologji, të cilin e mbartin nga tekstet kodifikuese – gramatikat. Nuk ka as vështrime teorike të mirëfillta dhe të thelluara të këtij problemi.

Po kështu, në studimet bashkëkohore, vërehet depërtimi i semantikës dhe lidhja e fjalëformimit më shumë me leksikologjinë. Edhe në botimet e veçanta për problemet leksikologjike, sidomos në tri vëllimet “Studimit mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe” (I, II, Tiranë, 1972, III, 1989), fjalëformimi zë vend kryesor. Në sesionë dhe në konferenca shkencore, ky problem, edhe kur nuk përfshihet brenda leksikologjisë, i afrohet më shumë asaj se morfologjisë. Siç shihet, vendi i fjalëformimit në gjuhësinë shqiptare ende nuk është përcaktuar qartë dhe shoqërohet me të njëjta probleme që “shqetësojnë” gjuhësi të tjera.

Qëllimi nuk është të përmenden emrat e çdo njërit prej atyre që në gjuhësinë shqiptare e gjen gjykojnë fjalëformimin nga aspekti morfologjik, nga aspekti semantik, ose nga aspekti sintaksor, edhe pse ky i fundit, fatkeqësisht, nuk është përfillur, as për së afërmi, si duhet dhe sa duhet në gjuhësinë tonë teorike e praktike. Po ashtu, është e pamundur të sillen të gjitha problemet, tanimë të shqyrtuara, në këtë lëmë. Përveç kësaj, numri i tyre është i madh. Kemi paraqitur vetëm pikëpamjet dhe qëndrimet që lidhen me trajtimin e tyre nga pikëpamja morfologjike dhe nga pikëpamja semantike, të rëndësishme për shtjellimin e huazimeve – anglicizmave – duke pasur parasysh se gjuha shqipe, ashtu si mjaft gjuhë të tjera, vazhdon të pasurohet me ritme të shpejta përmes fjalëformimit që, sipas mendimit tonë, shfaqet si krijim fjalësh të reja (fjalëformimi i drejtpërdrejtë ose burimor), por edhe si “importim” fjalësh të huaja (fjalëformimi i tërthortë ose marrës), njëherësh.

²² M.Celiku, *Mbi analizën strukturore të fjalës*, në *Arsimi popullor* 6, 1964, f.56

Kreu i tretë: Huazimet – Anglizma në gjuhën shqipe, si gjuhë marrëse

3. 1. Përkufizimi

“Huazim” quhet fjala që përvetëson gjuha amtare nga gjuha e huaj në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përmes përkthimit të pjesshëm ose duke e shmangur plotësisht përkthimin. Përkundrazi, “kalku”, pra, fjala ose shprehja e përkthyer, edhe pse përfshihet në këtë dukuri, përftohet përmes huazimit të kuptimit ose të idiomës, në vend të vetë njësisë leksikore gjegjëse.

Megjithëse huazimet janë shumë më të pakta se fjalët burimore të shumicës së gjuhëve, ato kuptohen dhe përdoren gjerësisht, sepse shërbejnë për qëllime të ndryshme, për shembull, për t’u vënë emrin shpikjeve të reja.

Gjuhëtari gjerman Hugo Shuhart pohonte se asnjë gjuhë nuk është krejtësisht e pastër. Pra, s’ka gjuhë të ndonjë populli të qytetëruar që s’ka elementë të gjuhëve të tjera.

Blumfildi (Bloorfield) dallonte të huazuarit intim apo të drejtpërdrejtë dhe të huazuarit kulturor apo të tërthortë. Të huazuarit e drejtpërdrejtë, sipas tij, është kur dy gjuhë fliten në bashkësinë unike në pikëpamje topografike dhe politike. Të huazuarit e tërthortë bëhet ndërmjet dy kombeve që topografikisht dhe politikisht nuk janë një njësi. Ky kontakti i fundit, sipas autorit, është më i rrallë se i pari.

Rudolf Filipoviç konsideron se ata që sjellin me vete elemente gjuhësore janë në radhë të parë bilingët e gjuhës marrëse, ndërsa ata në përgjithësi janë intelektualët, udhëtarët, turistët, punëtorët që punojnë jashtë vendit etj.

Të huazuarit, pa dyshim, dallon nga shumë rrethana të ndryshme shoqërore, politike dhe ekonomike. Gjuha që flitet në një vend me shkallë të lartë të arsimit dhe të kulturës huazon më pak nga ndonjë gjuhë tjetër. Ndërsa në një shoqëri të zhvilluar jo sa duhet, me kulturë dhe arsim jo të lartë, ka gjasa që të huazohet më shumë nga ndonjë gjuhë tjetër e cila i përket një populli apo një shoqërie të zhvilluar. Kështu, dikur shumë gjuhë evropiane dhe të tjera huazonin nga frëngjishtja, e cila kishte status të lartë politik (diplomatik), po edhe ekonomik. Nga ajo huazonte edhe rusishtja. Ndërsa sot huazohet pothuaj në të gjitha gjuhët nga anglishtja. Kjo bëhet jo për shkak të ndonjë ndikimi të madh të Anglisë, por pikërisht të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Arritjet e mëdha të tyre në shkencë, në teknikë dhe në ekonomi, në përgjithësi, ndikojnë që shumë anglicizma doemos të futen në fjalorë të shumë gjuhëve.

Pastaj, po të tërhiqej një segment ndërmjet shqipes së folur në FYROM dhe shqipes së folur në SHBA, shihet se pakrahasueshëm më shumë anglicizma huazon shqipja në SHBA nga ajo në FYROM. Arsyet janë fare të qarta: shqipja në rastin e parë me statusin e vet të plotë të një gjuhe publike (e shkollës, e zyrës, e mjeteve të komunikimit masiv), e barabartë me të gjitha gjuhët e tjera që fliten në të njëjtën trevë, se dhe duke qënë larg nga treva ku flitet anglishtja, huazon shumë pak anglicizma, ndërsa në rastin e dytë gjuha shqipe, si qindra gjuhë të tjera të grupeve etnike që nuk kanë ndonjë status të gjuhës publike, gjallëron nën presionin e jashtezakonshëm të anglishtes, prandaj edhe të huazuarit nga anglishtja është pasojë e evidente.

Të dhëna të ndryshme që dalin nga statistikat gjuhësore vërtetojnë se sasia e të huazuarit nga ndonjë gjuhë dhënëse është krahasimisht e vogël në raport me gjuhën marrese. Sipas shumë pohimeve të gjuhëtareve, që është edhe logjike, sasia e të huazuarit me largesinë e vendit të gjuhës dhenëse qëndrojnë në përpjestim të zhdrejte: nëse gjuha që shërbën si burim i të huazuarit është gjeografikisht larg gjuhës marrese, të huazuarit pritet të jetë në sasi të vogël dhe të ketë ndikim po ashtu të vogël në gjuhën marrese, ndërsa nëse gjuhët dhenëse dhe marrese janë në kontakt të drejtpërdrejtë, nëse ato fliten në të njëjtën trevë ose janë fqinjë, ndikimi është shumë më intensiv dhe thuajse i përhershëm. Njerëzit në përgjithësi, e sidomos gjuhëtarët, nuk brengosen kur të huazuarit haset në një shkallë të parëndësishme. Mirëpo, ata fillojnë të bejnë llogari kur të huazuarit haset në përqindje të lartë dhe zakonisht fillojnë të marrin masa për ta penguar shtimin e mëtejshëm të asaj përqindjeje të ndikimit.

Mirëpo, në ndikimin gjuhësor ka dorë edhe qëndrimi i folesit ndaj gjuhës së dytë, përkatesisht ndaj gjuhës dhënëse. Dihet se të huazuarit bëhet nëpërmjet individëve, madje nëpërmjet individëve të posaçëm të një komuniteti. Individët, sidomos të arsimuarit që punojnë në profesione të ndryshme, huazojnë edhe elemente të ndryshme nga gjuhët e huaja, secili në fushën e vet të punës. Për këtë arsye nuk mund të dihet kurrë në mënyrë të saktë cilat fjalë të huaja janë huazuar deri në një kohe të caktuar. Në shumë fusha huazimet mbeten për një kohë të gjatë inventar gjuhësor „detern“, d.m.th. vetëm i atij grupi që e ka atë lëm të ngushtë: vetëm pjesëtarët e atij grupi të ngushtë profesional komunikojnë ndërmjet tyre duke i përdorur ato huazime. Kështu, po të hynte njëri në mesin e teknikëve të televizionit, mahnitet kur dëgjon aq shumë emra stabilimentesh teknike në gjuhë të huaja (sot kryesisht anglisht). Disa nga ato fjalë e shprehje shumë më vonë mund ta marrin dhenë, ndërsa shumë prej tyre kurrë nuk dalin nga ai rreth.

“Ndikimi i një gjuhe në gjuhën tjetër quhet edhe *interferencë* (ndërndikim) gjuhësore. Interferenca është përdorim i tipareve që i përkasin një gjuhe kur flitet ose shkruhet një gjuhë tjetër, thotë gjuhëtari i shquar kanadez Meki (Mackey). Pra folësi që është biling, duke folur në njëren gjuhë, mund të përdorë elemente të gjuhës tjetër dhe ashtu të shkaktojë që të bëhet shmangie nga norma e një gjuhe duke u bërë interferenca nga gjuha tjetër. Interferenca mund të haset në fusha të ndryshme gjuhësore, në leksik, në gramatikë, në fonologji ose në fonetikë dhe në semantikë. Folësi bën interferencën zakonisht në një drejtim, rëndom prej gjuhës së huaj në gjuhën e vet. Sadoqë një folës mund të bëjë interferencë nga gjuha e tij e parë (amtare) në gjuhën e dytë (të huaj), ajo mbetet interferencë vetëm e ligjëritimit të tij dhe mjaft rrallë mund të përhapet të folësit burimorë.

Në të vërtetë, folësit burimorë e marrin si gjë të zakonshme që një folës i gjuhës tjetër të bëjë shmangie norme në gjuhën e tyre. Mirëpo kur folësi i gjuhës burimore sjell ndonjë risi, ndonjë element të huaj, pra, ndonjë interferencë në gjuhën e vet, e nëse kjo përsëritet shpesh, ka gjasa që folësit e tjerë ta marrin atë risi, atë element, pra, ta përvetesojnë dhe ta fusin në ligjërimin e tyre. Siç duket, folësit e tjerë kanë besim në folësin burimor që huazon elemente të huaja. Natyrisht, në këto raste ndikojnë shumë faktorë të tjerë shoqërorë dhe gjuhësorë. Gjuha nuk e pranon dosido çdo element të huaj. Të rralla janë elementet e huaja që shtresohen në gjuhën marrëse në krahasim me ato që pranojnë të futen në atë gjuhë. Mirëpo, me rrjedhën e kohës ato elemente mund të grumbullohen dalëngadalë dhe një ditë mund edhe ta vërshojnë gjuhën marrëse.

Mendohet dhe thuhet zakonisht se bartësit kryesorë të huazimeve ose shkaktarët e interferencës gjuhësore janë *bilingët*. Ndërsa sa i përket çështjes së bilinguizmit, autorë të

ndryshëm kanë mendime pak a shumë të ndryshme. Derisa Blumflldi pohonte se biling mund të quhet dikush që i njëh dy gjuhë njësoj si gjuhën burimore, Haugeni thotë se biling mund të jetë ai folës i cili mund të prodhojë thënie plotësisht kuptimplotë në gjuhën tjetër. Ndërsa Dibolt (Dieboldt) parasheh se për të qënë biling njëriu duhet të ketë „njohje pasive të gjuhës së shkruar ose çfarëdo kontakti me modelet e mundshme të gjuhës së dytë dhe aftësi për t'i përdorur ato në rrethanat e gjuhës burimore". Haugeni në një vend tjetër pohon që dikush për t'u quajtur biling mjafton t'i njohë dy gjuhë, ndërsa nuk është e domosdoshme edhe t'i përdorë ato.

Rrjedhimisht, në bazë të këtyre pohimeve të gjuhëtareve, e sidomos në bazë të studimeve më të reja, shkalla e zotërimit të çdo gjuhe e bilingut mund të ndryshojë, duke u nisur që nga zotërimi i plotë i dy (ose me shumë) gjuhëve deri në njohjen elementare të gjuhës së dytë. Duket se nuk ekziston biling me kompetencë të njëjtë në dy apo më shumë gjuhë. Po edhe sikur të ekzistonte, siç thotë Fogti ai nuk do të ishte me interes për të hulumtuar interferencën gjuhësore sepse ajo nuk do të paraqitej tek ai folës fare. Përkitazi me bilinguizmin, Meki pohon se pika në të cilën folësi i një gjuhe të dytë bëhet biling caktohet në mënyrë arbitrare ose është e pamundshme për t'u përcaktuar.

Folësi biling ka kompetencë të dyfishtë. Ai tenton të krijojë një mostër e cila i rrafshon dallimet ndërmjet gjuhës burimore dhe gjuhës së dytë. Në situatën kur gjuhët janë në kontakt, folësi i tillë e ka vështirë t'i ruajë të dy kodet (gjuhët) të painfektuara nga njëri apo tjetri. Rezultati që del nga përvoja e këtillë gjuhësore është se bilingu pak nga pak kalon nga të dy gjuhët në një gjuhë (të tretë) me elemente nga të dyja gjuhët e meparshme .

Çështja e ndikimeve ndër-gjuhësore, duhet thënë, nuk është objekt thjesht gjuhësor, ajo është më tepër çështje sociologjike dhe antropologjike e lidhur ngushtë me gjuhësinë. Interferencat gjuhësore, pra, mund të vështrohen nga shumë pikëshikime. Përndarja funksionale e çdo gjuhe në shoqëri multilinguiste si dhe qëndrimi i folësve ndaj gjuhëve që i flasin përbën atë që mund të quhet pikëshikim sociokulturor (kulturor shoqëror). Mund të shqyrtohet, po ashtu, edhe shkalla e njohjes së çdo gjuhe nga ana e folësit. Studime te tilla janë bërë në shumë vende, sidomos në Kanada.

Çështje shumë e rëndësishme gjatë studimit të bilinguizmit dhe interferencave gjuhësore kudoqoftë është mbledhja e të dhenave të rëndësishme demografike të cilat do të tregojnë se cilët folës dhe sa prej tyre si dhe në cilën trevë e përdorin ndonjë gjuhë të huaj dhe me çfarë kompetence e përdorin atë gjuhë. Informatat e tilla zakonisht nuk ekzistojnë ose janë të shkapërderdhura, prandaj gjuhëtari për t'i përcaktuar faktorët shoqërorë që ndikojnë në dukurinë e bilinguizmit dhe të interferencave gjuhësore duhet t'i mbledhë vetë ose me anë të studimeve të tjera të bera më parë.

“Anglicizëm” quhet fjala e huazuar nga gjuha angleze, duke u bërë “pronë” e gjuhës amtare. Qëndrimet ndaj anglicizmave janë të kundërta. Kështu, disa folës i quajnë të padëshirueshme dhe dëshmi të ndotjes gjuhësore, ndërkohë që qarqe të tjera i quajnë të nevojshme dhe shprehje të begatisë gjuhësore.

Këto qëndrime pasqyrohen më së miri në fjalitë e mëposhtme:

“Duhet të ruhem nga përdorimi me tepri i anglicizmave”.

“Anglicizmat e pasurojnë gjuhën shqipe me koncepte të reja”.

“Anglicizmat e dëmtojnë gjuhën shqipe”.

“Ndryshimet e gjuhës janë krejt të natyrshme në epokën tonë të globalizmit”.

Vitet e fundit, në Republikën e Shqipërisë, në Republikën e Kosovës, në Republikën e Maqedonisë dhe në Republikën e Malit të Zi, thënie të tilla shkruhen e thuhën gjithnjë e më

shpesh, por problemit në fjalë ende nuk i është dhënë “zgjidhje e drejtë”.

Gjuhëtari i madh zviceran, Ferdinand de Saussure, ka thënë se gjuha është lumë që rrjedh pareshtur.²³ E tillë është edhe gjuha jonë amtare. Ajo ka rrjedhur qysh nga zanafilla, është zhdërvilluar dhe pasuruar ndër shekuj, duke u mbrujtur me fjalët dhe shprehjet më të bukura të popullit dhe ka bërë të vetat përkryerjet e njerëzve më të shquar të penës të kombit tonë.

E, në këtë rrjedhë të furishme, nuk ka mënuar “të huajë” edhe gjëra të spikatura nga simotrat e saj, fjalë e shprehje të bukura që, me kalimin e kohës, ndihen si në “shtëpinë e vet” në “shtratin” e lumit të shqipes. Ndër ato që kanë gjetur vend fort bukur në mjedisin tonë gjuhësor dhe kulturor janë edhe huazimet, në daç si fjalë, në daç si kalke, në daç si njësi frazeologjike, në daç si idioma, në daç si fjalë të urta, në daç si proverbat, në daç si thënie të njerëzve të shquar, të cilat, shpesh, duke kaluar nga një gjuhë në tjetrën, kanë mbetur anonime. Duke studiuar këtë realitet gjuhësor, huazimet – anglicizmat - nuk duhet të vështrohen si “mish i huaj” në trupin e shqipes, por pjesë e saj si gjuhë kulture, si dëshmi e marrëdhënies të ndërsjellëta me kulturat e popujve të ndryshëm, dhe si shprehje konkrete e përngritjes kulturore të popullit shqiptar.

Popujt, sot e gjithë kohën, kanë përfituar nga kultura e njëri-tjetrit. Në këtë kuptim, hyrja dhe përdorimi i huazimeve është dukuri që haset në të gjitha kombet e zhvilluara. Edhe në gjuhën shqipe kjo është dukuri e vënë re prej kohësh. Por, vitet e fundit, në gjuhën tonë amtare ka prurje të mëdha, herë-herë të panëvojshme, veçanërisht të anglicizmave, prandaj, edhe punimi ynë do të përqëndrohet në mënyrën e përdorimit të tyre në realitetin gjuhësor shqiptar.

Ndërkohë, me “anglicizëm” nënkuptohet gjithashtu edhe futja, pranimit, në gjuhën amtare i sintaksës, gramatikës, kuptimit dhe strukturës së gjuhës angleze, me modifikime të shkallëve të ndryshme.²⁴

Gjuhët, si kulturat, rrallë i mjaftojnë vetvetes. Nëvoja për marrëdhënie i sjell folësit e një gjuhe në kontakt të drejtpërdrejtë apo të terthortë me ata të gjuhës fqinjë ose me gjuhën e folësve që kanë kulturë mbizotëruese. Kjo marrëdhënie mund të jetë miqësore ose armiqësore. Ajo mund të përparojë ndonjë plan të zakonshëm afarist dhe marrëdhëniet tregtare, ose mund të konsistojë në huazime apo këmbime të gjërave shpirtërore - të shkencës, të fesë. Do të ishte vështirë të tregohej ndonjë gjuhë si e izoluar, kjo më së paku midis popujve primitivë. Fisi nganjëherë është aq i vogël saqë janë të rëndomta martesat midis fiseve që flasin dialekte ose gjuhë të ndryshme që nuk janë fare të afërta. Madje mund të dyshohet nëse martesat e përziera, tregtia ndërfisnore si edhe këmbimet e përgjithshme kulturore s'kanë rëndësi më të madhe për lidhjet në nivelet primitive sesa në nivelin tonë.

Çfarëdo që të jetë shkalla ose natyra e kontaktit midis popujve fqinjë, zakonisht mjafton që ajo të prijë drejt ndonjë ndërnikimi gjuhësor. Ndikimi shpesh shkon në mënyrë të konsiderueshme vetëm në një drejtim. Gjuha e një populli, që shikohet si qëndër e kulturës, ka shumë më tepër gjasa të ushtrojë ndikim të dukshëm mbi gjuhët e tjera që fliten në afersi, se sa të ndikohet prej tyre. Kinezishtja me leksikun e saj i ka vërshuar me shekuj gjuhët koreane, japonishten dhe anamishten, por asgjë s'ka marrë prej tyre. Në Evropën Perëndimore të mesjetës dhe të kohës së re frëngjishtja ka ushtruar ndikim të ngjashëm, ndonëse më të vogël. Anglishtja ka huazuar një numër shumë të madh fjalësh nga frëngjishtja e pushtuesve romanë, më vonë natyrisht, nga frëngjishtja e oborrit të ishullit të Francës përshtati një numër elementesh

²³ F. De Saussure, *Kurs i gjuhësisë së përgjithshme*, Dituria, Tiranë, 2002, f.184

²⁴ V.Nuhiu, *Ndikimet ndërgjuhësore*, Rilindja, Prishtinë, 1990, f.206

ndajshesore me vlerë prejardhjeje (p.sh. *-ess* në *princess*, *-ard* në *drunkard* „pijanec“, *-ty* në *royalty* „privilegje“ mbretërore), mund të kenë qënë nxitur nga kontakti me frëngjishten në zhvillimin e tyre të zakonshëm analitik,²⁵ madje lejoi që huazimet frënge të ndryshonin pak modelin fonetik të anglishtes (p.sh. *v* dhe *j* nistore në fjalet si *veal* „mish viçi“ dhe *judge* „gjq, gjykim“, në fjalët me origjinë anglosaksone *v* dhe */xh/* mund të hasen vetëm pas zanoreve, p.sh. *over* “mbi, përtej”, *hedge* „gardh“). Por anglishtja, praktikisht, gati nuk ka ushtruar ndikim mbi frëngjishten.

Lloji më i thjeshtë i ndikimit të një gjuhe mbi tjetrën është „të huazuarit“ e fjalëve. Kur ekziston të huazuarit kulturor, gjithmonë ka gjasë që gjithashtu të huazohen edhe fjalët që kanë lidhje me të. Kur popujt e hershëm gjermanikë të Evropës Veriore mësuan se pari për verën dhe për rrugët me trotuare nga kontaktet tregtare ose luftarake me romakët, ishte gjë fare e natyrshme që të përvetësonin fjalet latinë për ate pije të panjohur (*vinum*, anglisht *winë*, gjermanisht *Wein*) dhe për tipin e panjohur të rrugës (*strata/via*, anglisht *street*, gjermanisht *Strasse*). Më vonë, kur depërtoi krishtërimi në Angli, një numër fjalësh lidhur me të, si *bishop* „ipeshkv“ dhe *angel* „ëngjell“ hynë edhe në anglishte. Dhe kështu vazhdoi ky proces pa ndërprerje deri tani, duke sjellë çdo valë kulturore depozitim të ri huazimesh në gjuhë.

Studimi me kujdes i këtyre huazimeve jep një shpjegim interesant në histori të kulturës. Nga kjo gati mund të vlerësohet roli që e kanë luajtur popujt e ndryshëm për zhvillimin dhe shpërndarjen e ideve kulturore, duke shënuar shtrirjen e fjalëve që kanë depërtuar në gjuhën e popujve të tjerë. Kur kuptojmë se japonezi i arsimuar mezi mund të thotë një fjali të gjuhës letrare pa përdorur burime kineze, se sijamezët dhe birmanezët si edhe kampucianët ende e ndjekin shkrimin e pagabuar të sanskritishtes dhe të gjuhës pali që kanë depërtuar me të huazuarit hindus shekuj më parë, apo nëse vendosim që të mësohet apo të mos mësohet greqishtja dhe latinishtja, ky argument sigurisht duhet të jetë i ngjeshur me fjalë që na kanë ardhur nga Roma dhe Athina, mund ta marrim me mend atëherë se çfarë roli kanë pasur kultura e hershme kineze, budizmi dhe qytetërimi klasik mesdhetar në historinë e botës.

Vetëm pesë gjuhë kanë pasur rëndësi të gjithmbarshme si bartëse të kulturës. Ato janë kinezishtja klasike, sanskritishtja, arabishtja, greqishtja dhe latinishtja. Në krahasim me këto, madje edhe gjuhë të tilla me rëndësi kulturore si hebraishtja dhe frëngjishtja bien në vend të dorës së dytë. Është pak për t'u dëshpëruar kur mësojmë se ndikimi i përgjithshëm kulturor i anglishtes deri tani është i padukshëm. Vetë gjuha angleze po përhapet, sepse anglezet kanë kolonizuar teritore të mëdha. Por asgjë nuk tregon se ajo po hyn diku në zemrën e leksikut të gjuhëve të tjera ashtu siç është larosur kompleksi anglez nga frëngjishtja ose siç ka përshkuar arabishtja persishten ose turqishten. Vetë ky fakt është i rëndësishëm për fuqinë e nacionalizmit, po ashtu edhe për fuqinë kulturore dhe politike gjatë shekullit të kaluar. Prandaj të huazuarit s'ka rezistenca psikologjike, ose s'ka burime të reja të të huazuarit e që nuk ishin shumë të gjalla në Mesjetë ose gjate Rilindjes.

A ekzistojnë rezistenca të natyrës më intime ndaj të huazuarit të fjalëve? A supozohet zakonisht se natyra dhe shtrirja e të huazuarit varen plotësisht nga të dhënat historike të marrëdhënieve kulturore, e nëse gjermanishtja, për shembull, ka huazuar nga latinishtja dhe frëngjishtja më pak se anglishtja, kjo ka ndodhur vetëm për shkak se Gjermania s'ka pasur marrëdhënie aq intime sa Anglia me kulturën e sferave të Romës klasike dhe të Francës. Kjo

²⁵ Studiuesit e hershëm të anglishtes, megjithatë e zmadhuan shumë efektin e „çintegrimit“ të zakonshëm frëng në anglishten e mesjetës. Anglishtja ecte shpejt kah struktura me analitikë shumë para se të zinte vend ndikimi i frëngjishtes.

është e vërtetë, deri diku, por këtu nuk qëndron krejt e vërteta. Nuk duhet ta ekzagjerojmë rëndësinë fizike të pushtimit norman, as ta eliminojmë rëndësinë e faktit se pozita gjeografike qëndrore e Gjermanisë e beri atë veçanërisht të ndjeshme ndaj ndikimit të Francës gjatë gjithë Mesjetës, ndaj ndikimit humanist nga fundi i shekullit të pesëmbëdhjetë dhe fillimi i shekullit të gjashtëmbëdhjetë, dhe përsëri ndaj ndikimit të fuqishëm frëng në shekujt e shtatëmbëdhjetë dhe të tetëmbëdhjetë.

Duket fare qartë se qëndrimi psikologjik i vetë gjuhës që huazon ndaj materialit gjuhësor ka të bëjë shumë me gatishmërinë e saj për fjalë të huaja. Anglishtja është përpjekur për fjalë fare të njësuara, të pashkoqitshme, pa marrë parasysh se është ajo njërrrokëshe apo shumërrrokëshe. Fjalët si *credible* "i besueshëm", *certitude* "siguri", *intangible* „i paprekshëm" janë fare të mirëseardhura në anglishte, meqë çdonjëra paraqet ide të pandarë, të nuancuar mirë, sepse analiza e tyre formale (*cred-ible*, *cert-itude*, *in-tang-ible*) nuk është akt i domosdoshëm i mendjes së pavetëdijshme *cred-*, *cert-* dhe *tang*, s'kanë ekzistencë të vërtetë në gjuhën angleze sikur që ka *good-* në *goodness* „mirësi"). Fjalët si *intangible*, kur përshtaten njëherë, janë gati njësi psikologjike të thjeshta si çdo njërrrokësh rrënjor *vague* „i/e paqartë", *thin* „i/e hollë", *grasp* „kap").

Mirëpo, në gjermanishte fjalët shumërrrokëshe përpiqen të përfillen si elementë kuptimplotë. Prandaj një numër i madh fjalësh frënge dhe latine të huazuara me rastin e disa ndikimeve kulturore ka mundur të mbetet në këtë gjuhë. Fjalët latine-gjermanë si, *kredibël* dhe fjalët frënge-gjermane si, *reussieren* „kam sukses" s'kanë ofruar asgjë që t'i asimilonte mendja e pavetëdijshme vetëm pse ato ndihen dhe përdoren si fjalë. Duket sikur kjo mendje e pavetëdijshme të thoshte: "Dëshiroj të pranoj fjalën *kredibël* nëse ju vetëm më tregoni çka doni të thoni me *cred-*". Prandaj gjermanishtes zakonisht i është dukur më lehtë të krijojë fjalë të reja nga burimet e veta, sa herë që ishte nevoja.

Kontrasti psikologjik ndërmjet anglishtes dhe gjermanishtes sa i përket çështjes së materialit të huaj është punë që mund të haset në çdo pjesë të botës. Gjuhët atabaskane të Amerikës i flasin njerëzit që kanë pasur kontakte kulturore jashtëzakonisht të shumëllojshme, megjithatë, askund nuk gjejmë se ndonjë dialekt atabaskan ka huazuar fare lirisht nga ndonjë gjuhë fqinjë. Këto gjuhë gjithmonë e kanë pasur më lehtë të krijojnë fjalë të reja duke përberë forma të reja nga elementet që kanë pasur. Për këtë arsye ata kanë bërë rezistencë të madhe ndaj pranimit të gjurmëve gjuhësore të folësve të tyre që kishin përvujtë gjuhësore të huaj.

Gjuhët kampuciane dhe tibetiane ofrojnë kontrast të madh instruktiv me reagimin e tyre ndaj ndikimit sanskrit. Të dyja janë gjuhë analitike, secila dallon krejtësisht nga gjuha mjaft e përpunuar flektive e Indisë - sanskritishtja. Gjuha kampuciane është izoluese, por ndryshe nga kinezishtja, përmban shumë fjalë shumërrrokëshe, përimtimi etimologjik i të cilave nuk prish punë. Pra, si anglishtja në marrëdhënie me frëngjishten dhe latinishten, ajo u ka hapur dyert shumë huazimeve sanskrite, shumë nga të cilat kanë përdorim të zakonshëm. Ajo s'ka pasur rezistencë psikologjike ndaj tyre.

Letërsia klasike tibetiane ishte adaptim pikë për pikë i letërsisë hinduse budiste dhe budizmi nuk është mbjellë askund më fort se në Tibet, megjithatë është çudi sa pak fjalë sanskrite kanë marrë rrugën e kësaj gjuhe. Tibetishtja u ka rezistuar shumë fjaleve shumërrrokëshe të sanskritishtes për shkak se ato nuk mund të binin automatikisht në rrokje kuptimplotë siç është dashur të bënin për t'i kënaqur kerkesat tibetiane për formë. Tibetishtja, pra, u detyrua ta përkthente pjesën më të madhe të fjalëve sanskrite me barasvlera burimore. Dëshira e madhe e tibetishtes për formë përmbushej, ndonëse termat e huaja të përkthyer fjalë

për fjalë shpesh kanë përdhunuar lokucionin e vertetë tibetian. Edhe emrat e përveçëm me origjinë sanskrite përktheheshin me kujdes element për element të tibetishtes, p.sh. *Sryagarbha* "midis-dielli" është „tibetianizuar" me kujdes në *Nyi-mai snying po* „midis zemres", "zemra (thelbi) e diellit". Studimi i reagimit të gjuhës ndaj pranisë së fjalëve të huaja - duke i refuzuar, duke i përkthyer ose duke i pranuar lirisht - mund të hedhë drite të çmueshme në vështrimin e tendencave të brëndshme.

Të huazuarit e fjalëve të huaja gjithmonë sjell me vete ndryshimin e tyre fonetik. Sigurisht që do të ketë tinguj të huaj ose veçori të theksit që nuk përputhen me shprehjet fonetike të gjuhës burimore. Ato në atë rast ndryshojnë në atë mënyrë sa më pak t'i dëmtojnë ato shprehi. Shpesh kemi kompromis fonetik. Në fjalë të tilla angleze si *camouflage* "kamufllazh", shqiptimi i rëndomte tani nuk i përgjigjet përdorimit fonetik tipik as të anglishtes as të frëngjishtes. Tingulli *k* i aspiruar, zanorja e mbyllët e rrokjes së dytë, cilësia e pikërishme e u-së dhe e a-së, ndërsa mbi të gjitha, theksi i fuqishëm mbi rrokjen e parë, janë të gjitha rezultate të asimilimit të pavetëdijshëm të shprehive angleze të shqiptimit. Këto shprehi veçojnë qartë fjalën *camouflage* të anglishtes nga shqiptimi burimor francez. Nga ana tjetër, zanorja e gjatë, e rëndë, në rrokjen e fundit dhe pozita fundore e tingullit *zh* nuk i përkasin fare anglishtes, mu si në anglishten e mesjetës kur *j* /zh/ dhe *v* nistore dukej në fillim se nuk përputheshin plotësisht me përdorimin anglez, ndonëse tani nuk vërehet më ajo që atëherë ishte e huaj. Në të gjitha këto kater raste k-ja nistore, u-ja nistore, *zh-ja* fundore dhe a-ja si te fjala *father*, po e theksuar, anglishtja s'ka marrë tingull të ri, por vetëm e ka zgjeruar përdorimin e tingullit të vjetër.

Ndonjëherë paraqitet ndonjë tingull i ri, por zakonisht pa kaluar shumë kohë ai shkrihet. Në ditët e Coserit tingulli anglo-sakson y kishte kohë që ishte delabializuar në *i*, por një grup i ri i zanoreve y pat ardhur nga frëngjishtja (në fjalet si *due*, *value*, *nature*). Kjo y e re nuk mundi të qëndronte gjatë, por u diftongua në *iu* dhe u shkri së bashku me *ew* të anglishtes që gjendet në fjalet si *new*, i ri, e re" dhe *slew* „vrava, thera". Ky diftong nganjëherë paraqitet si *ju*, me ndryshim të theksit — *dew* (nga *deaw* anglosaksonë) si *due* (*dy* goserianë). Të dhënat si këto tregojnë sa me kokëfortësi i bën rezistencë gjuha përshtatjes rrënjësore ndaj modelit fonetik.

Megjithatë, dimë se gjuhët ndikojnë njëra mbi tjetrën në kuptimin fonetik dhe ai ndikim bëhet fare ndryshe nga marrja e tingujve të huaj, së bashku me fjalë të huazuara. Një ndër faktet më interesante që duhet të shënojnë gjuhëtari është paraqitja e paraleleve fonetike në gjuhë, pa kurrëfarë lidhjeje ose me lidhje shumë të largëta të një regjioni të kufizuar gjeografik. Këto paralele bëhen sidomos interesante kur shikohen në mënyrë kontrastive nga një perspektivë e gjërë fonetike. Ja disa shembuj. Gjuhët gjermanike, në përgjithësi, nuk kanë zhvilluar zanore hundore. Disa dialekte të gjermanishtes së epërme (suabishtja), megjithatë, e kanë hundorëzuar tani zanoren në vend të sekuencës së vjetër zanore - bashkëtingellore hundore (*n*). A është kjo çështje vetëm pse këto dialekte fliten në afërsi të frëngjishtes, gjë që bën të përtërihet përdorimi i braktisur i zanoreve të hundorëzuara?

Sidoqoftë, janë disa tipare të përgjithshme fonetike që e karakterizojnë holandishten dhe flemishten në krahasim, bie fjala, me dialektet e gjermanishtes veriore dhe të skandinavishtes. Një ndër to është prania e bashkëtingëlloreve mbylltore të pazëshme që janë të paaspiruara (*p*, *t*, *k*), të cilat kujtojnë cilësi të saktë metalike të tingujve përkatës frëngë, por që janë në kontrast me bashkëtingeloret mbylltore të forta, të aspiruara të anglishtes, të gjermanishtes dhe të danishtes. Edhe nëse supozojmë se këto bashkëtingëllore mbylltore të paaspiruara janë më të vjetra, se ato janë pasardhësit e bashkëtingëlloreve të gjuhës gjermanike të vjetër, a nuk është pra ky fakt me rëndësi historike që dialektet e holandishtes, fqinjë të frëngjishtes, e penguan nga

ndryshimi i atyre bashkëtingëlloreve që do të duhej të ishte në pajtim me atë që duket se ka qënë zhvillim i përgjithshëm fonetik i gjuhës gjermanike? Edhe më interesante se këto raste është ngjashmëria e veçantë, nga disa pikëpamje të posaçme fonetike, e rusishtes dhe e gjuhëve të tjera sllave me gjuhët e largëta uraloaltaike të regjionit të Volgës. Zanorja tipike e shurdhër, për shembull, që njihet në Rusishte si „jeri” ka analoge uralo-altaike por është tingull i „deshirit” në gjuhët gjermanike, greke, armene dhe indo-iraniane, gjuhë indoevropiane me të afërme me sllavishten. Mund të dyshojmë, së paku, se kjo zanore sllave nuk është pa lidhje historike me paralelet e veta uralo-altaike.

Një ndër rastet më enigmatike të paralelizmave fonetike gjendet në shumë gjuhë indiane të Amerikës që futen në perëndim të Andeve. Edhe me vlerësimin më rrënjësor dalin së paku katër grupe gjuhësore fare të palidhura që paraqiten në regjionin prej Alaskës Jugore deri në Kaliforninë Qëndrore. Gati të gjitha ose praktikisht të gjitha gjuhët e këtij regjioni të hapur kanë disa tipare të përbashkëta fonetike me rëndësi. Kryesorja prej tyre është prania e serisë së bashkëtingëlloreve mbylltore të „globalizuara” me formim shumë të veçuar dhe me efekt akustik fare të pazakonshëm. Në pjesën veriore të këtij regjioni të gjitha gjuhët, qoftë të afërta ose të largëta, kanë gjithashtu tinguj të ndryshëm të pazëshëm dhe një seri të bashkëtingëlloreve mbylltore „qiellzore” (guturale të sprasme) të cilat veçohen në mënyrë etimologjike nga seria e rëndomtë e ftesë. Është veshtirë të besohet se tri tipare të veçanta, si ato që i përmëndëm, kanë mundur të zhvillohen pavarësisht nga grupe gjuhësh fqinjë.

Si do t'i shpjegojmë këtë dhe qindra konvergjenca të ngjashme fonetike? Në raste të veganta vërtet ndoshta kemi të bëjmë me ngjashmëri të vjetra, për shkak të raportit gjenetik të cilin nuk jemi në gjendje ta vërejmë. Mirëpo, ky shpjegim nuk na shpie larg. Duhet flakur si fare të pavend, për shembull, shëmbujt që përmëndëm në dy nga tri gjuhët evropiane; të dy zanoret e hundorëzuara dhe „jeri” sllav, shihet se kanë origjinë të dores së dytë në indoevropianishte. Sadoqë ta shqyrtojmë në hollësi këtë proces, nuk mund të mos përfundojmë se ekziston një tendencë që tinguj të të folurit ose disa mënyra të veçanta të nyjëtimin të përhapen mbi një regjion, pikërisht ashtu si rrjedhin elementët e kulturës nga një qendër gjeografike. Mund të supozojmë se variacionet individuale që çojnë krye në kufijtë gjuhësore — qoftë nga ndikimi i pavetëdijshëm sugjestiv i shprehive të huaja të të folurit ose nga transferimi i vërtetë i tingujve të huaj në gjuhën e individëve bilingë — përfshihen gradualisht me zhvillimin fonetik të gjuhës. Gjersa çështja kryesore fonetike është ruajtja e modelit të tingullit e jo e tingujve si të tillë, nuk ka vërtet arsye pse një gjuhë nuk mund të asimilojë pavetëdijshëm tinguj të huaj që kanë arritur të gjejnë vend në gamën e variacioneve individuale, gjithmonë me kusht që këto variacione të reja (ose variacione të vjetra të nxjerra në shesh) të jenë në drejtim të gjuhës burimore.

Një ilustrim i thjeshtë mund të hedhë dritë mbi këtë koncept. Të supozojmë se dy gjuhë fqinjë dhe pa lidhje origjine, A dhe B, e kanë tingullin *l* të pazëshëm (krahaso *ll-në* e rusishtes). Na e thotë mendja se ky nuk është rast i vetëm. Ndoshta studimet krahasuese nxjerrin të dhënën se në gjuhën A tingulli *l* i pazëshëm i përgjigjet serisë së sibilantëve në gjuhët e tjera të afërme, se alternimi i vjeter *s:sh* ka kaluar në alternimin e ri *l* (e pazëshme: *s*).⁸ A del nga kjo se *l* e pazëshme e gjuhës B ka tendencë të fuqishme drejt liritimit të zhurmes së dëgjueshme në fund të fjalës, kështu që *l-zie* fundore si edhe zanoren e fundit, në fillim e ka përcjellë aspiracioni i dukshëm. Individët ndoshta kanë tentuar ta parashohin çlirimin e pazëshëm dhe ta „bëjnë të pazëshme” pjesën e dytë të tingullit *l* fundor (po ashtu si *Z-ja* e fjalëve angleze b. f. no *feel* (aoristi i *feel* „ndjej” që tenton të jetë pjesërisht e pazëshme në parashikimin e pazëshmërisë së *t-së*).

Megjithatë, kjo *I* fundore me tendencë të fshehtë drejt pazëshmerisë, ndoshta kurrë nuk do të ishte zhvilluar në *I* plotësisht të pazëshme, sikur të mos kishte vepruar prania e tingujve *I* të pazëshme në gjuhën A, si stimulim i pavetëdijshëm ose si shtytje sugjестive drejt ndryshimit me rrënjësor në vijën e zhvillimit të vetë gjuhës B. Posa është paraqitur Z-ja e pazëshme fundore, alternimi i saj në fjalët e ngjashme me Z-në mesore të zëshme si duket ka shpënë drejt përhapjes se saj analogjike. Del se si A ashtu edhe B kanë trajtim të rëndësishëm fonematik të përbashkët. Eventualisht, sistemet e tyre fonetike, gjykuar si ngjashmëri të thjeshta tingujsh, mund të asimilohen, madje plotësisht, njëri nga tjetri, ndonëse ky rast është shumë ekstrem, saqë gati kurrë nuk është sendërtuar në praktike. Çështje shumë me rëndësi rreth ndërndikimeve të tilla fonetike është tendenca e fuqishme e çdo gjuhe për ta ruajtur modelin e vet fonetik të paprishur. Sado që të dallojë radhitja përkatëse e tingujve të ngjashëm, sado që të kenë „vlera" dhe „pesha" të ndryshme në gjuhë me prejardhje të ndryshme, ato gjuhë nuk mund të thuhet se janë mënjeluar materialisht nga vija e rrjedhës së tyre qënësore. Në fonetike si edhe në leksik, duhet të kemi kujdes që të mos e teprojmë me rëndësinë e ndikimeve ndërngjuhësore.

Vumë në pah kalimthi se anglishtja ka huazuar një numër elementësh morfologjikë prej frëngjishtes. Anglishtja po ashtu përdor një numër ndajshitesash që rrjedhin nga latinishtja dhe greqishtja. Disa nga këto elemente të huaja, si *-ize* te fjala *materialize*, *materializojë*", ose *-able* në *breakable* „i thyeshëm" janë tani edhe produktive. Shëmbujt si këta mezi mund të vlejné si evidencë për ndikim morfologjik të një gjuhe në tjetrën. Duke lënë anash faktin se ato i përkasin sferës së koncepteve të prejardhura dhe nuk e prekin problemin qëndror morfologjik të shprehjes së ideve të ngjashme, ato nuk u shtojné asgjë veçorive strukturale të gjuhës. Anglishtja ka qënë gati e përgatitur për lidhjen e *pity* „dëm, keq" me *piteous* „i mjerë, i gJORë" me anë të palës burimore si *luck* „fat" me *lucky* „fatbardh". Raporti *material* — *materialize* vetëm e lekundi rangun e modelit të formes së njohur nga shëmbujt si *wide* „i/e gjerë" dhe *widen* „zgjeroj". Me fjalë të tjera, ndikimi morfologjik i ushtruar nga gjuhët e huaja në anglishte, nëse duhet të vlerësohet me shëmbuj si ata që përmëndëm, gati nuk dallon nga vetë të huazuarit e fjalëve. Futja e prapashtesës *-ize* gati nuk bëri më shumë ndryshim në ndërtimin qënësor të gjuhës se vetë fakti që ajo përzieu një numër fjalesh.

Sikur anglishtja të pësonte një kohë të ardhshme të re sipas modelit të kohës sintaksore të frëngjishtes, apo sikur të huazonte inkuadrimin apo dyfishimin e tyre si mjet funksional nga latinishtja ose greqishtja (latinishtja *tango: tetigi*, greqisht *leipo: le-loipa*) do të kishim të drejtë të flisnim për ndikim të vërtetë morfologjik. Por ndikime aq të gjera nuk vërehen. Gjatë tërë historisë së gjuhës angleze nuk mund të shënojmë gati asnjë ndryshim të rëndësishëm morfologjik që nuk e përcaktoi zhvillimi burimor, ndonëse aty këtu mund të pandehim se ai zhvillim është shpejtuar pak nga ndikimi sugjektiv i formave frënge. Ka rëndësi të kuptohet zhvillimi i vijueshëm, i pavarur morfologjik i anglishtes dhe shtrirja modeste deri ku ka pësuar ndërtimi i saj themelor nga ndikimet e jashtme. Historia e gjuhës angleze herë-herë është paraqitur sikur është kthyer në një lloj kaosi me arritjen e normave, të cilët vazhduan të loznin ballot me traditën anglosaksone. Sot studiuesit janë më konservativë. Se një zhvillim aq i gjërë mund të bëhet pa ndikim të huaj nga jashtë, siç mendohet për anglishten, është e qartë nga historia e danishtes, e cila me disa tendenca rrafshimi ka shkuar edhe më larg se anglishtja.

Gjuha angleze mund të shërbejë fare mirë si një provë *a fortiori*. Ajo ishte vërshuar nga huazimet frënge gjatë mesjetes së vonë, në kohën kur zhvillimi i saj drejt tipit analitik ishte veçanërisht i fuqishëm. Ajo, pra, ndryshonte shpejt si brenda ashtu edhe në sipërfaqë. Çështja tani nuk është se ajo ka marrë një numër tiparesh të jashtme, morfologjike, ka shtuar inventarin

konkret, por që ajo, ndonëse u ishte ekspozuar ndikimeve të formave, ngeli aq besnike ndaj tipit të vet dhe ndaj rrjedhës historike.

Përvoja e fituar nga studimet e gjuhës angleze përcaktohet me të gjitha ato që dimë nga historia e dokumentuar gjuhësore. Nuk gjejmë kund gjë tjetër, pos ndërlikimeve sipërfaqësore morfologjike. Nga kjo, pos tjerash, mund të përfundojmë edhe një gjë: se ndikimi vërtet serioz morfologjik nuk është ndoshta i pamundshëm, por veprimi i tij është aq i ngadalshëm, sa që gati kurrë nuk ka pasur rast të përmblihet as në pjesë relativisht të vogël të historisë gjuhësore, që të mbetet i hapur për shqyrtim; apo se janë disa kushte të volitshme që shkaktojnë tronditje të thella morfologjike nga jashtë, b.f. një lëkundje e veçantë e tipit gjuhësor ose një shkallë jo e zakonshme e kontaktit kulturor, kushte këto që nuk sendërtohen në materialet tona dokumentare, ose në fund, që s'kemi të drejtë të supozojmë se një gjuhë mund ta shtrijë lehtë ndikimin e formës morfologjike mbi një gjuhë tjetër.

Ndërkohë hasim në kundërshtim nga fakti se tipare të rëndësishme të morfologjisë shpesh gjenden nëpër gjuhë fare të ndryshme, brenda një regjioni të hapur, që vertet dallojnë aq shumë, sa që konsiderohen se kanë zanafilla të ndryshme. Ndonjëherë mund të dyshojmë se ngjashmëria është për shkak të njëllojshmërisë, se një tipar i ngjashëm morfologjik është zhvilluar pavarësisht në gjuhë me prejardhje të ndryshme. Megjithatë, disa përndarje morfologjike janë me karakter aq specifik, sa që nuk mund të pushojnë aq lehtë. Duhet të jete ndonjë faktor historik që i shpjegon ato. Tani nuk duhet të harrohet se koncepti i materialit lingistik kurrë nuk është i përcaktuar në kuptimin ekskluziv. Ne vetëm mund të themi me siguri të arsyeshme se cilat gjuhë rrjedhin nga burimi i përbashkët, por nuk mund të themi se kjo e ajo gjuhë s'kanë lidhje gjenetike. E gjithë çka mund të bëjmë është vetëm të themi se evidenca e raporteve nuk është mjaft përmbledhëse, sa për të sjellë përfundim krejtësisht të nevojshëm rreth origjinës së përbashkët. Shumë raste të ngjashmërisë morfologjike ndërmjet gjuhëve të ndryshme të një regjioni të kufizuar, ndoshta janë vetëm gjurmë të fundit të grupit të një tipi dhe substance fonetike, të cilat puna shkatërruese e rrjedhave të ndryshme i ka bërë që të mos njihen.

Sigurisht ka ende ngjashmëri të mjaftueshme leksikore dhe morfologjike ndërmjet anglishtes dhe irlandishtes, për të na bërë të mundur të kuptojmë këtë rast bindës për raportet e tyre gjenetike vetëm në mbështetje të evidencës përshkruese të sotme. Është e vertetë se ky rast do të dukej i dobët në krahasim me rastin që mund ta krijojmë me ndihmën e të dhenave historike dhe krahasuese që i kemi në dispozicion. Sidoqoftë, ky nuk do të ishte rast i keq. Brenda dy apo tre mileniumeve, pra, ka gjasa që pikat e ngjashmërisë të jenë shlyer aq shumë, sa që anglishtja dhe irlandishtja, duke munguar çdo gjë pos evidencës deskriptive, do të duhej të llogariteshin si gjuhë me gjeneza të ndryshme. Ato përseri do të kishin të përbashkëta disa tipare themelore morfologjike, por do të ishte vështirë të gjendej mënyrë për t'i vlerësuar. Vetëm në dritë të perspektivës kontrastive të gjuhëve edhe me të ndryshme, si të baskishtes dhe të finlandishtes, ato gjurmë të ngjashmërisë do ta fitojnë vlerën e vërtetë historike.

3. 2. Shtresimet e gjuhës së gjallë. Shtresimet e anglicizmave sipas grup-moshave.

Çdo shoqëri dhe çdo gjuhë e gjallë shtresohet në mënyra të ndryshme. Njerëzit e ndajnë veten e tyre dhe njëri tjetrin në grupime klasore, statusi social dhe pushteti. Për të kuptuar se si e përdorin gjuhën grup-mosha të ndryshme në duhet të dijmë se si janë shtresuar këto grup-mosha.

Kirby (1999: 3) e lidh shtresimin me pabarazinë. Ilustrimi i mëposhtëm tregon se si e trajton ai shtresimin dhe si e lidh ai këtë me shtresimin gjuhësor:

“Në thelb çështja e shtresimit ka të bëjë me pabarazinë. Në aspektin sociologjik, pabarazia është trajtuar duke analizuar mënyrën se si burime të ndryshme në shoqëri duket se shpërndahen sipas disa ndarjeve sociale, veçanërisht sipas ndarjeve klasore, gjinore dhe etnike.”

David Lane-i (1971) shkruan në parathënien e librit të tij: “Studimi i shtresimeve përfshin kuptimin e shoqërisë si një e tërë, të politikës së saj ekonomike, si dhe të sistemit të saj të vlerave dhe besimeve. Çdo formë shtresimi ka bazë ligjore; ajo ka “politikën e vet ekonomike”, arsyetimin e vet ideologjik.”

Crompton-i (cf. 1998: 1) shkruan se ka shumë pikëpamje lidhur me pabarazinë. Në kohëra të lashta, në shoqëritë tradicionale ose paraindustriale, pabarazia shoqërore si dhe shtresimi shoqëror konsideroheshin si të natyrshme, gjë që do të thotë se nëse pabarazitë janë të natyrshme, nuk është e nevojshme t’i shqyrtojmë ato. Një pikëpamje tjetër ngulmuese e trajton pabarazinë si diçka që buron nga një strukturim hyjnor, i paracaktuar i shoqërisë, gjë që do të thotë se toka i është dhënë qenieve njërezore nga Zoti më qëllim që t’u japë mundësi atyre të jetojnë në tokë duke synuar që të fitojnë shpëtimin e amshuar. Bota u transformua nga zhvillimi i industrializimit kapitalist apo ardhja e modernizmit. Duke zhvilluar më tej arsyetimin e krijimit të njërezimit nënkuptohet se të gjitha qëniet njërezore kanë lindur të barabarta. Pavarësisht nga kjo, pabarazitë vazhdojnë dhe kanë nëvojë të shpjegohen e të justifikohen. Disa i lidhin ato me gjëndjen e natyrës së jetës, e cila karakterizohet nga lufta e njëriut kundër njëriut. Shumë njerëz mendojnë se të drejtat e natyrshme të jetës mbrohen më mirë nga autoriteti i shtetit.

Për më tepër, Crompton-i (1998: 1) arsyeton se të gjitha shoqëritë komplekse karakterizohen në shkallë të ndryshme nga shpërndarja e pabarabartë e shpërblimeve materiale e simbolike. Ajo shkruan se ‘shtresimi shoqëror’ është një term i përgjithshëm, i cili përshkruan këto struktura sistematike të pabarazisë.

Carol Owen-i (1968: 16) mendon se pabarazia shoqërore është një tipar i përhershëm e gjithpërfshirës i shoqërisë njërezore që ka të bëjë me vlerësimin e cilësive dhe veprimeve të ndryshme të individëve. Sipas mendimit të saj, po të marrim si të qënë se këto cilësi e veprime të vlerësuar mund të çohen akoma më tej nëpërmjet transmetimit kulturor e shoqëror nga një brez më i vjetër tek një brez më i ri, mund të dallojmë një shtresë relativisht të qëndrueshme, e cila përbëhet nga njerëz të rangjeve të ndryshëm. Ajo vazhdon më tej me arsyetimin se një shoqëri e shtresuar do të shfaqë rregullsi rangjesh të cilët vazhdojnë të ekzistojnë në kohë dhe shoqërohen me shumë dallime në përvojën jetësore të popullit në atë shoqëri.

Shoqëritë e shtresuara karakterizohen nga dallime në gjuhë. “Sa më e shtresuar të jetë një shoqëri, aq më të mëdha do të jenë dallimet në gjuhë” (Blount dhe Sanches, 1977: 8).

David Crystal-i (1977: 19) mendon se gjuha është një mjet kryesor që e dallon një grup shoqëror nga një tjetër. Nichols-i (1984: 23) shkruan se statusi shoqëror i njerëzve tregohet nëpërmjet gjuhës. “Gjuha”, siç thotë Wittgenstein-i (1969), “është një ‘formë e jetës’ dhe si e tillë është një nga format nëpërmjet të cilës shfaqën marrëdhëniet tona”.

Gjuha është një tregues i marrëdhënies midis njerëzve. Ajo gjithashtu tregon pozitën që kanë njerëzit në shoqëri. Nichols-i (1984: 24) shkruan: “Gjuha, thuajse përtej çdo forme tjetër të jetës, mund ta na japë thelbin e marrëdhënieve konsensuale që arrihet midis pjesëmarrësve në situata bashkëbisedimi në lidhje me pozitën e tyre relative në shkallën shoqërore në çdo kohë e vend të veçantë”.

Përveç ayre që thamë më lart, shtresimet gjuhësore, konkretisht dhe shtresimet e

anglicizmave, lidhen dhe me grup-moshat. Gjuha e fëmijëve dhe e të rinjve ndryshon nga ajo e të rriturve. Studimet sociolinguistike tregojnë se gjuhët shtresohen sipas ndryshimeve që lidhen me klasat shoqërore, racat, grupet etnike e gjinitë specifike. Nichols-i (1984: 25) vë në dukje se fakti që fëmijët flasin ndryshe nga të rriturit në komunitetet e tyre bashkëbiseduese dhe që këto dallime janë të parashikueshme në gjuhë të ndryshme është dokumentuar mirë nga Ferguson-i dhe Slobin-i (1973).

Në Republikën e Shqipërisë, pas vendosjes së pluralizmit politik dhe hapjes së vendit, gjuha nuk mund të izolohej nga fjalët e huaja. Dy faktorët që kishin ndikuar në ruajtjen relative të pastërtisë së gjuhës, në mënyrë paradoksale, totalitarizmi dhe izolimi, filluan të zhduken. Vakuumi që u krijua nga shembja e regjimit totalitar, kërshëria e shqiptarëve për të përqaftuar progresin, sidomos për të prekur Amerikën e gjithshka amerikanë, kontakti me dukurinë botërore të globalizmit të anglishtes, e cila në vetvete përbënte një faktor të rëndësishëm që i nxiti njerëzit të rrëzojnë regjimin, ishin disa arsye që i motivuan folësit shqiptarë t'i pranojnë me zell huazimet e reja nga anglishtja në fjalorin e tyre. Në këtë situatë të re ndryshimesh dinamike të shoqërisë shqiptare paskomuniste, pasi potencialet e tyre njëzore kishin mbetur të porealizuara në shumë drejtime, i bënë shqiptarët e të gjitha moshave t'i hedhin sytë nga përendimi, nga demokracia. Fjalët e anglishtes nënkuptonin përparim, modernitet, liri dhe demokraci. Rregullat dhe ligjësitë gjuhësore, sidomos ato që lidhen me pastërtinë e gjuhës, nuk u respektuan si duhet me qënë se njerëzit kishin probleme më vitale e pragmatiste për të zgjidhur. Kjo dukuri mund të etiketohej si 'kontakt ekstra-linguistik'.

Fenomeni i kontaktit ekstra-linguistik (jashtë-gjuhësor) ilustron nga studjuesi Weinreich (cf. 1974: 3). Sipas mendimit të Weinreich-ut, një shpjegim i plotë i interferencës në situatën e kontaktit gjuhësor bëhet i mundur në qoftë se merren parasysh faktorët ekstra-linguistikë. Këta faktorë burojnë nga kontakti i sistemeve me botën e jashtme, nga njohja e individëve të caktuar me sistemin, si dhe nga vlea simbolike, të cilin mund ta evokojë sistemi në tërësi.

Ai arsyeton se kontakti gjuhësor konsiderohet nga disa antropologë pikërisht si një aspekt i kontaktit kulturor dhe se interferenca gjuhësore është një shfaqje e difuzionit kulturor dhe e kapërcimit të kufijve të ngushtë kulturorë. Rezultatet e transmisionit nuk mund të konsiderohen thjesht si përfitime suplementare. Ndryshimi kulturor normalisht përfshin jo vetëm shtimin e një ose më shumë elementëve të rinj në një kulturë të caktuar, por dhe eliminimin e disa elementëve që ekzistonin më parë dhe modifikimin e riorganizimin e të tjerëve. Është e rëndësishme të pranohet se një praktikë kulturore është e veshur me emocion, por kjo nuk është vendimtare për stabilitetin dhe as nuk është përgjegjëse për ndryshimet.²⁶ Weinreich-u vë në dukje se ajo që vendos për vazhdimësinë apo ndryshimet duket se është fakti nëse një praktikë është përfshirë ose jo në një sistem të organizuar të ideve e ndjenjave; me fjalë të tjera, deri në çfarë shkalle ajo është ndërthurur me elementët e tjerë të kulturës në një plan më të gjërë. Nëse është i lidhur në këtë mënyrë, ka shumë mundësi të ketë vazhdimësi, me qënë se sistemet e medha kanë prirjen për të qënë të qëndrueshëm. Por një tipar që është lidhur dobët dhe është në thelb shëtitës mund të zëvendësohet shumë shpejt.

Sipas Downs-it (1998: 223-224), të rinjtë janë të parët që përqafojnë të rejtat dhe progresin. Ai vë në dukje se shumë studime kanë treguar që folësit e rinj përdorin një 'varietet' që është i shmangur në maksimum nga një tjetër që është dukshëm më prestigjioz. Në kushte të

²⁶ M.Samara, *Cështje të anatomisë në gjuhën shqipe*, 1985, f.67

reja të rinjtë huazojnë pjesën më të madhe të anglicizmave, ndoshta sepse anglicizmat shoqërohen me të rejat dhe progresin.

Si në stacionet televizive të Shqipërisë ashtu dhe në ato të Kosovës e Maqedonisë (që transmetojnë programe shqip), ka shumë anglicizma në programet për të rinj. Kjo tregon qartë lidhjen midis përdorimit të fjalëve anglisht dhe perceptimit social. Stacionet e radios që kanë emisionë që dëgjohen kryesisht nga të rinj të grup-moshave 16-30 vjeçarë, gjithashtu janë përdorues entuziastë të anglicizmave. *Top Albania Radio*, një nga radiostacionet më të ndjekura, njihet nga të rinjtë si 'Topi'. Kanali televiziv që ndiqet më shumë në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni, quhet 'Top Channel' dhe i fillon programet e tij me '*Good Morning, Albania*'. Duke pasur parasysh popullaritetin e shikueshmërinë e lartë të programit, fjalët anglisht kapen e nguliten shpejt midis të rinjve. Artikujt e revistave, sidomos ato që janë të destinuar për të rinjtë, janë plot anglicizma.

Përveç programeve televizive dhe artikujve të revistave, vitet e fundit kanë shënuar një rritje të dukshme të popullaritetit të muzikës "rock", "rap" e "hip-hop" në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni dhe natyra e këtyre formave të muzikës çoi në përdorimin e anglicizmave. Me ndryshimin e stilit të jetesës kudo në rajon, fjalët "pub", "bar", "snack bar", "hamburger", "fast food", etj., dëgjohen dendur midis të rinjve.

Të rinjtë mësojnë fjalë anglisht në shkollë. Shumica e adoleshentëve shqiptarë mësojnë anglisht në shkollë dhe në kurse gjuhe. Pasi i mësojnë fjalën anglisht në klasë, ata e përdorin në të folurit e përditshëm thjesht për variacion linguistik ose për argëtim. Anglicizmat sot kanë të bëjnë më shumë me imazhin që krijojnë sesa me mbushjen e ndonjë boshllëku semantik të gjuhës shqipe.

Ia vlen të përmendet lidhja midis anglishtes dhe modernitetit. Përdorimi i gjërë i fjalëve anglisht nga ana e adoleshentëve shqiptarë shërbën si mjet për të bërë dallimin e atij/asaj nga ngurtësia e jetës së të rriturve dhe si riafirmim i statusit të adoleshentit. Kjo është gjithashtu, e ndoshta mbi gjithshka, një mjet për të etiketuar e për të bërë të dallueshëm identitetin e tjetrit. Anglishtja e anglicizmat përdoret edhe për motive snobizmi.²⁷

Megjithatë, mendësia e vjetër është ende gjallë dhe disa nga metodat e vjetra ende ekzistojnë. Ka një numër folësish të vjetër (konservatorë, dogmatikë apo pedantë), të cilët ende i rezistojnë përdorimit të anglicizmave, sepse ata e lidhin pastërtinë gjuhësore me identitetin kombëtar. Procesi i rezistencës ndaj të rejave në gjuhë shpjegohet qartë nga Trask (1995: 72).

"Gjatë gjithë historisë, folësit më të moshuar e më konservatorë kanë qënë kundër ndryshimeve në gjuhë kurdoherë që i kanë konstatuar. Thuajse në çdo kohë e thuajse në çdo vend, duket se ka pasur gjithnjë një bllok të opinionit konservator që pretendon se gjuha ka arritur njëfarë kulmi në zhvillimin e saj pak a shumë para një gjenërate, kurse tani po bie me shpejtësi poshtë e më poshtë me tërë këto përdorime të reja "të shëmtuara", "të pakujdeshme" e "injorante" që jemi duke dëgjuar përditë. Në shumicën e rasteve, kjo 'armiqësi' ndaj ndryshimeve gjuhësore, sado të fuqishme dhe elokvente qofshin, nuk zgjasin shumë. Folësit e vjetër që janë kundër formave të reja thjesht vdesin dhe ua lëshojnë vendin folësve të rinj, të cilët janë rritur me ato dhe dhe i konsiderojnë ato si normale. Ndërsa këta folës të rinj bëhen më të moshuar, edhe ata pa dyshim do të jenë kundër novacioneve që përkrahen nga brezi që vjen pas tyre. Rezultati do të jetë i njëjtë. Sido që të ndjehemi rreth këtij fakti, rezistenca ndaj

²⁷ P.Geci, *Pasunia e leksikut të shqipes*, BUSHT, 1959, f.28

ndryshimeve të gjuhës është thuarje gjithmonë e kotë.”

Këto qëndrime ende ekzistojnë tek ne sot, por ato rrallë kanë ndonjë ndikim në zhvillimin e ndryshimeve gjuhësore. Nevoja për të emërtuar gjëra, vende e koncepte të reja duket qartë se është shkaku universal i novatorizmave leksikore. “Huazimet leksikore të këtij lloji mund të shpjegohen me faktin se përdorimi i formave të gatshme është më ekonomik sesa përshkrimi i gjërave sërish” (Weinreich 1974: 56-57).

Për këtë arsye huazimet shkencore janë më pak të debatueshme. Procesi i huazimit të fjalëve anglisht përshkohet me shpejtësi edhe tek brezi i vjetër. Intelektualët i përdorin fjalët anglisht për të treguar se janë të kulturuar e të përditësuar me arritjet e shkencës, kurse politikanët e gazetarët i përdorin ato për të treguar se janë kompetentë e të besueshëm në misionin e tyre. Fjalë të tilla si “OK”, “uikend”, “konsensus”, “bum” apo “shok” janë pjesë e fjalorit të tyre të përditshëm. As vetë gjuhëtarët nuk i shmangen plotësisht përdorimit të fjalëve anglisht. Ata janë për hartimin e një fjalori të ri sepse fjalët e reja që kanë hyrë në gjuhën shqipe për shkak të progresit duhet të përfshihen në fjalorin e ri. Për më tepër, ata gjithashtu mendojnë se nga dy gjuhët që mësohen sot në shkollë, e para duhet të jetë anglishtja, si gjuhë globale. Përveç këtyre, ata nuk mund të injorojnë faktin se fjalët e huaja kanë qënë të pranishme në gjuhën shqipe gjatë tërë historisë së saj të dokumentuar.

Pushtimet e përsëritura mund ta vërshojnë gjuhën me huazime. Thuhet se shqipja përmban një fond prej vetëm disa qindra fjalësh burimore. Të gjitha të tjerat janë fjalë të sunduesve — fjalë latine, romane, greke, sllave dhe turke. Romët evropianë flasin një gjuhë indo-ariane: duket se në vendbanimet e tyre të ndryshme kanë qënë mjaft të veçuar sa për ta ruajtur gjuhën e vet, por ajo gjuhë ka qënë gjithmonë inferiore dhe huamarrëse. Të gjitha të folmet e romëve, në veçanti, përmbajnë huazime nga greqishtja. F. N. Fink (Finck) e përcakton gjuhën rome të Gjermanisë thjesht si një të folme të gjuhës rome në të cilën „çdo shprehje që mungon në leksik” zëvendësohet me fjalë gjermane, sikurse /"flikëra:ëa/ „arnoj” nga gjermanishtja *flic-ken*, ose /"Stuh"/ „karrige” nga gjermanishtja *Stuhl*. Sistemi i eptimit, pra, është i pacënuar, ndërsa fonetika padyshim dallohet nga ajo e gjermanishtes.

Modeli i gjuhës superiore mund të ndikojë madje edhe në trajtat gramatikore të gjuhës inferiore. Anglicizmat në gjermanishten amerikane të emigrantëve gjejnë shumë paralelizma në gjuhët inferiore. Kështu, thuhet se latinishtja ka mjaft nga sintaksa e gjermanishtes fqinjë, ndërsa morfemat janë latine. Në anglishte ka jo vetëm ndajshitesa latinofrënge, si në *eatable* “diçka që hahet”, *murderous* „vdekjeprures”, por dhe disa tipare të huaja në modelin fonetik, si në *zoom* “ngritja e aeroplanit me te shpejte”, *jounce* “tundje”. Tiparet jodalluese të fonemave duket se nuk huazohen. Kur e vështrojmë amerikanin me prejardhje gjermane (anglishtja e të cilit njëherit mund të tregojë disa tipare gjermane) duke përdorur /l/-në ose /r/-në e anglishtes amerikane në gjermanishten e tij, këtë e shpjegojmë me faktin se gjermanishtja për të është gjuhë e huaj.

Me ndryshimin e kushteve politike dhe kulturore, folësit e gjuhës inferiore mund të bëjnë përpjekje të pushojnë së huazuari, madje dhe t'i heqin huazimet nga gjuha e tyre. Kështu, gjermanët kanë bërë një fushatë të gjatë dhe fort të suksesshme kundër huazimeve latinofrënge, ndërsa popujt sllave kundër huazimeve gjermane. Në gjuhën bohemiane evitohen madje edhe kalket, kështu që /zana:ska/ „te hyrat” (si në librin e llogarive), një kalk nga *Eintragung*, po zëvendësohen me mend me një fjalë burimore (za:pis/ „shënim”).

Përveç konfliktit normal midis gjuhës superiore, nëse ajo mbetet e gjalle dhe ngel e paprekur, dhe gjuhës inferiore, nëse mbetet gjallë dhe merr me zor një mori huazimesh dhe kalkesh, madje dhe struktura sintaksore, gjejmë një numër rastesh ku duhet të ketë ndodhur edhe

dicka tjetër. Teorikisht do të dukej se ka shumë mundësi për rezultate te cuditshme. Pos versionit mistik të teorisë së substratit, duket e mundshme që një popullatë e madhe që e ka përvetësuar në mënyrë te papërsosur gjuhën superiore, mund ta përvetësojë versionin e saj madje dhe ta begatojë me tipin më origjinal të folur nga klasa e lartë. Në anën tjetër, nuk e dimë kufirin deri ku mund të ndryshojë gjuha inferiore dhe përsëri të mbetet gjallë. Në fund, është për t'u besuar që konflikti mund të marrë fund me ekzistencën e një përzierjeje aq të barabartë sa që historiani nuk do të mund të vendoste cilën fazë ta konsiderojë si material kryesor të gjuhës e cilën si përzierje të huazuar. Mirëpo, nuk dimë cili nga këto ose nga komplikimet e tjera të marra me mend ka ndodhur në të vërtetë, dhe duket se askush nuk ka arritur t'i shpjegojë rastet konkrete të përzierjes së shumënduarshme.

Nga fundi i shekullit VIII e tutje, vikingët danezë e norvegjeze e sulmonin Anglinë dhe zinin vend atje, ndërsa prej vitit 1013 deri 1042 Anglinë e sundonin mbreterit danezë. Mirëpo, elementet skandinave në anglishte nuk pajtohen me tipin që e lë prapa gjuha superiore. A to janë kufizuar në pjesën intime të fjalorit: *egg* „ve“, *sky*, „qiell“, *oar* „lopatë“, *skin* „lëkurë“, *gate* „portë“, *bull* „dem“, *bait* „Josh“, *skirt* „fund fustani“, *fellow* „shok“, *husband* „burrë“, *sister* „moter“, *law*, „ligj“, *wrong* „gabim“, *loose* „i lire“, *loë* „i ulet“ *meek* „i urtë“, *weak* „i dobët“, *give* „jap“, *take* „marr“, *call* „thërras“, *cast* „hedh, flak“, *hit* „qëlloj“. Ndajfolja angleze *though* „ndonëse është skandinave, e të tilla janë trajtat përemërore *they, their, them* „ata, i/e/ te tyre, ata (kallezore)“, forma burimore /m/ si në / *saw 'em* „i pashë“ (< anglishte e vjeter *him*, shumë i dhanores) tani trajtohet si variant i patheksuar i huazimit *them*. Emrat skandinave të vendeve tani janë të shumtë në Anglinë Veriore. Nuk dimë çfarë rrethanash e kanë sjellë këtë rezultat të veçantë. Gjuhët në kohën e kontaktit, sipas të gjitha gjasave, njiheshin nga të dy palët. Ndoshta sa i përket numrit të folësve dhe mbizotërimit, dallonin raportet sipas lokaliteteve të ndryshme dhe ndryshonin në mënyra të ndryshme në rrjedhë të kohës.

Shumica e rasteve të të huazuarit të çrregullt tregojnë sikur gjuha superiore ka pësuar ndikim nga gjuha inferiore. Rasti më i qartë është spanjishtja kileane. Në Kil trimëria e vendësve shkaktoi grupimin e jashtëzakonshëm të ushtarëve spanjollë të cilët u vendosën në atë vend dhe u martuan me gra vendëse, në kontrast me pjesën tjetër të Amerikës Latine, në Kil janë zhdukur gjuhët indiane dhe flitet vetëm spanjishtja; nderkaq kjo spanjishte dallon fonetikisht nga spanjishtja që flitet (nga klasa e lartë mbizotëruese) në pjesën tjetër të Amerikës spanjolle. Dallimet shpiten drejt gjuhëve indigjenë që u zëvendësuan me spanjishten. Supozohet se fëmijët e martesës së parë të përzier e përvetësonin gjuhën spanjolle në mënyrë të papërsosur, ashtu si nënat e tyre.

Disa veçori të tipit normal të gjuhëve romane janë shpjeguar si pasqyrime gjuhësh që kanë pushuar së ekzistuari nga shkaku i latinishtes. Do të duhet të tregohet se ato veçori në fjale në të vërtetë datojnë që nga koha kur folësit e gjuhëve më të hershme, duke përvetësuar latinishten në mënyre te papërsosur, ua përcillnin atë fëmijëve te vet në këtë të folme. Nëse është ashtu, do të duhej të supozonim se klasa sunduese dhe kolonizuese e folësve burimorë të latinishtes nuk ish-te mjaft numerike për të siguruar një model për gjithnjë, asish që do të shpiente kah rrafshimi i atyre mospërsosjeve. Në te vërtete, tiparet e vecanta të gjuhëve romanë dalin në shesh aq vonë sa që ky shpjegim duket i pabesueshem, përderisa nuk mbështëtemi në versionin mistik (te atavizmit) te teorisë së substratit.

Gjuha indoariane duhet të jetë sjellë në Indi nga një grup relativisht i vogël i pushtuesve dhe te jete imponuar gjate një mbizotërimit të gjatë nga ana e ndonjë kaste sunduese. Se paku disa nga gjuhët që u shuan duhet te kenë qënë të afërta me materialin e sotëm gjuhësor joarian të

Indisë. Materiali kryesor i këtillë, ai dravidian, përdor vargun e eksplozivëve qiellëzore /T, D,N/ përveç eksplozivëve dhëmbore /t, d, n/. Në mesin e gjuhëve indoevropiane vetëm gjuhët indoariene i kanë të dyja këto seri, ndërsa gjatë historisë së tyre qiellëzoret janë shumë. Gjuhët indoariene tregojnë po ashtu edhe një mosdallim të vjetër të /l/-së dhe /r/-së që është shpjeguar si shkak i substratit, i cili e kishte vetëm njërin apo asnjërin nga këta tinguj. Lakimi i emrave i indoarianishtes së vonshme tregon një ilfonim, me të cilin të njëjtat mbaresa rasore u shtohen temave të ndryshme për njëjës dhe shumës, ashtu si në gjuhën dravidiane. Kjo e zëvendësoi dukurinë karakteristike indoevropiane që me grupe të ndryshme të mbaresave rasore të bëhet dallimi në mes të njëjesit dhe shumësit, të cilat u shtohen temës së njëjtë.

Në sllavishte, sidomos në rusishte dhe polonishte, ndërtimet pavetësore dhe pjesore shkojnë në mënyrë shumë paralele me rregullat e finlandishtes. Gjuhët e Gadishullit Ballkanik kanë ngjashmëri të llojllojshme, ndonëse paraqesin katër degë të indoevropianishtes: greqishten, shqipen, sllavishten (bullgarishtja, serbishtja) dhe latinishten (rumanishtja). Kështu, shqipja, bullgarishtja dhe rumanishtja përdorin nje të shquar që vendoset pas emrit. Gjuhëve ballkanike në përgjithësi u mungon paskajorja. Në pjesët e tjera të botes, po ashtu gjejmë veçori fonetike ose gramatikore që u përkasin gjuhëve jo të afërta. Kështu ndodh me disa tipare fonetike në Kaukaz, ato janë të përbashkëta si për disa gjuhë joindoevropiane ashtu dhe për armenishten dhe osetishten iraniane.

Në bregdetin veriperëndimor të Amerikës Veriore hasen veçori fonetrike dhe morfologjike në shtrirje të ngjashme. Kështu gjuhët kejet, kuakiutel dhe cimshian kanë nje të ndryshme për emrat e përgjithshëm dhe për emrat e përvetshëm dhe bëjnë dallimin midis të dukshmes dhe të padukshmes të përemrat dëftore. Kjo veçori e fundit haset po ashtu edhe në të folmet fqinje të gjuhëve ginuk dhe salish, por jo dhe në të folmet në brendi. Mendohet se fiset e ndryshme i kanë grabitur grate prej njëri-tjetrit; ato brezit të ri ia kanë përcjellë të folurit e tyre me gjurmë të idiomit të tyre burimor.

Në disa raste, megjithatë, një grup folësish heq dorë nga gjuha burimore në llogari të zhargonit. Kjo ndodh sidomos kur ai grup përbëhet nga individë të bashkësive të ndryshme folëse, të cilat mund të komunikojnë në mes vete vetëm me anë të zhargonit. Si duket kështu ka ndodhur me skllëverit zezakë në shumë pjesë të Amerikës. Kur zhargoni të jetë bërë e vetmja gjuhe e një grupi subjektsh, ajo quhet *gjuhë kreole*. Gjuha kreole ka status të së folmes inferiore të ligjërimit të klasës së lartë. Ajo është objekt i rrafshimit të përhershëm dhe të përmirësimit drejt gjuhës kreole. Tipet e ndryshme të së "folmes zezake" që i vërejmë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës na tregojnë disa nga etapat e fundit të atij rrafshimi. Me përmirësimin e kushteve shoqërore ai rrafshim shpejtohet. Si rezultat lind ligjërimit i një kaste, folësit e së cilës, përta u përket faktorëve gjuhësore, kanë vështirësi më të mëdha se folësit e tjerë substandarde për ta përvetësuar gjuhën standarde.

Është çështje në vete se gjatë atij procesi të folurit që behet kreol mos ndoshta ndikon në ligjërimitin e bashkësisë së anglishtja kreole e skllëverve të jugut, për shëmbull, mos ndoshta ka ndikuar në tipet lokale të gjuhës substandarde ose madje dhe në anglishten standarde. Holandishtja e Afrikës Jugore, e niohur si *afrikana*, tregon disa veçori që ta kujtojnë gjuhën kreole, si për shëmbull, thjeshtimin deri në fund të eptimit. Meqë flitet nga e tërë bashkësia, duhet supozuar se holandezët vendës zhvilluan një formë zhargoni të holandishtes duke komunikuar me vendësit afrikanë dhe se ai zhargon, ndonëse mjet i shërbëtorëve vendas (sidomos i infirmierëve), pastaj ndikoi në gjuhën e patronëve.

Pikërisht në rastin e jashtëzakonshëm, kur grupi i subjekteve pasi të zhdukë gjuhën ose gjuhët burimore e duke folur në gjuhën kreole, i largohet mbizotërimit të gjuhës model — gjuha kreole i ikën asimilimit dhe i hyn një karriere të pavarur. Janë vërejtur disa raste të tilla. Kështu, pasardhësit e skllëvërve të arratisur që u vendosen në ishullin San Tome të bregdetit të Afrikës Perëndimore, flisnin një portugalishte kreole. Njëfarë holandishte kreole flitej gjatë në Ujëdhesat Virgjire. Dy trajta kreole të anglishtes fliten në Surinam (Guajana Holandeze). Njëra prej tyre, e njohur si *nin-gre tongo* ose *taki-taki* flitet nga pasardhësit e skllëvërve përgjatë bregdetit. Tjetra, që dallohet më shumë nga tipet e zakonshme të anglishtes njihet si *tongo çifute*, (xhutongo). Atë e flasin zezakët bushë pranë lumit Salamanka, pasardhës të skllëvërve që e fituan lirinë në shekullin XVIII me kryengritje dhe luftë. E mban këtë emër për shkak se disa nga skllëvërit u përkisnin çifutëve portugezë. Veçori e dallueshme e anglishtes së zezakëve bushë është përshtatja e saj e jashtëzakonshme ndaj fonetikës dhe strukturës së gjuhëve të Afrikës Perëndimore dhe ruajtja e madhe e leksikut të Afrikës Perëndimore: sikur skllëvërit të flisnin ende një gjuhë afrikane, do të ishte enigmatike pse ata ta braktisnin atë gjuhë në llogari të zhargonit të anglishtes.

3. 3. Vështrim diakronik i anglicizmave në shqip. Anglicizmat si dukuri e kontaktit gjuhësor.

Në shekujt XX-XXI kontakti i anglishtes me gjuhët e tjera evropiane bëhet më i ngushtë për shkak të mjeteve të reja të komunikimit (email-i, website-i, facebook-u, skype-i, etj.). Ky kontakt solli si rezultat huazimet gjuhësore shumë të lira të fjalëve anglisht nga gjuhët evropiane. Fjalët e huazuara nuk janë përshtatur të gjitha në gjuhën pritëse. Anglicisti austriak B. Kettemann (cf. 2002: 255) është i mendimit se këto fjalë mund të grupohen si më poshtë:

- 1 Fjalë të huazuara, ose fjalë që janë adoptuar në sistemin e gjuhës amtare për sa i përket shqiptimit, gjermëzimit dhe/ose gramatikës.
- 2 Fjalë të huaja, ose fjalë që i referohen një shprehjeje të importuar nga një gjuhë e huaj në gjuhën amtare, shpesh me importimin njëkohësisht dhe të produktit kulturor që tregon shprehja, dhe
- 3 Fjalë të pseudo-huazuara, të cilat janë fjalë që vetëm se duken sikur janë importuar nga një gjuhë e huaj, por në fakt nuk ekzistojnë në gjuhën huazuese, të paktën jo në atë kuptim me të cilin përdoren në gjuhën marrëse; ato ndoshta kanë të njëjtin efekt në kuptimin që çojnë në novatorizëm e diferencim semantik ose adoptojnë kuptime kulturore të mëtejshme ose të reja.

Burimet elektronike japin mjaft artikuj që trajtojnë përdorimin e fjalëve anglisht në gjuhë të tjera ose globalizimin e jetës angleze. Për shembull, ata e ilustronë këtë dukuri si më poshtë:

“Gjatë tre shekujve të kaluar (nga shekulli XVII deri në shekullin XIX), ka pasur një trafik lingvistik të ndërsjelltë e të vazhdueshëm, i cili thajse krejtësisht monitorohej nga marrëdhëniet kulturore dhe nga ndikimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i Anglisë dhe vendeve të tjera evropiane. Autori i këtij artikulli ka mendimin se të studiosh lidhjet gjuhësore në shekullin XX do të thotë, në fakt, të hetosh shkallën e kontakteve ekonomike e kulturore me Anglinë (në kohëra më të reja, edhe me Amerikën), sepse ky ndikim pasqyrohet më së shumti në huazimet e fjalëve anglisht në gjuhët evropiane. Ndonëse shkalla e kontakteve të anglishtes me gjuhët e tjera të Evropës varet nga shumë faktorë, pasojat e këtij kontakti mund të ilustron

më së miri nga numri dhe lloji i fjalëve të huazuara nga anglishtja.”²⁸

Në një artikull tjetër shkruhet: “Rezultati më i dukshëm i kontaktit gjuhësor të anglishtes me gjuhët e tjera të Evropës është transferimi i fjalëve anglisht në gjuhët e tjera evropiane. Fjalori i tyre pasurohet drejtpërdrejt nga ky transferimi”²⁹ Është shumë e vështirë të numërohen të gjitha fushat e veprimtarive njëzore të kombeve të Evropës mbi të cilat ushtron ndikim anglishtja. Rezultati i ndikimit të anglishtes është që gjuhët marrëse të Evropës huazojnë fjalë nga anglishtja, i përshtasin ato si anglicizma dhe rrjedhimisht i integrojnë ato në fjalorin e tyre. Në fakt, huazimi i fjalëve anglisht ka nisur shumë më herët.

“Fjalët e huazuara më të herëshme nga anglishtja janë terma komerciale dhe detare. Huazimet e shekullit XVII janë kryesisht nga sporti dhe politika. Prestigji politik dhe ekonomik i Anglisë në gjysmën e dytë të shekullit XVII është kryesisht shkaku i anglofilisë së asaj periudhe. Në shekullin XVIII dolën dhe amerikanizmat e para si “dollar” dhe “Yankee” (janki). Shekulli XIX solli një intensifikim radikal në huazimet leksikore. Shumë fjalë janë të lidhura me shkencën dhe teknologjinë: ‘tramvaj, tunel, ion, teleskop, linoleum’, etj. Ka po ashtu dhe më shumë fjalë nga Amerika, si për shembull ‘poker’ dhe ‘koktejl’. Këtu do të shohim një rritje të menjëhershme që vazhdoi dhe në shekullin pasardhës. Në fakt, fenomeni u bë shumë i përhapur.”³⁰

Në ditët tona anglishtja ka status zyrtar në 60 vende dhe zë vend në krye në 20 vende të tjera (Johnson 1996). Këto shifra që jepen në studimin “*English in a Changing World*” (“Anglishtja në një botë që po ndryshon”) tregojnë përdorimin gjithnjë në rritje të anglishtes si rezultat i globalizmit, i anglishtes si gjuhë globale (Ghim dhe Chew, 1999:43). Pikërisht ashtu siç bëjnë ambientalistët, Ghim dhe Chew i ftojnë njerëzit të mendojnë në mënyrë globale. Sipas mendimit të tyre, Anglishtja duhet të shihet si pjesë e një lëvizjeje globaliste mbarëbotërore, si një gjuhë që është bërë si një “lingua franca” për një hapësirë të madhe të shumë gjuhëve, si një aspekt i globalizmit, më shumë se si një aspekt i komunikimit gjuhësor që ka për qëllim të lehtësojë kontaktin midis njerëzve (Ghim dhe Chew, 1999: 44-45).

Ndikimi i jashtëm dhe shkëmbimi i kulturave ushtrajnë trysni mbi gjuhën. Studimi “*English in a Changing World*” (“Anglishtja në një botë që po ndryshon”) zbulon trysninë e anglishtes mbi gjuhë të ndryshme për shkak të kontakteve të vendosura për t’iu përgjigjur nevojave ekonomike dhe politike të njerëzve. “Gjuha dhe kultura janë të lidhura ngushtë me njëra tjetrën, prandaj dhe është e kuptueshme që ndryshimet në gjuhën e komunitetit, veçanërisht ndryshimet e qëndrimeve të njerëzve ndaj gjuhës dhe kulturës së tyre kanë impakt të pakthyesëm mbi gjuhën”(Sajavaara, 1986: 65).

“*The Dictionary of European Anglicisms*” (*Fjalori i Anglizmave Evropiane*) e autorit M. Görlach ilustron impaktin e kontakteve të ndryshme që ka vendosur gjuha angleze me gjuhët evropiane. Gjuhët evropiane janë pasuruar nga fjalët që kanë përvetësuar nga gjuha angleze. Në parathënieën e këtij *Fjalori*, Görlach-u shkruan:

²⁸ www.intellectbooks.com/europa/number5/hart.htm [9 qershor 2005].

²⁹ pauloc@nospam.please.pobox.com, [15 dhjetor 2002].

³⁰ (<http://www.instantweb.com/a/anglais/menu.html>).

“Për më shumë se njëmijë vjet anglishtja ka përvetësuar fjalë dhe shprehje nga shumë burime të jashtme [. . .]. Në të njëjtën kohë, gjuhët dhënëse, përfshirë këtu dhe ato gjashtëmbëdhjetë gjuhë evropiane që janë zgjedhur për trajtim nga Manfred Görlach-u, futnin fjalë në gjuhën e tyre.”

Fjalët që përfshihen në këtë fjalor konfirmojnë se fjalët anglisht po pranohen në gjashtëmbëdhjetë gjuhë evropiane që kanë studjuar Görlach-u dhe bashkëstudjuesit e tij.

3. 4. Klasifikimi i huazimeve – anglicizmave

Gjuhëtari kroat, Rudolf Filipoviç, ka përcatuar shtatë mënyra të klasifikimit të huazimeve – anglicizmave – në gjuhë, të cilat janë:

- (1) klasifikimi sipas rendit alfabetik;
- (2) klasifikimi sipas fushave të veprimtarisë njërëzore;
- (3) klasifikimi sipas llojit të fjalëve;
- (4) klasifikimi sipas rrafshëve e kategorive gramatikore – emër, mbiemër, folje, ndajfolje, ndajshim, togfjalësh);
- (5) klasifikimi sipas shkallës dhe mënyrës së “tjetërsimit”;
- (6) klasifikimi sipas nëvojshmërisë dhe panëvojshmërisë;
- (7) klasifikimi sipas shtresave të përdoruesve dhe të pikëpamjeve të tyre. Edhe huazimet – anglicizmat – në gjuhën shqipe mund të klasifikohen si më sipër. Kështu kemi:

3. 5. Ndërhyrjet (interferencat) fonike, ortografike, gramatikore dhe leksikore

Kur dy gjuhë bien në kontakt me njëra-tjetrën, ato ndërhyjnë, interferojnë me njëra-tjetrën dhe folësit e gjuhës mund të përdorin elementë nga secila gjuhë. Ndërhyrjet (interferencat) dhe tipet e interferencave përkufizohen si më poshtë:

“Interferenca mund të konsiderohet si transferimi i elementëve të një gjuhe në një gjuhë tjetër në nivele të ndryshme që përfshijnë ato fonologjike, gramatikore, leksikore dhe ortografike (Berthold, Mangbhai & Batoroëicz, 1997). Berthold et al (1997) përcaktuan si interferenca fonologjike ato elementë që përfshijnë akcentin e huaj si theksin, rimën, intonacionin tingujt e ligjëritimit të një gjuhe që ndikojnë në një gjuhë tjetër. Interferenca gramatikore përcaktohet si ndikim i gjuhës së parë mbi gjuhën e dytë në rendin e fjalëve në fjali, përdorimin e përemrave dhe përcaktorëve, kohëve dhe mënyrave. Interferenca në nivel leksikor jep hua fjalë nga një gjuhë në një tjetër duke i përshtatur ato në tinguj më të natyrshëm në gjuhën tjetër, kurse interferenca ortografike përfshin ndryshimin e germëzimit të fjalëve të një gjuhe në gjuhën marrëse.”³¹

Duke pasur parasysh këtë përkufizim, interferenca mund të konsiderohet si një transferim që mbulon të gjitha sferat e gjuhës.³² Sipas studjuesit Weinreich (1974: 2): “Qofshin të mëdha

³¹ <http://iteslj.org/Articles/Skiba-CodeSwitching.html>

³² A.Xhuvani, *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1956, f. 37

apo të vogla, të gjitha ndryshimet dhe ngjashmëritë midis gjuhëve në kontakt duhet të jepen për çdo fushë: fonike, gramatikore dhe leksikore – si parakusht për një analizë të interferencave“.

Për sa i përket interferencave fonike e ortografike, studjuesi Weinreich (1974: 14) shkruan:

“Problemi i interferencave fonike ka të bëjë me mënyrën se si i merr e i riprodhon folësi tingujt e një gjuhe, e cila mund të quhet si gjuha e dytë (L2) në dallim nga tjetra, të cilën do ta quajmë gjuhë të parë (L1). Interferenca ndodh kur një dygjuhësor identifikon një fonëmë të gjuhës së dytë me një fonëmë të gjuhës së parë dhe, gjatë riprodhimit të saj, ia përshtat atë rregullave fonike të gjuhës së parë. “

Ndonëse folësit kanë prirjen ta shqiptojnë tingullin sipas akcentit (theksit) të huaj, ndërhyr (interferon) theksi i gjuhës së tyre dhe në shumë raste mund të shkaktojë keqkuptime. Weinreich-u (1974: 21) tregon se si funksionon ky proces i interferencës:

Kur një njeri i zakonshëm njëgjuhësor dëgjon gjuhën e tij të shqiptohet me një “theks” të huaj, perceptimi dhe interpretimi i tij për theksin i nënshtrohet në vetvete interferencës së sistemit fonik të gjuhës së vet. Një dygjuhësor që përpiqet të flasë me gjuhën “S”, për shembull, i shqipton tingujt e “S” duke iu referuar sistemit të gjuhës “P”, e cila për të është gjuhë e parë.”

Ka arsye të ndryshme që të çojnë në interferencën e sistemeve fonike të gjuhës amtare, por ato kryesoret janë pikërisht arësyet që i referohen interferencës në përgjithësi: ato individuale dhe shoqërore. Weinreich-u (1974: 27) shkruan: “Ushtrimi i përpjekjeve për ruajtje të tingujt origjinalë monitorohet ndoshta nga faktorët shoqërorë e individualë shumë të ngjashëm me ato që rregullojnë të gjitha interferencat në tërësi. “

Kur gjuhët bien në kontakt me njëra-tjetrën, tingujt e gjuhës amtare mund të ruhen, por në shumicën e rasteve ato pësojnë ndryshime.³³ Hoch dhe Joseph (1996: 9) shkruajnë se gjuhëtarët përdorin termin “*ndryshim tingullor*” për t’iu referuar ndryshimeve të tilla në shqiptim, dhe si shumë terma të tjera teknike, ai përkufizohet më ngusht se në përdorimin e zakonshëm vetëm për t’iu referuar tipeve të caktuara të ndryshimeve në shqiptimin e fjalëve. Sipas këtyre autorëve, ajo që përcakton shqiptimin nuk ka të bëjë vetëm me faktorët gjuhësorë dhe ekstra-linguistikë (jashtëgjuhësorë). ”Nuk është vetëm ndryshimi i tingujve i vetmi ndryshim që ndikon në shqiptim. Fjalët shpesh ndryshojnë shqiptimin e tyre nën ndikimin e fjalëve të tjera dhe me analogji me to”. (Hock & Joseph, 1996: 9).

Sipas mendimit të Weinreich-ut (cf. 1974: 21), një determinant tjetër i mundshëm i përzgjedhjes, të cilit nuk i është kushtuar ende vëmendja e duhur, është qëndrimi i folësit ndaj gjuhës burimore të morfemave gjuhësore. Në qoftë se ajo gjuhë gëzon prestigj të madh kulturor e shoqëror në komunitetin gjuhësor, shqiptimi i fjalëve të huazuara në një trajtë fonike të afërt me origjinalen mund të shërbejë si shembull edukimi dhe statusi. Nga ana tjetër, në qoftë se gjuha e huaj nuk gëzon prestigj, ajo mund të shkaktojë përdorimin e formave artificiale e tallëse. Disa tipe interferencash mund të shkaktojnë keqkuptime bile dhe në të njëjtin kontekst, kurse disa të tjera i rezistojnë kohës dhe mund të bëhen pjesë e leksikut.

Me qënë se fjalët mund të huazohen nga një gjuhë edhe në formën e saj të shkruar, integrimi fonik nganjëherë fillon me formën e gërmëzuar të një fjale. Niveli ortografik tregon se si përshtatet gërmëzimi i një fjale të origjinës anglisht në ortografinë e gjuhës marrëse.

³³ Po aty.

Morfema e huazuar mund të integrohet në sistemin fonik të gjuhës, por mund të ruajë tingujt origjinalë. Është diskutuar se nëse folësi është dygjuhësor (bilingual), ai/ajo do të përpiqët t'i riprodhojë morfemat e huazuara me tungujt e tyre origjinalë; në qoftë se ai/ajo është njëgjuhësor (unilingual), atëherë ka shumë të ngjarë që "t'i detyrojë fjalët e huazuara t'i përshtaten sistemit fonetik e fonematik të gjuhës së vet." (Weinreich, 1974: 26).

Folësit arrijnë t'i shqiptojnë fjalët e huaja duke u ushtruar. Weinreich-u (1974: 21) shkruan:

"Konceptimi i panatyrshëm i mënyrës së huaj të të folurit përcaktohet strukturalisht nga fonematika e njëgjuhësorit; në saje të përforcimit, të të ushtruarit të vazhdueshëm, ai bëhet lehtë stereotipik".

Interferenca fonologjike çon në interferencë strukturore. Sipas Thomason dhe Kaufman (1988: 38):

"Inkorporimi i tipareve fonologjike që hyjnë në gjuhën huazuese me fjalë të huaja me sa duket është lloji i parë dhe më i dukshëm i huazimeve strukturore që mund të pritet . . . të paktën në rastet e huazimeve mesatare deri në ato të larta . . . ku ka interferencë fonologjike, do të ketë edhe një shkallë të krahasueshme të interferencave sintaktike. Interferencat morfologjike mbeten mbrapa."

Problemi i interferencave gramatikore ka një karakter mjaft kompleks. Ai është sot një nga çështjet më të debatueshme të gjuhësisë së përgjithshme. Shumë gjuhtarë të njohur e kanë vënë në pikëpyetje sadopak mundësinë e ndikimeve gramatikore, ose të paktën të atyre morfologjike. Weinreich-u (1974: 29) përshkruan një model se si një sistem gramatikor hyn në një tjetër.

"Sistemet gramatikore të dy gjuhëve . . . janë të përshkueshme, hyjnë tek njëra tjetra", tha Meillet-i dhe u mbështet nga Sapir-i: "Askund nuk gjejmë ndonjë ndikim morfologjik të ndërsjelltë, me përjashtim të rasteve sipërfaqësore". Po me aq forcë, është përkufizuar edhe pikëpamja e kundërt nga Schuchardt: "Bile as strukturat e ngjeshura fort . . .], siç janë mbaresat inflektive, nuk janë të sigurta kundër invazionit të materialit të huaj." Sipas një riformulimi bashkëkohor të këtij mendimi, "nuk ka ndonjë kufi në parim për ndikimin një sitem morfologjik mund të ketë mbi një tjetër."

Nganjëherë ndodh që format e reja të transferohen në një gjuhë në çift, me dhe pa afikse (parashtesa e mbrapashtesa). Prania e çiftit në gjuhën marrëse e mundëson edhe përdoruesin njëgjuhësor që të analizojë fjalën e përbërë me dy morfema në rrënjë dhe afiks dhe ta shtrijë përdorimin e afiksit në rrënjë të tjera të gjuhës amtare (Weinreich, 1974: 31). Prefiksi (parashtesa) anglisht super në fjalë të tilla si *supermen* apo *superhero* përfaqëson një mjet më produktiv për të formuar fjalë të tilla si *superaksion*, *supermjete*, etj., se sa transferimi direkt i një morfeme të përbërë nga anglishtja.

Studjuesi Weinreich shpjegon se si transferohen në një gjuhë morfemat e lidhura, morfemat e palidhura dhe ato komplekse. Sipas mendimit të tij, folësi dygjuhësor duket se ndjen nevojën për të shprehur disa kategori të një sistemi thuajse po me aq forcë sa në tjetrin dhe rrjedhimisht i transferon morfemat për qëllime t'u ushtruar. Nga ana tjetër, folësi njëgjuhësor i gjuhës marrëse, i pandikuar nga një sistem tjetër, mund të mos e ndjejë nevojën për t'u ushtruar. Për më tepër, për shkak se ato shpesh nuk bien në sy, morfemat e lidhura që transferohen duke u

përdorur në të folurit e të huajit shpëtojnë lehtë pa u vënë re nga ai/ajo. Duke mos e vënë re praninë e tyre dhe duke mos e ditur funksionin e tyre, ai/ajo nuk ka të ngjarë që t'i përvetësojë ato. Një morfemë relativisht e palidhur ka shumë të ngjarë të zëvendësojë ekuivalentin e saj në gjuhën tjetër në qoftë se ky ekuivalent është më i lidhur dhe krijon një larmi më të madhe ekuivalentesh në përmbushjen e funksionëve korresponduese, shkruan Weinreich-u (cf. 1974: 34).

Gjithnjë sipas Weinreich-ut (cf. 1974: 29), morfemat me funksionë gramatikore komplekse kanë më pak të ngjarë të transferohen nga dygjuhësorët (bilingualët) se sa ato me funksionë më të thjeshta. Për shembull, një parafjalë që përcakton një nga rasat ka më pak të ngjarë të transferohet se një emër që funksionon vetëm; gjithashtu, një folje ndihmëse që shoqërohet nga lidhëse ose mënyrat kryesore të foljes kryesore, është ndoshta më pak e transferueshme se një folje e qënësishme. Përkundrazi, morfema të tilla të paintegruara si pashirrat duket se janë të transferueshme lirisht, sipas dëshirës. Natyrisht, këtu merr pjesë edhe struktura e gjuhës marrëse. Në qoftë se ajo përmban rase që dygjuhësori mund t'i identifikojë me sistemin e rasave të gjuhës tjetër në kontakt, atëherë mund të lehtësohet transferimi i një parafjale. Për sa i takon interferencës gramatikore, Weinreich-u (1974: 29) thotë: Kërkesa kryesore është që në një situatë kontakti të dhënë, të dy gjuhët të përshkruhen në të njëjtat kushte.”

Kur analizojmë se cila kategori fjalësh hyn më shumë në një gjuhë në një situatë kontakti gjuhësor, emrat zënë vendin e parë. Weinreich-u (1974: 36) e ka shpjeguar këtë fakt dhe arësytën që qëndron prapa këtij fakti:

“Në listën e fjalëve të huazuara emrat ka numrin më të madh. Arësyeja është ndoshta e natyrës sematike më tepër se e asaj gramatikore e strukturore. Në kushtet e ndryshme të kontaktit strukturor apo kulturor raporti mund të jetë i ndryshëm. Për shembull, në kontaktin e një gjuhe evropiane, ku shumë “sende” konkrete tregohen përgjithësisht nga emra me një gjuhë në të cilën foljet përmbushin disa nga të njëjtët funksionë, raporti i emrave midis fjalëve të huazuara ndoshta do të ishte më i ulët se zakonisht. Më tutje, në një mjedis kulturor ku theksi për huazim vihet mbi gjëra shpirtore dhe abstrakte, fjalët e huazuara që nuk janë emra përsëri mund të zënë një vend më të gjërë, bile edhe në një gjuhë evropiane. Një fjalë që është transferuar nga një gjuhë në një tjetër i nënshtrohet vetë interferencës së sistemit gramatikor ashtu dhe atij fonik të gjuhëve marrëse, sidomos nga ana folësve njëgjuhësorë. Mund të formulohet një shkallë e efekteve që radhiten nga mospërshtatja e plotë deri tek integrimi i plote gramatikor i një fjale.”

Në sferën e marrëdhënieve gramatikore, interferenca është jashtëzakonisht e rëndomtë. Në qoftë se një anglisht-folës që e ka anglishten gjuhë amtare do t'i përmbahej rendit të fjalëve në fjali S-V-O (kryefjalë-folje-kundrinë), tipik për gjuhën angleze, kjo do të ishte tejet monotone, por nuk do t'i shkelte rregullat e gramatikës. Për sa i takon gjinisë gramatikore, emrat e huazuar që tregojnë qenie të gjalla marrin gjininë që ka seksi i tyre. Me emrat që tregojnë sende forma e fjalës është më e rëndësishme se gjithshka tjetër. Kështu, sipas Weinreich-ut, është në dëshirë të folësit nëse do që t'i integrojë apo mos t'i integrojë fjalët e transferuara – një dëshirë që duket më e qartë në aspektin gramatikor se në atë të tingujve. Vetë dëshira duket se varet jo aq nga strukturat e gjuhës në kontakt, por më tepër nga faktorët socio-kulturorë e psikologjikë të individit që mbizotërojnë në situatën e kontaktit (cf. Weinreich, 1974: 46).

Për sa i takon interferencave leksikore, fjalori i një gjuhe është sfera kryesore e huazimeve, për shkak të strukturave më të lirshme në krahasim me fonëmikën dhe gramatikën. Thomason dhe Kaufman (1988: 37) shkruajnë: “Gjithnjë, në një situatë huazimi elementët e parë

të një gjuhe të huaj që hyjnë në gjuhën huazuese janë fjalët”.

Huazimi leksikor ndodh kur një grup folësish vihet në kontakt me një fjalë të huaj dhe e fusin dhe e përdorin atë në gjuhën e tyre. Kjo nuk do të thotë se fjala e adoptuar përdoret njësoj si në gjuhën origjinale. Po japim më poshtë ndryshimet që pësojnë fjalët në këtë proces:

“Zakonisht ndodhin ndryshime substanciale në morfologjinë e fjalës, në shqiptimin dhe bile në kuptimin e saj. Fenomeni me anën e të cilit dy gjuhë vihen në kontakt dhe huazojnë fjalë nga njëra tjetra njihet si interferencë dhe një interferencë e tillë ndodh disa herë gjatë gjithë historisë së gjuhës. Kjo interferencë luhetet në kohë, bëhet me e dukshme dhe më e suksesshme në disa periudha se në periudha të tjera. Kjo interferencë e ndryshueshme përcaktohet nga shumë arsye jashtë-gjuhësore (ekstra lingvistike): veprimtaritë kulturore (rëndësia dhe nganjëherë mbizotërimi i një vendi në fushën letrare apo, në mënyrë të përgjithshme, në fushën artistike në një periudhë të caktuar historike), ngjarjet historike (si luftrat, pushtimet, aleancat ushtarake midis dy vendeve, dominimet ushtarake etj.), arësyt sociale (një grup mbizotërues, p.sh. një aristokraci ekonomike ose një elitë kulturore që vendosin të përdorin disa fjalë të huaja për shkak të prestigjit social që buron nga një përdorim i tillë).³⁴ Cilatdo qofshin arësyt jashtë-gjuhësore për interferencën, forca kryesore lëvizëse në huazimet gjuhësore është folësi individual, i cili, pasi vihet në kontakt me një fjalë të huaj të shkruar apo të folur, formon një imazh akustik në mendjen e tij, i cili, pas një të ashtuquajturë periudhë përpunimi, bëhet një term i huazuar. Gjatë periudhës së përpunimit, folësi ia përshtat fjalën e huaj morfologjisë dhe fonetikës së gjuhës së vet duke u përpjekur t’i transformojë të gjitha tiparet morfologjike ose/dhe fonetike të cilat nuk ekzistojnë në gjuhën që flet”³⁵

Huazimi është zhvillimi më i rëndomtë në situatat e kontaktit; ai është futja ose përshtatja e fjalëve nga një gjuhë në një tjetër. Njerëzit janë të përgatitur për të pranuar ekzistencën e huazimeve leksikore me qënë se ato shkojnë dorazi me huazimet e objekteve, ideve ose koncepteve të shprehura me fjalë. Hock dhe Joseph (1996: 14) shkruajnë:

“[. . .] huazimi leksikor është sot rezultat i shkëmbimeve ndërkombëtare social-ekonomike. Shkenca, sporti, teknologjia media dhe shumë veprimtari të tjera me të cilat merren njerëzit, janë faktorët përcaktues të huazimeve leksikore”.

Ka mënyra të ndryshme me anën e të cilave një fjalor mund të ndërhyjë tek një tjetër dhe ato janë shpjeguar bindshëm nga Weinreich-u (1974: 48):

“Të marrim dy gjuhë, A dhe B. Morfemat mund të transferohen nga A tek B, ose morfemat B mund të përdoren për të modeluar funksionët në modelin e morfemave A me përmbajtjen e të cilave identifikohen ato; në fund, në rastin e elementëve leksikorë të përbërë, të dy proceset mund të kombinohen.”

Sipas Weinreich-u (cf. 1974: 47 – 48), lloji më i rëndomtë i interferencës leksikore është transferimi i menjëhershëm i sekuencave fonematike nga një gjuhë në një tjetër (pashirrat, *hello, pizza-pie*). Ai është i mendimit se fjala e transferuar është herë pas here i një forme të tillë që t’i ngjasojë fonematikisht një fjale potenciale ose aktuale në gjuhën marrëse (për shmbull, troka-truk). Sipas mendimit të tij, tipi tjetër kryesor i interferencës përfshin shtrirjen e përdorimit

³⁴J. Thomai, *Rreth leksikut dialektor e krahinor të shqipes*, SF,nr. 1, 1989, f.98

³⁵ <http://nunzio/darkwing.uoregon.edu>

të një fjale indigjenë të gjuhës marrëse në konformitet me një model të huaj.

Në situatat e kontaktit, në kontrast me fjalët abstrakte, fjalët konkrete janë më të lehta për t'u transferuar. Weinreich-u (1974: 35) citon Linton-in i cili thotë se:

“[. . . duke qënë disa gjëra të barabarta (p.sh. asociacioni i prestigjit), disa lloje te elementëve kulturorë janë më lehtë të transferueshëm se disa të tjerë. Objektët e prekshëm si veglat, enët, ose zbulimet përvetësohen me lehtësi të madhe; në fakt ato janë zakonisht gjërat e para që transferohen në një situatë kontakti. Transferimi i elementëve që u mungon konkretësia dhe prekshmëria e menjëhershme e objekteve është më i vështiri i të gjithë transferimeve. Në përgjithësi sa më abstrakt të jetë një element, aq më i vështirë është transferimi i tij.”

Frazat e fjalët e përbëra mund të transferohen. Në lidhje me transferimin e tyre, Weinreich-u bën sugjerimet e mëposhtëme:

- Të gjithë elementët mund të transferohen, në form të analizuar, për shembull, *conscientious objectors* (*kundërshtarët e ndërgjegjshëm*).

- Të gjithë elementët mund të riprodhohen me anë të zgjerimeve semantike, për shembull *e gjetsh nga përendia*.

- Disa elementë mund të transferohen, ndërkohë që të tjerët riprodhohen.

- Vetëm fjalët e huazuara më konkrete, siç janë fjalët e krijuara për të emërtuar objektet e importuar ose të shpikur kohët e fundit mund të mendohen si shtesa të thjeshta në fjalor.

Sipas mendimit të Weinreich-ut (1974: 35 – 54), vetëm fjalët më konkrete, siç janë emërtimet e objekteve të importuar ose të sapo-shpikur, mund të mendohen si shtesa të thjeshta në fjalor.

Përveç huazimeve me përmbajtje krejt të re, transferimi ose riprodhimi i fjalëve të huaja duhet të ndikojë në fjalorin ekzistues në një nga tri mënyrat:

1. Konfuzion midis përmbajtjes së fjalës së re dhe fjalës së vjetër.
2. Zhdukje e fjalës së vjetër.
3. Mbijetesën e të dy fjalëve, të resë dhe të vjetrës, me një specializim në përmbajtje.

Ka dhe një tip të butë të interferencës leksikore që ndodh kur shprehja e një shënjë është ndryshuar në modelin e një fjale me origjinë të njëjtë në një gjuhë në kontakt, pa pasur ndonjë efekt në përmbajtje, për shëmbull, kur fjala spanjisht *Europa* bëhet *Uropa* në *Tampa*.

3. 6. Huazimet leksikore. Përshtatjet e anglicizmave.

Një situatë kontakti mund të çojë në huazime reciproke. Thomason dhe Kaufman (1988: 37) shkruan:

“Hauzimi është inkorporimi i tipareve të huaja në gjuhën amtare të një grupi nga folësit e asaj gjuhe: gjuha amtare ruhet por ndryshohet nga shtesat e tipareve të inkorporuara. Gjithnjë, në një situatë huazimi elementët e parë të huaj që hyjnë në gjuhën e huazuese janë fjalët . . .]. Në qoftë se ka presion kulturor të fortë e afatgjatë nga folësit e gjuhës burimore mbi grupin e folësve

të gjuhës huazuese, atëherë tiparet strukturore mund të huazohen si elementë fonologjikë, fonetikë e sintaktikë dhe bile (ndonëse më rrallë) si morfologji inflektive.”

Sipas mendimit të Heath-it (1994: 383):

“Një ‘huazim’ është një formë që është përhapur nga një larmi gjuhësore (“burimi”) në një larmi tjetër (“target’-i ose replika, kopja identike). Në këtë kuptim ai është thujse sinonimik me ‘fjalën e huazuar’, por një huazim është shpesh vërtet një rrënjë (më e vogël se një fjalë) dhe mund të jetë një frazë (më e madhe se një fjalë) dhe mund të jetë.”

Huazimi është i ndryshëm nga interferenca. Huazimi kërkon një kopjim të vërtetë të formave (rrënjëve, morfemave, fjalëve, frazave), kurse interferenca (që quhet edhe transferim modelesh), është një rezultat më i mprehtë i kontaktit gjuhësor (Heath, 1994: 384). Huazimet përfshijnë shumë aspekte të strukturës gjuhësore, veçanërisht fonetikën, fonologjinë, morfologjinë dhe semantikën leksikore.

Thujse në të gjitha rastet e huazimit nëpër gjuhët, të paktën disa huazime kërkojnë përshtatshmëri fonologjike vetëm në qoftë se gjuha burimore nuk është e përbërë ng segmente, kombinime të rrokjeve dhe një model prozodie (p.sh. theksi) të cilat janë krejt normale mbrenda gjuhës pritëse (Heath, 1994: 385). Fonologjia e huazimit nuk mund të kuptohet pa njohur rolin e germëzimit (spelling). Sipas Heath-it (1994: 386), “Shfaqja më e dukshme e interferencës ortografike është shqiptimi i shpeshtë i shkronjave “të heshtura” në format e huazuara, të cilat i korrespondojnë zeros në trajtën e vërtetë burimore”.

Huazimet përshtaten morfologjikisht. Shirley Brice Heath (1994: 387) arsyeton se “[. . .] në shumicën e rasteve një rrënjë emri ose foljeje e huazuar kërkon në fund të fundit një seri normale mundësishtë derivacionale të të njëjtës kategori fjalësh”.

Për sa i takon huazimeve leksikore të anglicizmave në shqipen, mund të merret shëmbulli që jep Kettemann-i (2002: 256), i cili i konsideron fjalët e huazuara si fjalë që i janë përshtatur sistemit të gjuhës amtare për sa i takon germëzimit, shqiptimit, dhe/ose gramatikës dhe fjalë të huaj që nuk janë përshtatur ende në sistemin e gjuhës amtare për sa i takon germëzimit, shqiptimit dhe/ose gramatikës. Tipe të tjera të huazimeve që kanë të bëjnë me anglicizmat në shqip janë kalket dhe huazimet hibride. Një kalk si formë e konvergimit leksikor që favorizohet nga kontakti gjuhësor është një rikrijim që përdor materialin vendas të një fraze apo fjalë të përbërë nga një gjuhë tjetër (Heath, 1994: 385). Hibridizimi ndodh kur huazimet e vjetra nga gjuha burimore shoqërohen në mënyrë sekondare me format me origjinë të njëjtë në gjuhën burimore pasuese (Heath, 1994: 389).

Studimi i huazimeve nuk mund të mbështetet krejtësisht në strukturat e pastërta gjuhësore. Modelet e huazuara pasqyrojnë gjithashtu kontekstin social dhe historik në të cilin ndodh kontakti gjuhësor.

Sipas mendimit të Coulmas-it (1989: xi) përshtatja gjuhësore ka të bëjë si me proceset e qëllimshme ashtu dhe me proceset e padrejtuara të ndryshimeve gjuhësore. Me fjalë të tjera, gjuha shihet si një sistem që ka prirjen të zhvillohet në mënyrë të tillë që i shërbën nevojave të atyre që e përdorin atë, por zhvillimi i të cilit mund të ndikohet gjithashtu nga ndërhyrja e vetëdijshme në qoftë se është e nevojshme.

Ka raste kur zhvillimi i një shoqërie ecën më shpejt se zhvillimi i një gjuhe. Siç thotë Coulmas-i (1989: 4):

“Zhvillimi shoqëror dhe ndryshimet gjuhësore nuk janë gjithmonë të akorduara mirë. Për një numër arësyesh zhvillimi shoqëror nganjëherë mund të ecë me hap më të shpejtë se zhvillimi gjuhësor, veçanërisht kur komunitetet e përdoruesve të një gjuhe i nënshtrohen ndikimeve të jashtme si luftrat dhe kolonizimi. Rrjedhimisht krijohet një situatë kur një gjuhë nuk mund të kënaqë në të gjitha aspektet nëvojat komunikative të folësve të saj. Një gjuhë e tillë ka nevojë për përshtatje. Në qoftë se ajo nuk i përshtatet kushteve të reja shoqërore, ajo rrezikon të kalbet dhe eventualisht të zëvendësohet nga një gjuhë tjetër.”

Gjuhët mund t’i nënshtrohen një presioni për t’u përshtatur. Coulmas-i (1989: 3) shkruan se gjuhët nuk mund të bëhen të përshtatshme për t’i shërbyer funksionëve të reja ashtu kot, nga asgjëja. Ka më pak të ngjarë që diapazoni funksional i një gjuhe më parë të zgjerohet dhe pastaj kjo gjuhë të përdoret për të kryer funksionët e reja respektive që ajo gradualisht aftësohet t’i vërë në shërbim si rezultat i dëshirave të komunitetit folës për ta përdorur atë për detyra që ajo dikur kryente me gjuhë të tjera ose hiç fare. Sipas mendimit të tij, është përdorimi i gjuhës për qëllimet e komunikimit modern që krijon regjistra të rinj dhe kësaj çon në zgjerim funksional.

Është fakt i pamohueshëm që një numër i konsiderueshëm fjalësh anglisht është integruar tashmë në shumë gjuhë. Integrimi i një numri të madh anglicizmash në gjuhët marrëse të Evropës, sistemet gjuhësore të cilave janë të ndryshëm nga ai i anglishtes, kërkon një analizë gjuhësore për të shpjeguar si kryhet ky proces. Fjalët burimore anglisht, duke kaluar nga një sistem në disa sisteme të tjera, duhet të përshtaten përpara se të integrohen. Kështu, në mendojmë se anglicizmat duhet të analizohen të paktën në katër nivele:

- a. Në nivel ortografik, për të treguar si përshtatet germëzimi i një fjale burimore anglishte në ortografinë e gjuhës marrëse;
- b. Në nivel fonologjik, për të shpjeguar shqiptimin e anglicizmës veçanërisht kur ai ndryshon nga fjala burimore anglisht;
- c. Në nivel morfologjik, për të treguar se si përcaktohet trajta morfologjike e anglicizmës (dhe, në qoftë se është emër, si përcaktohet gjinia e tij, e cila tregohet me sb-m/f/n).
- d. Në nivel semantik, për të përcaktuar cili kuptim e fjalës burimore anglisht është transferuar në anglicizmin korresponduese.³⁶

Për sa i përket përshtatjes së fjalëve në gjuhën shqipe, leksikologu shqiptar Jani Thomai (1999: 231) shkruan:

“Fjalët që merren nga gjuhët e huaja i janë nënshtuar sistemit fonetik dhe gramatikor të gjuhës sonë, d.m.th. shkruhen dhe shqiptohen sipas vlerës fonike të alfabetit tonë, eptohen sipas klasave gramatikore dhe rregullave përkatëse. Në qoftë se janë emra, kanë trajtë të shquar, të pashquar, numrin njëjës e shumës dhe lakohen; po të jenë folje, marrin ato forma në mënyrë, vetë e kohë, sikurse fjalët e tjera.”³⁷

Gjuhëtari kosovar Rexhep Ismajli (1998: 312) shkruan se ai i përmbahet pikëpamjes se emrat e huaj duhet të lakohen dhe marrin mbareat e rasave pa vizë (hyphen). Për shembull, ai mendon se *Shakespeare* duhet të shkruhet *Shekspiri*, *Shekspirit*, dhe jo *Shekspir-i*, *Shekspir-it*, etj. Në këtë mënyrë, duke infiltruar në gjuhën tonë, fjalët e huaja pësojnë ndryshime në formë dhe përmbajtje. Ato evulojnë në sfondin e gjuhës shqipe, bëhen pjesë të fjalorit të saj dhe i

³⁶ pauloc@nospam.please.pobox.com

³⁷ J.Thomai, *Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1999, f. 73

nënshtrohen kushteve konkrete historike, të cilat përcaktojnë zhvillimin e e gjuhës shqipe dhe bëhen rrënjë produktive.³⁸

Libri *Drejshkrimi i Gjuhës Shqipe* (1974: 90), botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, përcakton rregullat ortografike të gjuhës shqipe. Për sa i përket përshtatjes ortografike, ky botim udhëzon:

“Shkrimi i emrave të përvetshëm të huaj mbështetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes. . . . kështu shkruhen *Aligeri* (jo *Aligheri*), *Karduçi* (jo *Carducci*), *Shekspir* (jo *Shakespeare*), *Ruso* (jo *Rousseau*) apo emrat e vendeve *Bolonjë* (jo *Bologna*), *Nju Jork* (jo *Nëë York*) dhe kështu me radhë”.³⁹

R. Ismajli (1998: 260) është i mendimit se emrat e huaj duhet të shkruhen në përputhje me parimet fonetike, për shembull, *Volter*, *Guinëja e Re*. Kur përmenden emrat e huaj për herë të parë, fjala origjinale duhet të shkruhet në kllapa, për shembull, *Shekspir* (*Shakespeare*), *Xhek London* (*Jack London*). Shqiptimi i fjalëve duhet të jetë në përputhje me shqiptimin e gjuhës origjinale.

Sipas Ismajlit (1998: 321) fjalët e huaja lakohen në përputhje me sistemin e lakimeve të gjuhë shqipe dhe marrin mbaresa të rasave pa vizë (hyphen); kështu *Shakespeare* është *Shekspiri* dhe jo *Shekspiri-i* në rasën emërore, dhe *Shekspirit* dhe jo *Shekspiri-t* në rasën dhanore.

Pse huazohen elementet gjuhësore ose pse behet interreferenca gjuhësore? Janë dhënë shkaqë të ndryshme nga gjuhëtarët dhe shkencëtarët e tjerë për interferencën gjuhësore, d.mth. që folesi i një gjuhe të përdore disa elemente të një gjuhe tjetër.

Mendohet se huazimet në përgjithësi i plotesojnë vendet e zbrazeta në gjuhën marrese. Kur një popull, prodhon dicka të vlefshme edhe për popujt e tjerë, të tjerët e marrin jo vetëm atë material ose objekt, por nëse në gjuhën e tyre nuk kanë emertim për të — e marrin edhe emrin e atij objekti ose materiali. Gjerat e reja, pra, zakonisht vijnë me emra të rinj. „Fjalet e reja vijnë me kuptime të reja”, thoshte Haugeni. Pra, nëvoja për t'i emertuar gjerat dhe konceptet e reja është një nder shkaqëte përgjithshme për risite leksikore, siç thoshte Vajnrāju. “Është e qarte, pra, se fjalet e tilla (te huazuara) në përgjithësi janë në përdorim të gjere dhe (te dendur në regjionë të ndryshme, prandaj disi janë te internacionalizuara — gjenden zakonisht në fjalore të shumë gjuheve. Përkitazi me te huazurit, gjuhëtarët kanë edhe një mendim me interes: është me lehte ndonjëhere te huazohen fjale te huaja se te krijohen fjale te reja me materialin e dhënë gjuhësor.

Sipas Paulit ndikimi i një gjuhe në tjetren varet, pos tjerash, edhe nga intensiteti i qarkullimit nderkombetar, i udhetimeve në vendet e huaja dhe nga importimi i materialit të shkruar. Ai mendon se ky ndikim varet shumë sidomos nga ajo nëse gjuha marrese pranon material nga ndonjë gjuhe e huaj ose jo. Duket se keto fakte janë gjithnjë e me evidente dhe kushtezojnë depërtimin e elementeve gjuhësore prej një gjuhe në tjetren.

Disa foles huazojnë fjale te huaja për te treguar se janë te ngritur nga aspekti intelektual, se njohin një gjuhe te huaj e me te edhe një kulture te huaj. Kjo ndodh vecanërisht kur ajo gjuhe e huaj ka prestigj te larte në ate vend ose në bote.

³⁸ Ismajli, Rexhep, “Në gjuhë dhe për gjuhë : rrjedhat e planifikimit të shqipes në Kosovë 1945-1968”, Pejë, Shtëpia Botuese “Dukagjini”, 1998, f.321

³⁹ Grup autorësh, *Drejshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1974, f.90

Pos te huazuarit e gjesendeve te reja me emrat e tyre, gje që padyshim paraqët mënyren, me te shpështë te te huazuarit, ekziston edhe një lloj te huazuarit it e „modes" e që mund te kete ndikim mjaft te madh në gjuhën marrese, çështje me rëndësi është se ato huazime gjithmonë kanë te bejnë me objekte e koncepte tashme te pranishme në gjuhën marrese dhe me emerime aktive në ate gjuhe. Mirëpo, për hir te njëfare rryme, mode, etj., huazohen fjale te huaja si, b.f. *adio, cao, okej* etj. sidomos në fjalorin e te rinjve. Ajo që ka rëndësi te vihet në dukje ketu është se fjalet e ketij tipi kanë frekuence te madhe te përdorimit. Prandaj atyre huazimeve duhet kushtuar kujdes jo me pak se huazimeve te tjera, ndonëse keto fare elementesh gjuhësore huazohen me tepër në gjuhën e folur dhe shumë rralle mund te depërtojnë në gjuhën standarde.

Edhe Jakobsoni e ka trajtuar çështjen e te huazuarit gjuhësor. Ai thote se gjuha pranon elemente strukturale te huaja vetëm kur ato përkojnë me tendencat e zhvillimit te saj. Kjo domethenë se në gjuhën marrese duhet te ekzistojë vend latent për ato elemente. Latenca duhet te kuptohet si dic që shenon paradispozicion strukturor në gjuhën marrese për te pranuar elemente gjuhësore nga gjuha dhenëse, te cilat përputhen me tendencat evolutive te gjuhës marrese. Mirëpo, me studimet e mevonshme u konstatua dhe u argumentua se kjo nuk është gjithmonë e vertete — pranohen ndonjëhere elemente gjuhësore te huaja edhe kur ato nuk përkojnë shumë me tendencat e zhvillimit te gjuhës marrese.

Nder te tjera, është vertetuar se elemente fonologjike te gjuhës spanjolle janë huazuar në gjuhën maja te Jukatoni, ndonëse ato dy gjuhët dallojnë shumë nga çdo pikepamje e po ashtu edhe nga shqiptimi. Pra, dukuria e interferencës gjuhësore duhet kerkuar, në radhe te pare, si rezultat i kontaktit gjuhësor, qofte ai kontakt i drejtpërdrejte ose i terthorte. Kjo çështje është dokumentuar mire si dukuri e përgjdhshme nga Vajnrajhu (1953), ndërsa Haugen (1953) për një gjuhe përkatëse. Si parakusht për interferencë gjuhësore është bilinguizmi i folesve. Dihet se bilinguizani si dhe multilinguizmi zhvillohen dhe përhapen me shumë në treva ku komunikimi ndermjet njërezve nuk është shumë i veshtire dhe ku grupet e komuniteteve te ndryshme mbajnë lidhje te shpeshta, qofte edhe me anë te luftes. Ai me pak përhapet në rajonë te largeta prej një gjuhe, ku te komunikuarit është i veshtire (në vende malore, për shembull), ku grupe te vogla njërezish përpiqën te jetojnë në vete.

Të cekim se arsyet për shmangie nga norma strukturore e gjuhës marrese duhet te kerkohen në rradhe te pare në interferencën nga jashte që ndikon në ligjerirnin e shumë folesve (e jo vetëm te një folesi), ndërsa jo aq shumë te kerkohen në zhvillimin organik te vete gjuhës. Po ashtu duhet cekur se arsyet e interferences nuk kanë karakter gjuhësor, por procesi si i tille e ka ate karakter. Arsyet, si u tha edhe me lart, natyrisht, janë në radhe te pare shoqërore po dhe psikologjike.

Disa gjuhëtare elementin gjuhësor te gjuhës dhenëse e quajnë *model*. Elementi i huazuar si shqiptohet nga ligjeruesit e gjuhës marrese, sipas tyre, quhet *replike*. Modeli behet replike në ate moment kur hyn në gjuhën marrese. Lende e ketij studimi në te vertete janë marredheniet e republikes ndaj modelit, d.m.th. *te* gjitha dukurite që paraqiten gjate kalimit prej modelit në replike.

Sistemet fonologjike te dy gjuheve mund te përputhen pak dhe fort rralle. Prandaj në te shumten e rasteve fonemat e gjuhës dhenëse zevendesohen me format me te aferta te sistemit te gjuhës marrese. Mirëpo, fonema e gjuhës dhenëse nuk zevendesohet gjithëhere me te njëjtën fonëme te gjuhës marrese, sidomos nëse në gjuhën marrese nuk ekziston dicka e tille. Për kete arsye togjet e konsonanteve shpesh mund te zhduken në huazime gjate hyrjes në gjuhën marrese ose zevendesohen me togje me te „lehta", te cilat ekzistojnë në gjuhën marrese. Përkitazi me kete

Vajnrajhu, padyshim, e ka thenë mendimin me te përpiket. Kjo dukuri, sipas tij, është „kur bilingu e identifikon një fonëme te sistemit te gjuhës se dyte me një fonëme te sistemit te gjuhës se pare, ndërsa kur e riprcdhon ate ia nënshton rregullave fonetike te gjuhës se pare" (1953:14). Edhe shumë gjuhëtare te tjerë kanë përfunduar se ai që përdor elemente gjuhësore te huaja tingujt e huaj i zevendeson me tingujt e gjuhës se tij me te afert me ta.

Gjuhëtarete kanë ardhur në përfundim se në rrugen prej gjuibels dhenëse deri në gjuhën marrese (ose prej modelit në replike) ekzistojnë kryesisht tri stade. I pari është *transferi*. Me kete nënkuptojme se ligjuesi e përdor fjalen e huaj krejtesisht te pa-asimiluar. Pastaj vjen faza e dyte në te cilen paraqitet procesi i *interferencës*. Kjo është ajo shkalle e përshtatjes kur te dy gjuhët përpulhen në fjalet e huazuara, si te thuash takohen nëpërmjet atyre fjaleve. Interferenca, pos formave tjera, mund te shprehet edhe në theksin e huaj te fjales se, huazuar. Po që se folesi biling e përvetëson mire sistemin fonologjik te te dy gjuheve, atehere nuk ka interferencë, thonë shumë gjuhëtare.

Stadi i fundit është *integrimi*. Në kete faze elementet e huaja përfshihen në sistemin e gjulies marrese. Tani fjala, e gjuhës dhenëse me asngje nuk dihet se është e huaj, sepse nuk dallohet nga fjalet e gjuhës marrese. Fjala e tille mund te quhet *huazim* në kuptimin e plote te f jales.

Shikuar nga pikepamja e shkalles se integritit te fjaleve te huaja në gjuhën marrese, fjalet me origjinë te huaj. gjuhëtarete i ndajnë në: fjale te huaja, fjale te huazuara dhe huazime.

Fjale e huaj është ajo e cila degjuesit apo lexuesit. i duket e huaj, sepse ka fonema te huaja, për ndarje te huaj te fonemave dhe vendin e theksit jo te rendomte.

Fjala e huazuar, në krahasim me fjalen e huaj, është me shumë e integruar në sistemin e gjuhës marrese. Mirëpo, ajo ende mban elemente te huaja fonë" tike dhe fati i saj ende nuk dihet nëse do te pranohet njëhere e përgjithmonë në gjuhën marrese apo do te largohet prej saj.

Huazimi është element i huaj nga origjina, por krejtesisht i integruar në sistemin e gjuhës marrese. Ai nuk dallon me asnjë tipar fonologjik apo tjetër (ndonëse jo gjithmonë kështu) nga fjalet e gjuhës marrese.

Çdo foles i cili e përdor për here te pare fjalen e huaj mundet, para se ajo te përvetesohet nga masa shoqërore, domethënë, nga folesit e tjerë, te formoje *repliken kompromise*. Ajo forme replike në rastet me te shpehta i ngjan shumë modelit. Kjo çështje ka te beje njësoj edhe me zevendesimin fonologjik si dhe fonetik. Prandaj shpesh mund te ndodhe që i njëjti element me origjime te huaj te kete trajta alternative, sidomos nëse depërton në gjuhën marre se nëpërmjet dy medimeve — me anë te te folurit dhe me anë te shkrimit.

Gjuha marrese disa elemente te huaja gjuhësore i përvetëson, disa i merr te përkthyer, ndërsa disa pasi te provoje t'i marre i refuzon. Prandaj në përgjithesi është veshtire te dihet që përpara nëse do te ndalen në gjuhën marrese te gjitha elementet e huaja që paraqiten në te.

Folesi biling, i vetedijshem për prejardhjen e huaj tefjaleve, te cilat i bart në gjuhën e vet, bën një lloj selektimi dhe pak a shumë ndryshime fonologjike e fonëtdke, si dhe grafologjike, duke u përpjekur që t'ia afroje sa me shumë shqiptimit te gjuhës dhenëse. Por ky stad nuk zgjat shumë. Folesit e tjerë, po ashtu, provojnë që elementin e huaj t'ia afrojnë sa me shumë natyres dhe sistemit te gjuhës marrese. Ky proces vijon gjithnjë deri në itegrimin ose zevendesimin e plote. Në këtë rruge ai element, pa dyshim, në rrjedhe e sipër kalon edhe nëpër stadin e replikes kompromise. Kur ate element te huaj gjuhësor e marrin folesit monoldnge, atebote behet zevendesimi i plote i tipareve fonetike. Mirëpo, vetëm bashkesite gjuhësore vendosen për fatin përfundimtar te një elementi te huaj gjuhësor — ose e përvetesojnë ose e rsfuzojnë.

Faza kalimtare prej trajtes origjinale te eiementit gjuhësor deri në integrimin përfundimtar ka rëndësi te madhe për te hulumtuar procesin e përshtatjes ndaj sistemit te gjuhës marrese. Sipas Filipoviçit, i cili e ka studiuar kete dukuri në elementet angleze në gjuhën kroateserbe, kompromisi fonetik paraqitet në keto tri forma:

- a) në te përdorurit e fonemave te huaja,
- b) në përndarjen e huaj te fonemave dhe
- c) në sistemin e huaj te theksit.

Gjate hyrjes se elementeve te huaja në gjuhën marrese, me se shpeshti paraqitet përshtatja e fonemave sipas sistemit te gjuhës marrese, gje e cila quhet *transfonëmizim*? Sipas Filipoviçit dallohen tri lloje te adaptimit te fonemave në gjuhën marrese.

1. Fjala e huaj hyn në gjuhën marrese pa ndryshime, nëse fonemat e saj kanë ekuivalente përkatese në sistemin fonologjik te vet. Po që se keto fjale barten sidomos me anën e te folurit — ato hyjnë në gjuhën marrese pa pesuar ndryshime te medha.

2. Mirëpo, nëse elementi i huaj gjuhësor transferohet me anën e materialit te shkruar, drejtshkrimi i huaj mund te kete ndikim te madh në shqiptimin e atij elementi, përkundër faktat se fonemat e një fjale te tille mund t'i kenë ekuivalentet në gjuhën marrese. Kjo do te thote se ndryshimet paraqiten jo për shkak se ndermjet dy gjuheve ekzistoin dallime në sistemin fonologjik, por për arsye se foljet e gjuhës marrese i „mashton" sistemi grafologjik i gjuhës dhenëse.

3. Kur elementi gjuhësor i huaj hyn në gjuhën ku nuk ka njësi ekuivalente, atehere ose behet zevendesimi i fonemave ose shqiptimi i fjales se huaj formohet në baze te drejtshkrimit te gjuhës dhenëse, përkatesisht drejtshkrimit te asaj fjale te huaj.

Te huazuarit gjuhësor ndonjëhere mund te ndikojë edhe në numrin e termave te sistemit fonologjik te gjuhës marrese. Po që se numri i fonemave shtohet në ndikimin e huazimeve, atehere kjo dukuri gjuhësore quhet *importim* i fonemave. Lidhur me kete çështje kanë dhenë mendime shumë gjuhëtare. Përkritazi me kete çështje vlen te kihet parasysh kontributi i Filipoviçit i përmbledhur në kete fushe.

Interferenca gjuhësore mund te behet në çdo fushe gjuhësore, si në fonologji, në morfologji, në leksik dhe në sintakse si dhe në semantike. Mirëpo, interferenca me e shpështë behet në fushen e leksikut. Kjo ndodh për arsye se fjalet e reja barten lirisht jo vetëm si rezultat i kontaktit te bilingeve, por edhe për shkak se në gjuhe vazhdimisht shtohet numri i fjaleve te reja për t'i emertuar (siç thame) objektet, idete dhe situatat e reja.

Haugeni (po edhe te tjerët) dallon tri forma te interferencës leksikore: huazimet, kallet dhe huazimet semantike. Përvoja e interferencës gjuhësore ka treguar se elementet gjuhësore nuk barten gjithëhere në gjuhën marrese në trajta te plota dhe me kuptime përkatese. Prandaj huazimet konsiderohen edhe si elemente pjeserisht te importuara e pjeserisht te zevendesuara. Çdo gje që është e ngjashme mes elementit gjuhësor te gjuhës dhenëse dhe te gjuhës marrese, pas transferit te tij mund te quhet e importuar, ndërsa dallimi mes tyre mund te konsiderohet si zevendesim me elemente te gjuhës marrese. Pra, zevendesimi dhe importimi e përjashtojnë njëri-tjetrin, por bashkejetojnë në fqinjësi.

Huazimi leksikor (fjala), pra, paraqet je lloj interferencë gjuhësore me anën e te cilit barten nga gjuha dhenëse në gjuhën marrese si forma (qofte fonetike apo e shkruar) ashtu edhe kuptimi. Huazimet e tilla, pra, leksikore, janë studiuar me se shumti deri me sot. Ato mund te jenë fjale te thjeshta, por mund te jenë edhe fjale te përbera, kompozita, sintagma etj. Sa u përket fjaleve te përbera, mund te jenë tri tipe te interferencës nga gjuha dhenëse.

- a) Në gjuhën marrese mund të barten të gjitha elementet e një fjale të përbere. Kjo quhet huazim i kompozitave ose i fjaleve të përbëra të analizuara, sipas Vajnraxhut.
- b) Te gjitha elementet e një fjale të përbere mund të zevendesohen me elemente të gjuhës marrese. Kjo quhet kalke.
- c) Disa elemente të fjales së përbere mund të huazohen nga gjuha dhenëse, ndërsa të tjerat të zevendesohen me elemente të gjuhës marrese. Kjo quhet hibrid.

Një dukuri e posaçme nga fusha e interferences leksikore është i ashtuquajti *transfer kodi*. Me të nënkuptohet ajo dukuri kur folesi (apo ai që shkruan) siç është duke folur kalon në gjuhën tjetër, qofte për një fjale, një sintagme apo një fjali të tere. Transferi i kodit behet ashtu që shqiptimi, intonacioni, theksi etj. realizohen sipas modelit të gjuhës dhenëse, kështu që folesi në atë moment, në të vertete, flet gjuhën e huaj (dhenëse). Për këte flasin shumë si Haugeni, Vajnraxhu, Fogti, Meki etj. dhe e konsiderojnë si dukuri jo gjuhësore. Edhe përdorimi i kodit behet, se paku sipas gjykimit të folesit në atë moment, për të gjetur shprehje me adekuate ose për të qënë me besnik në të paraqiturit e situates për të cilën behet fjale. Kjo dukuri, sa dime, është e pranishme thuaja në çdo gjuhe që huazon.

Në gjithë këte geshkje të të huazuarit gjuhësor shtrohet edhe një pyetje para hulumtuesve: kush kujdeset për ta ruajtur gjuhën „te paster“? Ka pak gjasa të jepet një përgjigje e cila do të vliente për të gjitha rastet dhe situatat. Në një rreth ku ekziston gjuha amtare e standardizuar, siç është b. f. shqipja në Jugosllavi, lektorët nëpër redaksi janë ata që me se shumti i bejnë rezistence depërtimit të elementeve të huaja në gjuhën e shkruar. Në të vertete, ata e ruajnë gjuhën nga çdo shmangie e normes, ata ruajnë gjuhën të „konservuar“. Lektorët duket se pikerisht për këte qëllim dhe marrin pagën. Mirëpo, për gjuhën e vet përkujdesen të gjithë intelektualet, sipas rregullit, në radhe të pare gjuhëtarët. Por puna e intelektualeve, sa i përket kesaj çështjeje, është thuaja thike me dy tehe. Në këte çështje të të huazuarit gjuhësor shtrohet edhe një pyetje para hulumtuesve: kush kujdeset për ta ruajtur gjuhën „te paster“? Ka pak gjasa të jepet një përgjigje e cila do të vliente për të gjitha rastet dhe situatat.

3.7. Fjalorët terminologjikë dhe termat ushtarake në gjuhën shqipe

Leksiku dhe terminologjia ushtarake në gjuhë të ndryshme kanë shoqëruar në të gjitha epokat zhvillimet e shkencës e të teknikës ushtarake, tërë dukuritë ushtarake dhe janë pasqyruar në fjalorët përkatës. Si fjalor i parë i këtij tipi vështrohet fjalori i botuar në Londër më 1557 me autor Xhorxh Polmen me diçiturë: “të gjitha betejat më të dëgjuara që janë zhvilluar në shekullin tonë në gjithë botën si në det, ashtu edhe në tokë”. Pas këtij botimi numri i fjalorëve terminologjikë ushtarakë në gjuhë të ndryshme erdhi gjithnjë duke u shtuar.

Në rrjedhën e kohës termat ushtarakë kanë pësuar ndryshime të vijueshme nga një epokë në tjetrën, në përputhje me dialektikën e zhvillimit të këtyre shkencave në kushte të caktuara politike dhe ekonomike-shoqërore. Në këtë rrugë është zhvilluar edhe terminologjia ushtarake e gjuhës shqipe. Megjithatë, ajo ka veçoritë e saj. Vendi ynë është shkelur për një kohë të gjatë nga armiq të shumtë e nga më të egrit që ka njohur historia, si romakët, bizantinët, osmanët, serbët, grekët, austrohungarezët, italianët, gjermanët etj. Të gjithë këta pushtues kanë synuar ta zhduknin kombin tonë nga faqja e dheut dhe, për të realizuar këtë objektiv, në radhë të pare janë munduar të zhduknin gjuhën tonë amëtare, në këtë kuadër edhe leksikun e terminologjinë ushtarake, për të shuar çdo traditë luftarake të popullit shqiptar. Aq më tepër që në kushtet e

pushtimit tek në nuk ekzistonte ushtria e rregullt, institucionët e saj dhe letërsia ushtarake në gjuhën shqipe.

Si pasojë, në gjuhën tonë hynë mjaft fjalë dhe terma ushtarakë të pushtuesve, veçanërisht termat ushtarakë të turqishtes dhe, nëpërmjet saj, edhe të arabishtes e përsishtes. U desh puna e madhe dhe qëndresa e paepur e rilindësve dhe e brezave të mëvonshëm që të nxirreshin jashtë gjuhës sonë këta terma dhe të përtëriheshin termat ushtarakë shqip. Në rrugën e tyre shumë të vështirë, por të lavdishme rilindësit hodhën themelet e para të terminologjisë ushtarake në gjuhën shqipe. Për këtë ata u mbështetën në gjuhën e gjallë e të pasur të popullit dhe në mundësitë e gjera të shqipes për të formuar fjalë-terma me mjetet e veta.⁴⁰

Megjithse edhe sot e kësaj dite ka ende ndonjë orientalizëm, që përdoret në terminologjinë ushtarake të shqipes, si bori, borizan, çizme, dylbi, fishek, fitil, hendeklidhje, top, xhep zjarri, etj.⁴¹ Në ndryshim me terminologjitë ushtarake të disa gjuhëve të tjera ballkanike, në gjuhën shqipe ata janë të papërfillshëm, ndonëse kanë qënë nga huazimet më të hershme e më të shumtat. Ato janë zëvendësuar me fjalë nga brumi i shqipes dhe pjesërisht me terma neolatine.

Pas Shpalljes së Pavarsisë më 28 nëntor 1912, kur u krijua shteti i ri shqiptar dhe Ushtria Kombëtare Shqiptare, në Shtabin Madhor të saj u ngrit për herë të parë në historinë e Forcave tona të Armatosura dhe në ato vite të vështira lufte e përpjekjesh, Komisioni i Terminologjisë Ushtarake. Ky komision në të cilin u aktivizuan personalitete me kulturë të gjerë ushtarake e gjuhësore, që zotëronin disa gjuhë të huaja dhe që e njihnin mirë edhe gjuhën shqipe, si Mustafa Maksuti (Shehu), Kamber Sejdiu etj., bëri përpjekje serioze dhe punë të lavdërueshme për krijimin e termave ushtarakë shqip dhe për shqipërimin e kufizave të ushtrisë, siç i quanin ata, sepse momenti historik e kërkonte që edhe në fushën e termave të kishin origjinalitet, mëvetësi, rilindje. Me përpjekjet e këtyre forcave filluan të hidhen bazat e një terminologjie të re ushtarake të gjuhës shqipe në kuptimin e vërtetë të fjalës. Në vargun e termave të krijuara prej tyre bëjnë pjesë komanda ushtarake, emërtime të pjesëve të armëve, të veprimeve me zjarr dhe të organizimit ushtarak si: gatitu!, qëtësohu!, eja në radhë!, tetësh (për skuadër), tog(ë), tubë, trumbë (për kompani), griq (për batalion), sogorië (për regjiment), ushtret (për gjenëral), deter (për admiral), epror, depror, gjilpërë, këmbëz (e shkrepjes), shënjëstër, siguresë, klith (për bori) e klithtar (borizan) e dhjetëra të tjera.

Në gazetën “Liria e Shqipërisë”, që botohej në Sofje, më 29 korrik 1913, në artikullin “Kufizat e ushtrisë” u botua një listë me 26 terma shqip-turqisht. Ndërsa në revistën “Zgjimi” të Korçës, në numrat 2 e 3 të vitit 1913, u botua një listë me 315 terma e togfajlësha terminologjike ushtarakë. Në vitin 1916 në Konstanca (Rumani) u punua Fjalori i ushtrimeve ushtarake të emërtuar “Përvuajtjet vetmore” me 315 komanda dhe ushtrime stërvitore.

Në Ushtrinë Mbretërore vijuan përpjekjet për pasurimin e mëtejshëm dhe kodifikimin e terminologjisë ushtarake. U botuan dy fjalorë të emërtuar: “Terminëllogji ushtarake” (shqip-shpjegues-italisht dhe italisht-shqip) me 700 terma (Tiranë, 1932) dhe “Manual bisedimi me landë ushtarake” (shqip-italisht-jugosllavisht) me 1350 fjalë e shprehje (Tiranë, 1933). Gjithashtu në rregulloret dhe botimet ushtarake bashkëngjiteshin edhe lista termash ushtarakë.

Në periudhën 1939-1944 në terminologjinë ushtarake u futën edhe terma të huaj, sidomos

⁴⁰ A. Kostallari, *Rreth depërtimit të turqizmave në gjuhën shqipe gjatë shekujve XVII-XVIII*, Gjurmime albanologjike, SSHF, 1979, f. 104

⁴¹ Po aty.

italianizma, që kanë të bëjnë me administratën, organizimin, teknikën, armatimin, detarinë etj., p.sh. akostim (për bregëzim), arrest (për ndalim), dragaminë (për minaheqëse), inkuadrohem (për rreshtohem), inkursion (për sulm i befasishëm), karikator (për krehër fishekësh), kolpo (për goditje), komanda tapa (për komandë e grumbullim-shpërndarjes së ushtarakëve), salutoj (për përshëndes), salva (për përshëndetje artilerie), korrier (për lajmëtar) etj.

Por lindja e një ushtrie të re dhe e një arti të ri ushtarak gjatë Luftës së Dytë Botërore solli edhe lindjen e zhvillimit të një terminologjie të re ushtarake. Në dokumentet e SHP dhe KP të UNÇSH, që kanë të bëjnë me drejtimin e veprimeve luftarake të formacionëve partizanë, u përdorën shumë terma të rinj si nga forma dhe përmbajtja, sepse ata emërtonin dhe shprehnin nocionë të reja. si çetë, luftë partizanë, pritë, brigadë sulmuese, grup vullnëtar, Komandë e Përgjithshme e Shtabit Madhor, luftim nate, luftim në qytet, zonë operative, plan operativ, rojë partizanë, etj.

Pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore, UNÇSH në Shqipëri u shndërrua në një ushtri të rregullt. Ajo u zgjerua me lloje forcash, armësh e shërbimesh të reja dhe u pajis me teknikë dhe armatime të kohës. U krijuan institucionë ushtarake, shkolla e kurse kualifikimi për oficerë, u dërguan me qindra oficerë në ish-BS për t'u specializuar në profile të ndryshme, filloi botimi në shkallë të gjerë i letërsisë ushtarake, si rregullore, tekste mësimore, udhëzues, albume, revista, gazeta etj. Në vijim të traditës së mëparshme, u zgjerua shumë sasia e nocionëve dhe e emërtimeve ushtarake me terma që shënojnë:

- 1 nocionë të përgjithshme ushtarake, si: art ushtarak, betejë vendimtare, doktrinë ushtarake, e drejta e luftës, ligjet e luftës, mësimje e përgjithshme etj.;
- 2 nocionë dhe emërtime të organizimit ushtarak të FA: armatë, artileri tokësore (bregdetare, kundërajrore), bateri, batalion, brigadë, grupim, korpus etj.;
- 3 mjete luftarake, armatime e municionë të ndryshme: aeroplan, anije, automatik, autobлиндë, flakëhedhëse, granatëhedhëse, nëndetëse, obus, raketë, silur etj.;
- 4 njëri që kryen një punë a funksion të caktuar në ushtri ose që përdor një armë a mjet të dhënë: anijedrejtues, aviudrejtues, fluturues, kufitar, nënujës, zhytës etj.;
- 5 mjete teknike, pjesë të mekanizmave të armëve ose procese të ndryshme: antenë, bashkues, busull, djep luajtës, dhëmb ndalues, flakëshuese, mosshkrepje etj.;
- 6 format ose mënyrat e ndryshme të luftimit: dinamikë e luftimit, dyluftim, kundërgoditje, kundërmësimje, kthesë luftarake, lidhje zjarri etj.;
- 7 vendi i përqëndrimit të forcave, e vendosjes së komandave: bazë nisjeje, brez mbrojtjeje, kryeurë, një kundërtanke, pikëmbështetje, vendkomandë etj.;
- 8 komanda e raportime ushtarake, përshëndetje ushtarake: armë mbush!, eja në radhë!, tek armët! etj.;
- 9 cilësi e dinamizëm të veprimeve luftarake: aftësi mbrojtëse, befasi, dinakëri luftarake, manovrueshmëri etj.

Terminologjia ushtarake në Republikën e Shqipërisë tashmë është formuar e funksionon si sistem. Gjate mobilizimit dhe organizimit të veprimeve të UÇK-s u verejt se e njëjta terminologji ushtarake përdorej dhe nga shqip-folesit në Maqedoni. Qartësimi, diferencimi dhe saktësimi i nocionëve në këtë sistem është bërë shkallë-shkallë, nga një periudhë në tjetrën, në përputhje me zhvillimin e mendimit dhe të praktikës ushtarake të shqiptareve. Veçanërisht në fillim të viteve '60-të të shekullit të kaluar u ndie e nëvojshme të rivështrohej më gjerë dhe në mënyrën më tërësore gjendja e saj, madje nga autorë të veçantë u bënë përpjekje edhe për

kodifikimin e pjeshëm të saj, duke hartuar dhe botuar dy fjalorë shpjegues për termat e artilerisë dhe termat taktiko-opërativë.

Këto përpjekje vijuan pa ndërprerje sidomos në vitet '80-të e në vazhdim. Krahas studimeve teorike në këtë fushë, në Akademinë e Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë filloi puna e organizuar shkencore për përpunimin sistemor, shqipërimin dhe kodifikimin tërësor të terminologjisë ushtarake, duke i dhënë asaj fytyrë kombëtare. Për këtë qëllim u vol letërsia ushtarake nga rilindja deri në ditët tona dhe u ndërtua një kartotekë shkencore me rreth 200.000 skeda. Mbi këtë bazë, me komisionë specialistësh e gjuhëtarësh, qoftë edhe nga autorë të veçantë, janë hartuar deri tani 25 fjalorë dy e shumëgjuhësh, që rrokin rreth 67.000 njësi terminologjike, prej të cilëve 22 janë në dorë të lexuesit ushtarak (shih listën) dhe 3 ende nuk janë botuar.

Ndërkohë është punuar për hartimin e serisë së fjalorëve shpjegues të termave ushtarakë, por ende nuk kanë gjetur dritën e botimit për shkaqë financiare. Ky fond termash përbën një rezervë të konsiderueshme për pasurimin e mëtejshëm të Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe në një ribotim të ardhshëm, sidomos me shkurtesa. Në Fjalorin e shqipes së sotme (2002) nga fusha e leksikut dhe e terminologjisë ushtarake janë përfshirë mbi 2.000 fjalë e terma, nga të cilat 700 fjalë shënuese dhe 1300 togfjalësha. Po ashtu janë botuar një varg artikujsh shkencorë për problemet e terminologjisë ushtarake në Revistat: “Gjuha Jonë”, “Studime filologjike”, “Përla”, “Mbrojtja”, “Detaria”, në Revistën Ushtarake dhe në gazeta. Kësaj punë i ka prirë edhe studimi monografik “Terminologjia ushtarake e shqipes”, botuar në vitin 1993.

Si rrjedhim i kësaj punë të kryer, mund të themi me bindje se terminologjia ushtarake e shqipes ka marrë fizionomi të plotë kombëtare dhe pasqyron në vetvete të gjitha zhvillimet që kanë ndodhur në fushën e mbrojtjes dhe të modernizimit të FA. Megjithatë, puna e bërë deri tani për shqipërimin e saj nuk duhet vështruar si detyrë e përfunduar. Terminologjia ushtarake shqipe ka ende në përbërje terma të huaj të panëvojshëm, që vijnë të përdoren si sinonime të termave të rinj të shqipëruar; ka gjithashtu edhe ndonjë term të papërshtatshëm.

Pastaj, krahas huazimeve të mëparshme të panëvojshme e plotësisht të zëvendësueshme me fjalë të shqipes, vitet e fundit në terminologjinë ushtarake shqipe vërehet depërtimi i anglicizmave vend e pa vend dhe prirja e shtimit të tyre (si fusha më e ndikueshme në kuadrin e NATO-s), madje edhe e neolatinizmave të tjerë nëpërmjet anglishtes. Të tilla janë, p.sh.:

briefing (për instruktim, trajtesë informim),

fidbek (për 1. rikthim, 2. lidhje e kundërt),

impakt (për 1. ndikim, 2. goditje),

leadership (për udhëheqje, drejtim),

lider (për drejtues, udhëheqës),

kamping (për fushim),

menaxhim e **menaxher** (për administrim e administrator),

staf (për shtab, organ, ekip),

implementoj (për zbatoj, realizoj, përmbush),

task force (për forcë operative), e shumë të tjerë, si dhe të **neolatinizmave**:

interaktivitet e **interoperativitet** (për ndërveprim),

komunalitet (për përbashkësim a njësim i modeleve të armatimit),

obligim (për detyrim),

primar (për parësor a në plan të parë),

operacional (për operativ),
aset (për mjete e pajisje),
atraktiv (për joshës, tërheqës),
alokim (për ndarje e fondeve),
prioritete (për përparësi),
duel (për dyluftim),
prezencë e prezent (për prani e i pranishëm),
komponent (për përbërës),
superioritet (për epërsi),
konfuzion (për pështjellim, rrëmuje),
rezistencë (për qëndresë),
influencoj (për ndikoj),
konsideroj ose **marr në konsideratë** (për marr parasysh),
fleksibël (për elastik),
multinacional (për shumëkombësh-e),
infiltrim (për depërtim, ndërfitje),
eksfiltrim (për dalje nga rendimi i luftimit), etj.

Këto terma e shumë të tjerë që po futen pa kriter në ligjërimin e përditshëm, në dokumentet e rëndësishme zyrtare e sidomos në organët e shtypit ushtarak, nuk janë as ndërkombëtarizma, as të karakterit teknik e teknologjik për të cilat do të mund të ndihej nëvoja në terminologji, si b.f. radar, sonar, lazer, kompjuter, internet, bit etj.. Kjo dukuri shpegohet me faktin se oficerët shqiptarë vitet e fundit kanë kryer në mënyrë masive dhe vazhdojnë të kryejnë në kuadrin e NATO-s akademitë e shtabeve të larta dhe kurse disamujore të anglishtes në SHBA, Kanada, Angli, Francë, Holandë, Itali, Greqi dhe Turqi. Të ndikuar nga trysnia e anglishtes, të cilën oficerët shqiptarë e përdorin dendur në takimet e shpeshta dhe në stërvitjet e përbashkëta të NATO-s në territorin shqiptar dhe në shtetet partnëre, dhe duke mos e njohur mirë gjuhën shqipe, ata futin në masë anglicizma në terminologjinë ushtarake të shqipes (shumë më tepër nga ç'qënë futur dikur rusizmat në vitet '50, '60 të shek. XX).⁴²

Prania e një sasive mjaft të madhe njësisish leksikore të shkurtuara përbën një nga tiparet më karakteristike të leksikut dhe të terminologjisë ushtarake. Shkurtesat gjejnë një përdorim të gjerë në ligjërimin e ushtarakëve, sidomos në dokumentet që hartojnë, ku kërkesa e shkurtesisë dhe e ngjeshjes (dendësimit) së informacionit është mbizotëruese. Kjo shpjegohet si me zhvillimin e lartë të teknikës së informacionit në kohën tonë, ashtu edhe me vetë natyrën e karakterit dinamik të veprimeve luftarake, të cilat zhvillohen me shpejtësi të madhe e të rrufeshme, ku ekonomizimi i kohës dhe fshehtësia e drejtimit dhe e zhvillimit të tyre marrin rëndësi të veçantë. Prandaj mbledhja, sistemimi dhe studimi i ligjësisive të ndërtimit dhe funksionimit të shkurtesave ushtarake është domosdoshmëri në këtë fushë. Të gjithë fjalorët terminologjikë ushtarakë që janë botuar gjer tani, janë pajisur me shtojca të shkurtesave përkatëse. Gjithashtu është botuar një fjalor i shkurtesave dhe i akronimeve të NATO-s në gjuhën shqipe (1999) me 8.000 shkurtesa e akronime.

Nisur nga dinamika e zhvillimit të fondit leksikor, e ndryshimeve në përmbajtjen kuptimore të termave, e mënyrave dhe e mjeteve të formimit të tyre, e klasifikimit të termave të

⁴² E. Cabej, *Karakteristikat e huazimeve latinë në gjuhën shqipe*, SF, 1974, f.78

huazuar dhe e rrugëve të ndjekura për shqipërimin e tyre, mund të përcaktojmë edhe prirjet kryesore në zhvillimin e sistemit të terminologjisë ushtarake në kohën tonë, siç janë: prirja drejt përsosjes së sistemit të tanishëm të kësaj terminologjie, e cila në rrafshin gjuhësor çon në kufizimin e mëtejshëm të dukurive negative të shumëkuptimësisë (polisemisë) dhe të sinonimisë, d.m.th. të dysorëve terminologjikë; prirja e forcimit të simetrisë në mes të tipave fjalëformues; kjo duket mjaft mirë në fushën e formimeve me parashtesa të kundërkuptimshme e mohuese dhe me temat përbërëse antonimike (p.sh. gjoksmbrojtëse-shpinëmbrojtëse, flakëhedhëse-flakëshuese etj.); prirja drejt sintetizimit, që pasqyrohet sidomos në formimet me ndajshtesim (me parashtesa e prapashtesa) dhe me kompozim (bashkim temash) që janë rrugët kryesore për pasurimin e terminologjisë ushtarake me vetë mjetet e shqipes; prirja për të ngritur në terma fjalë të leksikut të përgjithshëm dhe, anasjelltas, kalimi i shumë termave ushtarakë në leksikun e përgjithshëm si rezultat i përdorimit të tyre edhe jashtë sferës ushtarake, çka flet më së miri për bashkëveprimin dhe lidhjet e ngushta të terminologjisë ushtarake me gjuhën e përgjithshme letrare.

Puna për saktësimin e terminologjisë ushtarake duhet të vijojë pa ndërprerje. Model për këtë na shërbën veprimtaria praktike e Agjencisë së Terminologjisë Ushtarake të NATO-s në Bruksel, ku për çdo miratim termi të ri bëhet mbledhje plenare e Komitetit të Përfaqësuesve të të gjitha shteteve pjesëmarrëse në NATO dhe pastaj pothuaj çdo vit bëhet njoftimi zyrtar në formë broshure për heqjen e termave të papërshtatshëm dhe vendosjen e termave të rinj. Si në çdo fushë tjetër të jetës, të shkencës dhe të teknikës, edhe në ushtri ndodhin vazhdimisht ndryshime, futen në zbatim metoda, teknika e taktika të reja, prodhohen armë e mjete luftarake të sofistikuar e nga më të përkryerat, të cilat kanë terminologjitë e tyre. E kjo terminologji e re që do të futet në ushtri dhe që do të zgerojë më tej sistemin e nënsistemet e saj, është e nevojshme të ndiqet, të skedohet, të studiohet dhe të futet në fjalorët përkatës terminologjikë, të cilët do të pasurohen e do të ribotohen përsëri në të ardhmen.

3. 8. Standardizimi i terminologjisë së informatikës

Mosstandardizimi i terminologjisë së informatikës në gjuhën shqipe është duke u nxjerrë telashe jo vetëm gazetarëve, redaktorëve gjuhësorë, autorëve të teksteve profesionale e shkencore, por edhe njerëzve të rëndomtë – përdoruesve të kompjuterit e të Internetit – sidomos mësimdhënësve e nxënësve të të gjitha niveleve të shkollës shqipe.

Rritja gjithnjë më e madhe e numrit të përdoruesve të kompjuterëve personalë dhe të përdoruesve të Internetit, në të gjitha vendet, e aktualizon gjithnjë e më shumë çështjen e terminologjisë së informatikës, në të gjitha gjuhët. Me zhvillimin e teknologjisë së informacionit rritet dhe numri i termave të krijuar për të shprehur konceptet e reja që kanë të bëjnë me këtë fushë. Këta terma, pothuajse pa përjashtim, krijohen në gjuhën angleze, meqë rëndom vijnë, së bashku me produktet e teknologjisë së informacionit, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat që nga viti 1989 janë superfuqi e vetme hegjemonë botërore. Vendet që nuk e kanë gjuhë zyrtare gjuhën angleze, ose duhet t'i pranojnë këta terma ashtu si u vijnë, ose duhet t'i krijojnë barasvlerësit përkatës në gjuhët e tyre lokale, gjë që nuk është punë aspak e lehtë, duke pasur parasysh numrin e madh të këtyre termave dhe shpejtësinë me të cilën ata depërtojnë në secilën gjuhë. Si rrjedhojë, terminologjia e informatikës po bëhet një burim i rëndësishëm për shumë terma që po hyjnë në fjalorin e përgjithshëm të gjuhëve të ndryshme, pra dhe në atë të shqipes.

Anglishtja ngadalë po merr rolin e gjuhës ndërkombëtare, të ashtuquajturës gjuhë

botërore, *apo më saktë, “gjuhë globale”*, rol ky që disa shekuj e ka pasur para saj frëngjishtja, e para kësaj të fundit latinishtja, e një funksion të ngjashëm, por vetëm në Evropën Qëndrore, ka pasur jo aq moti edhe gjermanishtja. Kështu edhe *kompjuter*, edhe *harduer* edhe *softuer*, edhe *internet*, edhe *ueb* - po bëhen fjalë ndërkombëtare. (T’i kushtohet vëmendje temes “**Anglishtja si gjuhë globale**”). “**ANGLOSHQIPJA**” apo “**GJUHA ANGLOSHQIPE**” (“**ALBENGLISH**”)

Siç thekson Yves Laroche – Claire në Parathënien e fjalorit të parë në botë të antianglicizmave [një gjini e re leksikografike] “*Évitez le **franglais**, parlez français*” (Shmanguni frënglishtes, flitni frëngjisht), të botuar në Paris më 2004: “Nuk kalon ditë pa na ardhur një fjalë a shprehje e re nga matanë Atlantikut”.

Përvojat dhe përngjasimet

Shumica e termave të anglishtes që përdoren në Internet ende nuk janë përkthyer në gjuhë të tjera, madje as në gjuhët “e mëdha” (me numër të madh folësish), siç janë kinezishtja e arabishtja apo spanjishtja e frëngjishtja.

As shqipja nuk bën përjashtim për sa i përket shqipërimit të termave të informatikës. Madje ajo qëndron edhe më keq se shumë gjuhë të tjera, përfshirë këtu edhe ato “të voglat” (me numër të vogël folësish).

Pjesa më e madhe e ndërkombëtarizmave në terminologjinë e informatikës janë ose anglicizma të mirëfillta, ose anglicizma për nga kuptimi që bartin. Më poshtë po japim disa nga ndërkombëtarizmat – anglicizmat më karakteristike që përdoren në terminologjinë e informatikës në gjuhën shqipe, e të cilëve nuk kanë mundur t’u bëjnë ballë as shumë gjuhë të tjera:

- 1 **aplet** (angl. *applet*),
- 2 **aplikacion** (angl. *aplication*),
- 3 **asembler** (angl. *assembler*),
- 4 **bajt** (angl. *byte*),
- 5 **bit** (nga: *binary digit* – shifër binare),
- 6 **bus** (angl. *bus*),
- 7 **CCD** (nga: *Charge-Coupled Device*),
- 8 **CD** (nga: *Compact Disc* – kompakt-disk),
- 9 **CD-ROM** (nga: *Compact Disc - Read-Only Memory*),
- 10 **Dekoder** (angl. *decoder*)
- 11 **Dekodim** (angl. *decoding*)
- 12 **Dekodoj** (angl. *decode*)
- 13 **digjital/dixhital** (angl. *digital*),
- 14 **disk** (angl. *disk*),
- 15 **disketë** (angl. *diskette*),
- 16 **displej** (angl. *display* – përshfaq; përshfaqës: ekran),
- 17 **email** (angl. *e-mail, electronic mail* - postë elektronike),
- 18 **fajl** (angl. *file*)
- 19 **fejsbuk** (angl. *face-book*)
- 20 **foldër** (angl. *folder*)
- 21 **font** (angl. *font*),

- 22 **format** (angl. *format*),
- 23 **haker** (angl. *hacker*),
- 24 **hard disk** (angl. *hard disc*)
- 25 **harduer** (angl. *hardware*),
- 26 **hipermedia** (angl. *hypermedia*),
- 27 **hipertekst** (angl. *hypertext*),
- 28 **ikonë** (angl. *ikon*),
- 29 **internet** (angl. *Internet*),
- 30 **intranet** (angl. *Intranet*),
- 31 **klient** (angl. *client*),
- 32 **klik, klikoj** (angl. *click*, fjalë onomatopeike),
- 33 **kod** (angl. *code*)
- 34 **kodek** (angl. *codec*, nga: **coder-decoder**),
- 35 **kompjuter** (angl. *computer*),
- 36 **kompakt-disk** (angl. *compact disk*),
- 37 **laser** (angl. *laser*, nga: **light amplification by stimulated emission of radiation**),
- 38 **meny** (angl. *menu*),
- 39 **modem** (angl. *modem*, nga: **modulator-demodulator**),
- 40 **monitor** (angl. *monitor*),
- 41 **multimedia** (angl. *multimedia*),
- 42 **pasuord** (angl. *password*)
- 43 **portal** (angl. *portal*),
- 44 **pejst** (angl. *paste*)
- 45 **piksel** (angl. *pixel*, nga: **picture element - element i figurës**),
- 46 **ping** (angl. *ping*),
- 47 **printer** (angl. *printer* – *shtypës*),
- 48 **printoj** (angl. *print* – *shtyp*),
- 49 **printim** (angl. *printing*);
- 50 **procesor** (angl. *processor*) e **mikroprocesor** (angl. *microprocessor*),
- 51 **protokoll** (angl. *protocol*),
- 52 **ruter** (angl. *router* - *rrugëzues*),
- 53 **server** (angl. *server* - *shërbyes*),
- 54 **Skanoj, skanër, skanim** (angl. *scan, scannër, scanning*),
- 55 **softuer** (angl. *software*),
- 56 **spam** (angl. *spam*),
- 57 **telnet** (angl. *telnet*),
- 58 **terminal** (angl. *terminal*),
- 59 **transferoj** (angl. *transfer*)
- 60 **ueb** (angl. *Web*, nga: **World Wide Web, WWW** – *rrjet mbarëbotëror*),
- 61 **version** (angl. *version*),
- 62 **virus** (angl. *virus*) etj.

Disa nga këta terma do të mund të shqipëroheshin, siç është vepruar më lart me disa prej tyre, dhe sa më parë të bëhet kjo, aq më shpejt do të nguliteshin ata në leksikon e gjuhës shqipe. Vlen për t'u përmendur se madje edhe francezët, jo shumë moti, i kanë përdorur edhe ata anglicizmat *hardware* dhe *softëare*, por sot, pothuajse pa përjashtim, në vend të tyre përdorin termat e krijuar brendapërbrenda frëngjishtes: *materiel* dhe *logiciel*, përkatësisht. Po kështu edhe kroatët bëjnë përpjekje që, gjithashtu, në vend të anglicizmave të përmendur të përdorin barasvlerësit përkatës në kroatishte: *sklopovlje* dhe *programska podrška*. Sa më parë të bëhet shqipërimi i termave që mund të shqipërohen - pa kaluar në purizëm dhe pa rrezikuar funksionimin normal të teknologjisë së informacionit, e duke pasur gjithnjë parasysh se shqipërimi i termave bëhet për të lehtësuar të kuptuarit e nocionëve dhe të koncepteve të një fushe, në këtë rast të fushës së teknologjisë së informacionit, përkatësisht të informatikës - aq më lehtë do të pranohen këta.

Disa nga ndërkombëtarizmat – anglicizmat e mësipërme, për nga grafia, nuk ndryshojnë fare, e për nga shqiptimi, fare pak, nga ata të gjuhës burimore (anglishtes), si: *bit, font, internet, intranet, modem, monitor, ping, portal, printer, server, spam, telnet, terminal*, prandaj nuk paraqesin vështirësi për t'u integruar në gjuhën shqipe. Një pjesë tjetër e fjalëve terma të mësipërme, ndërkaq, nuk ndryshojnë për nga grafia prej atyre të anglishtes, por shqiptohen ndryshe në anglishte, si p.sh.: *bus* (shqiptohet: bas), *e-mail* (shqiptohet: imeil), *version* (shqiptohet: vërshën), *virus* (shqiptohet: vairës), dhe në raste të tilla mund të vihemi para dilemës se a duhet përdorur trajta e shkruar (anglisht) apo trajta e shqiptuar (po ashtu anglisht) si normë. Në të folur, sidomos në zhargonin e informatikës, por jo rrallë edhe në të shkruar, këto fjalë dhe shumë të tjera, sidomos ato që nuk janë të përdorimit të përgjithshëm, shqiptohen përafërsisht si në origjinal, d.m.th. si në anglisht; kështu thuhet *bas* për *bus*, *imeil* për *e-mail*, *fail* për *file* (shqip: *skedar/fajl*), *maus* për *mouse* (shqip: *mi, miush*) etj.

Për termat *bus, email*, e të ngjashëm, mendojmë që në normë do të duhej ngritur trajta e shkruar (në anglisht), si në rastin e fjalëve – termave: *version* dhe *virus*, të cilat janë përdorur në gjuhën shqipe edhe më parë, por jo me kuptimin që kanë në fushë të informatikës. Këtu do të hynte edhe fjala term *laser* që haset të shqiptohet dhe të shkruhet si *lazer* (e që në anglishte, ndërkaq, shqiptohet si: *leizër*), që do të duhej shkruar (dhe shqiptuar) si: *laser*. Të përmendim këtu se ky parim duhet të vlejë edhe për fjalën term *maser* (angl. *maser*, nga: *microwave amplification by stimulated emission of radiation*), të krijuar po në të njëjtën mënyrë, siç vlen për fjalën term *radar* (angl. *radar*, nga: *radio detecting and ranging*). Sa i përket termit *byte* të anglishtes, ky tashmë ka hyrë në terminologjinë (e shkruar) shqipe të informatikës si *bajt* dhe mendoj se duhet të standardizohet si i tillë.

Kur flitet për normëzimin e terminologjisë së informatikës, para së gjithash mendohet në terminologjinë që do të duhej përdorur në punimet shkencore dhe profesionale dhe në tekstet universitare dhe shkollore, por dhe në shtyp e televizion.

Mosstandardizimi i terminologjisë së informatikës në gjuhën shqipe është duke u nxjerrë telashe jo vetëm gazetarëve, redaktorëve gjuhësorë, autorëve të teksteve profesionale e shkencore, por edhe njerëzve të rëndomtë – përdorues të kompjuterit e të Internetit – e sidomos mësimdhënësve e nxënësve të të gjitha niveleve të shkollës shqipe. Prandaj sa më parë duhet t'i qasemi standardizimit të terminologjisë së informatikës. Kjo është nevojë e ngutshme, që nuk pret ditë më të mira.

Me standardizimin e terminologjisë së informatikës në vende të ndryshme merren zakonisht institucionet joqeveritare (shkencore, botuese ose arsimore) të cilat me fuqinë e

autoritetit të tyre profesional ndihmojnë në njësimin e terminologjisë. Shumë vende janë në fazën e “lokalizimit”, ku me lokalizim, sipas LISA (*Localisation Industry Standards Association*) nënkuptohet “procesi i adaptimit (përshtatjes) të një produkti (shpesh, por jo gjithnjë, të një aplikacioni softuerik ose të një komponenteje harduerike) për të plotësuar kërkesat gjuhësore, kulturore dhe të tjera të një mjedisi rrethues a të një tregu të synuar të veçantë - lokal”. Shpesh me lokalizim nënkuptohet procesi i përkthimit të një pjese të softuerit ose të një faqëje ueb (uebfaqëje) nga një gjuhë në një gjuhë tjetër. Për shembull, në Francë njerëzit nuk përdorin të njëjtin version të Windows-it si ai që përdoret në Amerikë. Ata përdorin një version “të lokalizuar”, ku komandat, menytë, dhe udhëzimet për përdorim e instalim janë në gjuhën e tyre amtare, në frëngjisht. Franca tashmë ka hyrë në shoqërinë e informacionit, dhe ka hyrë pikërisht në frëngjisht. Por lokalizimi nuk është punë e thjeshtë. Në Poloni, p.sh., në fjalorin e lokalizimit për dy vjet janë ndryshuar 40% të termave. As vendet e tjera, si Çekia, Rumania, Sllovenia, Kroacia etj. që janë duke punuar rreth lokalizimit nuk e kanë më lehtë. Edhe te ne janë ndërmarrë masa që të fillohet me procesin e lokalizimit. Mbetet të shpresojmë se punët do të venë mbarë dhe se edhe në së shpejti do të kemi Windows-in e shqipëruar, siç do të kemi së shpejti edhe Fjalorin anglisht-shqip dhe shqip-anglisht të informatikës (projekt ky në përfundim e sipër i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe Akademisë së Shqipërisë).

3. 9. Anglicizma apo joanglicizma? Ndërhyrja e diskutueshme e anglicizmave si të tilla në gjuhën shqipe. Vërshimi i anglicizmave

Studjuesit shqiptarë të anglicizmave Hajri Shehu dhe Xhevat Lloshi kanë qëndrime të ndryshme në lidhje me hyrjen apo ndërhyrjen e anglicizmave në gjuhën shqipe. Disa raste të hyrjes së leksikut të gjuhës angleze në gjuhën shqipe të cilat konsiderohen si anglicizma nga H. Shehu nuk pranohen si të tilla nga Xh. Lloshi.

Sipas Lloshit, dallohen katër raste kur huazimet nga anglishtja në gjuhën shqipe nuk duhen konsideruar si anglicizma:

1. Fjalët e ardhura në shqipen nëpërmjet gjuhëve të tjera, kryesisht neolatine.
2. Fjalët e huaja që ndeshen në kushtet e dygjuhësisë si në Ballkan, ashtu edhe jashtë trevës së shqiptarëve në Ballkan.
3. Mjetet leksikore të anglishtes të përdorura brenda një teksti shqip për arsye të ndryshme stilistike.
4. Fjalët anglisht që përdoren “shabllon” dhe gabim nga padituria vetjake.

Duke analizuar rastin e fjalëve të ardhura në leksikun e shqipes jo drejtpërdrejt nga anglishtja, por nëpërmjet gjuhëve të tjera, kryesisht neolatin, studjuesi Xh. Lloshi argumenton se huazimi është një dukuri mjaft e ndërlikuar dhe fjalët përkatëse vështrohen nga pikëpamja fonetike, morfologjike, sintaksore e semantike për të përcaktuar rrugën e përshtatjes derisa bëhen fjalë të gjuhës që i merr. Sipas tij, “fjalët në fillim mund të vijnë në mënyrë të rastit dhe me rrugë të ndryshme, nga gjuha e folur dhe nga gjuha e shkruar, përdoren me luhate dhe prej këndej përftohen variante të ndryshme të po asaj fjale.

Por, me kalimin e kohës, nguliten modele të caktuara. Pas kësaj huazimi i veçantë nuk ecën në rrugën e vet, por shkon pas modelit (nënkuptohet që me këtë nuk mohohen rastet e përjashtimeve).” Për të ilustruar këtë mendim ai merr fjalët e shqipes me ndajshesën *-man*. Kemi tre homonime: a) *-man* e fjalëve të shqipes, si: *çalaman, fjalaman, rreckaman*; b) *-man* nga greqishtja, lidhur me ‘mania’, si: *biblioman, kleptoman, narkoman, piroman*; prej greqishtes

ka kaluar në latinishten mjekësore dhe prej këtu në shek. XIV në italishten e frëngjishten, kurse nga shek. XVI me kuptimin e sotëm.

Rrjedhimisht, për shqipen kemi të bëjmë me huazime neolatine; c) *-man* e anglishtes me kuptimin e njeriut, e cila përfundimisht është përshtatur sipas shqiptimit [*men*] për të shmangur homoniminë e padëshirueshme me rastet e pikës (b); p.sh. *biznesmen, kongresmen, supermen*, madje kemi edhe një formim të brendshëm të shqipes: *bllokmen*. Huazimet e tjera që mund të vijnë në shqipen do t'u përmbahen këtyre modeleve. Njëkohësisht në rastin e tretë kemi përcaktuar qartë një grup anglicizmash të gjuhës shqipe.

Me këtë kriter në dorë jemi në gjendje të zgjidhim edhe raste të tjera. Një varg termash, që shënojnë fusha të ndryshme të dijes kanë si pjesë të dytë *-log, -logji*, si: *antropolog-antropologji, biolog-biologji, albanolog-albanologji*. Gjatë fundit të shek. XIX pati përpjekje nga rilindësit që të ndërtoheshin fjalë me tema të shqipes, si: *dheshkronjë, dhetregonjë, njeritregonjë, kafshëtregonjë*, por pa sukses. Përfundimisht u ngulit modeli, i cili është më afër italishtes, me ndryshimin se nga drejtshkrimi ynë është pranuar tingulli *-gj-* (edhe sot ndeshen shmangie nga drejtshkrimi për këtë tingull, si në rastet *gen* për *gjen*, ose *axhendë*, për *agjendë*, *axhensi* për *agjenci* etj.). Kohët e fundit ka hyrë në përdorim fjala *ufologji*. Është krijuar në anglishten më 1959, ka hyrë në italishten më 1968, kurse në gjuhën shqipe ka zënë vend pikërisht sipas modelit të huazimeve neolatine, sepse si shqiptimi, ashtu edhe shkrimi shqip nuk përputhen me anglishten. Megjithatë mbetet anglicizëm, sepse i përket periudhës së fundit, për të cilën do të flitet më poshtë. Ky shembull është një dëshmi e qartë e pohimit të mësipërm, se huazimet nga anglishtja gjejnë shtresa të tjera fjalësh, që tashmë janë në përdorim në gjuhën shqipe.

Nga fjalët që nisin me A po rendisim rastet, kur si zanafillë sipas R. Filipoviçit është anglishtja dhe prandaj ai i ka përfshirë te anglicizmat e kroatishtes, por ndryshe nga ky autor, e quaj se në gjuhën shqipe këto huazime kanë ardhur nga gjuhë të tjera, prandaj nuk do të pranoheshin si anglicizma në shqipen. Kur ka qënë e mundur, kam përmendur datat e vënies në përdorim të fjalëve, ndërsa për shqipen datimin më të hershëm që kam qënë në gjendje ta dëshmoj.

aberracion – angl. *aberration*, përdorur nga astronomi James Bradley më 1725 për aberracionin e dritës; it. *aberrazionë* 1750; shq. te 'Liria Kombëtare', 12.1.1927.

abolicionist – ang. *abolitionist*, përdorur më 1790; it. *abolizionista* 1830; shq. te 'Normalisti', 1933, nr. 6.

acetilen – angl. *acetylenë*, zbuluar nga H. Davy më 1836, që e ndërtoi fjalën acet(ic)+(h)ylenë; T. de Mauro dhe M. Mancini⁴ e kanë gabim që e datojnë në anglishten më 1864; it. *acetilenë* 1875; shq. 'Fletorja zyrtare', 1929, nr. 32, por me trajtën e italishtes *açetilenë*.

adrenalinë – angl. *adrenalinë*, zbuluar më 1901 nga Dr. Jokichi Takaminë në SHBA, ndërsa fjala vjen nga ad-renal; it. *adrenalina* 1902; shq. te 'Fletorja zyrtare', 1937.

aerobik – angl. *aerobic* nga *aerobe*; it. *aerobico* 1936; shq. G. Vavako, 'Mbi plehrat', 1959.

agnostik – angl. *agnostic*, krijuar më 1870 nga biologu britanik T. H. Huxley (1825-95); it. *agnostico* 1905; shq. te 'Hylli i Dritës', 1922; te 'Materializmi dhe empiriokriticizmi', 1955, është përdorur mbiemri *agnosticist*, që nuk njihet në gjuhët e tjera europianë, me sa duket, për shkak të përkthimit të mbiemrit të rusishtes *agnostičeskij*, por duke ndjekur modelin e mbiemrave të tjerë, që lidhen me emrin me të njëjtën temë e me prapashtesën *-izëm* (kapitalizëm – kapitalist).

agnosticizëm - angl. *agnosticism*, 1884; it. *agnosticismo* 1897; shq. 'Fjalori i gjuhës shqipe' 1954.

akualang – angl. *aqualung*; shq. 1959 në një përkthim nga rusishtja; nuk njihet në gjuhët neolatine.

akuaplan – angl. *aquaplanë*, 1931 sipas *ëaterplanë* 1889; it. *acquaplano* 1931; shq. rreth 1960.

akuarium – angl. *aquarium*, 1854; it. *aquarium* 1955; shq. 'Fjalori i gjuhës shqipe', 1954.

albatros – angl. *albatross*, 1748; fr. *albatros* 1750; shq. 'Albania', 1902.

aligator – angl. *alligator*, 1568; it. *alligatore* 1763; shq. 1934 te Fjalori i N. Drizarit.

aliteracion – angl. *alliteration*; fr. *allitération*, 1751 nga anglishtja sipas 'Le Petit Robert', por jo sipas 'Larousse étymologique', kurse T. de Mauro gjithashtu nuk e lidh me anglishten, e quan it. *alliterazionë* të vitit 1609 nga lat. mod.; shq. rreth 1930.

alumin – angl. *aluminium*, 1812 nga H. Davy alum+inium si: sodium; it. *alluminio* 1819; shq. pas 1920.

amator – angl. *amateur*; fjalorët etimologjikë nuk e pranojnë si anglicizëm, siç bën R. Filipoviçi; fr. 1680 dhe it. 1753 prej frëngjishtes me kuptimin që e ka sot shqipja; shq. 1911 te 'Dielli e flamuri'.

amatorizëm – angl. *amateurism*; po ashtu nuk pranohet si anglicizëm si më lart; fr. *amateurisme* 1892, it. 1941; shq. në shtyp fundi i viteve 1950.

amerikanizëm – angl. *americanism*, 1794; nuk pranohet si anglicizëm, fr. *américanisme* formim i brendshëm 1866; it. po ashtu 1882; shq. në një përkthim 1959.

anabaptizëm – angl. *anabaptism*; nuk pranohet si anglicizëm, fr. *anabaptisme* 1564, *anabaptiste* 1525; shq. 1962 te 'Historia e mesjetës'; jo nga it. ku është anabattismo.

anëstezi – angl. *anaesthesia*; fr. *anesthésie* sipas 'Larousse étymologique' nga anglishtja 1771, me kuptimin e sotëm mjekësor 1827, por 'Petite Robert' e daton 1753 dhe nuk e pranon si anglicizëm; gjithashtu T. de Mauro it. *anestesia* 1819 nuk e shënon si anglicizëm; shq. 1939 te Th. Floqi, 'Fjaluer italisht-shqip'⁸, prej italishtes.

anglicizëm – angl. *anglicism* 1642; nuk pranohet si anglicizëm, fr. *anglicisme*, 1652, it. *anglicismo*, 1764 nga frëngjishtja; shq. 1939 te Th. Floqi, 1939.

anglikan – angl. *anglican* mesi i shek. XVI; fr. *anglican* 1554; it. *anglicano* 1606; shq. 1934 te 'Illyria'.

anodë – angl. *anode*, 1834 nga M. Faraday; fr. *anode* 1838; it. *anodo* 1849; shq. 1941 te 'Kimija', por si em. mashkullor anodi, për shkak të përkthimit nga italishtja, kështu që trajta e sotme del prej frëngjishtes.

antibiotik – angl. *antibiotic* 1947, propozuar për herë të parë nga S. A. Ēaksman-i në SHBA, por fjala ekzistonte në kuptimin e farmakut që më 1860; fr. *antibiotique* 1951; it. *antibiotico* nga frëngjishtja; shq. pas 1950, por jo drejtpërdrejt nga anglishtja, nuk i përgjigjet as shqiptimit anglisht.

anticiklon – angl. *anticyclonë*; nuk pranohet si anglicizëm, por merret si formim i brendshëm: fr. *anticyclonë* 1885; it. *anticlonë* 1890; shq. 1955 te 'Klima e Shqipërisë'.

antidumping – angl. *antidumping*; it. *anti-dumping* 1987 si formim i brendshëm; shq. fundi i viteve 1980.

antilopë – angl. *antelope*, 1607; fr. *antilope* 1622; it. *antilope* 1772; shq. 1882 te K. Kristoforidhi, 'Nomi i dytë'.

antiseptik – angl. *antiseptic*, 1751; fr. *antiseptique* 1763, formim i brendshëm nga botanisti Michel Adanson; shq. 1939, Th. Floqi.

antracit – angl. *anthracite*; fr. *anthracite*, 1752; it. *antracite*, para 1796; shq. 1939, Th. Floqi.
astronaut – ang. *astronaut*; fr. *astronaute*, 1933; it. *astronauta*, 1937; shq. 1963, te ‘Ylli’.
 Pastaj, duke polemizuar me studjesin H. Shehu, ai rendit një varg fjalësh që nuk mund të konsiderohen anglicizma të mirëfillta. Sepse ato janë marrë dhe janë përdorur më parë nga gjuhë të tjera, duke shënuar burimin dhe datën kur dëshmohen në gjuhën shqipe, si më poshtë:

aranxhim (nga fr.),
asistoj (nga it., 1928 Kodi civil),
bunker (ka pasur bunkerë italianë e gjermanë, prandaj fjala del që të Fjalori serbokroatisht-shqip më 1947),
emergjencë (nga it. ku dëshmohet që më 1667),
fiskal (nga it., pas 1920),
inicim (nga it., nuk ka asnjë përputhje të drejtshkrimit dhe të shqiptimit me anglishten),
instaluj (nga it., 1937 A. Leotti, Fjalori shqip-italisht, e ka edhe Fjalori i gjuhës shqipe 1954),
interferoj (nga it., në fillim sidomos lidhur me dukurinë fizike *interferencë* – te Fjalori terminologjik i akustikës 1963),
investigativ (nga it., ku njihet që përpara 1322),
instaluj (nga it. installare, e ka A Leotti më 1937 dhe Fjalori i shkurtër shqip-rusisht më 1950),
klonuj (nga it. clonare),
kolaps (nga lat., 1975 Fjalori latinisht-shqip i mjekësisë),
licensë (nga fr. dhe it., 1948 te S. Mann, Fjalori historik shqip-anglisht në trajtën liçencë sipas it.; nuk përputhet nga shqiptimi dhe drejtshkrimi me fjalën angleze),
moderator (nga it. dhe fr., nuk përputhet nga shqiptimi me anglishten),
nonsens (fr. dhe it., kjo e fundit mund ta ketë marrë nga anglishtja që më 1754), *promocion* (it. dhe fr.; në kuptimin e angl. *promotion* sot përdoret *promovim*, sepse shqipja nuk e ka pranuar shqiptimin e anglishtes),
rikapitullim (fr. dhe it., ku njihet që në mesin e shek. XIV, si dhe e njëjta vërejtje si për *promocion*),
satelit (it. e fr. që në shek. XV, shq. 1954 Fjalori i gjuhës shqipe,
satelitor që më 1970, madje është interesante se më 1635 F. Bardhi ka pasur nevojë të përkthente lat. *satellites* për shoqërues, rojë),
superficialitet (fr. e it. që në shek. XVI-XVII; M. Kuteli ka ndërtuar neologjizmin *sipërfaqëtar* më 1937).

Në një artikull të mëparshëm H. Shehu ka quajtur anglicizma një varg tjetër fjalësh, nga të cilat: *balast*, *biom*, *eksport*, *logaritëm*, *puritan*, *puritanizëm*, *turist*, *turizëm*, *votë* nuk kanë ardhur në gjuhën shqipe prej anglishtes. *Skremoj* dhe *granuloj* jo vetëm që nuk kanë ardhur prej anglishtes, por as nuk janë formime brenda shqipes, sepse janë nga italishtja: *scremare*, *granulare*. Ndërsa *raketë*, *rul* dhe *rroveshatë* jo vetëm nuk kanë ardhur nga anglishtja në gjuhën shqipe, por as nuk ka fjalë të tilla në anglishten. Përfundimisht të përfundim në fjalë *raketë*. *Raketës* shqipe i përgjigjen në anglisht fjalët *rocket* dhe *missile*. Homonimi tjetër për pallaskën raketë ka ardhur në shqipen nga frëngjishtja. Ruli ka disa kuptime në shqipen, që vijnë nga italishtja. Po ashtu *rrafishatë* apo *rroveshatë* është italianizëm i pastër: *rovesciata*.

Duke mënjanuar këtë grup, hapet rruga për të shtruar një pyetje tjetër: në rast se huazimet janë dukuri e gjuhëve në kontakt, atëherë mund të shtrojmë pyetjen logjike: Që nga cila kohë mund të

thuhet se shqipja ka hyrë në kontakt me anglishten? Ana tjetër e nënkuptuar në këtë pyetje, do të ishte: Kur janë njohur shqiptarët me anglishten në ato rrethana dhe në atë shkallë, saqë të ndikoheshin prej saj?

Me sa duket, K. Kristoforidhi ka qënë i pari që ka bërë një përkthim prej anglishtes. Në Abetaren e tij gegërisht të vitit 1866 ka përfshirë vjershën *Ylli lart ndë qiell* (angl. *Twinkle, twinkle little star* e R. L. Stevensonit). Në këtë libër ka edhe një fakt tjetër interesant. Janë përfshirë disa foto për ilustrim, klishtët e të cilave janë marrë nga ndonjë botim anglisht, sepse në disa prej tyre ka mbetur dëmtura anglisht. Kështu, në një tekst shqip nxënësit, të cilëve u drejtohej libri, gjenin edhe këto fjalë: *dog, goat, eagle, swallow, spider, cat, butterfly*. Edhe në ribotimet e mëvonshme, edhe në variantin toskërisht janë po ato ilustrime. K. Kristoforidhi kishte ndjekur tre vjet një koleg protestant në Maltë dhe për shumë vjet më pas bashkëpunoi me Shoqërinë Biblike të Londrës.

Dhjetë vjet përpara tij kishte mbaruar shkollën tregtare në Maltë Zef Jubani, i cili më 1853 ishte sekretar i nënkonsullatës britanike të Shkodrës, ku titullar ishte shqiptari Spiridon Bollati. Gjasim Qiriazzi më 1878 hyri në Kolegjin amerikan të Samakovit në Bullgari, ndërsa edhe motra e tij, Sevastia, ndoqi një shkollë amerikanë.

Ndonëse anglishtja nuk u përfshi në programin e shkollës së Korçës më 1887, shkolla shqipe për vajza për të marrë lejen e sulltanit u paraqit si shkollë në gjuhën angleze (1891). Më 1892 erdhi mësuese Fanka Efthimi, e cila gjithashtu kishte mbaruar Kolegjin amerikan dhe kështu nisi dhënia e anglishtes si gjuhë e huaj në një shkollë shqipe.

Vazhduesi i punës së Gjasimit, vëllai i tij Gjergji, po njësoj kishte mbaruar shkollën amerikanë. Gjithashtu, më 1904 nga po ajo shkollë amerikanë e Stambollit si edhe e motra, erdhi në shkollën e vajzave Parashqevi Qiriazzi, e cila jepte anglishten në të katër klasat që nga viti 1900. Rrethanat historike ndryshuan ndjeshëm në dhjetëvjeçarit e parë të shekullit XX, me pasojat edhe gjuhësore. Është me vlerë të dallohen dy zhvillime kryesore.

Së pari, pas shpalljes së Kushtetutës turke, atdhetarët shqiptarë patën mundësi të vepronin edhe me rrugë të tjera. Më 31 korrik 1908 u themelua i pari Klubi ‘Bashkimi’ i Manastirit nga F. Zavalani dhe Gj. Qiriazzi. Pas tij u themeluan edhe të tjerë. Nuk është e rastit që u përdor fjala angleze *klub*, në një rast të tillë të lidhur me Qiriazët.

Plot një vit më vonë A. Z. Çajupi botoi pamfletin Klub’ i Selenikut, në të cilin ndër të tjera shkruan: **“Mbase shumë shqipëtarë nuk e dinë se ç’domethënë kjo fjalë Klub (Club) ... kjo fjalë qënka përdorur ndë ballë fare nga englezët.”** Ky është jo vetëm një dokumentim plotësues për fjalën, por edhe një mendim i parë rreth hyrjes së anglicizmave në gjuhën shqipe. Në Normalen e Elbasanit më 1909 anglishtja u përfshi si lëndë me zgjedhje sipas dëshirës së nxënësve. U përpilua dhe u botua me alfabetin e Stambollit një “Metodë për gjuhën inglisht prej Dr. Ahn, shpjeguar prej Lumo Skendo”.⁴³

Së dyti, pas disa rasteve sporadike në fund të shekullit XIX, tashmë zgjerohet emigrimi i shqiptarëve në SHBA, më pas edhe në Australi. Për herë të parë në një numër jo të papërfillshëm, shqiptarët u ndodhën në kushtet e dygjuhësisë me anglishten. Revista e F. Konicës ‘Albania’ nga mesi i vitit 1902 nisi të shtypej në Londër. Nga viti 1906 nisi të dalë në Boston të SHBA gazeta ‘Kombi’ e S. Pecit dhe F. Nolit, e cila paraqitej anglisht si: *Weekly Albanian Nëëspapër*. Dhe në shkurt 1909 nisi botimin gazeta më jetëgjatë në historinë e shtypit shqiptar, ‘Dielli’, në të cilën një pjesë e lëndës ishte anglisht. Valë të tjera shqiptarësh kanë shkuar në

⁴³ Sh.Demiraj, *Kongresi i Manastirit*, Dituria, Tiranë, 2000, f.112

Amerikë e në Australi. Madje sot edhe në Angli ka një bashkësi të qëndrueshme shqiptarësh. E vlen të studiohet dygjuhësia e shqiptarëve në vendet anglishtfolëse, por për anglicizmat ka nevojë të bëhet një vërejtje thelbësore. Kështu vijmë te një grup i dytë.

2. Duke përjashtuar rastet e anglicizmave në kushtet e dygjuhësisë, Lloshi jep përkufizimin e tij rreth anglicizmave. Sipas tij, **“Anglicizëm është ajo fjalë që ka gjetur përdorim në këtë trevë, natyrisht, pa e përjashtuar edhe ndihmesën e mjedisit dygjuhësh, por për atë që ka sjellë në shqipen e përgjithshme dhe jo që ka mbetur brenda bashkësisë dygjuhëse.”**⁴⁴ Në fakt, ndihmesa e mjedisit dygjuhësh asnjëherë nuk është përjashtuar, kur botimet në vendet e huaja kanë qarkulluar në Shqipëri dhe kanë ushtruar ndikim, ose kur e kanë sjellë me vete shqiptarët e ardhur prej vendeve anglishtfolëse. Për shembull, emigrantët shqiptarë nga Australia kishin sjellë në Korçë fjalën për biçikletën sipas anglishtes *bashikëll* (angl. bicycle); fjala është përdorur deri në fund të viteve 1950.

Por nuk ishte ende anglicizëm më 1909 fjala *'kek'*, ndonëse e gjejmë te ‘Dielli’: *“Premë cake-t dhe i ndamë bashkë me të pirat.”* (Dielli, 31.12.1909). Po kështu, nuk është sot anglicizëm folja në fjalinë: *“Nobelisti Ferid Murad autografon disa kopje të gazetës.”* (V. Bajrami, Shqiptarët e Amerikës, Albanian Publishing, 2003, f. 349). Sot folësit në programet shqip nga radiot në SHBA (Zëri i Amerikës) dhe Angli (Radio Londra) nganjëherë nuk e vënë re se i përdorin mjetet nën ndikimin e dygjuhësisë. P.sh. *bombers* për atentatorin me bomba është përkthyer *bombardues* në një emision të BBC-së në shkurt 1996.

Pas Luftës I Botërore, me gjithë ndikimin e gjerë të italishtes e të frëngjishtes, hap pas hapi u krijuan kushtet në të cilat mund të flitet për shqipen në kontakt me anglishten.⁴⁵ Në radhë të parë u ngritën shkolla me mësues anglezë ose amerikanë, që ndërtuan edhe veprimtari anglisht me nxënësit shqiptarë.¹⁵ Dy vjet pas themelimit të Shkollës Teknike, që njihet si shkolla e H. Fulcit, nisi më 1924 botimin revista *Laboremus*, e cila që në titull i përfshinte të dyja gjuhët: The Albanian Vocational School – Shkolla Teknike Shqiptare. Po më 1922 Kristo Dakoja hapi Shkollën e vajzave në Kamzë, kurse më 1925 u themelua Instituti Shqiptaro-Amerikan i Kavajës. Si kureshti nuk mund të mos përmenden hyrja e lojës së futbollit në Shqipëri, terminologjia e së cilës për shumë vjet ishte tërësisht anglisht, lëvizja e bojskautëve dhe lojërat e bixhozit me terma nga anglishtja. Puna arsimore kërkonte tekstet përkatëse, prandaj filloi botimi i librave, si p.sh. Dhialloge inglisht-shqip më 1929 në Korçë nga Dh. Koti. Peshë të veçantë marrin fjalorët dygjuhësh. Pas ribotimit të glosarëve të Th. Kavaliotit dhe Dh. Voskopjarit më 1814 nga Ë. Martin-Leak-u, duke i zgjeruar dhe duke u shtuar përkthimin anglisht, i pari fjalor anglisht-shqip u shtyp më 1915 nga D. J. Kamburi dhe u ndoq pastaj nga Kostandin A. Çekrezi (1923), Th. Hondro (1927), Nëlo Drizari (1934) etj.⁴⁶

Rrjedhimisht, disa mendime se shqipja ka pasur më pak anglicizma se çdo gjuhë tjetër europianë ose se denduria e përdorimit të tyre është përgjithësisht e kufizuar¹⁸ janë shprehur pa e njohur lëndën dhe historinë gjuhësore. Madje i kanë quajtur si huazime të viteve të fundit fjalë, të cilat kanë një histori më të gjatë në gjuhën shqipe. Po përmend disa shembuj interesantë që përpara Luftës II Botërore.

Te ‘Liria Kombëtare (28 nëntor 1926) janë shkruar *çarlestona* e *fokstrota* dhe po këto fjalë janë shkruar anglisht “të kërcyerët *charleston* dhe *foxtrot*” te “Mësuesi”, nr. 1-2, 1928. Në të njëjtin numër 2 për vitin 1928 të revistës “Dialëria”, që dilte në Vjenë, kam gjetur anglicizmat

⁴⁴ Xh.Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, SHBLU, Tiranë, 1999, 175

⁴⁵ Po aty, f.177

⁴⁶ Gj.Shkurtaj, *Kundërime gjuhësore*, Pegi, Tiranë, 2006, f.65

board, farm, start. Në revistën “Ora” (1929): *Olrajt!* E pranoj që të më hapni barkun (tetor); *kartunist* i fletores “New York Evening Journal” (gusht); të dy *championët* shqiptarë (prill); *emfatizon* artikullin e vet me një *kartun* të posaçmë (nëntor); *kabinetin* e tij laburist.

Madje që në atë kohë kemi shenjat e para të ndërhyrjes së anglicizmave në mënyrë të gabuar, siç e cilëson G. Devoto për italishten në përkufizimin e cituar në fillim. Revista ka përdorur në diciturat: ‘Ajo që shëkon në këtë pikturë’ (janar) - është sipas anglishtes, sepse shqip përdoret ‘foto’ dhe fjala ‘pikturë’ nuk e ka kuptimin e fotografisë. Kjo ndeshet edhe të “Gazeta e Korçës”: Piktura tregon një vapor (14 janar 1934). Te po kjo gazetë hasen edhe: *Direksioni* i *Tennis-Kllubit* nuk i mungonte asgjësant; Ish elegant, i *animuar* ndë një *rithm* të njohëshëm (19 janar 1934); Një ‘*cowboy*’ me famë amerikan (25 shkurt 1934), armiq të cilët *dispozojnë* ushtërira (11 janar 1934) – dhe ky shembulli i fundit është te përkthimi i një artikulli të Ll. Xhorxhit.. Janë bërë përpjekje edhe për shqipërime, për “skautizmin” është gjetur gjyrmuesia, për “bojskautin” – gjyrmues, ndërsa për drejtuesin kryegjyrmuesi. Në një tekst shkollor (Bujqësia speciale, 1937) për egjrën shumëvjeçare thuhet: e përzejmë me ray-grassin engles.

Përkthimet nga anglishtja jo vetëm u zgjeruan, por arritën cilësi të lartë letrare me penën e Fan Nolit. Ndër autorët e tjerë u përkthyen vepra nga D. Defoe, J. Ludlow, A. Tennyson, H. G. Wells, O. Wilde, C. Doyle, G. F. Williams, me përkthyes si: Gj. Pekmezi, Dh. Koti, K. Skendi, S. Luarasi, I. Qafëzezi, A. Frashëri, L. Kristo, V. Xhaçka. Tashmë kishte shqiptarë, që e zotëronin anglishten në atë shkallë, sa që mund të shkruanin libra anglisht dhe ndër ta F. Konica e F. Noli kanë lënë vepra anglisht, të cilat ka qënë e nëvojshme t’i përkthejmë më pas shqip. Në këto rrethana shfaqët një dukuri tjetër e posaçme, e cila, sipas Lloshit, përbën grupin e tretë.

3. Mjetet e anglishtes të përdorura brenda një teksti shqip për arsye të ndryshme stilistike nuk duhen konsideruar si anglicizma të mirëfillta.

Sidomos në letërsinë artistike dhe në publicistikë e gojëtarë, autori mund t’u drejtohet mjeteve nga gjuhë të huaja për qëllime të ndryshme shprehëse pikërisht duke iu larguar shqipes dhe jo si mjete të shqipes. Interesi i gjuhësisë për këto raste përmbledhet në një konstatim: ky fakt është dëshmi se tashmë ajo gjuhë e huaj është e njohur për autorët shqiptarë dhe lexuesit e tyre në atë masë, sa që mund të shfrytëzohet për lojëra stilistike.⁴⁷ Po të mos ishte kështu, përftesa stilistike nuk do të kishte efekt. Po sjell një shembull, që i përfshin të dy njohësit e shkëlqyer të anglishtes: F. Konicën dhe F. Nolin. Te “Immigranti” (26 dhjetor 1926) F. Noli përgjigjet në polemikë: “Na akuzon që e atakuam *unfairly*, Faiku mban gjithnjë në gojë fjalën inglisht *fairness*. Po a ka qënë *fair* ay vetë?” Edhe më parë po aty (12 dhjetor 1925) F. Noli kishte shkruar: “Si burri me burrin që thomi shqip, *fairly* si thonë inglizët.” Gazeta është e kuptueshme që do ta kishte titullin anglisht, por po ajo fjalë është përdorur sipas anglishtes nga F. Konica në Parathënien e Fjalorit të K. A. Çekrezit më 1923: shkollarit dhe immigrantit. Dhe për ta mbyllur me këtë gazetë, F. Noli (26 dhjetor 1925) shkruante aty: “disa *sportsmanë* patriotë të treshë . . . rrojnë në Ballkan, me të cilin nuk përputhet *sportsmanësia*.”

Siç e vura në dukje më lart, këtë tip anglicizmash shqipja e ka përvetësuar **sipas shqiptimit**, pra *supermen* dhe jo *superman*. Si shembull i përftesave stilistike vlen edhe shtrembërimi i trajtave të shqipes sipas ngjashmërisë me anglishten, që e ka bërë I. Kadareja te “Dosja H”: Fort gjithkund e çmojnë mikpritjen e shqiptarëve ... Besa po. Në mjaft këtu do të rrijmë ... Me eposin e vjetër fort do të merremi, e ndoshta ... *O, jes* ...

⁴⁷ Gj. Shkurtaç, *Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës*, sh.b.”Kristalina”, Tiranë, 2003, f.57

Pas Luftës II Botërore regjimi enverist u përpoq të mbyllte çdo lloj kontakti me botën Përndimore, veçanërisht me vendet e anglishtes, nga të cilat u cilësua se vinte “reziku anglo-amerikan”. Por pas prishjes me shtetet e sistemit sovjetik pak nga pak nëpër shkolla vendin e gjuhës ruse e zuri anglishtja, u shtuan përkthimet e sidomos u hartuan fjalorë dygjuhësh me cilësi gjithnjë e më të mirë. Nuk është pa interes të vihet në dukje se madje nëpërmejt rusishtes kanë hyrë në gjuhën shqipe gjatë asaj periudhe disa fjalë të anglishtes, si: *ballast, dispetçer, grejder, matç, skrepër, tanker* të cilat prandaj që në fillim janë paraqitur me trajtën e përcaktuar në rusishten, pa kaluar proceset e përshtatjes që do të kërkoheshin në rastin e kontaktit të drejtpërdrejtë me anglishten. Një pengesë e ndjeshme ka qënë mungesa jo vetëm e produkteve me emërtime të anglishtes, por sidomos mungesa e makinerive dhe e teknologjive nga vendet anglishtfolëse. Njihej mirë vetëm makina qepëse *Singer*. Madje edhe sot vijjnë pajisje e produkte nga të gjitha anët me reklamimin anglisht, por ka shumë pak me mbishkrimin *Made in USA* ose *Made in UK*.

Përfundimisht do të pranohet se deri në periudhën kur do të fillonte vërshimi i papenguar i anglicizmave, domethënë deri më 1990, tashmë kishte një fond huazimesh angleze në gjuhën shqipe. Pa hyrë në hollësitë e rrugës së secilës fjalë në veçanti, po japim një listë, natyrisht jo të plotë:

- A. absenteizëm, ajsberg, aut (pas 1920, zëvendësuar me: jashtë; gjuajtje anësore), apartejd, autostop (1958),
- B. bar, basketboll, bejsboll, bënxxh, biftek, bihejviorizëm, bitëlls, biznes, biznesmen, blister, bluxhins (xhinse), bluz, bojkot, bojkotoj, bojskaut (pas 1920), bojskautizëm, boks (dy homonime), bokser, boksier, bos, brixh, buding, bugivugi, buldozer, bum, bumerang, buxhet,
- C. cent, centërbeg (pas 1920, zëvendësuar me qëndërmbrojtës), centërfor (zëvendësuar me: qëndërsulmues), centërhalf (zëvendësuar me: gjysmësulmues, çarleston, çartist (1957), çartizëm,
- D. dendi, destroyer, dok, doker, dollar, doping, dragë,
- E. ence (zëvendësuar me: prekje me dorë),
- F. faull (zëvendësuar me: goditje e gabuar), film, finish, flirt, flirtoj, flit (1954 Fjalori i gjuhës shqipe), foks (fokstrot), futboll,
- G. gangster, gol, golaverazh, golf, grejpfрут,
- H. hamburger, handikapat, hendboll, hipi, hokej, huligan,
- I. import, importoj, inç, jaht, janki, jard (1954 Fjalori i gjuhës shqipe),
- J. jaht (yacht)
- K. kauboj, kek, king, kliring, klub, klloun, kokakola, koks, koktej, kolt, komiks, kompjuter, kongresmen, kontejnër, kornër (zëvendësuar me: goditje nga këndi), kreking, kros (1954 Fjalori i gjuhës shqipe), kultivar,
- L. laburist, lazer, ledi, lider, lidershhip, linç (1954 Fjalori i gjuhës shqipe), linçoj, liliput, lobizëm (1972), lokaut, lord, ludizëm,
- M. marins (1967), mikser, miting (në Fjalorin e gjuhës shqipe 1954: meting),
- N. napalm, nokaut, nokdaun,
- O. okej (OK),
- P. pas, pasoj, paund, penallti (zëvendësuar me: goditje nga njëmbëdhjetëmetërshi), peni (pens), piknik, pop art, pot, pulovër,
- Q. quiz (*kviz* ose *kuiiz*)

- R. ramstek, raund, refer (zëvendësuar me: gjyqtar), ring, rokenroll, rum,
- S. samit, sandviç, skrap, skrepër, slogan, snajpër, snob, snobizëm, spidometër, spiker, splin (spleen në Fjalorin rusisht-shqip 19 1954), sprint, sprinter, standard, starking, start, sterlinë, stop, stres, striptizë, stuardesë, suing, sherif, shilingë, shut, shutoj,
- T. tank (rreth 1939, në fillim në trajtën e shumësit të anglishtes: tanks), teletajp, tenis, trajler, trajnër, trajning, traktor, transistor, tredunion, trust, tuist, tunël,
- U. uestern, uiski (viski)
- V. vat, vaterpolo, volejball,
- W.
- X. xhaz (xhez), ,xhaul, xhentëlmen, xhin, xhinse, xhips, xhoker, xhol.

Natyrisht, nuk mund të mohohet që dukuritë e huazimit të anglicizmave kanë mjaft anë të përbashkëta me marrjet prej gjuhësh të tjera. Edhe për këto mund të bëhen vëzhgime e hulumtime dhe të hartohen tabela sipas fushave tematike, sipas mjeteve fjalëformuese, sipas kategorive gramatikore, sipas etapave, etj. Gjithashtu, mund të shihen përshtatja me shqipen dhe ndryshimet fonetike, morfologjike, sintaksore e semantike, si dhe përpjekjet për zëvendësimin e tyre. Kjo është një problematikë e gjerë dhe ndoshta e diskutueshme.

Por është e domosdoshme të theksohet, se pas vitit 1990 filloi një etapë krejt tjetër e ndikimit të anglishtes mbi shqipen, të cilën mund ta quajmë **vërshim i anglicizmave**. Shpjegimi i këtij vërshimi gjithashtu kërkon trajtime të gjera, prandaj këtu po përmendim disa nga faktorët kryesorë që e shkaktuan: globalizimi; ndryshimet e thella politike, ekonomike, shoqërore, kulturore dhe arsimore duke iu përshtatur Perëndimit; hapja e befasishme e vendit më të izoluar në Europë kundrejt mallrave dhe produkteve kulturore të paraqitura në gjuhën angleze; dygjuhësia²⁰ (pas pavarësisë në Kosovë anglishtja është bërë gjuha e tretë shtetërore); trysnia e mjeteve elektronike të formatuara anglisht; goditja e prestigjit të shqipes standarde; ulja e kujdesit për kulturën e gjuhës dhe e nivelit kulturor në përgjithësi. Është përfutur moda e anglishtes, si shenjë e njëriut më të avancuar, por pashmangshmërisht e shoqëruar me anët qësharake të snobizmit. Shembulli më i fundit janë *letrat e njoftimit*, të cilat filluan të quhen *karta identiteti*, mirëpo deri në nivelet më të larta të ligjvënësve shqiptarë janë përmendur publikisht si “aj-di”, domethënë anglisht ID. Dokumenti zyrtar për fat të mirë është quajtur Letërnjoftim, ndërkohë që të gjitha fjalët shqipe janë shoqëruar me përkthimin anglisht, duke nisur që nga kreu: LETËRNJOFOTIM ID. Tashmë dygjuhësia na shoqëron zyrtarisht në mënyrë të përhershme.⁴⁸

Po ta përmbledhim këtë tërësi rrethanash, do të vëmë re se praktikisht shqiptarët me globalizimin janë në vendin e tyre të zhytur në mjedisin e anglishtes. Në shtëpi dëgjojnë këngë anglisht dhe shohin programe televizive shqiptare anglisht, në rrugë janë të rrethuar nga reklama anglisht, lexojnë gazeta me faqe të tëra anglisht madje edhe me tituj anglisht (*Tirana Observer*, për shembull), shkojnë në dyqanë me tabela anglisht ku shkruhet anglisht ‘Open’ ose ‘Closed’ dhe blejnë produkte shqiptare me etiketa anglisht (edhe ujin e burimeve shqiptare *Spring*), hanë në restorante me listat e gjellëve anglisht, në shkolla e në kurse të pafundme mësojnë anglisht, punojnë në kompjuter me programe anglisht, deri edhe ligjet hartohen anglisht e pastaj

⁴⁸ J.Thomai, *Teksti dhe gjuha*, Tiranë, 1992, f.46

përkthehen shqip.⁴⁹

Megjithatë, shtrirja tërësore e anglishtes te në nuk do të thotë se po aq tërësisht është arritur përvetësimi i drejtë i saj, siç mund të thuhet për shembull, për norvegjezët. Në veprimtaritë publike me anë të fjalës marrin pjesë njerëz, që jo vetëm nuk e zotërojnë mirë anglishten dhe rendin pas modës, por nuk zotërojnë as pasuritë e ngulitura të shqipes. Për këtë arsye do të dalloja edhe një grup të fundit.

4. Sigurisht, nuk duhen pranuar si anglicizma në gjuhën shqipe rastet kur fjalët anglisht përdoren gabim nga padituria vetjake, kryesisht në gjuhën e shkruar. Po përmendim vetëm pak shembuj, ndër ata që me të vërtetë përbëjnë një fatkeqësi për kulturën e shqipes së shkruar.

- Stoqet evropiane u ulën në mënyrë të ndjeshme të mërkurën. (gaz. Shekulli, 13.5.1999) – stocks anglisht do të thotë aksionët e bursës.
- numri i tankeve që ka urdhëruar Turqia. (Shek. 23.2.2000) – *ordered* anglisht në këtë rast do të thotë *porositur*.
- impiantin e fuqisë bërthamore në Temelin. (Shek. 22.8.2001) – *power* anglisht në këtë rast do të thotë *energji*.
- qeliza të lëndëve djegëse komerciale. (Shek. 6.12.2004) – *cell* anglisht përdoret edhe për *njësi*, pila.

Një shfaqje e veçantë e kësaj injorance, por edhe e ndërhyrjes së anglishtes, është shkrimi shqip i emrave të përveçëm sipas drejtshkrimit të anglishtes. Nga lufta e fundit në Gjeorgji po sjell dy emra, që u përmendën gjerësisht: Abhazia dhe Chinvali. Në shtyp dolën Abkhazi dhe Tskhinvali, pothuaj të palexueshëm nga njerëzit e zakonshëm. Në të vërtetë Abhazi dhe abhazian njihen prej kohësh, për shembull, janë në Fjalorin rusisht-shqip të vitit 1954. Mund të tingëllojë si e pavend fjala ‘injurancë’, por si mund të quhet ndryshe rasti: “botimi i parë i tregimit *Khadzhi-Murat*’ (Shek. 7.4. 2001), kur tregimi i L. Tolstoit “Haxhi Murati” është përkthyer shqip që përpara Luftës II Botërore dhe nuk ka shqiptar që të mos e ketë dëgjuar emrin Haxhi. Jo dhe aq rrallë kanë filluar të shkruajnë Beijing për kryeqytetin e Kinës, në një kohë që gjuhët e tjera europiane nuk e kanë bërë këtë katapultim, kurse në gjuhën shqipe kemi edhe pata pekinize.

Për ardhjen e anglicizmave në tërësinë e rrethanave të përmbledhura më sipër nuk është e mjaftueshme të flitet si gjithmonë deri më sot, se kemi hyrje të huazimeve, ashtu si është thënë zakonisht lidhur me gjuhët e tjera që kanë ndikuar mbi shqipen në periudha të ndryshme historike. Në këtë periudhë të vërshimit të tyre, jemi përballë ndërhyrjes së huazimeve angleze në gjuhën shqipe. Rrjedha e sotme nuk vjen në një vend të zbrazët, nuk plotëson thjesht mangësitë e nëvojat, madje nuk është kalimtare si modë, as nuk pritet ndonjë etapë në të ardhmen, kur gjërat shpresohet se do të ndryshojnë, siç shpresohet për shembull, për mënjanimin e orientalizmeve me arritjen e Pavarësisë që ndodhi më 1912. Vala e globalizimit është edhe kohësisht globale.⁵⁰ Nëpërmjet disa shembujve më poshtë besoj se do të dalë e qartë se çfarë kuptohet me ndërhyrjen e huazimeve angleze. Me shenjën # kam dalluar përdorimin e ri nën trysinë e anglishtes.

akademik - me tre kuptimet që jep Fjalori 1980 është përdorur qysh përpara Luftës II, e jep Th. Floqi 1939; vjen nga it.; po ashtu akademist te Fletorja zyrtare 1939, prej it. për studentët e akademive ushtarake; për *accademicamente* janë bërë përshtatje të ndryshme – akademisht në

⁴⁹ Po aty.

⁵⁰ Gj.Shkurtaç, *Ta duam dhe ta mbrojmë gjuhën tonë të bukur*, SHBLU, Tiranë, 1998, f.78

një përkthim 1957, por Fjalori 1954 e ka akademishtë, ndërsa akadimishtë te Kombi 1907 mund të jetë nën ndikimin e greqishtes. # Nga mesi i viteve 1990 po përdoret sipas ang. academic për gjithçka ka të bëjë me shkollën e lartë dhe sinonime me universitar: shkrimi akademik, bagazhi akademik (Shek. 2009).

akomodim, akomodoj - që në mesin e shekullit të kaluar është përdorur si term në akustikë dhe optikë (akomodimi i syrit, akomodimi i tingujve). Huazim nga it. accomodazione, accomodare me kuptimin e përshtatjes, rregullimit, dhe ka krijuar çerdhen e fjalëformimit në shqipen. # Nga mesi i viteve 1990 nisi të përdoret sipas angl. accomodate me kuptimin e vendosjes së dikujt për të fjetur ose banuar në hotel a gjetkë: akomodimi në hotel (1997); sistemi i burgjeve nuk mund të akomodojë të tjerë (2008). Italishtëja nuk e ka këtë kuptim, kurse përkundrazi, anglishtja e ka si kuptim të parë dhe tashmë në gjuhën e përditshme del edhe për shqipen si kuptim i parë.

akses – është përdorur në mjekësi prej lat. accessus, edhe fr. accès, p.sh. aksese të forta - Patologjia 1963. # Nga fundi i shek. XX nisi përdorimi sipas angl. access me kuptimin e parë: mundësia për të hyrë, për të përdorur, për ta pasur, si: akses interneti (Shek. 15.9.2002). Ky kuptim ka qënë i pranishëm edhe në fr. e it. accesso, por vetëm tashti vërehet për shqipen.

aplikim, aplikoj - është përdorur pas Luftës I Botërore (aplikoj dispozitat në “Fletoren zyrtare” 1928; aplikoj një doktrinë në “Illyria” 1934; dukuri të aplikueshme në “Ekonomia kombëtare” 1939). Huazim nga it. applicare, ku ka kuptimet: ngjis dhe zbatoj. Pas Luftës II B. u përdor edhe për një lloj punimi të artizanatit, sidomos të ngjitjes me kashtë (aplikacionë kashte, reparti i aplikim-kashte), si edhe artet e aplikuarra, aplikacion në shëndetësi. # Në mes të viteve 1990 nisi të përdorej gjerësisht për paraqitjen e një kërkesë sipas angl. apply dhe application. Folja e anglishtes ka si kuptim të parë pikërisht paraqitjen e kërkesës, prandaj Fjalori anglisht-shqip i N. Drizarit (1934) e përkthente: zbatoj, ujdís, kërktoj, i drejtohem; po ashtu G. Kici dhe H. Aliko²¹ e kanë dhënë më 1969 në fjalorin e tyre application = lutje, kërkesë, zbatim. Në këtë rast jo vetëm folja e italishtes nuk e ka kuptimin e kërkesës, dhe po kështu nuk e ka pasur gjuha shqipe, por edhe trajta e italishtes e përshtatur në shqipen ka marrë një kuptim të anglishtes, pavarësisht se trajtat e dy gjuhëve nuk përputhen, domethënë dallohen dukshëm it. applicare dhe angl. apply. Shqipja tashmë po ka të njëjtën fjalë me dy burime etimologjike. Kemi edhe aplikant për paraqitësin e kërkesës sipas ang. applicant, pasi italishtëja nuk e njeh dhe as frëngjishtëja nuk e ka si fjalë.

audiencë – nga it. audienza është përdorur me kuptimin e posaçëm të pritjes te kryetari i shtetit, siç e ka Fjalori i vitit 1954, por sidomos te Papa. Më përpara po me këtë kuptim e ka Fjalori i shkurtër shqip-rusisht më 1950, ndërsa Th. Floqi më 1939 ka: dëgjim, audjencë. Në mesin e viteve 1950 u përdor auditor për klasat e studentëve dhe për dëgjuesit në ato klasa. # Kurse pas vitit 1992 ka nisur të përdoret audiencë sipas angl. audience në vend të ‘auditor’, domethënë për tërësinë e dëgjuesve, rrjedhimisht fjala është me dy kuptime dhe jo me një, siç e kanë fjalorët e Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë që nga viti 1980 deri më 2006; nuk e ka përdorur me këtë kuptim as P. Qësku²² në Fjalorin e vitit 2002, kur tashmë dëgjohej rregullisht. T. de Mauro e shënon si huazim nga angl. edhe në it. audience, të cilën G. Devotoja nuk e kishte më 1982, por tashmë e kishte Fjalori i N. Zingarell-it më 1989.

bazik – term i kimisë nga it. basico; te Kimija, përkth. nga it. 1941 gjenden: hidrogjen bazik, acid monobazik, bibazik, tribazik ... polibazik. # Në shek. XXI po ndeshen përdorime me kuptimin ‘themelor, bazal’ sipas angl. basic, si: mendimi bazik i politikanëve (Shek. 25.8.2008), dhe interesat bazike në Kuvend 29 mars 2009. Nuk gjendet me këtë kuptim në fr., ku përdoret

basal.

divizion – term në ushtri, përdorur para Luft. II B. nga it. divisionë. # Nga viti 2000 për degën e një sipërmarrjeje sipas angl. division, p.sh. Divizioni i shpërndarjes i KESH (Shek. 24.8.2004).

drogë - huazim neolatin për shqipen, it. droga, fr. drogue. Fjalori i gjuhës shqipe më 1954 nuk e kishte si fjalë, as dhe çerdhen e saj, ndonëse specialistët e njihnin për drogat mjekësore, khs. edhe drogeri të ‘Bashkimi’ 1948, sipas it. e fr. me kuptimin e farmacisë. Fjalori kishte përfshirë narkotik dhe narkotizoj me kuptimin e lëndës që vë në gjumë, por jo për lëndët me veprim halucinogjen. Në fillim të viteve 1970 shfaqën në shtyp drogim, drogohem, i droguar, domethënë lidhur me kuptimin e dytë për lëndët halucinogjenë. Më 1980 Fjalori i gjuhës së sotme shqipe e ka përfshirë drogë, e ka ndarë në dy kuptime, por kuptimin e dytë e ka shpjeguar thjesht me sinonimin narkotik. Më 1980 gjejmë në këtë Fjalor edhe drogaman, është huazimi nga it. drogomanë, ndërtuar më 1968. Përkthyesit e kanë ndier se nuk përputhej me formimet në shqipen dhe e bënë drogaman sipas analogjisë me formimet me prapashtesën –man. Sinonimi narkoman mbështetej te tema narko-, kurse drogë nuk jepte një temë të tillë. Hartuesit e Fjalorit 1980 e kanë interpretuar krejt gabim si temë të shumësit droga- dhe prandaj kanë përdorur shumësin në shpjegim, por kjo është në kundërshtim me modelin e shqipes që nuk mbështetet te tema e shumësit. Ndeshet rastësisht edhe trajta drogmen, por është e gabuar, sepse këtu –man nuk ka të bëjë me angl. man. Përfundimisht, askush nuk e përdor sot këtë trajtë. Në ligjërimin e shkujdesur është në përdorim drogaxhi, ndërsa në përdorimin letrar ka disa zgjidhje për të dy kuptimet: i droguar, përdorues i drogës; shpërndarës droge, trafikant droge. Fjalori i gjuhës shqipe i vitit 2006, si një ribotim nuk e ka rregulluar punën dhe ka mbajtur këtë fjalë që askush nuk e përdor.

Në ribotimin e vitit 2006 drogë është shpjeguar me hollësi, domethënë tashmë drogë si halucinogjen është fjala më e përdorur kundrejt narkotik pikërisht duke iu nënshtruar ndikimit mbizotërues të angl. drug. Më 1980 folja jepej si vetvetore: drogohem, ndërsa më 2006 është pranuar të vihet trajta veprorë drogoj. Më 1980 mbiemri i droguar thuhej thjesht i narkotizuar, kurse më 2006 shpjegohet, e njëkohësisht është shtuar emri prejfoljor drogim. Kështu, brenda gjysmë shekulli fjala drogë hyri në shqipen, duke gjetur aty narkotik. Sot ajo ka marrë përparësinë lidhur me përhapjen e vesit, ndërsa narkotik dhe çerdhja e saj është ngulitur mirë për fushën e mjekësisë, ku lidhet kryesisht me narkozën.⁵¹ Ka ndodhur një rishpërndarje e fushës tematike. Por kjo është bërë në praninë e ndikimit të anglishtes. Narcotrafficante e italishtes (e ndërtuar më 1987) dhe narcotraffico (e vitit 1986) i kishin të gjitha mundësitë që të zinin vend si huazime, mirëpo janë parapëlqyer ndërtimet me drogë: trafikantët e drogës dhe trafiku i drogës, sepse është anglishtja (drug trafficker, drug traffic) që mbizotëron në përkthimet e deri te hartimi i ligjeve.

Ana më interesante është se trajtat fonetike e ruajnë të qartë prejardhjen nga gjuhët neolatine, kurse kuptimet dhe ndërtimi i togjeve ndjekin anglishten. Drogë ndryshon fonetikisht nga anglishtja drug, por kjo nuk e pengon ndërhyrjen e anglishtes. Është e njëjta dukuri si më sipër te aplikim, aplikoj.

edukim - përdorur pas Luftës I Botërore për rritjen me vlera morale, qytetare dhe intelektuale të njëriut, sipas italishtes *educazionë*, bashkë me fjalët e tjera të së njëjtës temë. Thelbi kuptimor del sidomos qartë te mbiemri: i edukuar, i paedukatë. Në anglishten kjo çerdhe

⁵¹ J.Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, SHBLU,Tiranë, 2002, f.88

fjalësh nuk e bën këtë dallim dhe tashmë sipas angl. education po përdoret për arsimimin, duke përfunduar në zëvendësimin e disa fjalëve të shqipes: edukim, edukatë, arsim, arsimim me një fjalë të vetme, me të parën sipas anglishtes. Vetëm një dhjetëvjeçar më parë do të vështrohej si absurditet togfjalëshi edukim në distancë, sepse asnjë lloj edukimi nuk mund të bëhet në distancë, kurse qartë shqip thuhet arsim në largësi. Te: Edukimi dhe kompetenca teknike (Shek. 23.8.2008), është e dukshme se bëhet fjalë për arsimin teknik.

ese - del te 'Stilistika' e A. Xhuvanit dhe K. Cipos 1930, duke dhënë prejardhjen nga frëngj. "prova (fr. essai)." Përgjithësisht është përdorur në shkollën tonë fjala 'hartim'. # Në dhjetëvjeçarin e fundit ka marrë përdorim të gjerë në shkollë nga angl. essay. Shqip fjala theksohet esé sipas fr. dhe trajta e shquar: eseja, sh. esetë. Në angl. theksi është [ései] dhe në shqipen do të dilte e shquar *esja, sh. *eset, prandaj prej këtej te disa përdorues, që nuk njohin tjetër gjë veç modës së anglishtes, ka lindur një pështjellim fonetik, shqiptojnë ése dhe nuk dinë pastaj si t'i ndërtojnë trajtat e tjera.

gradohem, graduat – në gjuhën shqipe emri gradë me shumë kuptime ka shërbyer për një çerdhe fjalësh, por nuk ka pasur kuptimin e notës shkollore ose të klasës, aq më pak për formime sipas angl. graduate si emër, mbiemër dhe folje. Gradë është huazim nga it. grado, N. Drizari 1934 e jep pikërisht në trajtën e it. grado, madje në krahinat kufitare është përdorur gradho, grado për termometrin prej greqishtes. Gradim, gradoj, i graduar nuk kanë pasur lidhje me mbarimin e një shkolle, sepse nuk e ka një kuptim të tillë as italishtja në këtë çerdhe. Por, N. Drizari më 1934 është përpjekur të përkthejë *graduate school* me shkollë gradonjëse dhe ky është fillimi i ndikimit të anglishtes. Shqip për këtë është përdorur aspirantura nën ndikimin e rusishtes dhe sot ndoshta afërsisht master. Th. Floqi 1939 graduat e ka sipas it. për i shkallëzuar; Fjalori i vitit 1954 e ka për ushtarakun me gradën më të ulët sipas it. graduato. Kurse përgjithësisht për mbarimin e shkollës kemi pasur diplomim, diplomohem, i diplomuar. # Por pas vitit 2000 kanë filluar të përdoren fjalët sipas anglishtes: graduat për i diplomuar, gradohem për: mbaroj shkollën, diplomohem, marr një gradë nga shkolla, si dhe: Të formuar në përfundim ose të graduar në Përfundim (Shek. dhjetor 2005).

infrastrukturë – nga fr. infrastructure (1875), it. infrastruttura (1952); dëshmohet në shtyp (infrastrukturë që përfshin linja të përbashkëta të enërgjisë, Zëri i popullit, 1.4.1972); është përfshirë në Fjalorin e vitit 2002 me një përkufizim të çuditshëm: "strukturë organizative dhe teknike e një shkalle më të ulët, që nuk bie shumë në sy ..." # Pas vitit 1991 është përdorur nën ndikimin e angl. infrastructure, e cila sot edhe te në ndër të tjera përdoret po me ato kuptime gjithashtu për rrugët, urat, kanalet, në shëndetësi për spitalet etj., të cilat sipas autorëve të vitit 2002 nuk bien në sy (!). Tashmë është shtuar edhe një përdorim i posaçëm në fushën e elektronikës kompjuterike: përfshin printimin, kompjuterat personalë, softëare, shërbimet dhe infrastrukturën IT. (Shek. 14.6.2009).

inteligjencë, inteligjent – në Fjalorin 1954 jepet me dy kuptime. Kuptimi i dytë për intelektualët si shtresë është përhapur në gjuhët europiane nga rusishtja pas viteve 1860, ndonëse si fjalë lindi në Gjermani në vitet 1840. Në kuptimin e parë për zgjuarsinë e kemi nga it. intelligenza, kurse me kuptimin e dytë it. është intelligenzia dhe shqip *inteligjencie*, -a dhe kështu e ka Fjalori 1980. Por, ky fjalor e ka përjashtuar fjalën inteligjencë si zgjuarsi, që e kishte Fjalori më 1954, për shkak të purizmit të skajshëm dhe kjo gjë ka vijuar në të gjitha ribotimet deri më 2006, e gjithashtu nuk e ka as Fjalori sinonimik i vitit 2004. Që nga viti 1967 flitet për inteligjencën artificiale lidhur me informatikën dhe kjo përdoret edhe në italishten, tashmë nën ndikimin e angl. artificial intelligence. Shqip te inteligjencë janë kontaminuar kështu dy fjalë. #

Por rreth vitit 2000 u ndërlikua edhe kuptimi i ardhur nga angl. intelligence për zbulimin informativ. Deri atëherë fjalorët e jepnin shqip, p.sh. Fjalori anglisht-shqip, botim shkollor 1966, e kishte: intelligence service – shërbim i zbulimit, zbulim; në Fjalorin anglisht-shqip të vitit 1986, në të cilin kam qënë redaktor, e kemi dhënë: shërbim sekret (informativ), kurse G. Kici e H. Aliko në Fjalorin e vitit 1969 e jepnin: sekcion i informatave, i zbulimit; së fundi, edhe P. Qësku në Fjalorin e vitit 2002 e ka: shërbim i fshehtë i informacionit. Zyrtarisht sot quhet Shërbimi Informativ të në, por në gazetari shpesh del: shërbimet e inteligjencës (burime të inteligjencës amerikanë, Shek. 31.10.2002) dhe shërbimet inteligjente. # Kështu, te rastet, si: shërbimet inteligjente të një vendi (Shek. 23.10.2002) del se edhe mbiemri inteligjent ka tashmë një kuptim të dytë si ndërhyrje të anglishtes, që nuk është regjistruar në asnjë fjalor.

intervistë, intervistoj – del më 1934 te N. Drizari, është huazim nga it. intervista, bashkë me intervistare, intervistatore, kjo e fundit shq. intervistues, gjithnjë me kuptimin e bisedimit për qëllime gazetarie dhe me këtë kuptim del te fjalorët që nga viti 1954 e deri te fjalorët më të fundit.

Mirëpo pas vitit 1995 ka marrë kuptimin: shqyrtimi nëpërmjet bisedës i aftësisë së dikujt për të hyrë në një punë, kuptim i cili është i pari për angl. interview. Po kështu kanë këtë kuptim tashmë: intervistoj, marr në intervistë, intervistues, i intervistuari. P. Qesku më 2002 e ka pranuar në Fjalor: intervistohem për punë. Përsëri kemi ndërhyrje të anglishtes, pavarësisht prej dallimit të dukshëm fonetik ndërmjet intervista dhe interview. Për gjuhët e tjera europiane pranohet se fjala angleze vjen prej fr. entrevue, por pastaj me kuptimin e specializuar të një gjinie të publicistikës edhe frëngjishtja ka huazuar interview, interviewer. Për italishten sipas G. Devotos gjithashtu ka ardhur nga frëngjishtja, por për T. de Mauron ka ardhur drejtpërdrejt nga anglishtja që më 1869. Gjermanishtja e ka po ashtu trajtën e anglishtes për gjininë e publicistikës, por për kuptimin e ri në shqipen ka Vorstellungsgespräch.

kablo – në kushtet e dygjuhësisë në SHBA është përdorur për kablogram, që e ka Fjalori më 1954 dhe vjen nga fr. cablogramme e it. cablogramma; del që te N. Drizari më 1934: dërgoj kablo, edhe te Gazeta e Re e Tiranës më 1929-30. Për 70 vjet nuk haset më në shkrimet shqipe me atë kuptim, sepse fjala kablo është ngulitur për telin e shumëfishtë që vjen nga fr. cable, prandaj hasen edhe variante drejtshkrimi të saj. # Por tashmë në përkthimet e nxituara të shtypit sot ndeshemi edhe me: deshifrimi i shumë kabllove të koduara (Koha jonë, 10.1.1996).

komitet – është ngulitur në gjuhën shqipe me kuptim të dalluar qartë prej komision. Që të dyja fjalët kanë ardhur nga italishtja: comitato, commissione dhe i përkasin fundit të shek. XIX, kur lëvizja shqiptare u ndesh me këto fjalë në marrëdhëniet ndërkombëtare. # Mirëpo angl. committee (nga e cila ka ardhur edhe it. comitato) ka disa përdorime, të cilave shqip u përgjigjet fjala komision; p.sh. credentials committee shqip është komisioni i mandateve dhe kështu përdoret për të gjitha komisionët parlamentare, të cilat anglisht quhen committee, prandaj standing committee është komision i përhershëm. Edhe në dokumente zyrtare kam vënë re se edhe kur fjala angl. committee ka kuptimin e komisionit, e përkthejnë drejtpërdrejt komitet.

kondicionuar (i) – nga it. condizionato. Në Fjalorin e vitit 1954 nuk ndeshet ende kalkimi i kushtëzuar, prandaj është vënë i kondicionuar për: që u shtrohet disa konditave; ndeshet edhe më vonë (problemet janë të kondicionuara me njëra tjetrën, nga shtypi 1962). Th. Floqi ishte nisur nga konditë dhe më 1939 kishte sajuar i kondituem. Për shkak të purizmit Fjalori i vitit 1980 e ka përjashtuar dhe po ashtu ka ndodhur në botimet e tij të mëpastajme.²⁴ Shqipërimi i kushtëzuar, me sa duket, është bërë nga mesi i viteve 1950, sidomos lidhur me termin në psikologji: reflekset e kushtëzuara. Por tema e huaj nuk është mënjeluar, p.sh. Fjalori anglisht-

shqip 1966 ka: conditioning – kushtëzim, kondicionim; në drejtësi për dënimet është përdorur në gjuhën e folur: kondicional.

Tashmë në Fjalorin anglisht-shqip të vitit 1986 kemi pranuar: conditioned air – ajër i kondicionuar, në një vend me conditioned reflex – refleksi i kushtëzuar. Mund të mendohej se huazimi për kuptimin e ri në teknikën e ftohjes vjen gjithashtu nga italishtja aria condizionata, mirëpo kudo sot e gjejmë rreth nësh thjesht anglisht air conditioning, kurse aparati quhet kondicioner, një fjalë që nuk njihet në italishten, por fr. conditionneur dhe anglisht (air) conditioner. Edhe ky është një shembull, kur trajta e fjalës shqipe vjen nga gjuhët neolatine, por kuptimi i dytë për ftohjen vjen nga anglishtja, me grafinë dhe shqiptimin e së cilës dallohet ndjeshëm.

konsideroj – A. Xhuvani në shënimet e tij për pastërtinë e gjuhës që nga viti 1950 ka propozuar që të zëvendësohen: konsideratë, konsideroj, i konsiderueshëm me kuptimet: nderim, çmoj, e quaj, e marr për; Fjalori i vitit 1954 ka vetëm konsideroj – e marr për, e zë për, e quaj për.⁵² Natyrisht, janë huazime nga italishtja që përpara Luftës II B. Shqipërimet nuk kanë arritur ta mënjanojnë, prandaj më 1980 janë përfshirë në fjalor edhe: konsideratë, i konsiderueshëm. # Nga mesi i viteve 1990 nën dikimin e anglishtes consider ka nisur të përdoret me kuptimin shqyrtoj. Është e vërtetë se këtë kuptim e ka edhe fjala përkatëse e italishtes, por me sa duket, në gjuhën shqipe mbizotëronte fjala konsideratë, një formim për it. considerazione, fr. considération, me të vetmin kuptim: nderim. Togfjalëshat: e marr në konsideratë, e mbaj në konsideratë, kam konsideratë, shpreh konsideratë, me konsideratat e mia më të denja etj. nuk lejonin që të vendosej një sinonimi marr në konsideratë – konsideroj me kuptimin marr në shqyrtim – shqyrtoj. Ndikimi i angl. consider drejtpërdrejt mbi foljen e shqipes ka sjellë lindjen e togfjalëshave të tipit konsideroj një çështje me kuptimin ‘e shqyrtoj një çështje’, ndryshe nga: e konsideroj çështjen të mbyllur, e konsideroj me rëndësi çështjen, e konsideroj si një çështje, domethënë: *e quaj, e vlerësoj, e mbaj*. Më tej kjo ka çuar deri te neologjizmi *konsiderim*, p.sh. Konsiderimi i të gjitha këtyre sfidave po zë vend. (R. Mejdani, Globalizimi, 2002, f. 44). Te shembulli: ndërkombëtarët kanë nxituar të ushtrojnë ndikim mbi qëverinë shqiptare për të rimarrë në konsideratë ndryshimet. (Shek. 9.2.2010) – togfjalëshi rimarr në konsideratë është përdorur për angl. reconsider, e cila tashmë jo rastësisht del edhe shqip: rikonsideroj.

kredit – Fjalori i vitit 1954 e jep si sinonim me kredi me kuptimin financiar dhe me kuptimin e dytë për besimin, autoritetin. *Kredit* vjen nga italishtja, ndërsa *kredi* nga frëngjishtja, që të dyja njësoj nga latinishtja dhe për shqipen i përkasin fillimit të shek. XX. Por, trajta prej frëngjishtes pak nga pak ka mbizotëruar, siç e tregon fakti që Th. Floqi më 1939 e kishte kredit pa iu larguar italishtes, Fjalori serbokroatishtshqip 1947 e kishte po ashtu kredit, pa iu larguar serbishtes, mirëpo Fjalori shqip-rusisht 1950 tashmë e kishte vetëm kredi, ndonëse edhe rusishtja e ka kredit. Megjithatë, ka formime të tjera, si: kreditor, kreditim, kreditoj, kreditues, i kreditueshëm me temën kredit. # Në fillim të shek. XXI, me ndryshimet në sistemin e vlerësimit arsimor, hyri ang. credit me kuptimin e dëshmisë për plotësimin e një detyrimi, provimi ose kursi mësimor dhe që shqip mund të thuhet: pikë dëshmie. Nuk është pasqyruar në Fjalorin anglisht-shqip të P. Qëskut më 2002, por e kam të dëshmuar që atë vit: për të plotësuar kreditet (Shek. 11 janar 2002). Për shkak të kuptimit më shpesh del në numrin shumës, por rastis edhe në njëjës. Një shembull përmbledhës: Do të jenë tre kredite ato që do të bëjnë vlerësimin e performancës vjetore të një mësuesi. Krediti i parë që duhet të sigurojë një mësues është ai për njohuritë

⁵² A.Xhuvani, *Për pastërtinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1956, f.67

profesionale, ku një arsimtar duhet të sigurojë një numër minimal kreditesh. Sigurimi i krediteve në njohuritë profesionale do të bëhet nëpërmjet provimeve. (Shek. 26.5.2009). Në raste të tilla ndoshta do të ishte më mirë që në fjalorët e shqipes të dalloheshin si dy homonime.

officer – huazim nga fr. officier për ushtarakun me gradë sipër nënofficerit, në shqipen pas Luftës I B., duke zëvendësuar tq. *zabit*. Fjala e frëngjishtes e ka pasur si kuptim të vjetër për ofiqar, kjo e lidhur në shqipen edhe me it. ufficiale, e cila i ka gjithashtu të dy kuptimet, por në gjuhën shqipe oficerë janë quajtur vetëm ushtarakët. Prandaj që nga N. Drizari më 1934 e deri te P. Qësku më 2002 fjalorët e kanë dhënë angl. officer me dy kuptime të ndara: zyrtar dhe oficer.

Mirëpo që nga fundi i shek. XX, nën ndikimin e fjalës angleze, edhe shq. oficer po përdoret me kuptimin e nëpunësit, zyrtarit, p.sh. oficeri politik i OSBE-së (Shek. 6 janar 2002). Madje është shfaqur edhe trajta për femrën: znj. Elena Ballauri, oficere e projektit (Albania, 28 prill 2005). Më duket se ky është një zhvillim, i cili duhet kundërshtuar pa mëdyshje.

operator – nga it. operatore, është përdorur kryesisht për mjekun operues (S. Mann, 1948), ndërsa Fjalori i viti 1954 ka shtuar kuptimin e teknikut të regjistrimit dhe të shfaqjes kinematografike; më pas nën ndikimin e rusishtes është përdorur kino-opëror, që e ka përfshirë edhe Fjalori më 1980, ndërsa sot është zëvendësuar nga kameraman. [Kjo fjalë duhej të ishte në shqipen *kameramen bashkë me fjalët e tjera prej anglishtes, mirëpo duket se është përdorur më herët sipas trajtës së italishtes cameraman, gjithashtu të huazuar në italishten nga anglishtja (që prej vitit 1908) dhe prandaj në nuk e kemi drejtpërdrejt prej anglishtes]. Për operatorin Fjalori 1980 e ka hequr kuptimin e parë dhe e ka bërë më të përgjithshëm: punëtor me një mekanizëm. Edhe fjala e italishtes e ka kuptimin e vepruesit në financa, prandaj Fjalori italisht-shqip i F. Lekës dhe Z. Simonit 1986 e ka vënë opëror ekonomik,

Por, pas vitit 1991 fjala e shqipes është barazuar kuptimisht me angl. opëror, sepse ka shkuar bashkë me foljen angl. opërate. Shembulli: Operatorët kanë investuar miliona dollarë për zhvillimin e softwerave (Shek. 4.2.2002) do të ishte i pamundur më parë. Fjalori më 1954 foljen opëroj e kishte vetëm për ndërhyrjen në kirurgji, Fjalori më 1980 e ka zgjeruar me një kuptim të dytë për veprime të caktuara, ndërsa tashmë ka marrë kuptimin e anglishtes opërate për veprimin me aksionë dhe përgjithësisht në biznes, kuptim që nuk është specifik në italishten, ndërsa në frëngjishten gjithashtu opérateur nuk e kishte kuptimin specifik në ekonomi, përpara se aty gjithashtu të niste përdorimin e me këtë kuptim nën trysninë e globalizimit. Është interesante që Petit Robert 1976 ka opérateur: caméraman, mirëpo nuk ka një fjalë caméraman te rendi alfabetik, ndonëse e shënon caméra si anglicizëm që nga viti 1900.

panel – huazim nga it. pannelo. Del për veshjen e murit te Fjalori rusisht-shqip më 1954, por edhe te Fjalori anglisht-shqip më 1966; e kanë Fjalori anglisht-shqip 1986 dhe Fjalori italisht-shqip i po atij viti, por për shkak të purizimit nuk e ka asnjë fjalor i gjuhës shqipe, as ai që e quan veten Fjalor i fjalëve të reja i A. R. Berishës i vitit 2006. Nga angl. panel ka ardhur së pari përdorimi special për panelin e kontrollit – pulti, fusha në të cilën janë çelësat dhe aparate të drejtimit, pastaj për panelet diellore, që e ka P. Qësku më 2002.

Porse nga fundi i shek. XX ka hyrë kuptimi i angl. panel si grup njërezish që mbledhen për një diskutim ose program transmetimi, madje edhe për vetë këtë organizim, p.sh. Nis paneli i ri i sigurisë së ushqimit. (Agon, 15.3. 2009). P. Qësku nuk e ka me këtë kuptim, prandaj e ka të gabuar përkthimin: “A panel of experts – komision specialistësh”, sepse ky nuk është asnjë lloj komisioni.

platformë – nga fr. plate-forme. Ka hyrë përpara Luftës II B., e kanë në fjalorët e tyre A. Leotti më 1937 dhe Th. Floqi më 1939 pikërisht me trajtën e frëngjishtes e jo të it. piattaforma,

ndonëse kuptimisht nuk përjashtohet ndikimi i kësaj. U përdor gjerësisht në kuptimin politik gjatë Luftës II B. dhe më pas nën ndikimin e serbishtes (khs. Fjalori serbokroatisht-shqip, 1947) dhe të rusishtes (khs. Fjalori i shkurtër shqip-rusisht, 1950, ku cilësohet: platformë politike), ndërkaq vetëm me këtë kuptim e jep Fjalori i vitit 1954. Fjalori i vitit 1980 ka shtuar si kuptim të parë atë të një rrafshi për qëllime të ndryshme, si në hekurudhë. # Kurse në shek. XXI ka nisur përdorimi për komunikimin në internet sipas angl. platform, sidomos në togun: platformë digjitale; p.sh. platformën HP BladeSystem Tipi Carrier (CG), serverin HP ProLiant. (Shek. 14.7.2009)

prezencë – huazim nga it. presenza me dy kuptime kryesore: prani dhe pamje e mirë e njëriut. Është përdorur përpara Luftës II B. dhe më 1950 A. Xhuvani kërkonte zëvendësimin me prani. E ka Fjalori shqip-rusisht më 1950, pastaj Fjalori rusisht-shqip 1954 dhe prej tij Fjalori rusisht-shqip i botuar në Moskë më 1989, por për shkak të purizmit nuk e ka përfshirë asnjë fjalor i gjuhës shqipe. Madje nuk e ka as Fjalori i M. Elezit më 2006, ndërkohë që aty ka një varg sllavizmash, të cilët nuk janë fjalë të shqipes, por dalin vetëm në zonat kufitare në kushte e dygjuhësisë, me derivate të sajura nga autori: preznjak, preznjaki, preznjakisht, preznjakohem, preznjakoj, preznjakuaer (khs. serb. przni, prznica). # Para vitit 2000 ka nisur përdorimi sipas angl. presence me kuptimin: përfaqësi me rol politik, p.sh. Burime pranë Prezencës së OSBE-së (nga shtypi, 1997).

redaktoj – huazim nga rus. redaktirovat', por për shkak të pranisë së fjalëve me të njëjtën temë redaktor, redaksi; as nga it. redigere, as nga fr. rédiger. # Në dhjetëvjeçarin e fundit, nën ndikimin e angl. redact po përdoret edhe për: hartoj, përgatis një shkrim, kuptim që e kanë edhe foljet përkatëse të it. e fr. Në të njëjtin tekst (Shek. 24.2.2000) janë përdorur të dyja fjalët: në spitalet e Parisit duhen redaktuar raporte shkencore në gjuhën angleze . . . kërkon që raportet në ministrinë e tij të hartohen në anglisht.

rekord – është një shembull interesant i ndërhyrjes në një anglicizëm tashmë të njohur të shqipes, ose i huazimit për së dyti; haset që përpara Luftës II B., më 1947 e ka Fjalori serbokroatisht-shqip. Edhe në gjuhët e tjera europiane është huazim nga angl. record, por gjithnjë me kuptimin e arritjes sportive. Ndërkaq, në anglishten fjala ka si kuptim parësor dëshminë, regjistrimin, dokumentin e një ngjarjeje ose informacioni. F. Noli (Immigrant, 28.2.1925) ka përdorur fjalën angleze: sikundër provohet nga rekordi i tij në parlament. Edhe N. Drizari më 1934, në kushtet e dygjuhësisë nuk ka ditur si ta zgjidhë përkthimin dhe ka: vë në rekord; rekord, pasqyrë për t'arthmen, që nuk janë përdorur në Shqipëri. Fjalori i vitit 1966 këtë kuptim e ka dhënë si dokument dhe protokoll, kurse P. Qësku më 2002 ka marrë përkthimin tonë të vitit 1986: regjistrim, dokumentim. # Pas viti 2000 tashmë e gjejmë këtë kuptim të parë të anglishtes edhe në gjuhën shqipe: kontrolli për rekorde të shumëfishta që i përkasin të njëjtit shtetas ose dublime (Agon, 12.2.2009); Shtëpinë e ka ndërtuar një njëri që mund të them se ka rekordet më të mira si producent ekzekutiv vitet e fundit. (Shek. 16.6.2009).

sfidë – huazim nga it. sfida, për të cilën shqip thuhet edhe: i hedh çik. Me sa duket, është përdorur pas Luftës II B., e ka Fjalori rusisht-shqip më 1954 dhe e ka pranuar Fjalori më 1980. # Por kohët e fundit është përdorur gjerësisht për të përkthyer angl. challenge dhe prandaj ka marrë kuptimin e saj: detyrë e vështirë ose me kërkesa të larta; p.sh. janë të vetëdijshëm për sfidën madhore që shtrohet përpara tyre (Shek. 15.8.2008), kuptim që nuk e ka fjala e italishtes dhe as fr. défi. Që më 1986 e kemi përkthyer challenge me sfidë dhe e ka pranuar P. Qësku më 2002.

statizëm – term i mekanikës si edhe it. statismo, ku quhet se ka hyrë në përdorim më 1960, por te në është përdorur pavarësisht prej kësaj edhe për paraqitjen e ngurtë, statizmin e figurave në

teatër e skulpturë. Për angl. statism kemi pasur termin etatizëm nga fr. étatisme, të cilën e ka huazuar edhe italishtja. Termin 'etatizëm' nuk e kanë përfshirë fjalorët e shqipes, por në Fjalorin politik të Oksfordit, përkthyer më 2001, është vënë etatizëm – angl. statism. # Mirëpo përkthyesit tashmë marrin drejtpërdrejt fjalën e aglishtes, si p.sh. të bazuar në parimet e statizmit dhe të nacionalizmit (K. Flemming, Bonaparti mysliman, 2003, f. 6).

zhvillim, zhvilloj – E. Çabej te 'zhdrivilloj' e quan fjalë të lashtë të shqipes. Në Fjalorin e gjuhës shqipe 1980 folja jepet me 8 kuptime, # por në dhjetëvjeçarin e fundit, nën ndikimin e angl. develop, development ka nisur të përdoret me kuptimin: e përgatit, e përpunoj që të përfundohet ose të bëhet veprues; p.sh. zhvilloj një plan.

Ndërhyrja e anglishtes nuk vërehet vetëm në leksik përgjithësisht. Pa hyrë në hollësi, po shënojmë se janë cenuar aspekte, që tradicionalisht kanë pasur një zgjidhje të ngulitur, kurse tashti po ndryshohen duke imituar verbërisht anglishten: shkruajnë me shkronjë të madhe çfarëdo fjale të titujve, të emërtimeve të popujve e deri të muajve; ligjërata e drejtë jepet me thonjëza gjatë dialogëve dhe jo me një vizë përpara sipas traditës sonë nga gjuhët neolatine (një zgjidhje e dhënë prej J.-F. Marmontelit tre shekuj më parë); shënohet me presje ndarja e grupeve me tri shifra, kurse presja dhjetore tradicionalisht ka tjetër kuptim të në; pikëpresjet zëvendësohen me viza në fillim e në fund etj.

Kanë nisur kalkimet e fjalëve të përbëra sipas modeleve të anglishtes, p.sh. politikëbërje, vendimmarrje, paqëruajtësit. Togfjalësha të anglishtes merren dhe përdoren me të njëjtin rend sintaksor si të anglishtes. Kështu, raporti për ecurinë, përparimin në një fushë, anglisht quhet progress report, e marrin po me këtë renditje dhe e lakojnë shqip: bazuar mbi progres raportin e fazës raportuese (2009). Nuk mund ta kapërcej këtë rast pa e vënë në dukje ndërhyrjen e anglishtes, sepse *raport* është huazim i vjetër në shqipen, por këtu përdoret sipas anglishtes, ku trajta është report. Po sipas këtij rendi sintaksor kemi tabelat e një studioje në disa pika të Tiranës: Art Galeri Kledi. Është sipas anglishtes Art Gallery, por e shkruar sipas shqipes. Të njëjtën natyrë ka emërtimi i një qëndre tregtare: Kristal Center.

Nuk mund të mos habitesh, kur sheh se po ajo qëndër prodhuese reklamon panele sanduiç dhe panele sandëiç. Kjo e fundit është me të vërtetë një shartim, sepse ka një dyvë (ë) të anglishtes dhe një 'ç' të shqipes së bashku! Në morfologji po shtohen fjalët e anglishtes në shumës që përdoren shqip si njëjës: kaubojs, fans, hackers, skorpions. Përshtypje të keqë bën sidomos shqiptimi pa mbaresë rasore i emrave të njerëzve nga ana e folësve të radiotelevizionit thjesht si modë (p.sh. Bush tha). Madje mund të duket sikur është gabim shtypi shkrimi i fjalës kompani, mirëpo në të vërtetë mjaft shpesh ndodh kjo në gazeta e përkthime të tjera, sepse thjesht ndiqet teksti anglisht, mbi të cilin punon përkthyesi drejtpërdrejt në kompjuter dhe prandaj, p.sh. në faqët e shtypit gjejmë edhe *action, economic* etj.

Një ndër rrethanat që e ndihmon ndikimin e anglishtes është dukuria e re, kur në tekste të plota po e njëjta fjalë ose shprehje ndeshet edhe shqip, edhe anglisht, si në këtë shembull: UNMIK do të fillojë të reduktojë stafin e vet. 70 për qind e përsoneilit të UNMIK-ut pritet të largohen nga Kosova; Kërkojnë të ndjekin studimet në sistemin part-time... në sistemin me kohë të pjesshme. ('Shekulli', 21.08.2008); Lindsay ndryshon look. Lindsay Lohan ka ndryshuar pamje. ('Republika', 25.08.2009). Projektligji për verifikimin e figurës së zyrtarëve të lartë është drafti i parë. ('Shekulli', 29.08.2008). Me këtë rrugë anglicizmat aklimatizohen për shqiptarin dhe hapet rruga që të zënë përfundimisht vendin në gjuhën shqipe.

Dukuria e ndërhyrjes nuk është diçka që vërehet vetëm për gjuhën shqipe. Në përkufizimin e G. Devotos për anglicizmat është mbajtur qëndrim kundrejt rasteve, për të cilat

jepet si shembull 'lettura'. Fjalori etimologjik i T. de Mauro dhe M. Mancini-t është detyruar në mjaft raste të japë etimologjinë e fjalës italianë duke treguar formimin e brendshëm, por duke shënuar gjithashtu që të krahasohet me termin përkatës të anglishtes, sepse tashmë për përdoruesit e sidomos për specialistët e fushave përkatëse e njëjta fjalë ekziston njëkohësisht, e njohin njëkohësisht në të dyja gjuhët. Po rendis trajtimet e tilla në atë Fjalor vetëm për disa raste nga shkronja A:

abolizionismo – khs. abolitionism; abolizionista – khs. abolitionist; acculturare – khs. (to) acculturate; acculturativo – khs. acculturative; acculturazionë – khs. acculturation; acetilenë – khs. acetylenë; acquametria – khs. aquametry; acquaplano – khs. waterplane; acroletto – khs. acrolet; adattivo – khs. adaptive; aerobico – khs. aerobic; aerobus – khs. airbus; aerospazio – khs. aerospace.

Prej këndeje mendoj se edhe për fjalorin etimologjik të ri të gjuhës shqipe do të ishte e dobishme të ndiqej një rrugë e ngjashme. Për shembull, fjala opzion që po përdoret gjerësisht nga viti 1995, fonetiki vjen nga fr. option, ndonëse ndonjëherë del edhe opcion, kjo sipas it. opzione, të gjitha prej latinishtes, madje e kam ndeshur të shkruar edhe obsion. Fjalori ekonomik i M. Koninit dhe I. Peçit (1997) e ka si fjalë të parë opzion, por pastaj ka përdorur vetëm opcion: blerës i opcionit, treg i opcioneve, për arsyen se fjalori është shqip-anglisht-gjermanisht dhe puna është bërë me bashkëpunim gjerman; gjerm. Option lexohet [opcion]. Nuk pasqyrohet në fjalorët e shqipes, për shkakun se edhe në fjalorët e zakonshëm dygjuhësh kurdoherë është përkthyer zgjedhje. Mirëpo përdorimi i sotëm i gjerë vjen drejtpërdrejt nga ballafaqimi i përditshëm i shqipes me angl. option. Prandaj e ka përfshirë L. Kaceli në Fjalorin e termave juridikë, ekonomikë dhe të biznesit (2002): option n - zgjedhje, alternativë, opzion.

Në përpjekjet për shqipërimen *option* më 1989 është bërë *optim* te *Fjalori i termave të tregtisë së jashtme*. Mirëpo kjo do të nënkuptonte një folje optoj prej fr. opter. Përkthimi rusisht po aty optacija është i gabuar, sepse në rusishten ky është term në drejtësi dhe jo në tregti. Është te Fjalori i termave të së drejtës 1986 te fjala zgjedhje, sepse edhe optim ky Fjalor e ka referuar te zgjedhje: option, optacija. F. Leka ka qënë në komisionin hartues të tij dhe prandaj e ka po më 1986 Fjalori italisht-shqip: opzionë – 2. (drejt) optim, zgjedhje (shtetësie). Tashmë optoj dhe optim do të jenë nën trysinë e drejtpërdrejtë të angl. opt.

Njëkohësisht me emrin është edhe mbiemri opsional. T. de Mauro e shënon krahasimin me anglishten, por Fjalori i termave të ekonomisë së transportit (2002) optional route e ka përkthyer itinërar fakultativ. Përfundimisht, në një fjalor të ardhshëm etimologjik paraqitja do të ishte kjo:

opcion m. ~i nga fr. option dhe it. opzionë, fundi i shek. XX; khs. ang. option.

opsional mb. ~e nga it. opzionale, fundi i shek. XX; khs. angl. optional.

Anglishtja si gjuha e globalizimit nuk mund të mënjanohet më dhe prandaj as dukuria e ndërhyrjes në gjuhën shqipe. Mbetet si detyrë të ndiqet ajo për të dëshmuar drejt proceset leksikore dhe për të mënjанuar gabimet në trajtimin e fjalëve më vonë në studimet tona gjuhësore e sidomos në punimet etimologjike.⁵³

⁵³ A.Kostallari, *Gjuha letrare shqipe dhe disa probleme themelore të drejtshkrimit të saj*, Tiranë, 1973, f.77

Kreu i katërt: Standardi gjuhësor i shqipes në emisionet e lajmeve të Radio-Televizionit (Maqedoni dhe Kosovë)

Në trojet shqiptare gjuha letrare kombëtare nuk është e barabartë me mësimin e gjuhës në shkollë si lëndë mësimore, por duhet parë si pjesë themelore e kulturës qytetare. Në këtë kuptim emisionet e lajmeve të radiotelevizionëve kanë kontribuar për normëzimin e gjuhës shqipe, kurse problemet e standardit gjuhësor në të kanë të bëjnë me disa çështje të përkthimit nga gjuhët e huaja në shqip, si dhe në disa raste me veçoritë e fonetikës shqiptare.

Një nga arsyt kryesore të shkarjes nga standardi gjuhësor në mediat shqiptare në Maqedoni është elementi historik, përkatësisht zhvillimi i shqiptarëve jashtë institucionëve shtetërore, mosqëniti shqipja gjuhë zyrtare, bashkëjetesa dhe kontaktet e vazhdueshme me maqedonasit, futja e fjalëve sllave në leksikun popullor, në të folmet e Maqedonisë etj.

4. 1. Drejtshqiptimi

Drejtshqiptimi është ndër çështjet kryesore të gjuhës në radio. Nga folësit kërkohet që të flasin qartë, me shqiptim të pastër e të pranueshëm radiofonik, duke u mbështetur në stilin e plotë të shqiptimit letrar.⁵⁴

Drejtshqiptimi (ortoepia) kërkon kujdes më të madh gjatë prezantimeve apo të folurit publik, duke u kujdesur sa për shqiptimin e drejt të fjalëve në aspektin fonetik, po aq edhe për leksikun e përdorur dhe sintaksën e drejt e pa kalka.

4.1.1. Mbi zbatimin e parimit fonetik të drejtshqiptimit

Parimi themelor i shqipes është ai fonetik - shqiptohet siç shkruhet. Krahas parimit fonetik vepron edhe parimi morfologjik, kur “zbatimi i veçuar i parimit fonetik do të çonte në errësimin a në prishjen e strukturës morfologjike a fjalëformuese të fjalëve”. Kundërshtimi midis këtyre dy parimeve shfaqet në të shumtën e rasteve në mosshqiptimin e zanores -ë.⁵⁵ Spikerët shqiptarë kanë zbatuar gjithmonë këtë dukuri tek -ë-ja fundore të emrat femërorë, të mbiemrat e formuar me anën e prapashtesës -të, të numërorët rreshtorë, të trajta e vetës së tretë njëjës e mënyrës lidhore të gjitha foljet; të pjesoret e foljeve me temë me zanore a me sonantet -l, -ll, -r, -rr dhe mbiemrat e nyjshëm të formuar prej tyre etj. Tejkalimi i parimit fonetik të shqiptimit nganjëherë vihet re në fjalë të prejardhura, të formuara nga një temë më -ë me anë prapashtesash që nisin me bashkëtingëllore: *botëror, drejtësi, frikësoj, frymëzoj, hollësi, hollësisht, gjuhësi, gjërësi, gjatësi, këmbësori, lehtësim, mirësi, përmirësoj, rreptësisht, thellësi*, dhe në fjalë të përbëra e të përngjitura, që kanë si pjesë të parë një temë të tillë me -ë, të ndjekur nga një temë

⁵⁴ M.Çeliku, *Çështje të gjuhës standarde*, Tiranë, 2001, f.69

⁵⁵ F.Agalliu, *Mënyra lidhore në gjuhën e sotme shqipe*, në *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f.34

që nis me bashkëtingëllore: *armëpushim, çfarëdo, frymëmarrje, gjashtëdhjetë, gjysmëhënë, kokëfortë, shumëfishoj, vetëdashje* etj.

Gjatë diskutimit të normës fonetike duhet të përmendet edhe një dukuri tipike historike për shqipen – shurdhimi i bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të fjalëve ose në trup të fjalës para bashkëtingëlloreve të shurdhëta, për shembull, *vend, gaz, i madh, oriz, ndez, mblihte*. Kjo dukuri bie në kundërshtim me parimin fonetik të shqipes dhe sipas studiuesve është “në tërheqje dhe rrudhje te brezi i ri”.⁵⁶

4. 1. 2. Zbatimi i normës lidhur me dukuri të veçanta

Spikerët e radiotelevizionit gjithmonë kanë qënë të kujdesshëm në vlerësimin e dukurive fonetike sipas parimit: duhet të përdoret – nuk duhet të përdoret. Disa shembuj të veçantë janë:

a) Ngulitja e formës me **e** para bashkëtingëlloreve hundore në fjalë të tilla si *qëndër, shpend, emër, femër, vend, mend, zemër, brenda, dhemb, tremb, shtrenjtë*, etj.

b) Fjalët me burim nga greqishtja dhe latinishtja, ose nga gjuhët romanë që kanë në përbërjen e tyre **c+i** ose **c+e** ruhen si të tilla në shqiptim: *citat, proces, deficit, recension*.

c) Shqiptimi i drejtë më **-l** dhe jo me **-ll** i fjalëve si *spekuloj, lotari, ambulancë, diplomë, deklaratë, luks, komplot, bulon, Holandë*. Kjo dukuri është ndjekur me shumë konsekuencë dhe meriton vëmendje qoftë për vetëm vaktin se në shqipe **-l** dhe **-ll** janë fonema të veçanta.

d) Shqiptim i drejtë i bashkëtingëlloreve **sh-**, **ç-**, **zh-** në ballë të fjalës në fjalë si *shfaqje, zhvendosje, zhdoganim* etj.

4. 1. 3. Shqiptimi i pakujdesshëm

Shqiptimi i pakujdesshëm individual i spikerëve shqiptarë karakterizohet me veçoritë e stilit bisedor, si dhe me ndonjë shmangie dialektore nga norma letrare, siç ndodh me spikerët e Radio Tiranës, Radio Shkodrës, Radio Prishtinës, Radio Shkupit dhe të medieve të tjera shqiptare, duke çuar në thellimin e theksit krahinor, madje edhe të huaj, i cili për shqiptarët ka pak a shumë tiparet e mëposhtme të përbashkëta:

a) Mosartikulimi i tingujve “**q**” dhe “**gj**” dhe zëvendësimi i tyre me “**k**” dhe “**g**” ose me “**ç**” dhe “**xh**”, për shembull, *përçind, përçind, përkind; gjithë, xhithë, githë* etj. Këtu madje lind pyetja se cili devijim është më i pranueshëm në rastet kur është i pashmangshëm – ai që është tipik edhe për vetë mbartësit e gjuhës, ose ai që bëhet vetëm nga të huajt.⁵⁷

⁵⁶ Xh.Lloshi, *Gjuha, stili dhe redaktimi në shtyp*, Tiranë, 1977, f.53

⁵⁷ I. Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të rrethit të Preshevës dhe të Bujanovcit*, në *Gjurmime albanologjike*, 2, Prishtinë, 1961, f.6

b) Përdorimi i zanores “u” ose “ju” në vend të “y” pas dhe në mes të bashkëtingëlloreve qiellzore dhe qiellzoalveolare: *gjq, gjuq; gjyqtar, gjuqtar; shyqyr, shuqur, shuçyr, shyqur, ky, ku, kju, ki; zhytem, zhutem, zhjutem* etj. Kjo dukuri pothuajse nuk vihet re në fillim të fjalës *yt, yshtje* dhe në pozicionë pas bashkëtingëlloreve buzore, për shembull, *bymej, Myzeqë*. Po kështu ndeshet relativisht rrallë pas bashkëtingëlloreve dhëmbore, për shembull, *syprinë, lypës, dysHEME, trysni* etj.

c) Shqiptimi i mbyllur ose zëvendësimi i zanoreve të patheksuara, për shembull, *pozitë, puzitë, kapak, këpak, demonstratë, demunstratë, koleq, kuleq, karakter, kërkarakter, prezantim, prezëntim* etj.

4. 2. Çështje të stilistikës gramatikore (morfologo-sintaksore)

Gazetarët e radiotelevizionëve shqip-folëse kanë punuar për ngulitjen e disa tipareve të normës letrare, që zbatohen rreptësisht si për shembull:

1. Shumësi i emrave në pajtim me normën.
2. Përsëritja e parafjalëve dhe të lidhëzave bashkërenditëse e të nyjave në gjinore me emra të bashkërenditur, përsëritja e elementeve trajtëformuese të trajtat e bashkërenditura të foljeve si *duke, për të*. Këtu duhet theksuar se ndikimi i ekonomisë gjuhësore është shumë i fuqishëm.
3. Përdorimi i rregullt i trajtave të përemrave pronorë (*sonë-tonë, sate-tënde*) dhe të nyjave (*së-të*).

Në emisionet e lajmeve të radiotelevizionit jo rrallë ndeshen luhatjet e normës morfologjike dhe sintaksore, tipike për mediet shqiptare, të cilat janë vënë në dukje gjatë diskutimit rreth temës “Kultura e gjuhës dhe media”. Kështu:

1. Përdorimi i përemrit pronor *i/e vet* edhe në vend të përemrit pronor të vetës së parë dhe të dytë, për shembull, “...*kam mundur të ruaj të gjallë në kujtesën e vet...*”.
2. Mbiemrat, kur kanë kuptim përkatësor, nuk jepen në shqip me një emër në rasën gjinore, për shembull, *marrëveshja paqësore-marrëveshja e paqës, oborri shkollor-oborri i shkollës, guri themelor-guri i themelit*. Ky dallim është vështirë të shpjegohet thjesht teorikisht, sepse ka edhe raste kur mund të thuhet edhe ashtu, edhe kështu, për shembull, *qëveria e Shqipërisë* ose *qëveria shqiptare*, pa pasur ndonjë mundësi tjetër interpretimi të kuptimit.
3. Formimi i disa mbiemrave me prapashtesën *-ist* në gjuhën shqipe, për shembull, *koopërativist, optimistik-optimist, farmaceut-farmacist*, etj.
4. Huazimet terminologjike ose toponimet, që kanë hyrë në shqipe dhe me gjini të ndryshme dhe kërkojnë verifikim të vazhdueshëm në fjalor, për shembull, *alarmi-alarma, Lisboni-Lisbonë* etj.
5. Përdorimi i së kryerës (*perfektit*) në vend të së kryerës së thjeshtë (*aoristit*) për veprime që nuk kanë lidhje me momentin e ligjërimit ose anasjelltas, për shembull, *siç është theksuar në*

komunikatën e datës...; për këtë Maqedonia ia shprehu shumë herë vullnetin politik për të bashkëpunuar... .

6. Përkthimi fjalë për fjalë i foljes ndihmëse dhe pjesores së perfektit të anglishtes, për shembull, *në mbledhje ishte vendosur që... në vend të në mbledhje u vendos që... .*

7. Përdorimi i së kryerës (*perfektit*) të dëftores në vend të lidhores për të shprehur modalitet në pohime të pavërtetuara, për shembull, *Mendohet se ai është zhdukur gjatë operacionit...në vend të Mendohet se ai të jetë zhdukur....*

8. Kundërvënia kuptimore e emrave të huaj (anglicizmave emra) që kanë formuar në shqipe emrat me *-cion* dhe *-im*, për shembull, *deviacion-devijim, komunikacion-komunikim, informacion-informim, kombinacion-kombinim, operacion-opërim, dokumentacion-dokumentim, motivacion-motivim, provokacion-provokim* etj.

9. Shmangie në përdorimin e rasës rrjedhore të pashquar: Rrudhja e përdorimit të trajtës me *-sh* , për shembull, *pas debateve të ashpra* në vend të *pas debatesh të ashpra* etj.

10. Përdorimi ose mospërdorimi i trajtës së shkurtër përemërore të rasës kallëzore, për shembull, *Me çfarë do ta mbani mend këtë vit?* dhe *Me çfarë do të mbani mend këtë vit?* etj.

11. Interferenca e strukturave sintaksore, për shembull, *ai gjithashtu mori pjesë në takim* (ndajfolja para foljes); *lajmet e lidhura me Kosovën* për *lajmet nga Kosova* dhe *lidhur me Kosova*; *një delegacion në krye me...* për *një delegacion me...në krye*; *t'u jepen mundësi palëve që...* për *t'u jepet mundësi palëve që...* etj.

4. 3. Probleme të leksikut dhe të semantikës

Ndërkohë që norma drejtshkrimore, norma drejtshqiptimore dhe norma gramatikore janë kategorike, domethënë, të detyrueshme, në fushën e leksikut norma nuk është tërësisht kategorike. Kjo është rezultat i zhvillimit të shpejtë të realitetit jashtëgjuhësor, i cili bën që fjalë dhe shprehje sot të panjohura ose të huaja, nësër të bëhen të mirënjohura dhe të pranueshme. Gjithsesi do të veçojmë si më të rëndësishme në këtë fushë katër probleme të veçanta:

1. Problemi i pastërtisë së gjuhës shqipe

Vendi i huazimeve në media mbase është tema e diskutuar më gjerë në rrethet shkencore, prandaj këtu do të shprehim shkurt vetëm mendimin personal: Fjalët e huaja të panëvojshme duhet të evitohen si , për shembull, *investigator* në vend të *hetues*, *suport* në vend të *mbështetje* etj. Njëkohësisht fjalët që tashmë “kanë fituar të drejtën e qytetarisë” më shumë pasurojnë me sinonime sesa dëmtojnë thesarin leksikor të shqipes si , për shembull, *hezitohj-nguroj*; *stabel-i qëndrueshëm*; *unanim-i njëzëshëm*; *prioritet-përparësi* etj.⁵⁸

2. Terminologjia

Për shqipen janë botuar shumë fjalor shpjegues, dygjuhësh dhe shumëgjuhësh, që deri tani kanë mbuluar me sukses nëvojat e përkthyesve të masmediave shqiptare në fusha të specializuara të shkencës. Këtu vështirësi paraqesin më shumë shprehjet e qëndrueshme terminologjike, që nuk përputhen fjalë për fjalë me shqipen si , për shembull, *hedh shortin* dhe jo *tërheq shortin*; *toger*, por *gjenërallejtënant* dhe jo *gjenëraltoger*; *mocion* dhe jo *votë mosbesimi*

⁵⁸ A.Xhuvani, *Studime gjuhësore*, Tiranë, 1956, f.44

etj.

3. Pasuria dhe larmia leksikore

Gjinitë publicistike kryesore në programet e radiotelevizionit janë lajmi, informacioni, kronika, reportazhi, komenti. Gazetarët, redaktorët dhe përkthyesit kanë arritur që gjuhën e një materiali me profilim të ngushtë ose të specializuar ta adaptojnë për veshin e dëgjuesit, kështu që të mos jetë e njëjtë me gjuhën e po atij artikulli ose interviste në një revistë shkencore.⁵⁹ Për shembull, në një material kushtuar bashkësisë gjuhësore ballkanike është më e përshtatshme të përdoren terma më të përgjithshme e më të kuptueshme, të shoqëruara me shpjegime më të hollësishme të thelbit të tyre, për shembull, në fushën e gjuhësisë, fonema, morfema, kështu që materiali të kapet lehtë edhe nga dëgjuesit që nuk janë filologë.⁶⁰

Punë më këmbëngulëse vijon të bëhet për të luftuar me atë ngjyresë që ka krijuar edhe cilësimin me kuptim të keq “gjuhë gazete”, që i përket edhe gjuhës së radios në përgjithësi, e cila është shtyp i folur. Rruga më e lehtë është rritja e figurshmërisë përmes shtimit të figurave gjuhësore e letrare dhe të frazeologjisë.⁶¹ Sidomos për frazeologjinë është shumë me vlerë përdorimi i figurshmërisë tipike shqiptare në vend të asaj angleze si , për shembull, *kur vjen e keqja hap derën; të vrasësh edhe shtatë nuk gjen diçka, fjala jote në vesh të Përendisë; sipas vendit dhe kuvendit dhe jo asnjë e keqe nuk vjen e vetëm; sikur të vrasësh vetën; nga goja jote në vesh të zotit*; që janë përkthime fjalë për fjalë, të shoqëruara me klisenë justifikuese “siç thuhet shqip”. Këtu vështirësia vjen nga fakti, se shumica e materialeve në radiotelevizion jepen në momentin e fundit për të qënë sa më të përditësuara. Shkrimi ose përkthimi i afrohet veçorive të atij simultan ku nën ndikimin e presionit “në fjalorin aktiv të përkthyesit ndeshen fjalët me përdorim më të automatizuar sipas modelit të gravitacionit”.

4. Përputhja ligjërimore në shkrim / përkthim

Sfida më e madhe për gazetarët / përkthyesit e radiotelevizionit është stili bisedor, komunikimi, ngacmimi i dëgjuesit, sepse këtu duhet të kalosh nga kodi i shkrimit / përkthimit në kodin e bisedimit, të togfjalëshave të qëndrueshme të jetës së përditshme, që kanë modele të gatshme dhe çdo mospërputhje vret veshin e dëgjuesit. Elemente të stilistikës mund të quhen zëvendësimi i *Dëgjim të mbarë* me *Dëgjim të këndshëm*; përjashtimi i thirrjes *Mbetuni në valët e Radio Tiranës*, ku ndikimi i anglishtes ka çuar në krijimin e formës paekzistuese të urdhërores për foljen *mbetem* etj. Duhet të theksohet se pikërisht në fushën e përputhjes ligjërimore është më e vlefshme edhe ndihma e redaktorëve.

Përfundimisht, mund të thuhet se emisionet shqip të radiotelevizionit në mbarë hapësirën shqiptare kanë ecur paralelisht me proceset e normëzimit të gjuhës letrare shqipe. Gjatë viteve të fundit konkurrënca tematike dhe problematike në mjetet e informimit masiv është e madhe, por do të ishte e dëshirueshme që ajo të shtrihej me të njëjtin vrull edhe në nivelin e zbatimit të standardit gjuhësor.⁶²

Problem me rëndësi i të folurit është edhe sa lidhet me aftësinë e të kaluarit m korrektësi në mjedisin e të ashtuquajturave “ligjërimore ose stile sektoriale”, së paku të atyre që janë më të

⁵⁹ B.Kryeziu, *Si të flasim dhe si të shkruajmë drejt*, Prishtinë, 2006, f.76

⁶⁰ Gj.Shkurta, *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran* (dispensë), Instituti i Lartë i Arteve, Tiranë, 1976, f.73

⁶¹ Po aty.

⁶² Gj.Shkurta, *Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran*, Instituti i Lartë i Arteve, Tiranë, 1988, f.85

lidhur me hapësira, (areale) shprehëse që kërkojnë kompetencë profesionale.

Sikundër dihet, në çdo gjuhë natyrore, në qoftë se atë pranojmë si kodin kryesor të komunikimit të një kombi, ekzistojnë edhe nënkode që karakterizohen sidomos nga leksiku i posaçëm, specifik që lidhet me veprimtari të veçanta ose me sektorë të ndryshëm të jetës shoqërore. Disa prej këtyre nënkodeve janë **ligjërimi specialistike** të mirëfillta, të përdorshme vetëm nga specialistë të sektorëve të ndryshëm tekniko-shkencorë, me specializim të lartë (si shkencat e përpikta, mjekësia, drejtësia etj.). Të tjera janë thjesht **ligjërimi sektoriale**, d.m.th. mënyra të thëni që lidhen me disa sektorë a sfera të caktuara, të përdorshme në mjedise të caktuara, por me përhapje më të gjerë dhe me ndërlikime më të shumta me gjuhën e zakonshme (si p.sh.: ligjërimi i sportit, i politikës, po edhe i ndërmarrjeve ose i kompanive prodhuese, i komunikimit profesional etj.). Ndokush e quan si “ligjërim setorial” edhe atë të publicistikës, porse në të vërtetë, aty kemi të bëjmë me një ligjërim mjaft më të ndërlikuar, që ngërthen në vetvete shumë ligjërimi sektoriale dhe ka, sidoqoftë, dukuri të krijimit, të figuracionit etj., që e afrojnë më shumë me ligjërimin letrar sesa në atë mirëfilli sektorial.

Dallimi ndërmjet “ligjërimit sektorial” dhe “ligjërimit specialistik” nuk është studiuar sa duhet deri më sot ndër në. Për herë të parë, në vitet ’60 të shekullit që u mbyll, janë bërë disa përshkrime për “të folmet shoqërore”, të cilat janë të folme të fshehta të disa mjeshtërive të caktuara, kryesisht të muratorëve të Oparit, të belaxhinjëve të Shëngjergjit (punëtorë që shkonin andej-këndej për të punuar me bel) etj. Vetëm më vonë, në kuadër të shqyrtimeve të stileve funksionale të shqipes, së pari, nga Xh. Lloshi në librin e tij “*Gjuha, stili dhe radaktimi në shtyp*” (1977) e në “*Njohuri për stilistikën e gjuhës shqipe*” (1987) “*Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*” (1999); nga Gj. Shkurtaç në librin “*Kultura e gjuhës në skenë dhe në ekran*” (1988) dhe versionët e tij të mëpastajshme: “*Kahe dhe dukuri të kulturës së gjuhës*” (2003), “*Kultura e gjuhës*” (2006), janë trajtuar veçori të stileve të shkruara dhe të gjuhës së letërsisë artistike. Të dhëna me interes ka edhe në “*Gjuhësi teksti*” (1999) të K. Dibra – N. Varfi.

Nga hapësirat e gjuhëve të tjera, qysh në vitet ’70 janë trajtuar në mënyrë të përgjithshme “gjuhët speciale” ose “mikrogjuhët” që ekzistojnë në Itali, sipas profesionëve dhe sektorëve të ndryshëm.

PËRFUNDIME

Fjalët e huaja, përdorur vend e pa vend, ia cenojnë shqipes integritetin gjuhësor dhe identitetin kulturor. Që një dukuri e tillë na e shëmton gjuhën dhe e dëmton komunikimin mes shqiptarëve, kjo vështirë se mund të vihet në dyshim. Megjithatë, zgjidhjet e këshilluara, të cilat në thelb synojnë zëvendësimin mekanik të fjalëve të huaja me fjalë vendëse të shqipes, nuk kanë dhënë rezultat as do të japin, çka të bën të mendosh se molepsja e ligjërimit publik me fjalë të tilla, pak a shumë parazitare, është vetëm simptomë e një sëkëlldie më të thellë të komunikimit, që e ka burimin në interferimin konceptual prej gjuhësh dhe kulturash të tjera, edhe kur nuk e ka në snobizmin e ligjëruesve.

Në të kaluarën, kur baballarët e kulturës kombëtare bënë thirrje për pastrim të shqipes publike nga fjalët e huaja, objekt i fushatave pastruese ishin kryesisht orientalizmat, ose huazimet e shumta të shqipes qytetare nga osmanishtja; dhe nxitësit e këtyre fushatave, në vijën e idealeve të Rilindjes Kombëtare, mëtonin t'u jepnin shqiptarëve një identitet kombëtar të mirëfilltë edhe duke i shkëputur nga sfera kulturore e Përandorisë Osmane. Meqë lëvizja e Rilindjes ishte haptazi romantike, dukej afërmendsh që ideologjia rilindëse të fliste për gjuhë të pastër shqipe, sikurse fliste edhe për racë të pastër shqiptare (pellazge); me ç'rast edhe të ashtuquajturit turqizma do të dëboheshin prej ligjërimit publik, siç do të dëbohej administrata osmane prej Shqipërie, teksa krejt sistemi konceptual oriental i bashkëlidhur me shqipen rrekej të zëvendësohej me një sistem të huazuar nga Evropa Ndriçimtare. Edhe sot e kësaj dite ndesh njerëz të mirë që shqetësohen natyrshëm e vetvetiu, kur pikasin ndonjë turqizëm në ligjërimit publik; duke u identifikuar, dashur pa dashur, si vazhdues të denjë të politikave gjuhësore të Jani Vretos e të tjerëve publicistë të një shekulli më parë.

Tanimë turqizmat praktikisht i janë krasitur shqipes publike dhe nuk ia cenojnë më integritetin; por nga atmosfera kulturore e një shekulli më parë, kemi trashëguar e ruajtur vetëdijen ose vëmendjen për historinë e fjalëve që përdorim; ose mbindjeshmërinë ndaj biografisë ose origjinës së tyre, shoqëruar me prirjen në mos vendosmërinë për t'i nxjerrë e mbajtur jashtë qarkullimit, nëse i gjykojmë si të huaja. Një fjalë si *hyzmet* mund ta përdorim ende lirshëm në biseda joformale minderesh, rrugësh e kafenësh, por do ta zëvendësojmë me *shërbim* sapo nisim t'i drejtohemi një publiku më të gjerë, në rrethana më formale. Ky zell përzgjedhës varet i tëri nga aftësitë tona për t'i shquar fjalët e huaja mes fjalësh të tjera, që të huaja nuk janë; ose për të ndarë shapin nga sheqëri. Nëse një nga tezat themelore të gjuhësisë modernë ka të bëjë me nevojën për ta trajtuar funksionimin e gjuhës veçmas nga historia e saj, kjo tezë duket se nuk zbatohet dot kur vjen puna për të shpjeguar e motivuar shkencërisht përpjekjet ndonjëherë kaba për pastrimin e gjuhëve, të cilat shpesh lypin mobilizim të madh nga specialistë dhe institucionë.

Nëse fjalët e gjuhës, duke ndërmjetësuar shkëmbimet komunikuese, kryejnë një funksion të afërt me atë të parasë në transaksionët e tregut, atëherë filtrimi i këtyre fjalëve sipas prejardhjes do t'u ngjante orvatjeve për të diktuar paratë kallpe e për t'i hequr këto nga qarkullimi, në emër të shëndetit financiar kolektiv. Shqiptarët në periudhën e Rilindjes, nuk ishin i vetmi popull që kërkonte ta vinte gjuhën në shërbim të kulturës dhe të idesë kombëtare. Ndër fqinjët tanë, rumunët ishin vënë të qëronin gjuhën e tyre nga sllavizmat, për ta afuar me modelin latin primordial; sikurse kishin vepruar më parë grekët dhe do të vepronin më pas sllavët e Ballkanit me turqizmat. Pak dekada më vonë, edhe Turqia e Ataturkut do t'i shpallte si të padëshiruara fjalët me prejardhje arabe e përse të osmanishtes letrare, dhe do t'i largonte nga

turqishtja krahas me përpjekjet e suksesshme për të adoptuar një alfabet me bazë latinë. Lufta kundër fjalëve të huaja do të merrte pastaj përmasa të reja politike nën regjimin fashist të Musolinit e më tej, në Gjermaninë naziste; meqë si në një rast edhe në tjetrin harmonizohet me praktikën e pastrimit të racës, kombëtarizimin heroiko-mitik, antikomopolitizmin "hebreo-mason" dhe nevojën për njëtrajtshmëri e njëtrajtësim shoqëror.

Sipas së njëjtës logjike autoritare, institucionët shtetërore në Shqipërinë pas vitit 1945 e përshtatën instrumentin rilindës të pastrimit e të pasurimit të shqipes publike, për ta përdorur kundër ndikimeve të padëshiruara përendimore në kulturën shqiptare; me ç'rast lufta kundër fjalëve të huaja do të shtjellohet si formë e luftës kundër "shfaqjeve të huaja", ose në përgjithësi kundër prirjes së natyrsme të kulturës shqiptare qytetare modernë drejt Përendimit, sidomos Italisë. Njëlloj sikurse me turqizmat më parë, vendosja e kontrollit të rreptë mbi ligjërimin dhe imponimi voluntarist i kriterëve pak a shumë formale në përzgjedhjen e fjalëve sipas origjinës ose biografisë së tyre, shprehin një vullnët ideologjik të paepur. Nëse rilindësit kërkuan dhe ia arritën ta shkëputin Shqipërinë nga orbita osmanë, totalitarizmi synonte që ta mbante kulturën shqiptare të shkëputur nga kultura evropianë-përendimore, edhe duke ia filtruar interferencat konceptuale nga përtejdeti.

Nëse është kështu, dyndja e sotme e fjalëve të huaja në shqipen publike duket sikur nuk mund të shmanget lehtë; sa kohë që kultura shqiptare nuk ia mban më kyçur dyert komunikimit me Përendimin, ndërsa elitat në Tiranë, Prishtinë e Tetovë shkollohen në universitetet e televizionët e Evropës ose të paktën frymëzohen e ushqehen shpirtërisht prej andej. Një pjesë e mirë e atyre që përdorin fjalë të huaja në ligjërim janë të interesuar më tepër ta përcjellin mendimin e tyre sa më saktë, sesa të kujdesen për trajtat e atij ligjërimi; një takëm tjetër janë të vetëdijshëm se po përdorin fjalë që nuk janë të shqipes, por nuk i gjejnë dot zëvendësueset përkatëse; të tjerë nuk ua dinë fare prejardhjen fjalëve që përdorin, as duan e mundohen t'ua dinë; të tjerë akoma janë kolonizuar krejt prej gjuhëve madhore e nuk e kanë më shqipen gjuhë të parë, të paktën për sa i takon mendimit abstrakt ose analizës. Por gjendet edhe një kategori e gjerë përdoruesish, të cilët nuk njohin mirë as shqipen, as gjuhën tjetër që u shërbën si model; këta nuk janë të sigurt për kuptimin e fjalëve që u vijnë në majë të gjuhës. Njëfarësoj, këta përdorues të pasigurt nuk e flasin gjuhën, por fliten prej saj. Shqëtësimi dhe protesta për përdorimin e tepruar dhe pa nevojë të fjalëve të huaja në ligjërimin publik, vjen ndonjëherë nga njerëz të cilët gjuhët burimore të fjalëve përkatëse i njohin ndoshta më mirë se eksperimentuesit vetë!

Papastërtive të shqipes publike nuk mund t'i jepet një diagnozë e njësuar; sepse trysnitë e gjuhëve përendimore ndaj shqipes janë të shumëllojshme, dhe të shumëllojshme janë edhe rrugët e depërtimit të fjalëve të huaja në ligjërimet. Megjithatë, shpesh fjala e huaj përdoret për ta zhvendosur vëmendjen e publikut drejt personalitetit të ligjëruesit; ose kur fjala e huaj përdoret në emër të shkëlqimit vetjak, ose të përftimit të një stili ligjërimesor të tillë që ta ndjellë a ngashënjëjë publikun ndaj folësit. Edhe pse stili është vërtet njëri, dhe ligjërimi gjithnjë e bart fytyrën e ligjëruesit me vete, cenimi i komunikimit publik për hir të kotësisë së folësit ose dëshirës për të tingëlluar "i sipërm" nuk duhet të tolerohet, sidomos kur konsumohet në kontekstin e masmediave.

Ligjërimi publik vërtet cenohet e shëmtohet e përçudnohet me fjalë të huaja e barbarizma; por kjo dukuri nuk denoncohet e luftohet dot më me mjete romantike e me thirrje për përndjekje e internim të fjalëve kundërvajtëse; as mund të ndërmerret lufta brenda kufijve të ligjërimin në mediat, meqë mediat komunikojnë me publikun në kushte shtrëngesash të mëdha kohore dhe as autorët as redaktorët nuk merren dot hollë e gjatë me skalitje gjuhësore. Zgjidhja

do të vijë, përkundrazi, nga dy drejtime - përmirësimi me themel i të mësuarit të mjeteve shprehëse të shqipes në shkollë; dhe zgjerimi i hapësirës së komunikimit gjuhësor letrar-artistik, për t'ia kundërpeshuar njëfarësoj masmediave sundimin e tanishëm e për të hedhur në qarkullim kundërmodele e moda ligjërimore njëlloj të lakmueshme. Ashtu fjalët e huaja e të panëvojshme do të veniten nga përdorimi jo nëpërmjet censurimit të ndonjë farë autoriteti çfarëdo ose listave të zëvendësimit, as nëpërmjet vetëcensurimit të autorëve ose përkthimit ndërmjetësues; por vetëm ngaqë vetë folësit do t'ua ndiejnë efektet e padëshiruara e do t'i shmangin për t'ia ruajtur frytshmërinë komunikimit.

Ka dallime lidhur me përshtatjen e vendit të theksit të huazimet e reja, por jo më në raportet gegërishte/ toskërishte, po shqipe në Shqipëri dhe shqipe në Maqedoni, Kosovë apo në hapësira të tjera, për shembull, në një kalim rasti nëpër Shqipëri njëriu fare natyrshëm ndesh dallime në fjalët e huazuara, për sa i përket vendit të theksit, por edhe të tjera. Kjo ngjet dhe brenda vetë Shqipërisë, ashtu siç ngjet edhe brendapërbrenda Maqedonisë dhe Kosovës. Në raste të tilla, sipas mendimit tonë, në zgjedhjen përfundimtare do të ndikojnë faktorë të ndryshëm, si, për shembull, skemat theksore brenda shqipes, modelet e gjuhëve prej nga huazohet, gjedhet e gjuhëve me ndikim më të madh në shqipen si italishtja, moda dhe dukuri të tjera të natyrës shoqërore etj.⁶³

Disa prej dallimeve i detyrohen ndikimit të drejtpërdrejtë ende të gjallë të gjuhëve përreth. Më tej, ndryshimet prekin aspekte të tjera, ndonjëherë kemi të bëjmë me vlerësime të ndryshme të huazimeve të mëhershme, herë tjetër me tendenca evitimi të huazimeve etj. Ndeshen jo pak variacione të krijuara nga burimet e ndryshme të ndikimeve: në gjuhën shqipe terminologjia e teknologjisë po hyn sot kryesisht nga anglishtja dhe italishtja. Në Maqedoni dhe Kosovë sot kemi vërshime anglicizmash, por më herët kishim kryesisht huazime ndërkombëtarizmash përkatësisht përmes Maqedonishtes dhe serbishtes. Një pjesë e teknologjive kishte hyrë më herët në Kosovë, ndërsa shumë prej termave janë me prejardhje gjermanë, shpesh përmes serbishtes. Tash në Shqipëri ajo pjesë e termave injorohet në dobi të italianizmave të reja, që në Maqedoni dhe Kosovë nuk njihen. Këtu duhet të ndërhyjnë ekipet standardizuese për të rregulluar çka mund të rregullohet dhe për të krijuar qartësi të nevojshme për marrëveshje.

Gjuha pasqyron një kombësi, ajo është pasqyra më e qartë e një kombësie dhe e kulturës së saj. Shkalla e pasurisë dhe e pastërtisë së gjuhës është një tregues i nivelit të kësaj kulture. Prandaj ringjalljet nacionale kudo e në çdo kohë kanë shkuar hap më hap me pasurimin e pastrimin e gjuhës.

Një ndër detyrat kryesore të gjuhësisë shqiptare, krahas kërkimeve teorike, është edhe mbetet pasurimi i gjuhës me elemente të gurrave vetjake dhe spastrimi i saj prej masës së fjalëve të huaja, që kanë vërshuar së jashtmi dhe që po vazhdojnë edhe në ditët tona. Kanë depërtuar e depërtojnë në shkrimet shkencore edhe letrare, në shtyp, në radio, në televizion, në bisedën e përditshme. Është e vërtetë se me punën e kryer gjer më sot, një pjesë e tyre janë spastruar, po ndërkaq kanë hyrë e po hyjnë të tjera në vend të tyre. Pastrimi i gjuhës nga ky mish i huaj është një detyrë shkencore, njëkohësisht dhe kombëtare. Nuk është aspak një shenjë shovinizmi, shqiptari nuk e ka traditë shovinizmin.

Në këtë fushë është punuar me shekuj te në dhe vazhdon të punohet në këtë drejtim. Po të kundrohesh kjo veprimtari më nga afër, shihet se ka këtu një vazhdimësi, një vijë të pandërprerë. Në e çmojmë dhe e vlerësojmë veprimtarinë e paraardhësve tanë, njëkohësisht synojmë ndërkaq

⁶³ B.Kryeziu, *Si të flasim dhe si të shkruajmë drejt*, Prishtinë, 2006, f.93

ta çojmë përpara veprën e tyre dhe ta thellojmë. Në këtë punë nuk do të kufizohemi të zbulojmë fjalë të moçme nëpër shkrime të vjetra. Nuk është kjo e vetmja rrugë për në, sepse plot fjalë janë edhe sot të gjalla në gojë të popullit dhe presin të shtihen në përdorim. Kjo punë ka filluar që me përmendoret e para të shkrimit të gjuhës shqipe. Autorët e vjetër si Gjon Buzuku, Pjetër Bogdani e të tjerë kanë vepruar me vetëdije në këtë rrugë. Qysh te këta autorë të vjetër gjejmë fjalë si *derëtar, dëftues, grykësi, gjetës, gjuhëtar, kangëtar, këshilltar, kopshtar, krye* për "kapitull", *lutës, madhështi, mbarim, mjeshtëri, ndjekës* për "ithtar, imitues", i përbrendshëm, përndjek për "përsekutoj", *poem* për "popull, vegjëli", *pushim, rrëfim, shkollar, urta, vetmi, vjershëtar* e plot të tjera, pa mundur në sot të dimë se cilat janë fjalë të marra prej gojës së popullit dhe cilat janë formime të këtyre autorëve.

Në lidhje me këtë, dihet se në pasurim të gjuhëve letrare e të shkrimit, dy janë kryesisht rrugët që ndiqen përgjithësisht. E para është marrja e fjalëve të gjalla në ligjërimin popullor e nëpër dialekte dhe të shtënë e tyre në përdorim të përgjithshëm, shpeshherë duke i ngritur më lart në punë të nivelit kuptimor. Rruga e dytë është formimi i fjalëve të reja, i të ashtuquajturave nëologjizma. Këto mund të jenë formime të mëtejme të fjalëve popullore, si anëtar nga anë. Shpeshherë ndërkaq janë të tilla, porse të farkuara si përkthim fjalësh të huaja, si kalke. Janë, pra, formime pozitive, me gjedhe (model) të huaj, po me brumë vendi, një mënyrë veprimi me të cilën janë pasuruar me kohë gjithë gjuhët e Evropës edhe të botës, rrugë pasurimi e ndjekur që në kohët e lashta (latinishtja prej greqishtes), por sidomos në kohët modernë.

Gjuha shqipe është e pasur jo vetëm në elemente leksikore të kulturës materiale, po edhe në fushën e fjalëve të sferës abstrakte-mendimore. Nuk është i drejtë mendimi i disa dijetarëve të huaj se shqipja qënka e pasur vetëm në fjalë të sferës baritore, as i drejtë mendimi se shqiptarët paskan qënë një popull barinjsh nomadë, shtegtarë. Një mendim i tillë nuk përlligjet as me të dhënat e ekonomisë politike historike. Janë, pra, të gjitha mundësitë për një zëvendësim të fjalëve të huaja me fjalë vendi, dhe kjo pa bjerrje aspak të vlerës kuptimore të fjalëve.

Edhe në lëmin e sintaksës, gjuhësinë shqiptare e presin detyra të reja në pastrim të ndërtimit të fjalisë prej ndikimit të huaj. Këto përdorime duhet të zëvendësohen me ndërtime të vendit, të cilat kanë depërtuar tashmë aq thellë në gjuhën bisedore dhe të shkrimit, sa më nuk ndihet si element i huaj, dhe do të jetë vështirë të mënjanohet.

Puna e pastërtisë së gjuhës përfshin dhe frazeologjinë. Edhe aty vërehen në gjuhën e sotme ndikime të jashtme, me ndjekje gjedhesh të huaja me anë përkthimi. Në shqipen e mirëfilltë nuk thuhet *i hedh pluhur syve*, si thonë në disa gjuhë të tjera, po thuhet *i hedh hi syve*. Gjuhësia jonë edhe në këtë fushë është e caktuar të gjurmojë rrugët vetjake të gjuhës.

Fjalët e vendit dhe termet që do të zëvendësojnë me kohë elementin e huaj duhet të shtihen në përdorim që në shkollat, që me moshën e re. Shumë fjalë që do të vendoset të përdoren e të hyjnë në gjuhë, edhe nëve vetë në fillim do të na duken pakëz si çudi. Porse brezat që do të vijnë do t'i mësojnë e do t'i përdorin vetvetiu; sikurse kanë hyrë në përdorim shumë fjalë vendi që janë farkuar prej paraardhësve tanë e prej brezit tonë, janë për në sot të natyrshme dhe janë bërë pronë e qëndrueshme e gjuhës.

Sot më fort se kurrë na shtrohet detyra që këtë "gjuhë perëndie" ta pasurojmë me fjalë të visarit popullor dhe ta spastrojmë nga masa e lëndës së huaj.

SHTOJCA 1

Klasifikimi i huazimeve – anglicizmave

Gjuhëtari kroat, Rudolf Filipoviçi, ka përcaktuar shtatë mënyra të klasifikimit të huazimeve – anglicizmave – në gjuhë, të cilat janë: (1) klasifikimi sipas rendit alfabetik; (2) klasifikimi sipas fushave të veprimtarisë njërezore; (3) klasifikimi sipas llojit të fjalëve; (4) klasifikimi sipas rrafshve gramatikore; (5) klasifikimi sipas shkallës dhe mënyrës së “tjetërsimit”; (6) klasifikimi sipas nëvojshmërisë dhe panëvojshmërisë; (7) klasifikimi sipas shtresave të përdoruesve dhe të pikëpamjeve të tyre. Edhe huazimet – anglicizma në gjuhën shqipe mund të klasifikohen si më sipër. Kështu kemi :

A

ABSENTIZËM (nga “absentism”) për “Mospjesëmarrje” (në zgjedhje); POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ABSORBOJ (nga “absorb”) për “Thith”; “gëlltit”; “gulçoj”; “përvetësoj”; SHOQËRI / POLITIKË; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ABUZIM (nga “abuse”) për “Përdorim i keq a me tepri i diçkaje që më është besuar, kalim i masës së lejueshme në përdorimin e diçkaje”; “veprim në kundërshtim me ligjin a me normat e moralit shoqëror, duke shfrytëzuar detyrën a besimin e të tjerëve për përfitime vetjake”; “shpërdorim”; SHOQËRI / POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ABUZIV (nga “abusive”) për “Shpërdorues”; SHOQËRI / POLITIKË; MBIEMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ABUZOJ (nga “abuse”) për “E përdor keq a me tepri diçka që më është besuar, e kaloj masën e lejueshme në përdorimin e diçkaje”; “veproj në kundërshtim me ligjin a me normat e moralit shoqëror, duke shfrytëzuar detyrën që kam a besimin e të tjerëve për përfitime vetjake”; “shpërdoroj”; SHOQËRI; POLITIKË; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ADOPTOJ (nga “adopt”) për “Miratoj” (ligjin); DREJTËSI; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

AEROBIKË (nga “aerobics”) për “Gjimnastikë”; SPORT; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

AGJENDË ose AXHENDË (nga “agenda”) për “Rend dite”; “ditar” – “plan ditor punë”; SHOQËRI / POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

AGRAVOJ (nga “aggravate”) për “Përkeqësoj”; “rëndoj”; “acaroj”; “ashpërsoj”; SHOQËRI / POLITIKË; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

AKS (nga “axis”) për “Bosht”; SHOQËRI / POLITIKË / TEKNIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

AKSEPTOJ (nga “accept”) për “Pranoj”; “miratoj”; SHOQËRI / POLITIKË; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

AKSES (nga “access”) për “Leje hyrëse”; “liri shfrytëzimi”; “qasje”; “kalim”; SHOQËRI / POLITIKË / TEKNIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

AKSESOR (nga “accessories”) për “Pjesë plotësuese ose e dorës së dytë, që i shtohet kryesores; “shtojcë”; “plotësues”; “ndihmës”; “hollësi plotësuese në një vepër arti”; “sendet e vogla, që plotësojnë mjedisin e ngjarjes në një shfaqje teatrale”; PUBLICISTIKË / ART / DREJTËSI; EMËR / MBIEMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

AKSIDENT (nga “accident”) për “Fatkeqësi e papritur dhe e rastit, që mund t’i sjellë njëriut dëmtime në trup ose vdekjen”; “ngjarje e rastit, e papritur dhe shpesh e padëshiruar”; SHOQËRI / PUBLICISTIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR / LIBROR.

AKSIDENTAL (nga “accidental”) për “Që shkaktohet nga një aksident”; “i rastësishëm”; “i papritur”; “i paparashikuar”; PUBLICISTIKË; MBIEMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR / LIBROR.

AKTIV (nga “active”) për Veprues; SHOQËRI / POLITIKË; MBIEMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

AKTIVIST (nga “activist”) për “Veprimtar”; POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

AKTIVITET (nga “activity”) për “Veprimtari”; SHOQËRI / POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

AKTIVIZOJ (nga “activate”) për “Vë në lëvizje”; “vë në punë”; “përfshij në veprimtari”; EKONOMI / SHOQËRI / POLITIKË / SPORT; FOLJE; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

AKTUAL (nga “actual”) për “I ditëve tona”; “i sotëm”; “i tanishëm”; SHOQËRI / PUBLICISTIKË / POLITIKË; MBIEMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

AKTUALITET (nga “actuality”) për “E sotmja”; PUBLICISTIKË / POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

AKTUALIZOJ (nga “actualise”) për “E lidh me të sotmen”; PUBLICISTIKË / POLITIKË; FOLJE; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ALINJOHEM (nga “align”) për “Radhitem”; “rreshtohem”; PUBLICISTIKË / POLITIKË; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ALOKOJ (nga “allocate”) për “Caktoj”; “shpërndaj”; “ndaj” (sipas zërave); FINANCË; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

AMENDAMENT (nga “amendment”) për “Ndreqje ligji”; “parashtrim ndryshimesh”; DREJTËSI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

ANALE (nga “annals”) për “Vepër ku shënoheshin vit për vit ngjarjet më të rëndësishme të kohës”; “përmbledhje e ngjarjeve kryesore, të radhitura sipas kohës”; “historiku i një fushe të veprimtarisë”; HISTORI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

ANALIZË (nga “analysis”) për “Metodë” (studimi); “shqyrtim”; “zbërthim”; SHOQËRI / EKONOMI / POLITIKË / GJUHËSI / LETËRSI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

ANARKI (nga “anarchy”) për “Gjendje që krijohet në shoqëri, kur mungon pushteti shtetëror i organizuar dhe kur nuk veprojnë ligjet e rregullat e detyrueshme për anëtarët e shoqërisë”; “mohim i shtetit dhe i çfarëdo pushteti politik të organizuar”; “çrregullim që krijohet nga mungesa e drejtimit, e organizimit dhe e planifikimit”; “çrregullim i madh”; “pështjellim në një fushë”; SHOQËRI / EKONOMI / POLITIKË / ARSIM / KULTURË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

ANARKIK (nga “anarchic”) për “Që është karakteristik për anarkinë”; “që shpie në anarki”; “i çrregullt”, “i paorganizuar”; SHOQËRI / EKONOMI / POLITIKË / ARSIM / KULTURË; MBIEMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

ANARKIST (nga “anarchist”) për “Pasues i anarkizmit”; “ai që është kundër rregullit, disiplinës dhe organizimit, që shkel me mospërfillje ligjet dhe rregullat shoqërore”; SHOQËRI / EKONOMI / POLITIKË / ARSIM / KULTURË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

ANARKIZËM (nga “anarchism”) për “Rrymë politike e shoqërore oportuniste mikroborgjeze, që nuk pranon asnjë lloj autoriteti, organizimi e disiplinë, që kërkon zhdukjen e menjëhershme të çdo pushteti shtetëror”; POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

ANOMALI (nga “anomaly”) për “Çrregullim”; shmangie nga rregulli i zakonshëm”; SHOQËRI / EKONOMI / POLITIKË / BIOLOGJI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

ANULOJ (nga “annul”) për “Heq fuqinë”; “shfuqizoj”; “e kthej mbrapsht”, “e tërheq”, “nuk e lejoj të bëhet”; DREJTËSI / SPORT; FOLJE; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ANUNÇOJ (nga “announce”) për “Njoftoj”; “shpall”; “bëj të ditur”; “lajmëroj”; RADIO dhe TELEVISION; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

APARENCË (nga “appearance”) për “Shfaqje”; “dukje ose pamje e jashtme”; “formë”; SHOQËRI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

APDEJTIM (nga “updating”) për “Freskim”; “përditësim”; KOMPJUTËR; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

APDEJTOJ (nga “update”) për “freskoj”; “përditësoj”; KOMPJUTER; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

APELOJ (nga “appeal”) për “I drejtohem një gjykatë më të lartë për të rishikuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët”; “i drejtohem një organi më të lartë për të rishikuar vendimin e dhënë nga një organ më i ulët”; DREJTËSI; FOLJE; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

APLIKIM (nga “application”) për “Kërkesë”; “lutje”; “formular”; “zbatim”; SHOQËRI / ADMINISTRATË / POLITIKË / SPECIALITET; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

APLIKOJ (nga “apply”) për “Parashtroj” (një kërkesë); “zbatoj”; SHOQËRI / EKONOMI / POLITIKË / TEKNIKË; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ARREST (nga “arrest”) për “Paraburgim”; “mbajtje e përkohshme nën rojë”; “ndalim”; “ndëshkim disiplinor për ushtarakët, duke i mbajtur të mbyllur në një vend për një kohë të caktuar”; DREJTËSI / MJEKËSI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ARRESTOJ (nga “arrest”) për “Kap një njëri që dyshohet për një faj dhe e mbaj nën rojë”; “vë dikë në arrest në emër të ligjit”, “ndaloj”; DREJTËSI; FOLJE; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ARTIKULOJ (nga “articulate”) për “Përveçësoj”; “qartësoj”; “shqiptoj”; “nyjëtoj”; GJUHËSI / LETËRSI / POLITIKË / BOTANIKË; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ASET (nga “asset”) për “Aktiv”; “vlerë”; “pasuri”; EKONOMI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ASISTENCË (nga “assistance”) për “Ndihmë”; EKONOMI / POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ASISTOJ (nga “assist”) për “Ndihmoj”; EKONOMI / POLITIKË; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ATAK (nga “attack”) për “Sulm”; “goditje” (e papritur në shëndet); MJEKËSI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ATAKIM (nga “attack”) për “Sulmim”; “goditje” (e papritur në shëndet); MJEKËSI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ATAKOJ (nga “attack”) për “Sulmoj”; POLITIKË; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

ATRAKTIV (nga “attractive”) për “Tërheqës”; “joshës”; “ngashënjes”; “i hirshëm”; SHOQËRI / EKONOMI / POLITIKË; MBIEMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

AXHENDË (nga “agenda”) për “Rend dite”; “program”; SHOQËRI / POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

B

BAJ-BAJ! (nga “Bye-bye!”) për “Mirupafshim!”; SHOQËRI; PASTHIRRMË; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

BAJPAS (nga “bypass”) për “Kalim”; “rrugë” (anësore); “shmangëse”; MJEKËSI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM / I NËVOJSHËM; LIBROR.

BALANCË (nga “balance”) për “Peshore”; “baraspeshë”; “drejtpeshim”; SPECIALITET / EKONOMI / POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BARRIERË (nga “barrier”) për “Pengesë; SHOQËRI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BASKETBOLL (nga “basketball”) për “Lojë me top, gjatë së cilës lojtarët, të ndarë në dy skuadra nga pesë veta, përpiqën ta hedhin topin me dorë në një kosh të varur në tabelën e kundërshtarit”; SPORT; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

BEJBI-TOK (nga “baby talk”) për “Gjuhë foshnjore”; SHOQËRI / POLITIKË; TOGFJALËSH EMËROR; GRAMATIKOR / LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BEK (nga “back”) për “Lojtar” (mbrojtës); “mbrojtës”; SPORT; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

BEKGRAUND (nga “background”) për “Mjedis”; “sfond”; “hije”; “prapaskenë” (e ngjarjes); “formim” (kulturor); “kualifikim” (i njëriut); “e kaluar” (familjare); SHOQËRI / POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

BENEFIT ose BENIFIT ose BENIFIC (nga “benefit”) për “Përfitim”; “fitim”; “dobi”; “e mirë”; EKONOMI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BERMUDE (nga togu “Bermuda shorts”) për “Pantallona të shkurtra”; VESHMBATHJE; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

BESTSELLER (nga “bestseller”) për “Libër që shitet në sasi të mëdha dhe shpejt”; “shitjemadh”; TREGTI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

BEXH (nga “badge”) për “Distinktiv”; “shenjë dalluese prej metali etj. me përmasa të vogla, me një figurë a me diçka të shkruar mbi të, që mbahet në gjoks dhe që u jepet anëtarëve të një organizate, atyre që marrin pjesë në një veprimtari a në një ngjarje të shënuar etj. ose atyre që dallohen në një fushë të caktuar”; SHOQËRI / POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

BIFTEK (nga “beefsteak”) për “Thelë mishi nga brinjët e viçit a të kaut, e pjekur në skarë ose në furrë”; KUZHINË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

BIG (nga “big”) për “I madh”; “shumë i njohur”; SHOQËRI; MBIEMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR / LIBROR.

BILATERAL (nga “bilateral”) për “Dypalësh”; “që bëhet ndërmjet dy palëve”; DIPLOMACI; MBIEMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BILLBORD (nga “billboard”) për “Stendë” (afishimi); SPECIALITET; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BILLDING (nga “building”) për “Ndërtesë”; NDËRTIMTARI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

BILLDINGJE (nga “building”) për “Ndërtesa”; NDËRTIMTARI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

BINGO (nga “bingo”), për “Fitova”; LOJËRA FATI; FOLJE; GRAMATIKOR / LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

BIPARTIZAN (nga “bipartisan”) për “Dypartiak”; POLITIKË; MBIEMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BIT ose BAJT (nga “bit”) për “Njësi kujtese gjegjëse e aftësisë për të magazinuar rezultatin e një zgjedhjeje midis dy alternativave”; INFORMATIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

BIZNIS ose BIZNES (nga “business”) për “Veprimtari fitimprurëse”; “punë”; “detyrë”; “tregti”; “biznes”; “çështje”; “problem”; “kompetencë”; EKONOMI / SHOQËRI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

BIZNISMEN ose BIZNESMEN (nga “businessman”) për “tregtar”; “afarist”; “Sipërmarrës”; EKONOMI / SHOQËRI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

BJUTI-SHOP (nga “Beauty Shop”) për “Floktores”; SHËRBIME / SHOQËRI; TOGFJALËSH EMËROR; GRAMATIKOR / LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

BLAST (nga “blast”) për “Shpërthim”; “plasje”; “hedhje në erë”; USHTRI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BLLEKAUT (nga “blackout”) për “Terr”; “errësirë e plotë”; TEATËR / MJEKËSI / POLITIKË / ENËRGJITIKË / EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BLU (nga “blue”) për “I kaltër”; SHOQËRI; MBIEMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

BODI (nga “body”) për “Bluzë” (e ngushtë që tregon format e trupit); “trup”; VESHMBATHJE; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR / LIBROR.

BODIBILDING ose BADIBILLDING (nga “bodybuilding”) për “Zhvillim i muskulaturës trupore”; SPORT; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

BODIGARD (nga “bodyguard”) për “Truprojë”; USHTRI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

BOJKOT ose BOJKOTIM (nga “boycott”) për “Mospajtim”; “kundërshtim”; “pengim”; “përrjashtim”; POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BOJKOTOJ (nga “boycott”) për “Mospajtohem me, ose kundërshtoj, qëllimet politike, ekonomike etj. të organëve shtetërore, të një organizate ose të një pronari, duke ndërprerë lidhjet e marrëdhëniet dhe duke mos u shërbyer atyre”; “pengoj, së bashku me të tjerë, veprimtarinë politike, ekonomike, kulturore etj. të organizatave dhe të institucionëve, duke mos marrë pjesë në aksionët e organizuara prej tyre, si në zgjedhje, në mbledhje, në takime e lojëra sportive etj.”; “përrjashtoj dikë nga një shoqatë, nga një organizatë etj., duke e lënë të vetëm, pa asnjë lidhje me të tjerët”; “kundërshtoj të marr në dorëzim, të blej ose të përdor diçka”; POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BORD (nga “board”) për “Këshill drejtues”; ADMINISTRATË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BOS (nga “boss”) për “Padron”; “shef”; “i pasur”; ADMINISTRATË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

BOTA E TRETË (nga “Third Eorld”) për “Bota e Tretë”; DIPLOMACI; TOGFJALËSH EMËROR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

BRIFING (nga “briefing”) për “Konferencë e shkurtër shtypi”; “trajtesë”; “informim”; “informacion”; MJETET E INFORMIMIT; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BROJLER (nga “broiler”) për “Zogëz” (58-90 ditëshe); SHPENDARI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

BRUSH (nga “brush”) për “Furçë”; SPECIALITET; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

BRUTAL (nga “brutal”) për “I ashpër”; “i vrazhdë”; “i panjërëzishëm”; “i dhunshëm”; “i egër”; “i trashë”; “i pahijshëm”; SHOQËRI; MBIEMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

BUM (nga “boom”) për “Rritje e menjëhershme, e përkohshme, e prodhimit”; EKONOMI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

BUMERANG (“boomerang”) për “Shkop i trashë, i përkulur e me majë, që kur hidhet me forcë, dredhon në ajër dhe kthehet përsëri tek ai që e ka hedhur”; “Iloj arme”; “goditje që jep dikush dhe e pëson vetë”; “fjalë ose vepër, e cila kthehet kundër atij që e thotë a që e bën”; SPECIALITET / SHOQËRI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

BUS (nga “bus”) për “Autobus”; “trolejbus”; TRANSPORT / TEKNIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

BUTIK ose BUTIKË (nga “boutique”) për “Dyqan i vogël, ku shiten rroba të gatshme dhe stoli të modës për gratë”; TREGTI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

C

CELULAR (nga “cellular”) për “Telefon dore i lëvizshëm”; TELEKOMUNIKACION / TEKNIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; BISEDOR.

CENSOR (nga “censor”) për “Zyrtar i lartë në Romën e lashtë, që drejtonte regjistrimin e vlerësimin e pasurisë së qytetarëve për vjeljen e taksave dhe mbikëqyrte sjelljen e qytetarëve”; “nëpunës që është ngarkuar të shqyrtojë e të kontrollojë nga përmbajtja shtypin e botimet e tjera para se të dalin në qarkullim, pjesët teatrale, filmat para se të shfaqen”; “ai që bën censurën”; HISTORI / POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CENSURË (nga “censor”) për “Shqyrtim e kontroll i përmbajtjes së veprave të ndryshme para se të botohen a të shfaqen ose kontroll i letrave, i telegrameve para se të dorëzohen, që bëhet nga një organ zyrtar ose nga një i ngarkuar”; “organi zyrtar që bën këtë punë”; “kontroll i rreptë që i bëhet dikujt a diçkaje për të mos vepruar a për të mos qënë në kundërshtim me kërkesat”; POLITIKË / ADMINISTRATË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CENSUROJ (nga “censor”) për “Shqyrtoj e kontrolloj përmbajtjen e veprave para se të botohen a të shfaqen ose të letrave, të telegrameve para se të dorëzohen”; POLITIKË; FOLJE; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CENTAUR (nga “centaur”) për “Figurë e mitologjisë greke, që përfytyrohej si një qenie, nga mesi e sipër si burrë e nga mesi e poshtë si kalë”; “automjet gjigant 40 tonësh”; TRANSPORT / TEKNIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

CENTIGRADË (nga “centigrade”) për “Një e qindta pjesë e gradës”; SPECIALITET; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CENTIGRAM (nga “centigrade”) për “Një e qindta pjesë e gramit”; SPECIALITET; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CENTILITËR (nga “centiliter”) për “Një e qindta pjesë e litrit”; SPECIALITET; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CENTIMETËR (nga “centimeter”) për “Një e qindta pjesë e metrit”; SPECIALITET; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CENTRIST (nga “centrist”) për “Pasues i centrizmit”; “anëtar i një partie centriste ose i një grupi centrist”; POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CENTRIZËM (nga “centrism”) për “Qëndrim politik në mes krahut të majtë dhe krahut të djathtë në një parti ose në mes partive të majta e të djathta”; POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CEREMONI (nga “ceremony”) për “Veprime kremtuese a përkujtimore që kryhen me rastin e një ngjarjeje të shënuar; festim”; “kremtim”; “mënyrë e përpunuar dhe e stërholluar e sjelljes, që shoqërohet me etiketë të tepruar”; SHOQËRI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

CEREMONIAL (nga “ceremonial”) për “Që ka të bëjë me ceremoninë, i ceremonisë”; “që bëhet me ceremoni, që shoqërohet me ceremoni”; “që bëhet me një mirësjellje të stërholluar, që shoqërohet me një etiketë të tepruar”; “që bëhet sa për etiketë”; SHOQËRI; MBIEMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CEREMONIAL (nga “ceremonial”) për “Tërësia e veprimeve, që bëhen sipas një rendi të caktuar, me rastin e një ceremonie”; SHOQËRI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CERTIFIKATË ose ÇERTIFIKATË (nga “certificate”) për “Shkresë, që e lëshon një zyrë për të dëshmuar vërtetësinë e një fakti ose të një veprimi zyrtar”; “dokument që e lëshon një shkollë a një kurs për të vërtetuar mbarimin e studimeve”; “vërtetim”; “dëshmi”; ADMINISTRATË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

CEZIUM (nga “cesium”) për “Metal alkalin shumë, i butë, me ngjyrë të bardhë si të argjendit, që përdoret në qelizat fotoelektrikë dhe në gypat e ndriçimit”; KIMI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CEZURË (nga “caesura”) për “Pushim i shkurtër brenda një vargu gjatë leximit, që bëhet në një vend të caktuar, sipas metrit, për të theksuar me mirë ritmin”; “pushim që shënon vendin e ndarjes së ritmit në një melodi”; LETËRSI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CIA (nga “Central Intelligence Agency”) për “Agjencia Qëndrore e Zbulimit”; ADMINISTRATË; TOGFJALËSH EMËROR; GRAMATIKOR / LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

CICERON (nga “cicerone”) për “Ai që shoqëron vizitorët dhe u jep shpjegime”; “shpjegues”; MUZE; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

CRUCIAL (nga “crucial”) për “Vendimtar”; “thelbësor”; “palcor”; “kritik”; SHOQËRI; MBIEMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

Ç

ÇARTER (nga “charter”) për “Avion me porosi”; TRANSPORT / TEKNIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

ÇEK (nga “check”) “Urdhërpagesë e shkruar sipas një modeli të caktuar, me të cilën dikush ka të drejtën të tërheqë nga banka ose nga arka një shumë të caktuar prej llogarisë së ndërmarrjes, të institucionit ose të përsoneit që e ka lëshuar këtë dokument në emër të tij”; EKONOMI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

ÇEKAUT (nga “check-out”) për “Çregjistrim nga hoteli duke shlyer pagesat”; SHËRBIME; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

ÇEKIN (nga “check-in”) për “Regjistrim”; SHËRBIME; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

ÇERTIFIKOJ (nga “certify”) për “Autorizoj me shkrim”; “pajis me dokument”; DREJTËSI; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

ÇET (nga “chat”) për “Bisedë”; “fjalosje”; INTERNET; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

ÇIPS (nga “chips”) për “Patatina”; USHQIM; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

ÇIZBURGER (nga “cheeseburger”) për “Simite me djathë”; USHQIM; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

D

DABËLLJU (nga anglishtja “w”) për “Shkronja e njëzetetretë e alfabetit të anglishtes”; GJUHËSI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

DEBAT (nga “debate”) për “Rrahje mendimesh ndërmjet dy a më shumë vetave rreth një çështjeje”; “diskutim i gjerë, i hapur për një çështje me rëndësi”; SHOQËRI / POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

DECENTRALIZËM (nga “decentralism”) për “Sistem i qëverisjes, i drejtimit e i organizimit politik, ekonomik etj., që mbështetet në shpërqëndrimin e pushtetit dhe sipas të cilit një pjesë e funksionëve të pushtetit qëndror u kalon organëve më të ulëta”; “zgjerimi i së drejtës së organëve më të ulëta për të qëverisur vetë”; “shkëputja e organëve më të ulëta nga organët më të larta ose qëndrore”; “mohim a dobësim i centralizmit”; POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DECENTRALIZIM (nga “decentralisation”) për “Shpërqëndrim”; POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DECENTRALIZOJ (nga “decentralise”) për “Ia kaloj një pjesë të funksionëve të pushtetit qëndror organëve më të ulëta, zgjeroj të drejtat e organëve më të ulëta”; “shkëput organët më të ulëta nga organët më të larta ose nga ato qëndrore”; “dobësoj centralizmin”; “shpërqëndroj”; POLITIKË; FOLJE; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DECIZIV (nga “decisive”) për “Vendimtar”; SHOQËRI / EKONOMI / POLITIKË; MBIEMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DEFECT (nga “defect”) për “E metë”; “mungesë”; “cen”; SHOQËRI / EKONOMI / POLITIKË; MBIEMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DEFINICION (nga “definition”) për “Përkufizim”; “përcaktim”; SHOQËRI / EKONOMI / POLITIKË / FILOZOFI / GJUHËSI / LETËRSI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DEKONFLIKTOJ (nga “deconflict”) për “Shmang përplasjen e mjeteve fluturuese”; USHTRI; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DEKORUAR, I/E (nga “decorated”) për “I veshur” (me ar); ARTIZANAT; MBIEMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DEKRET (nga “decree”) për “Akt i shkruar i një organi të lartë të pushtetit shtetëror ose i kryetarit të shtetit, që ka fuqi ligjore”; LEGJISLACION; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

DEKRETOJ (nga “decree”) për “Lëshoj një dekret, vendos për diçka me anë të një dekreti, urdhëroj me dekret për diçka; i jap fuqi ligjore diçkaje”; LEGJISLACION; FOLJE; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

DENIGROJ (nga “denigrate”) për “Errësoj, zvogëloj a ul me qëllim vlerat e dikujt a të diçkaje, duke shpifur e duke folur keq për të, e nxij dikë a diçka përpara të tjerëve”; “përgojoj”; SHOQËRI; FOLJE; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DENONCOJ (nga “denounce”) për “Njoftoj organët përkatëse për diçka që kam gjetur, që kam zbuluar ose që kërkohet, që duhet t’i nënshtrohet kontrollit shtetëror”; “njoftoj organët përkatëse shtetërore për veprimtarinë armiqësore a të kundërligjshme të dikujt”; “kallëzoj”; “shpall si të pavlerë e të pafuqi një traktat, një marrëveshje etj., që kam pasur me një shtet tjetër a me disa shtete”; “bëj të njohur botërisht qëndrimin tim kundër një vendimi a veprimi të dikujt”; “hedh poshtë a dënoj botërisht”; DREJTËSI / SHOQËRI / POLITIKË; FOLJE; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

DEPRESSION (nga “depression”) për “Rënie” (ekonomike); “mërzi”; EKONOMI / MJEKËSI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DERBI (nga “derby”) për “Ndeshje e rëndësishme sportive”; “kryendeshje”; SPORT; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

DESK (nga “desk”) për “Redaksi”; SPECIALITET; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DESPOT (nga “despot”) për “Sundimtar me pushtet absolut e të pakufizuar”; “sundimtar feudal, në një krahinë të caktuar, i cili varej nga mbreti a nga përandori dhe nuk qëveriste në bazë të ligjeve, por vepronte në mënyrë arbitrare pa përfillur fare dëshirat e vullnëtin e popullit”; “titull i lartë në hierarkinë feudale”; “tiran”; POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

DESPOTAT (nga “despotat”) për “Shtet a krahinë që sundohej nga një despot”; POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

DESPOTIK (nga “despotic”) për “Që lidhet me atë formë qëverisjeje ku gjithë pushteti është në duart e një sundimtari absolut, që bazohet në despotizëm”; “tiranik”; “shtypës”; POLITIKË; MBIEMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DESPOTIZËM (nga “despotism”) për “Formë qëverisjeje që bazohet në sundimin e një monarku a të një njërii të vetëm me pushtet të pakufizuar e absolut”; “sundim arbitrar e i egër me anë të dhunës e të shtypjes”; “tirani”; Politikë; Emër; Leksikor; I qëndrueshëm; I panëvojshëm; Libror.

DETERMINIM (nga “determination”) për “Vendosmëri”; SHOQËRI / POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DETERMINOJ (nga “determinë”) për “Përcaktoj”; “kushtëztoj”; SHOQËRI / POLITIKË / EKONOMI; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DIFERSIFIKOJ (nga “diversify”) për “Ndryshoj”; “i jap larmi”; “shumëfishoj”; “zgjeroj” (veprimtarinë); “shpërndaj” (investimet); SHOQËRI / POLITIKË / EKONOMI; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DIGITRON (nga “digit”) për “Telekomandë”; TEKNIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DIKLIN (nga “decline”) për “Tatëpjetë”; “rënie”; “keqësim”; “ulje” (çmimi); “dobësim”; “përendim”; “kalbëzim”; SHOQËRI / POLITIKË / EKONOMI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DILER ose DILLER (nga “dealer”) për “Matrapaz”; TREGTI; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DIMENSION (nga “dimension”) për “Përmasë”; “shtrirje”; FIZIKË / SHOQËRI / POLITIKË / EKONOMI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DIPENDENCË (nga “dependence”) për “Varësi”; SHOQËRI / POLITIKË / EKONOMI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DIPENDOJ (nga “depend”) për “Varësoj”; SHOQËRI / POLITIKË / EKONOMI; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DISK (nga “disk”) për “Pllakë e rrumbullakët prej druri, e mbështjellë për qark me një rreth metali, e cila flaket larg nga atletët”; “pllakë” (gramafoni, magnëtofon, televizori, kompjuteri); SPORT / TEKNIKË /; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

DISKO dhe DISKOTEKË (përkatësisht nga “Disco” dhe “discotheque”) për “Klub nate intim me muzikë argëtuese të regjistruar ose të gjallë”; ELEKTRONIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

DISKONT (nga “discount”) për “Zbritje”; “ulje”; TREGTI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

DISK-XHOKEJ ose DI-XHEJ (nga “DJ”, shkurtesë e togut “disk-jockey”) për “Përzgjedhës muzike në diskoteka, që komenton dhe krijon atmosferë gazmore”; TEKNIKË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR / BISEDOR.

DISPEÇER (nga “dispatcher”) për “Teknik që rregullon lëvizjen e mjeteve të transportit, shpërndarjen e lëndës së parë ose të prodhimit në një ndërmarrje etj., duke qëndruar në një vend të caktuar”; “aparaturë automatik që bën punën e këtij tekniku”; “nëpunësi që u jep udhë trenave,

autobusëve” etj.; SPECIALITET; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

DISTRIBUTOR (nga “distributor”) për “Shpërndarës”; “firmë shpërndarëse”; SPECIALITET; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DIVIZION (nga “division”) për “Ndarje”; “shpërndarje”; “pjesëtim”; “vijë” (ndarëse); “kufi”; “përçarje”; “sektor”; “divizion”; SHOQËRI / USHTRI / ADMINISTRATË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DIXHITAL (nga “digital”) për “Gishtar”; “shifror”; MATEMATIKË / INFORMATIKË; MBIEMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

DIZAJN (nga “design”) për “Faqsje”; TIPOGRAFI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DIZAJNËR (nga “designër”) për “Faqsës”; TIPOGRAFI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DIZAJNIM (nga “designing”) për “Faqsje”; TIPOGRAFI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DIZAJNOJ (nga “design”) për “Faqs”; TIPOGRAFI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DJUTI-FRI-SHOP (nga “Duty-Free Shop”) për “Dyqan në vendkalimet kufitare, ku malli shitet duke zbritur taksën doganore”; SPECIALITET; TOGFJALËSH EMËROR / EMËRTIM; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

DOMINANCE (nga “dominance”) për “Mbizotërim”; “sundim”; SHOQËRI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DOMINIM (nga “domination”) për “Sundim”; SHOQËRI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DOMINOJ (nga “dominate”) për “Sundoj”; SHOQËRI; FOLJE; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DOPING (nga “doping”) për “Lëndë narkotike që u jepet sportistëve për stimulim, që të arrijnë rezultate të mira”; MJEKËSI / SPORT; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

DRAFT ose DRAJFT (nga “draft”) për “Paraprojekt”; SHOQËRI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DRAGSTOR (nga “drugstore”) për “Kinkaleri”; TREGTI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

DRES (nga “dress”) për “Veshje sportive”; VESHMBATHJE; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

DRIBLER (nga “dribbler”) për “Lojtar që mashtron kundërshtarin përmes përdorimit të përkryer të topit në futboll”; SPORT; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

DRIBLING (nga “dribbling”) për “Mashttrim i lojtarit kundërshtar dhe kalim i topit ndërmjet këmbëve”; SPORT; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; BISEDOR.

DUALIST (nga “dualist”) për “Ithtar a përkrahës i dualizmit”; FILOZOFI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

DUALIZËM (nga “dualism”) për “Doktrinë filozofike, e cila pohon se bota e të gjitha dukuritë e kanë burimin e tyre te dy baza fillestare të pavarura, që mohojnë njëra-tjetrën, te materia e ideja, te qënia e ndërgjegjja”; “qënia e dy gjërave, e dy cilësive a e dy anëve të ndryshme, që bien ndesh njëra me tjetrën ose kundërshtojnë njëra-tjetrën”; “besimi se ekzistojnë dy baza fillestare – e mira dhe e keqja, drita dhe errësira, trupi dhe shpirti, tokësorja dhe qiellorja”; “sistem i qëverisjes, ku klasat sunduese të dy kombeve më të mëdha bashkohen nën pushtetin e një monarku të vetëm e veprojnë në mënyrë mjaft të pavarur”; FILOZOFI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

DUBLIKATË (nga “duplicate”) për “Kopje e dytë e një dokumenti zyrtar, që ka fuqinë juridike të origjinalit”; ADMINISTRATË; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

DUKAT (nga “ducat”) për “Monëdhë e vjetër prej argjendi dhe më vonë prej ari, që përdorej në disa vende të Evropës Përendimore”; “ar”; SPECIALITET; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

DUKË (nga “duke”) për “Titull i lartë aristokratësh, më i ulët se ai i princit”; “sundimtari i një dukate”; “ai që mbante këtë titull”; HISTORI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

E

EFFORT (nga “effort”) për “Mundim”; “përpjekje”; “orvatje”; SHOQËRI / EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

EFICENSE (nga “efficiency”) për “Efektshmëri”; “efikasitet”; “prodhimtari”; SHOQËRI / EKONOMI / POLITIKË; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

EGZIBICIONIST (nga “exhibitionist”) për “Shitamendës”; “përfushës”; SHOQËRI; EMËR; LEKSIKOR; I PAQËNDRUESHËM; I PANËVOJSHËM; LIBROR.

EKLIPS (nga “eclipse”) për “Errësim i përkohshëm i një trupi qiellor kur zihet nga një trup tjetër”; “qiellzënie”; ASTRONOMI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

EKLIPSOJ (nga “eclipse”) për “I del përpara një trupi tjetër qiellor dhe e zë a nuk e lë të duket për një farë kohe, shkakton eklipsin e një trupi qiellor”; “e errësoj a e zbeh punën, vlerën ose lavdinë e dikujt, ia ul rëndësinë a vlerën”; “i hedh hije dikujt ose diçkaje”; “ia kaloj dikujt”; ASTRONOMI / SHOQËRI; FOLJE; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

EKOLOGJI (nga “ecology”) për “Degë e biologjisë, e cila studion marrëdhëniet e ndërsjella të qënieve të gjalla të botës bimore e shtazore me mjedisin ku jetojnë”; BIOLOGJI; EMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

EKOLOGJIK (nga “ecologic”) për “Që ka të bëjë me ekologjinë”; “që lidhet me mjedisin ku jetojnë qëniet e gjalla”; BIOLOGJI; MBIEMËR; LEKSIKOR; I QËNDRUESHËM; I NËVOJSHËM; LIBROR.

